

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-31
K14

ISMAIL
KADARE

NENTORI
I NDE
KRYEQTETI

ROMAN

8JH-37
K 14

ISMAIL KADARE

NËNTORI I NJË KRYEQYTETI

R o m a n



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

«Ouua, oooua, ouaaa...»
«Qfarë thotë ai, c'lajm po jep?»
«Ka erë. S'dëgjohet asgjë.»
«Mbani vesh!»
«Oooua, ouuuua, uuuu. . .»
«S'dëgjohet asgjë.»

(Nga britmat e fshatarëve
nga një breg në tjetrin.).

KAPITULLI I PARË

Telat me antenën e Radiostacionit ata i panë për herë të parë ndaj të gdhirë. Ishte ftohtë. Në sfondin e përhimë të qillit ato u ravijëzuan në fillim trubull, pastaj gjithmonë e më shkoqur, një grumbull vijash të drejta metlike, sipër tarracës së lagur, ca tangente e hipotenuza të nderura pa mëshirë në shi dhe sipër tyre një tufë spiralesh që synonin si shpirtra drejt qillit.

— Ja ku është, — i pëshpëriti Javeri mu te veshi partizanit Sherif Gorenin.

— Ku?

— Ja, atje, lart.

— Aha, e shoh.

Me bisht të syrit Javeri vështroi një copë herë ftyrën e kuqërreme prej fshatari të Sherifit me ata flokë tē zberdhulur, që, tē rënduar nga vesa, ngjanin tanë me kashtë tē lagur. Ai donte tē kuptonte se ç'pershtypje do t'i bënte atij pamja e Radiostacionit, por ftyra e fshatit kishte mbetur e ngrirë, si përparrë një misteri.

Para njëzet e katër orësh njësiti i tyre kishte marrë urdhrin që, gjatë sulmit të Brigadës në bulevardin «Musolini», të pushtonte Radiostacionin. Gjatë gjithë mbasditës së djeshme dhe pastaj, pothuaj gjatë gjithë natës, njësiti, duke përparuar ngadalë midis fortinove gjermane, rrugicë më rrugicë, dhe duke lënë pas një gjurmë të përgjakur, i qe afruar brinjazi bulevardit «Musolini»,

gjersa kishte dalë më në fund në krahun e tij të majtë.
Aty ishte groposur në pozicion.

— E, si të duket? — pyeti Javeri.

Sherif Gorenit ngriti supet. Në të vërtetë atij nuk do t'i mbushej mendja kurrë se ajo ndërtesë, vetëm se kishte ca tela të tendosur e të spërdredhur përsipër, mund të ishte vërtet ndërtesa më e rëndësishme në gjithë bulevardin «Musolini», siç u kishte thënë një ditë më parë komisari. Tani që po zbardhë dita, syri i Sherifit po dallonte qoshe godinash të bukura, kopshtet, xhamillëku apo shatërvanet e të cilave ngjanin edhe më të mrekullueshme, ngaqë dukeshin vetëm pjesë-pjesë. S'ka se si që kjo ndërtesë biçimsëze, vetëm për ca tela që ka sipër saj, të jetë më e rëndësishme se ato, kishte thënë me vete Sherifi, me qejf të prishur, por nejse, komanda ua bën qejfin të gjithëve. Dil një kasolle përrpara, o burra, se kjo është ndërtesa më e rëndësishme, dil një tjetër, pritni, se s'qe ajo, po është kjo. Nejse, tha ai me vete, në fund të fundit të gjitha duhen çliruar, por pse të mos na i thonë troc: kjo që keni përrpara është një ahur që s'i hyn në punë askujt, megjithatë duhet marrë me sulm, sepse kështu duhet, dhe pikë. S'ka nevojë të më përrallisësh jo po është ndërtesa më e rëndësishme, jo po ka ca vlera e ca shejtanllëqe. S'më duhen mua ato. Unë për herë të parë u plagosa të një drithnik i boshatisur. Kishte atje ca misra e ca kashtë të kalbur. Asgjë tjetër. Po, vallë, mos më rainderi mua që desh lashë kokën te një karakatinë?

— He, — ia bëri Javeri, duke treguar me kokë nga Radiostacioni, — nuk ta mbush syrin?

Sherifi e përvodhi me sy, duke u përpjekur të kuptonte nëse tjetri kishte ndër mend të tallej. Qepallat e tij të kuqërrrema ishin ndezur qysh tani nga zemërimi. Mirëpo fytyra thatime, gjatuce e Javerit, me ata flökë të çelët, tepër të hollë, që dukej sikur ia kishte lëpirë kalmthi një gjuhë lope, e mbante vështrimin në një largësi përtëj çdo sherri të mundshëm. Drita e kuqërrreme e qepallave të Sherifit u shua sakaq.

— Të them të drejtën, s'ma mbush synë, — tha.

— Ke të drejtë, — u përgjigj Javeri, pa i hequr sytë nga largësira. — Sikur të kishte sipër ndonjë mu-llar, ose, për shembull, ndonjë lopë që kulloste, ndry-shonte puna, por...

— Pizeveng, — shkrofëtiu Sherifi.

Javeri gjelltiti të qeshurën me një zhurmë që ishte midis teshtimës dhe lëmzës.

Sherifi i ktheu shpinën. Pizevengu, tha me vete, më prishi gjakun që pa gdhirë. Po ke faj vetë, or hajvan, që plekshesh me të.

Deshi ta hiqte mendjen duke vështruar përtej bu-levardin «Musolini», por nga zemërimi i dukej sikur gjithë bulevardi tallazitej.

Kishte gdhirë. Mbi trotuaret e shkreta vërtiteshin gjethë të thara, tepër të mëdha. Të tilla gjethë, avda-lle, të rënduara nga pluhuri si nga reumatizmi, mund të gjesh vetëm në qytet, mendoi Sherifi. Ashtu si të tillë pizevengë, si Javeri, tha me vete pas pak.

Javeri e ngacmonte prej kohësh. Sa herë që kishte vendosur Sherifi të mos i fliste me gojë, aq herë e kish-te kuptuar se megjithatë nuk ndahej dot prej tij. As vetë nuk e kuptonte, se me çfarë e kishte bërë për vete ky «pizeveng qyteti». Ndoshta kjo kishte filluar që nga dita e parë kur Javeri erdhi në batalion, me atë fytyrën e tij gjatuce, të verdhë dyllë e të lidhur me fasho në një mënyrë qesharake. Në të vërtetë njojja e parë e parti-zanëve me të porsaardhurin kishte qenë disi e jashtë-zakonshme. Disa ditë më parë se ai të vinte në mal, një aeroplan i ngathët, me ca turinj të shtypur, duke flutu-ruar sipër katundtheve të ciknosura nga dimri, hidhët ca letra të shtypura, ku tregohej se si një komunist i ri me emrin Javer Kurti kishte vrarë xhaxhanë e vet ballist në bukë e sipër. Kur pas një javë u fol se ai ilegal i ri kishte mundur t'u ikte milicëve dhe porsa kishte mbë-rritur në batalion, partizanët qenë bërë kureshtarë për ta njojur. Dino Sinojmeri, komandant kompanie, për të cilin thuhej se e njihet mitologjinë greke më mirë se hatullat e shtëpisë së vet, i kishte thënë kur ia sollën në kompani: Ti, more djalë, përpara se të na vish me

këmbë nëpër tokë, na ke zbritur nga qielli si Zeusi, në formë fletushkash. Si shumë lart e ke zënë. I porsaardhuri, ngaqë s'dinte ç'të thoshte, lëvizte supet. Sherifit i ishte mbledhur një lëmsh në gjoks, kur kishte parë duart e tij të dobëta, koskëholla, që përpinqeshin të rregullonin disi fashon e shtrembëruar. Milicët e kishin rrahu keq. Po ku janë ato duar për t'i goditur, si krahë lejleku, kishte thënë me vete dhe kishte rrëmbushur sytë Sherifi. Që atëherë se si ishte lidhur me të. Herë-herë e tregonte hapur dhemshurinë e tij, mirëpo, me sa duket, pikërisht këtë gjë Javeri nuk e duronte dot dhe ndoshta një nga shkaqet që e ngacmonte, ishte tamam frika se mos Sherifi bënte ndonjë shfaqje të re dhemshurie.

Nuk do t'i flas më, kjo punë mori fund, thoshte me vete Sherifi. Kurse në një thellësi më të madhe ai i përgjigjej vetës: Do t'i flasësh që ç'ke me të, or buf. Do t'i flasësh si gjithmonë dhe ai gjithmonë do të tallet me ty dhe ti nuk do të shpëtosh kurrë prej tij.

Gjithmonë, përsëriti ai me trishtim. Kur Javeri kishtë gjetur kohën ta ngacmonte, një ditë më parë, dhe pikërisht në çastin kritik, kur po kalonin nëpër sheshin e qendrës, nën plumbat e gjermanëve, kjo do të thoshte se ai do ta bënte këtë gjithmonë.

Sherifit i erdhi ndër mend mbasditja e djeshme. Ishte vërtet një mbasdite skëtëerre. Kishin disa ditë që luftonin brenda në qytet, kishin marrë me sulm lloj-lloj ndërtesash, hotele, kinema, depo mallrash, por ishte hera e parë që po i afroheshin qendrës së kryeqytetit. Kishte ditë që fjala «qendër» shqiptohej nga të gjithë në një mënyrë të veçantë. Ajo fjalë provokonte në trurin e Sherifit gjithfarë përfytyrimesh kaotike. Ku është, ku? pyeste ai herë pas here. Është më tutje, më larg, i përgjigjeshin dhe, siç ndodh gjithmonë me gjérat që fillojnë e zhvendosen para teje (Sherifit i dukej se qendra ikte dhe ikte gjithmonë prej tij), përfytyrimi për të sa vente dhe bëhej më i rafinuar. Por në mbasditen e djeshme, tamam në çastin kur porsa e kishin kapërcyer një udhë-kryq nën një breshëri predhash të paparë ndonjëherë, Javeri që zvaritej përbri tij, bashkë me pushkën e rëndë

antitank, që e têrhiqtë branazi përtokë, i kishte pëshpëritur: Ja qendra. Ku, ku, kishte thirrur si nëpër gjumë Sherifi, dhe Javeri i kishte treguar me kokë përparrë. Ishte një shesh i madh, jashtëzakonisht i madh, i rrëthuar nga ndërtesa masive, me dekoracione të rënda, me dyer të zeza metalike dhe me koka statujash të gdhendura nëpër qoshe. Ato janë pallatet e ministritëve, i shpjegonte Javeri, kurse më tutje, ajo ngrehina e madhe përballë është Bashkia, dhe nga e majta, e sheh atë pallatin e kuq, me kangjella të hekurta, është Banka e Shtetit. Të tjerat Sherifi i kuptonte vetë. Në skajet e sheshit dukeshin fortino gjermane. Në mes, një tank i ngulur në tokë rrrotullonte kullën e tij të çeliktë me grykën e gjatë të topit në të gjitha drejtimet. Tanku ngjante si një ulok i tmerrshëm pa këmbë. Sheshi dukej edhe më i gjerë, ngaqë ishte i shkretë. Herë pas here mbi atë si-përfaqë betoni gri, nga të çarat ngërdheshëse të fortinove fluturonin predha dhe plumbë si një erë vdekjeje mbi një shkretëtirë. Njësiti partizan duhej të kapërcente përtëj, duke u zvaritur nëpër skajin juglindor të sheshit, për të dalë në një rrugë paralel me bulevardin «Musolini». Ishte pikërisht skaji që në atë çast goditej më dendur prej gjermaneve, që, siç dukej, e kishin diktuar lëvizjen e njësitet. Në një rast tjetër njësiti do të përpinqej të groposej, por përreth kishte vetëm beton dhe asfalt dhe, veç kësaj, urdhri ishte që njësiti të përparonte me çdo kusht në drejtim të bulevardit «Musolini». Breshëria e predhave sa vente dendësohej, gjersa erdhi një çast dhe ajo u shndërrua në një shi skëtëerre. Megjithatë kishte edhe më keq, mund të arrinin tanket, prandaj komandanti dha urdhër të fillonte lëvizja për të kapërcyer matanë. Ata filluan të zvariteshin në një vijë zigzage, duke u përpjekur të shfrytëzonin si mbrojtje rrëthojën granitike të një shatërvani dhe piedestalin e një monumenti. Në të vërtetë ato ishin larg, por megjithatë herë pas here mbulonin pamjen e fortinove dhe të tankut.

Sherifi zvaritej përbri Javerit, duke têrhequr pas vetes mitralozin e rëndë. Në mënyrë mekanike, si të komanduar nga një sustë, ata ulnin ritmikisht kokat, si për

të lejuar kalimin e plumbave përbri. Sherifi ndiente poshtë trupit, dhe sidomos në bërrylat, betonin e fortë të sheshit. Në kokën e tij mendimet ishin të thjeshtuara dhe të ngathëta. Po kalojmë nëpër qendër, tha ai me vete ishte e vërtetë. Në një çast iu duk se kjo rrafshirë e patë hekurta ndërtesash qeveritare, ishte vetë shpina e shtetit, mbi të cilën tanë ai po zvaritej. Ata ishin në qendër, pra midis shtetit dhe, si ndëshkim për këtë, si ndëshkim që kishin guxuar të shkelnin në vendin e ndaluar, që rrëfejnë përrallat e shtrigave, ata po kositeshin nga vdekja. Jemi midis shtetit, tha ai me vete. Asnjëherë në kokën e tij kjo fjalë nuk kishte dalë kaq shkoqur nga mbretëria e abstraksionit për të marrë me shpejtësi formën konkrete të një rrafshi të lëmuar, mbi të cilin era e ngrirë dimërore zvariste copëra afishesh nga shfaqjet e fundit të një rendi, urdhra qeverish, orare tashmë të vdekura, lajmërimi për shtetrrethim. Për një çast vështrimi i kapi statujën, që ngjante me një të marrë të verbër, që s'gjente dot rrugën për të dalë nga kjo batërdi. Është statutja e një matufi pa vlerë, i kishte thënë pak përpëra Javeri. «U vra Beluli», tha dikush pas tij. Sherifi kafshoi buzën e poshtme. Një copë herë u bë petë me tokën, pastaj u zvarit më tutje. U rrrotullua me shpejtësi në brinjë për të kapërcyer një gjysmë metër vend që, kushedi pse, iu duk se ishte fare i zbuluar. Gjatë rrrotullimit, për një sekondë, i zunë sytë sipër kokës një orë të madhe që varej ogurzezë midis qiellit. Iu kujtua se në shesh kishte një orë. A është e mundur që ajo të punojë midis këtij ferri, pyeti veten. Është e mundur, mendoi. «Sahati duhet të punojë gjithmonë, — thoshte gjyshja e tij, — sepse secili ka kohën e tij për të jetuar dhe kohën e tij për të vdekur». Ku dreqin ma zuri syri atë orë?, mendoi. Iu duk se ajo rrinte e varur mbi atë shesh për të matur sekondat e jetës së tyre. Ora ime, tha ai me vete, si i mpirë. Mos po bie ora ime? Por në çast e dëboi atë mendim dhë u shty përpëra. «U vra Fredi», tha një zë përbri. Ah, ia bëri Sherifi me vete, shesh i mallëkuar! Gjys-

mëtanku rrotullonte pa pushim kullën e tij të hekurt. Sherifit i shkoi nëpër mend se, sikur të ishte një tank tamam, ai do të dukej ndoshta më pak i tmerrshëm se kështu siç ishte, ulok, i kruspullosur në vend si nga një damblla. Në fshatin e tyre tregonin për një ulok të tillë, një farë Tosun agai, që ishte bërë kob i farefisit, sepse, ashtu i ngujuar në tokë siç ishte, i urdhëronte dhe i torturonte të gjithë, duke tundur vazhdimi shët me kërcënëm një shkop të gjatë plot me mbishkrime turke.

Sherifi u zvarit më tej. Përbri tij dalloj profilin e bryllët të Teutës. Kujdes, Teuta, tha me vete. Ai vuri faqen e majtë pothuaj puq me tokën, sepse kështu i dukej se zvogëlonte lartësinë e kokës. Syri i tij i djathjtë pa përsëri statujën. Ndërsa herën e parë i qe dukur sikur ajo po largohej prej tyre, tani iu duk se po avitej. Ishte tamam një i marrë me rroba bronci. Tani veshi i Sherifit dallonte breshëritë e shkurtra, të shpeshta të fortinove, nga e shtimja e rëndë, pak më e rrallë e qenies së kobshme gjysmatank-gjysmabunker. Shtjer, Tosun aga, shtjer, qen bir qeni, murmuriti Sherifi, duke kërcellitur dhëmbët. Një forcë e padukshme u mëshonte brrylave, qafës, gjithë trungut të tij, për të shtrënguar muskujt e për t'u zvaritur në drejtim të ulokut, mirëpo urdhri ishte i prerë: asnjë nga partizanët e njësitet, në çfarëdo rrethane qoftë, nuk do të sulmonte fortinot e sheshit e sidomos tankun. Detyra e njësitet ishte të pushtonte Radio-stacionin dhe të gjitha forcat e tij duhej t'i ruante përkete. Veç kësaj, shumë partizanë që ishin përpjekur të sulmonin gjysmëtankun, ishin vrarë prej tij, prandaj pritej të vinin skuadra speciale të stërvitura posaçërisht për këtë punë, që ta shkulnin që andej përbindshin. Sherifi dalloj prapë Teutën që zvaritej pak përpara tij. Tregonin se Tosun agai, përpara se të vdiste, kishte vrarë një nga nuset e shtëpisë. Kjo kishte ndodhur në fund fare, në prag të vdekjes, kur atij s'para i bindeshin më, dhe ai e kishte joshur nusen pranë me zë të ëmbël, pastaj, kur ajo i qe afruar aq sa ta arrinte shkopi, e kishte goditur me të dhe e kishte lënë të vdekur në vend. Kujdes, Teutë, përsëriti me vete Sherifi.

«Ja Pirrua i Epirit», i pëshpëriti mu në vesh Javeri, që zvaritej përbri. «E shikon Pirron e Epirit?» dhe bëri me sy nga një ndërtesë e lartë.

«Ku?» tha Sherifi, që kujtoi se tjetri i tha për një farë Pirro Bakiri nga kompania e katërt.

«Te dritarja e qoshes, ai me helmetë në kokë.»

Sherifi mbeti pa mend. Si qenkësh ngjitur Pirro Bakiri në dritaren e ministrisë dhe, veç kësaj, me një helmetë në kokë?

Ata shkëmbyen disa herë fjalët «si», «ku», «nuk e shikon», «ajo koka me helmetë», gjersa Javeri mbyti nën vete një të qeshur, mbi të cilën ai dukej sikur kishte rënë përmbyss si mbi një dhëlpër. Ahere Shérifi e kuptoi se ishte fjala për një nga ato kokat e gdhendura në kolonat e ndërtesës.

«Pizeveng» vërvëllës nëpër dhëmbë. «Edhe këtu e gjete të më ngacmosh? Pizeveng qyteti.»

Sherifi u platis përdhe dhe gjatë zvaritjes së pastajme u përpoq të largohej sa më shumë prej Javerit.

Pas kapërcimit të sheshit dhe në orët e pastajme të natës, kur ata përparuan rrugicave, nëpër një errësirë që cirrej aty-këtu nga pika dhe vija zjarri, Sherifi e harroi plotësisht talljen. Mirëpo tani që Javeri e ngacmoi përsëri, iu rikujuan të gjitha.

Pse s'më lë të qetë, pizevengu, përsëriti ndoshta për të dhjetën herë. Tani kishte gdhirë plotësisht dhe ai u përpoq ta hiqte mendjen nga Javeri, duke vështuar drurët në trotuarin e mesmë të bulevardit. Nga era e ftohtë ata përkuleshin vazhdimi shëndetësish në një drejtim, bëheshin si me shpinë, si me pelerinë shtegtarë, saqë, kur era pushonte një grimë dhe ata drejtobështin në vend, të vinte çudi se si nuk kishin lëvizur më tutje. Sherifit i shkoi nëpër mend se nuk paskesh gjë më të trishtuar në botë se drurët e një bulevardi dimëror si ky këtu.

Në të vërtetë edhe ai vetë e ndiente veten pak të huaj këtu dhe pikërisht ky ishte shkaku, që ndijshmëria e tij ndaj ngacmimive të Javerit ishte rritur shumë, që kurse kishin hyrë në Tiranë. Ai ishte këtu, në një farë mënyre, mysafir, ashtu sikurse Javeri ishte, në një farë

mënyre, zot shtëpie, prandaj Javerit, më pak se kurdoherë, i përkiste ta ngacmonte. Maleve dhe fshatrave Sherifi nuk e çante kokën fort për ngacmimet e Javerit, bile dukej sikur ai kishte qejf të ngacmohej prej tij, madje, kur Javeri e tepronë, kthehej edhe ai për të marrë hak. Në të vërtetë, përvëç fjalëve «djalë i mamasë» dhe «pizeng» (bile edhe këto i kishte huajtur nga një skeç partizan), Sherifi, me gjithë përpjekjet që kishte bërë, nuk kishte gjetur dot ndonjë ngacmim më të madh. Më në fund, ai e kishte kuptuar se jo vetëm nuk ishte grindës, por nuk ishte i aftë të ngacmonte asnjeri dhe prandaj kishte hequr dorë përfundimisht nga kjo gjë.

Në bulevard era vazhdonte të përkulte drurët pa mëshirë. Të shkretët drurë! tha ai me vete dhe në çast i erdhën ndërmend mollët e fshatit të tij. I përfytyroi një copë herë, duke i krahasuar me drurët e bulevardit, pastaj tha me vete: Shyqyr që janë atje larg! Ato gjithashtu do të ishin të huaja këtu, midis këtyre drurëve vagabondë, beqarë të vjetër, të mësuar me gjithfarë kodoshllëqesh të qytetit. Ndër mënd i vetëtui një vajzë jetime nga fshati, një farë Hyrije, që iku në qytet dhe u bë grua e përdalë. Hm, qeshi me vete, ku nuk më vete mendja, dhe donte të mendonte prapë për mollët, por diçka e pengonte. Diku, nga veriperëndimi i qytetit, filluan të gjëmonin prapë topat. Njësiti, i fshehur prapa murit të një depoje manifakturash, në të cilin një pjesë e partizanëve po hapnin me qysqi vrima dhe të çara, për të vendosur mitralozat dhe pushkët antitanke, nuk ishte zbuluar, siç dukej, akoma nga gjermanët. Bulevardi «Musolini» ishte krejtësisht i vdekur. Ndërtesa të larta me grila të mbyllura ngrihen shin resht, të ngjitura sup më sup. Prapa kangjellave të lagura të kopshteve pemët lotarake ngjanin si vajtojca. Shtëpi e kopshte pasanikësh, mendoi Sherifi. Helmetat e rojeve gjermane te porta e Radiostacionit dhe lart në tarraca shkëlqenin nga shiu. Larg, nga e djathta, dukej pjesa e prapme e ndërtesës së kuqërrreme të Banksës së Shtetit. Nga e majta ishte një hotel. Sherifi lexoi me vështirësi: Hotel «Kontinental».

Nga drejtimi i burgut të ri u dëgjuan gjëmime mortajash dhe, në intervalin midis tyre, breshëritë e ngathëta të mitralozave të rëndë. Pas pak, sikur zhurma e luftës të ishte një erë që rrökullisej mbi qytet, ajo u përsërit më afër. Po gjuanin fërtinot e qendrës. Midis tyre Sherifi dalloj të shtimen e topit të tankut. Shtjer, Tosuni aga, tha me vete. Ai e mori me mend se si tani predhat e mitralozave të rëndë grinin e bënин shoshë trupat e vdekur të partizanëve, të mbetur aty-këtu në shesh nga kalimet e njësiteve që i ishin afruar gjatë natës bulevardit «Musolini». Tani për tani kjo ishte e vëtmja zonë e qetë e Tiranës. Thoshin se këtu ishte mbledhur lëmsh, gati për të ikur, gjithë zhgani i borgjezisë, kuislingëve, ish-ministrave dhe aristokratëve të kryeqytetit.

Nga qendra u dëgjuan përsëri breshëritë e fortinove. Kundër dëshirës, Sherifi përfytyroi predhat që shqyjenin tani trupat e Fredit dhe të Belulit. Ato shkatërronin shpinat dhe gjokset e tyre. Pastaj, sikur të mos mjaftonin këto, shkopi i gjatë, i hekurt, me mbishkrime turke ngríhej kërcënues mbi ta për t'u çarë kafkën më dysh. Sherifi tundi kokën si për të shkundur dremitjen që po i afrohej. Nga sheshi vinin gjëmime të rënda, ritmike. Vazhdonte të shtinte gjysmëtanku.

Të mësuar për stina të tëra me prozhime, traga fshati, hendekë me baltë dhe djerrinë, partizanët i bezdistë statizmi i qytetit, ky taban i fortë betoni dhe asfalti, i cili nuk i bënte asnjë lëshim thundrës së këmbës që mbësh-tetëj në të, por, përkundrazi, i jepte një kundërgoditje, që ndihej në të gjithë trupin.

Njësiti ishte përforcuar prapa murit rrethues të depos së manifakturave. Kishte mbaruar vendosja e mitralozeve dhe e pushkëve antitanke si dhe hapja e vrimave të mëdha te pjesa e prapme e murit, nëpërmjet së cilës njësiti mund të tërhiqej në rast të një sulmi të befasishëm të tankeve të rënda. Urdhri ishte i prerë; sulmi kundër Radiostacionit do të bëhej vetëm kur të fillonte sulmi në të gjithë krahan e majte të bulevardit «Musolini».

Bulevardi vazhdonte të ishte i vdekur. Tek-tuk kallonte ndonjë tricikël dhe akoma më rrallë ndonjë veturë. Nga porta e hotelit doli një grua e gjatë me rripin e çantës hedhur në sup. Ajo eci një copë herë duke trokitur takat e larta në trotuar, pastaj ndaloi, hapi çantën dhe u pa, siç duket, në pasqyrëzën e ngjitur në kapakun e saj. Pastaj po me atë gjest energjik e mbylli çantën dhe vazhdoi të ecte me kokën lart.

— Sherif, — u dëgjua zëri i butë i Javerit. Po Sherifi nuk e ktheu kokën. I habitur, ai ndiqte me sy gruan. Ajo dukej sikur murmuriste me vete. Bile nga lëvizja e buzëve Sherifit iu duk se ajo tha dy-tri herë fjalën «maskara». Ç'bëhet në këtë qytet, tha ai me vete. Të del një grua në një rrugë ku pritet të bëhet batërdia, nuk mjafton që ecën trak-truk midis dy ushtrive, por shikohet edhe në pasqyrë, gjatë ecjes, dhe thotë edhe «maskara».

Gruaja kishte një të ecur të veçantë, me një të hedhur të lehtë që u shpërndahej gjithë gjymtyrëve të saj. Dukej sikur në qendrën e atij trupi luksoz, diku brenëda, këllqeve dhe barkut, kishte një bosh ajror që e shkaktonte atë të hedhur.

— Sherif, të pëlqen? — u dëgjua pas shpine zëri i Javerit, por ai nuk e ktheu kokën. Po në atë çast ai ndjeu te veshi një frymëmarrje të rëndë. Pa kthyer kokën, e njohu dihatjen e Memecit.

— Cfarë ke? — tha Sherifi.

— Uu, — ia bëri Memeci, duke treguar me sy gruan që po ikte, duke u lëkundur mbi vithet e larta.

— E çë pastaj? — tha Sherifi.

Sytë e Memecit ishin thjesht të habitur dhe Sherifit i erdhë keq që i foli aq ftohtë.

— Është grua e keq, me siguri, — tha.

Memeci tundi kokën në shenjë pohimi. Ai kishte sy të çelët, si të qelqësuar, të mbushur tejpërtej me atë qetësi të tepërt që ua jep njerëzve të tillë mungesa e gojës. Ishte bashkuar me batalionin dy muaj përpëra, gjatë marshimit përmes një zone të mbushur me reaksionarë. Njëherë nuk kishin dashur ta mbanin në batalion, për shkak të gjymtimit të tij, por ai e kishte



ndjekur brigadën me kilometra të tërë nëpër një zallinë të mbuluar me dëborë. Partizanëve u vinte keq, por edhe i jepnin të drejtë komandantit të batalionit; nuk kishin dëgjuar ndonjëherë për ekzistencën e partizanëve të verbër, të shurdhër, ose memecë si ky. Mirëpo ai, gjysmë i zbardhur nga borima, capitej nëpër gjurmën e ngrirë të batalionit, duke bërë vazhdimisht «u, u» si një erë që nuk pushon. Përveç kësaj, në sytë e tij kishte një «përse» kaq të madhe dhe prekëse, saqë e bëri përvete praparojën. Dalngadalë ajo «përse» e tij, ashtu e madhe dhe hutaqe si një shpend i ngathët, u zhvendos nga sytë e tij në sytë e shumë partizanëve dhe komandanëve, gjersa puna u bisedua në shtab. Shtabi e pranoi. Sherifi vështroi për disa sekonda sytë e kthjellët të Memecit.

— Të pëlqen? — i tha, duke ia bërë me kokë në drejtim të gruas. Ai u habit dhe vetë se si u vu, padashur, në rolin e Javerit dhe i erdhi turp.

Memeci mblodhi supet me neveri dhe bëri «jo» me kokë.

Prapa shpinave të tyre kishte një gjallëri. Sherifi ktheu kokën dhe pa se rrrotull komisarit ishin mbledhur katër a pesë partizanë. Ata përkuleshin të gjithë poshtë, drejt diçkaje, që dukej sikur njëri prej tyre e kishte zënë për gryke dhe po i merrte shpirtin. C'po bëjnë ata atje? tha me vete Sherifi. Iu duk se vërtet ata kishin vënë në mes e po mbytnin dikë. I mbyturi, nën shtrëngimin e fytit, herë lëshonte një zë të ngjirur, herë e ngrinte papritur atë në një mënyrë arrogantë anë të çjerrë. C'është kjo? tha Sherifi me vete dhe në çast e kuptoi: Ata kishin venë poshtë e po i merrnin frymën ndonjë gjermani. Zëri ndihej që atje tej, fliste në gjuhën gjermane. Sherifi i tha Memecit të kishte kujdes pozicionin dhe bëri prapa.

— C'është? — pyeti, duke u përpjekur të shihë poshtë këmbëve të grumbullit robin e lidhur. Por atje nuk kishte asgjë. Ishte vetëm një kuti e vogël me një pëlhurë përpara, së cilës komisari i vërtiste me kujdes dy-tre butona të rrumbullakët.

— Eshtë radio, — tha dikush, — radio me bateri.

Aha, ia bëri Sherifi. Ishte hera e parë në jetën e tij që shikonte një radio. Iu duk tepër banale.

Zëri i spikerit gjerman herë hollohej, herë trashej, herë mbytej midis vërvëllimave të skëterrshme. Befas ai pushoi, duke lënë pas vetëm një gjullurdi boshe. Partizanët ngritën kokat dhe vështruan në mënyrë pjetëse në fillim komisarin, pastaj njëri-tjetrin. Komisari nuk i hoqi sytë nga kutia dhe as lëvizi ndonjë nga butonat. Gërhima e rëndë e radios u dendësua dhe fill pas kësaj, nga mesi i asaj gjullurdie, u ngrit një zë i mprehtë e melodioz femre: «Këtu radio Tirana. Dëgjuat lajmët gjermanisht. Po jepin lajme në gjuhën shqipe. Forcat e lavdishme të Rajhut gjerman po i zmbrapsin me sukses sulmet e rebelëve të kuq mbi Tiranë.»

— Oh, oh, oh, ti... nënën, — thirri me zë të ngjirur Mete Aliu, partizani më gjaknxehtë i njësitit. Sytë e tij të zgurdulluar jashtë mase u rrrotulluan mbi sytë e të tjerëve dhe për një çast u duk se gjakftohësia e tyre e tërboi atë më shumë se fjalët e spikeres.

— Si? — thirri ai, duke treguar me dorën që i dridhej radion e vogël, — si guxon... ajo... bijë kurve... tē... tē... Po ju, ç'bëni ju?

Buzët e tij ishin shkumbosur anëve.

— Shët, — ia bëri komisari, — na lër të dëgjojmë, Mete.

— Të dëgjosh? — ulëriti partizani dhe me një gjest të furishëm shkuli revolverin nga brezi. Dy-tri duar u përpinqën t'i zinin krahun, por ndërkaq ai arriti të lëshonte dy plumba në drejtim të radios. Njëri prej tyre e preku aparatin duke shkaktuar një zhurmë shurdhuese brenda tij.

— Ah, bravo Mete, — thirri komisari me një ton të keq. — Qenke trim i madh kundër një copë kutie! Bravo, s'ke ç'i thua!

Mete Aliu kërcelliti dhëmbët.

— Nuk rri unë të dëgjoj ç'thotë ajo bushtër, — murmuriti ai. — I fut një plumb mu në të s'ëmës, ja ç'i bëj.

— Nuk tregohet trimëri kundër një copë kutie, — tha komisari. — Trimërinë tregoje nesër ose pashësër, kur të vijë koha, atje, — dhe ai zgjati dorën në drejtëm të ndërtësës së Radiostacionit, nga tarracat e së cilës rojet gjermane vështronin me dylbi rreth e rrötull.

— Trimëri? — ia bëri si i ndërkryer Mete Aliu. — Mua më përmend trimërinë?

— Nuk thashë se s'je trim, — tha komisari. — Që je trim, bile ngandonjëherë trim i marrë, këtë e dinë të gjithë, po kjo që bëre sikur s'i shkon trimërisë.

Në vështrimin dhe në zërin e komisarit nuk kishte ndonjë shenjë ironie. Megjithatë, ajo përvijohej fare qetë në nofullën e tij të gjerë, eshtake. Në atë nofull ishin ngulur sytë e Mete Aliut. Ata ishin të vegjël dhe me një skuqje të përherershme të së bardhës, të ngjashme me damarët e hollë të stërrallit. Isbin nga ata lloje sysh që duket sikur gjumi i lodh po aq sa edhe pagjumësia dhe, veç kësaj, ashtu të trubullt pak në kuqëlimin e tyre, ata krijonin tek i panjohuri një lloj largësire, përshtypjen e së cilës e shtonte kapota bojë hiri, jashtëzakonisht e gjatë e partizanit.

Mete Aliu murmuriti digka të pakuptueshme. Të gjithë e dinin se vrulli i inatit, ashtu siç vërvshonte rrëmbiyeshëm mbi fytyrën e tij të eshkët, po aq rrëmbiyeshëm e braktiste atë, duke e lënë në një çrregullim të shushatur.

Spikerja e radios vazhdonte të fliste përmes rënkimësh, gërvishjesh e fishkëllimash të panumërtë. Mete Aliu dëgjonte me sytë të ulur.

— Kjo kuti s'ka faj, — tha komisari me zë të qëtësuar, pa iu drejuar asnjeriu. — Ajo, ashtu siç thotë fjalë të këqija, mund të thotë edhe fjalë të mira, sepse ajo komandohet nga larg. — Ai pushoi ca sekonda përtë gjetur, siç duket, një shpjegim më të thjeshtë dhe pastaj, përtë dytën herë, tregoi me dorë ndërtësën e lartë gri të Radiostacionit — Shpirti i saj është atje.

Dy-tre partizanë kthyen kokat andej.

Komisari kishte një zë të tillë prej baritonit, saqë Sherifi bënte gjithmonë çudi se si nga një qafë e gjatë

si e tij mund tē dilte një zë aq i plotë. Çdo herë që komisari matej tē fliste, Sherifit i dukej se ja, më në fund, zëri do tē ishte holluar, mirëpo nuk ndodhë kurrë ashtu. Në tē vërtetë, Sherifit do t'i pëlqente shumë tē kishte një zë tē tillë, tē ngrohtë, me timbër tē ulët, tē ngjashëm paksa me zërin e njeriut që i është ftohur gryka.

Shpirti i saj është atje, përsëriti me vete Sherifi. Në fshat, netve tē dimrit tregonin përralla për shtriga dhe lugetër, që ishin tē pamposhtur në dyluftime, sepse shpirtin e kishim larg, në fund tē detit, ose në një guaskë, diku në majë tē një mali me akull. Që t'i mposhtje ato, duhej t'u gjeje shpirtin. Kështu ishte edhe puna e kësaj kutie. Shpirti i saj ishte brenda asaj ndërtese me antena. përsipër, prapa rojeve gjermane. Për herë tē parë Sherifi besoi se ajo ndërtësë ishte vërtet e rëndësishme, përderisa kishte tē bënte me një shpirt, dhe bile, me një shpirt tē keq.

— Ky zë dëgjohet kudo nëpër botë, — tha komisari, duke vënë dorën mbi radio. Në tonin e zërit tē tij kishte shumë keqardhje. — Ky duhej tē ishte zëri i Shqipërisë, por ç'e do, — vazhdoi ai, — ky është një zë i huaj.

Ai rrrotulloi butonin dhe zëri u ngrit e u ul disa herë sikur po i shtrëngonin gurmazin. Gishtat e komisarit ishin nervozë.

— Shqipëria akoma s'ka zë, — tha ai. — Ajo është e pagojë, si Memeci.

Nga pozicioni i tij, ngaqë dëgjoi, siç duket, t'i përmendejnofka e tij, Memeci ktheu kokën. Sytë i kishte si gjithmonë tē çelët, dy pyetje tē mëdha që ishin shkrirë duke formuar pellgje tē vogla, tē pikëlluara.

— Si Memeci, — përsëriti komisari dhe në çast pëccerroi sytë sikur iu kujtua diçka, — ose, më mirë, ajo e ka pasur zërin, — vazhdoi ai mendueshëm, — por gjë më sot atë zë nuk ia ka dëgjuar kush në botë përmes valëve tē radios.

Supet e Mete Aliut u drodhën nga ngashërimi.

— Ja, këtë do tē bëjmë ne këto ditë, — tha komisari.

— Jo të luftojmë me kutira, por të marrim Radiostacionin, që ta bëjmë Shqipérinë me gojë.

Mete Aliu nuk e mbajti dot një gulçimë.

— Ç'kenke dhe një ti, o komisar, — tha me një zë të deformuar nga ngashërimi. Ai deshi të thoshte diçka, por ngashërimi po prishtë fjalët e tij, si ujët që merr përpara e shkatërron një ledh të butë. Bëri një gjest me dorë, sikur të shkundte diçka të paqenë, të ngjitur në gishtat e tij, dhe zuri të ikte përgjatë murit.

Ballë për ballë desh u përplas me komandantin. Trup mesatar, me kokë të qethur shumë lart anëve, gjë që i jepet asaj një pamje kryeneçe, me ca syze me xhamë krejt të plasaritur gjatë zvaritjes së djeshme, të lidhura në njërin vesh me tel, në tjetrin me spango, komandanti Dino Šinojmeri po vinte me atë vrull paksa të panatyrshtëm, që i kap herë pas here tipat e sertë, por të hutuar. Në njérën dorë ai mbante një grumbull çelësash të të gjitha madhësive.

— Ç'po bëni ju këndeja, — thirri ai, duke i zënë rrugën Mete Aliut, — duele?

Mete Aliu nuk dinte ku t'i shpinte sytë. Ai fshiu diçka në erë me pëllëmbën e dorës, sikur të thoshte: lëre tanë, u bë ç'u bë, dhe bëri t'i ikte anash komandanit, pikërisht nga ajo anë, ku xhami i syzeve të tjetrit nga plasaritja ishte kthyer në një tufë të dendur rezesh, prapa së cilave syri i komandanit me siguri e shikonte botën në një pamje krejt anormale.

— Stop, — thirri komandanti, duke e përplasur çizmen e majtë përpara këmbëve të Mete Aliut. — Do-methënë, këndo, o muzë, sherret e Mete Aliut nga kompania e tretë. Bravo, bravo, s'ke ç'i thua.

— Ditë e zezë, — murmuriti Aliu, — e poshtërojnë njeriun për një copë k...

— S'ka ndonjë gjë serioze, profesor, — ndërhyri komisari, — Mete Aliu pati një keqkuptim të vogël me aparatin e radios.

Dora e komisarit u përpoq të mbulonte vrimën që kishte bërë plumbi i Mete Aliut.

— C'janë köta çelësa, profesor? — pyeti ai menjëherë.

— Kopjet e çelësave të Radiostacionit, — tha komandanti. — Porsa m'i dërguan nga shtabi. Ja, ky i madhi është i portës kryesore, ky këtu i sallës së mikrofonave. Ky i arkivit.

— Ik tani që profesori nuk e ka mendjen, mbathja, — i pëshpëriti dikush Mete Aliut.

Ngaqë para lufte jepte greqishten e vjetër në një shkollë të një qyteti të humbur kufitar, disa nga partizanët, duke përfshirë edhe komisarin, e thërritnin komandantin e njësitit «profesor». Në të vërtetë askush nuk e kishte vërtetuar ndonjëherë se ajo gjuhë që ai u mësonte me vjete nxënësve, ishte vërtet greqishtja e vjetër. Relacionet e inspektorëve të Ministrisë së Arsimit kishin raportuar disa herë se ajo ishte një gjuhë e panjohur, që pretendohej prej mësimdhënësit se ishte greqishte e vjetër, por që, sipas mendimit të komisionit inspektues, mund të ishte greqishte e vjetër aq, sa mund të ishte sanskrite, ose keltiske e vjetër. Kur në batalion erdhi lajmi se profesori i greqishtes së vjetër, tuhafi i famshëm që kishte ngatërruar vite me radhë ministrinë mbretorre kishte dalë partizan dhe po vinte në batalion, të gjithë pritnin të shikonin një intelektual hollak e të zbetë, që e shtynte në partizanllék një idealizmë e vjetër kombëtare dhe që shpejtë vonë, duke mos duruar dot vështirësitet e jetës së malit, do të braktiste përsëri batalionin. Mirépo habia e tyre qe e jashtëzakonshme, kur në vend të njeriut delikat me bastun dhe ombrellë (kishë pasur raste të tillë daljesh në mal), ata kishin parë një burrë shpatullan, që ecte disi shtrembër, por me një shtremberësi të tillë, që të zgjonte çuditërisht ndjenjën e forcës. E vetmja gjë që i përmbahej përfytyrimi të tyre, ishin syzet, por edhe ato, si përinat, ishin ndryshe, dy rrathë kokëfortë, të rrumbullakët, prapa të cilëve ishin ngulur si me vida sytë e tij prej inatçiu, ku nuk kishte asnjë hije librash. Pas dy javësh, në sulmin e parë kundër një kazerme italianësh, «profesori», siç kishin filluar ta quanin, qe treguar trim i tërbuar dhe pas dy muajsh qe bërë komandant kompanie.

— Ja, — tha ai, — këta janë gjithë çelësat, — dhe i tundi me forcë. Ata, të vegjël, e të mëdhenj, bënë një zhurmë të gëzueshme.

Partizanët i vështronin ata me kureshtje dhe herë pas here kthenin kokën nga Radiostacioni, sikur të mos u besonin syve që çelësat e ndërtësës, me të cilën ishte lidhur fati i tyre këndej e tutje, ishin këtu, midis tyre.

— Ilegalët kanë punuar mirë, — tha Dino Sinojmeri.

Tutje, pas shpinës së tij, u dëgjua një e qeshur. Ish-te Teuta, e vetmja vajzë e njësitit, që ishte ndeshur, me sa duket, ballë për ballë me Mete Aliun.

— Hm, — ia bëri Dino Sinojmeri.

Teuta po vinte drejt tyre dhe dukej që të qeshurën e kishte jo vetëm në fytyrë, por ajo i kishte ndryshuar edhe ritmin e hapave dhe tani përpiquej ta përthyente te mesi.

Të qeshurën e Teutës partizanët do ta njihnin midis mijëra të qeshurash të tjera. Teuta qeshte lirshëm dhe shpeshherë, kur i dukej se kishte qeshur pa vend, ajo vinte dorën te goja, sikur e qeshura të ishte një shpend që dilte prej saj, dhe ajo përpiquej t'i kapte bishtin ose krahët, për ta kthyer atë mbrapsht. Edhe tani, kur pa komandantin, ajo vuri dorën te goja, por ishte pak vonë.

— Hm, — ia bëri prapë Dino Sinojmeri, duke e vështruar vëngërthi vajzën. Teuta ngriti supet si për të thënë «asgjë».

— E kishim fjalën te çelësat, — tha Dino Sinojmeri.

— Ilegalët kanë punuar vërtet mirë.

Ai e tundi edhe një herë grumbullin e tyre dhe pastaj iu kujtua, siç duket, diçka, sepse u kthye papritur dhe iku në atë anë, ku po hapnin një vrimë tjetër për mitralozin e dytë.

Grumbulli i vogël, që ishte krijuar për shkak të Mete Aliut, u shpërndau.

— C'u bë atje? — pyeti Javeri, kur Sherifi erdhi prapë në pozicion. Zëri i tij ishte i butë dhe serioz dhe Sherifi, që kishte vendosur të mos i fliste më, aty për aty, ndërroi mendje.

— Mete Aliu, — tha me zë të ulët, — goditi me revolver kutinë e radios.

Javeri qeshi me zë.

— S'kishte se si të mos ndodhët kjo, — tha ai. — Kish ditë që Mete Aliu s'kish bërë ndonjë proçkë.

— Uu, — ia bëri Memeci, duke treguar me kokë në drejtim të bulevardit.

— Cfarë ke, Memec, — tha Sherifi.

Në bulevard, duke bërë zigzage si një e dehur, po kalonte një veturë. Nga xhamet e saj të thyera vareshtin thekët e një qilimi persian.

— S'kam parë ndonjëherë makinë të ecë kështu, — tha Javeri.

Prite kur të më thotë: ke parë ti Sherif? mendoi Sherifi. Por Javeri nuk tha asgjë. Ai ndiqte me sy makinën sikur të shikonte një pamje gazmore.

— Është ndonjë veturë pasanikësh që nuk i njoinin rrugët e qytetit, — tha Javeri. — Prite kur të na futet mu në turi.

Por vetura u kthyte më në fund vrulltazë në një nga rrugët që lidhnin bulevardin me Rrugën Mbretërore.

— Uuu, — ia bëri përsëri Memeci, që, siç duket, pa diçka tjetër në bulevard. Por Sherifi nuk e ktheu kokën. Po binte muzgu dhe ai i ndiente tëmthat të rënduar. Sytë po i koteshin. Uuu, ia bëri përsëri Memeci. Ja, kështu ka qenë Shqipëria, pa gojë, kishte thënë komisari. Ku i vete mendja, tha me vete Sherifi. Po pse të mos i vejë. Ndaj është komisar, që t'i vejë mendja degë më degë. Pa gojë, si Memeci, përsëriti ai. Dhe kushedi sa kohë ka kështu. Një mijë vjet memecillék. Dy mijë ndoshta, kushedi. Sa vjeç është vallë Shqipëria? Sherifi kishte dashur ta bënte njëherë këtë pyetje në orën politike, po i kishte ardhur turp. Në fshatin e tij plaka Qenane ishte aq e moçme, saqë thoshin se mbante mend

kurrierin perandorak që çonte kokën e prerë të Ali Pa-shë Tepelenës në Stamboll. Karroca ishte me shenjë mbretërore dhe koka e vezirit, e mbështjellë me borë e me kripë, rrezëllinte si kokë e stolisur nuseje. Kështu rrëfente plaka Qenane. Kurse Shqipëria duhej të ishte shumë, shumë më e vjetër.

Atij iu kujtua fshati dhe shtëpia e tij. E kishte parë kaq herë në ëndërr shtëpinë me muret që i fryheshin dhe mundoheshin t'i hidheshin përsipër si një jorgan i keq dhe me oxhakun e zi që kërkonte ta kafshonte: i pabesë, o i pabesë. E kishte djegur atë shtëpi me dorë të tij, një ditë shkurti. Sikur dikush t'i thoshte më parë se do të vinte dita që ai do të merrte urën e do t'i vinte zjarrin shtëpisë së babait, ai, ose do të shqyhej gazit, ose do të vinte kujën. Mirépo kjo ndodhi vërtet në atë mbasditë dimri, kur njësiti i tyre hyri në fshatin e djegur nga ndëshkimorët gjermanë. Fshati mezi njihej. Ç'do gjë ishte bërë shkrumb e hi, ishte ftohur, kishte vdekur. Të gjalla ishin vetëm çesmat, që dukej sikur gulçonin midis asaj shuarjeje. Dhe befas, midis shtëpive kufoma, me ato zgavra dritaresh të nxira, atij i doli përpara shtëpia e vet, pér çudi e paprekur, e bukur midis mynxyrës, e vëngër, e pakuptueshme... Ai shqeu sytë, kur e pa atë, pér të cilën kaq muaj e kishte marrë malli ta shihte dhe që tani, midis asaj zie, i ngjau si një nuse shtrigë që krihet midis vdekjes. Ç'je ti? Pse je kësh-tu? kishte ulëritur me vete, sikur ta kishte kapur shtëpinë në turp dhe, pa menduar asgjë tjetër, kishte vra-puar pér të gjetur vajgur dhe shkrepëse dhe, para se dikush ta ndalonte, i kishte vénë zjarrin. Dhe ajo, duke e lënë veten të kapëllohej, prej flakëve, me oxhakun e ngritur përpjetë sikur kërkonte ndihmë, ishte djegur. Sherifi i kishte akoma në vesh ato murmurima të mby-tura trarësh, që herë i ngjanin si ankime, herë si mallë-kime të vjetra. Ja dhe tani, duke parë ndërtesat e bukura të këtij bulevardi të huaj, ai, padashur, psherëtiu. Sa shtëpi do të digjen akoma, tha me vete. Kur njësiti ishte larguar nga fshati, ai kishte kthyer sytë pér herë të fundit. Binte shi. Shtëpia e tij, tashmë gërmadhë, nxinte atje

përtej, midis fatit të përbashkët të gjithë fshatit. Vetëm oxhaku, që kishte mbetur, kushedi pse, në këmbë, ashtu i zi e i kapënësur, dukej sikur i thoshte që nga larg: Sherif, o bir, ç'qe kjo që na bëre?

Më vonë komisari i kishte thënë: «Kot e dogje shtëpinë tënde, Sherif. Njerëzit e tu, siç dëgjuam, s'u kishin bërë ndonjë shërbim gjermanëve». Sherifi qe skur-qur si asnijëherë tjetër. Domethënë edhe komisarit, ashtu si atij, i kishte shkuar nëpër mend se mos...

Sa shtëpi e pallatë do të digjen akoma, përsëriti ai me vete, pa i hequr sytë nga grilat e mbyllura, mospër-fillëse, matanë bulevardit.

Diku nga e djathta gjëmuani përsëri mitralozat rëndë.

— Ndoshata po kapërcen sheshin njësiti që do të marrë Bankën, — tha Javeri, duke zgjatur qafën, si për të dëgjuar më mirë.

Midis breshërisë së mitralozave gjëmuani plasje bombash.

— Ata janë, — tha Javeri.

Filluan të shtinin fortinot e sheshit «Skënderbej» dhe Sherifit iu duk se dalloj midis tyre topin e gjysmëtancut. Tyta e tij e gjatë, me shkronja gjermançe sipër (me siguri kishte shkronja të tillë), zgjatej tanë prapë mbi trupat e shokëve të vrarë, tej e tëhu. Tosun agai, në fshat, pasi e kishte vrarë nusen e re, e kishte goditur një copë herë të gjatë kufomën me atë shkopin me mbi-shkrime turke, gjersë të tjerët mezi arritën ta nxirrin trupin nga rrëthi i goditjeve të tij.

— Ftohtë, — tha Javeri.

Bënte vërtet shumë ftohtë. Muzgu sa lente dëndësohej mbi qytet. Mbi tarracën e lartë të Radiostacionit antenat po mjegulloheshin dalngadalë. Sherifit iu kujuan përsëri fjalët e komisarit për memecillëkun e vendit. Ku i vete mendja, tha ai prapë më vete. Shqipëria nuk ka zë. Ishte vërtet ashtu. Kishte bubullima, rënkimë erërash nëpër humnera, krisma armësh, ca iso të zgjatura, të zgjatura si të tjerrura sipër pllajash, rropama demonstratash, ca gjëmimë të mbytura të tokës

(ai vëtë i kishte dëgjuar ato duke vënë veshin përdhe, gjatë kohës që ruante dhitë), por këto treteshin si në humbëtirë. Pa zë, tha ai me vete. Ja, këtë s'e kisha menduar ndonjëherë. Në këtë kohë sytë e tij dalluan përtëj, matanë bulevardit, një si kolonë të bardhë që u ngrit heshtrazi drejt qiellit. Sherifi ndoqi me sy dritën e projektorit, që u lëkund, pastaj u anua, u anua dhe ishte gati duke rënë në tokë pér tu bërë copë e thërrime, kur befas, me një lehtësi të jashtëzakonshme, u drejtua përsëri. Dy muaj më parë Sherifi do të kishte mbetur me gojë hapur sikur të shikonte një fantazmë të tillë, por gjatë sulmit mbi Tiranën ai qe mësuar me projektorët.

— Po i bëjnë provën ndonjë projektori të ri, — tha Javeri. — Bëhu gati të luftosh me dritë llamburitëse, si në ballo...

Pas shpinës së tyre u dëgjuar përsëri gjerrëse e radios. Komandanti, komisari dhe ca partizanë të tjerë ishin përkulur prapë mbi të dhe po dëgjonin lajmet. Midis tyre Sherifi dalloj profilin e butë të Teutës dhe, siç i ndodhë gjithmonë kur e shikonte, ndjeu një squllje të vogël në pjesën e majtë të gjoksit. Një ditë më parë, gjatë kapercimit të sheshit, pér një çast i shkrepinë kokë dyshimi i marrë se Teuta, do të ngrihej e do t'i afrohej gjysmëtankut. Bile njëherë, duke rrezikuar të goditej nga predhat, ai qe ngritur mbi bërryla pér të parë se ç'bënnte ajo. Ishte gati të thërriste: Teuta, moj budallaqe, hiqë nga mendja atë gjë. Ai të vret. Të vret me shkopin e hekurt si... si... ti nuk e di... kishim në fshat një Tosun aga...

Kishte fjetur një natë ngjitur me Teutën në stanet e Belshit. Ishte tetor. I kishte zënë furtuna në pllajë dhe ishin futur pér të fjetur në stan, të gjithë rresht, të lagur qull, me nga një kollë, apo teshtimë sipër fytyrës. Atij i qëlloi të shtrihej përbri Teutës. S'kishte fjetur kurrë në jetë kaq afér me ndonjë femër. Nën përshkënditjen e zjarrit spikatnin herë pas here nëpër terr flokët e saj të rënduar nga shiu dhe vija e puthitjes së qepallave me qerpikët e ngrirë midis. Mbi atë fytyrë, e cila gjatë ditës, edhe kur nuk qeshte, ruante gjithmonë gjur-

mët e ndonjë të qeshure të vjetër, tani, në gjumë, s'kishte veçse një mundim. Dukej sikur për gjithë atë gëzim të dlirojë të ditës, ajo vajzë duhej të paguante natën dhe vëtëm për vetëm. Sherifi kishte ndier ta mbështillte papritur një valë e vakët, e ngjashme me ndjenjën e dhimb-surisë, por pa keqardhjen. Ishte më tepër një pikëllim, por vetëm pjesa e tij e gjëzueshme, pa atë bërthamëzën e helmët midis. Të tillë ndjesi të re, të shartuar nga ndjesi të vjetra, gjithsesi të pangjashme me to, ai, si një pemë të re, po e provonte për herë të parë dhe nga kjo gjë iu duk se mund të qante. A ishte e mundur që bota që do të vinte të ishte kaq e pastër, siç ishte ky fillim i saj këto ditë, në male? Ky mendim, si ndonjë tundës dybeku, kishte rrahur e shkumbëzuar atë natë gjithë mendimet e tjera, gjersa e kishte kapluar gjumi.

— Uuu, uuu, — ia bëri Memeci, që, siç duket, kishte parë diçka në bulevard.

— Ç'ke, Memec, — tha Javeri.

— Uuu, — ia bëri prapë Memeci.

Pa gojë, tha me vëte Sherifi. Një njeri pa gojë është një mynxyrë. Po një vend i tërë? Shqipëri memece. Një mijë vjet. Dy mijë vjet. Ndoshta më shumë.

Sytë e Sherifit mbetën të ngulur një copë herë të gjatë mbi tarracën e Radiostacionit, që sa vente tretej në muzg. Atje do të suleshin, njëri pas tjetrit, mes për mes plumbave, një mëngjes, për t'i sjellë gojën Shqipërisë. Dhe befas, si një gjëmë që shpërthen brendapërbrenda njeriut, atij iu ndriçua qartë, fare qartë gjithë kuptimi i misionit të njësitit.

Fortinot e qendrës shtinë përsëri me breshëri të rënda të zgjatura, si të lidhura me zinxhirë me njëra-tjetren. Pas pak do të binte mbrëmja mbi sheshin «Skënderbej» dhe partizanë të njësiteve speciale do të përpinqeshin të tërhoiqnin trupat e shokëve të vrarë. Ata tani dergjeshin të rënë në pozicione të ndryshme, një këtu, një atje, dy më tej, dhe midis tyre dukej sikur vërtitej ai monumenti i vjetër, ai tarrallak me pelerinë të hallakatur nga era, që dukej sikur përkulej herë mbi kufomat e njërs palë, herë mbi kufomat e tjetrës, sikur të pyeste: Ç'jeni ju, nga keni ardhur, pse, po ju të tjerët, ju të tjerët, pse...

KAPITULLI I DYTE

Ndërsa vështronte nga dritarja e hotelit bulevardin «Musolini», të lagur e të shkretuar, ai përfytyroi se si ajo e cte tani ndoshta akoma në trotuarin e tij, me atë të hedhurën e saj të lehtë, duke nxjerrë në ecje e sipër pasqyrën nga çanta dhe duke murmuritur nëpër dhëmbë: «maskara». Megjithëse nuk ishte hera e parë që një takim i tyre mbaronte kështu, ai ngriti supet, mblodhi buzët dhe i shkoi nëpër mend se, sidomos qoftë, kjo fjalë, «maskara», nuk do të tingëllonte ndoshta kaq rëndshëm, sikur të mos e kishte theksin në rrökjen e fundit. Dy-tri herë ai e përsëriti atë me vete, duke ia vënë theksin në mes, «maskára», por megjithatë fjala nuk iu duk sadopak më e pranueshme, dhe buzëqeshi hidhur.

Maskára. Maskará.

Pas tylit të dritare dukej një pjesë e kolonadës së rëndë të Bankës së Shtetit, ca kopshte luksoze dhe më tutje ngrehina e lartë e Radiostacionit, me kompleksin e antenave mbi tarracën kryesore. Herë pas here nga pikatë ndryshme të qytetit, herë më të mprehta, herë më të shurdhëta vinin zhaurimat e luftës.

Vendi po bëhet gati të ndërrojë rend, mendoi ai. Në trurin e tij, midis mekanizmave që, të stërvitura gjatë procesit të punës së tij prej shkrimtari, viheshtin lehtësisht në lëvizje për krijime figurash letrare, instiktivisht u bë një përpjekje e shkurtër, për t'i gjetur fenomenit

të ndërrimit të rendit një ngjasim sa më konkret. Ndërrimi i faqes së vendit, i thelbit, i fytyrës, lëkurës... ujku qimen... jo... jo... si gjarpri që ndërron lëkurën...

Jo, gati sa s'thirri ai. Kjo është një figurë e ndyrë, dhe ai shkundi kokën si pér ta flakur atë tutje. Veç kësaj ajo nuk është e saktë, mendoi ai. Në këto ditë po ndryshonte diçka e madhe. Këto ditë, përsëriti ai, kjo kohë... Ah, po q'mund të presësh nga arti juaj jashtëkohor, i kishte thënë para dy muajsh një koleg i tij i majtë. Sidoqoftë nuk mund të thuash se arti im nuk është i kohës, i qe përgjigjur ai. Së paku, kjo është një pikë ku bashkohen të gjithë kritikët që kanë shkruar pér mua, duke përfshirë edhe ata të korrenteve të kundërta. Tjetri kishte buzëqeshur pa e vështruar në sy (kësaj buzëqeshjeje shpendarake, që fluturonte anash, ai i trembej më tepër se çdo gjëje te njerëzit). Varet si e koncepton njeriu kohën, kishte thënë tjetri, duke e shuar gradualisht buzëqeshjen, si ato dritat e teatrit, që shuhen gradualisht përparrë hapjes së perdes. Maskara.

Koha, mendoi ai. Unë nuk i kam rënë ndonjëherë gjoksit, duke u mburrur që vepra ime qëndron jashtë kohës. Përkundrazi. Megjithatë na dalka që edhe kjo s'mjafton. Koha juaj. Koha jonë. Koha e tyre. Por ajo është një, dreqi e mori, duam apo nuk duam ne. Do të jetojmë në një kohë dhe do të vdesim në një kohë, të gjithë së bashku, miq dhe armiq.

Gjithë këto vitet e fundit, midis trubullirave dhe rrebeshevë të shkaktuara nga të dyja palët, ai kishte kërkuar një kohë të tretë, një kohë të vetën, më të përgjithshme dhe eterne, që qëndronte sipër pasioneve dhe batërdisë, si qelli i ftohtë që rri sipër furtunave. Ai ishte i bindur se pikërisht kjo ishte koha e vërtetë. Të tjerat ishin shi, kërkeshje resh, bubullima dhe gjullurdi, po kurssësi kohë.

Nga qendra e qytetit erdhi një gjëmim i rëndë. Të gjithë së bashku, mendoi ai. Megjithatë duhej të bënte gjithçka. Nuk mund të priste që koha të vinte drejt tij si një rreshje dëbore, që afrohet bashkë me dimrin. Duhej të bënte edhe ai diçka, të tërhiqte një cep të lëkurës

së gjarprit... jo, jo, jo... pér ta ndihmuar vendin tē zhvishej... jo lëkurë, jo gjarpër..., sidoqoftë ideja mbetej pér ta ndihmuar vendin tē çlrohej nga ankthi.

Kjo éshtë pér mua vazhdim logjik i jetës dhe i veprés sime, mendoi ai. Unë kam qenë gjithmonë i kohës... Së paku i kohës sime.

Ai i qe afruar dollapit, dhe gishtat e tij po kérkonin midis varëseve një këmishë dhe një kravatë. Pastaj hapi sirtarin e komodinës dhe nxori që andej revolverin. Embajti disa sekonda mbi pëllëmbën e hapur tē dorës, duke mos i hequr sytë nga tyta e shkurtër, mbi tē cilën lodronte një ndriçim tē marrtë. Pastaj i mbylli gishtat dhe e futi armën në xhep. Pa kuptuar dhe vetë, kishte filluar tē vishej. Të dal që këndeje, përsëriti me vete. Së paku tē mos mund tē thonë se, ndërsa pérreth bëhej luftë, ai ishte mbyllur me një femër në një dhomë hoteli. Maskara.

Përjashta ishte ftohtë dhe ai ngriti jakën e palltos së madhe. Në bulevardin «Musolini» s'kishte frymë tē gjallë njeriu. Po binte muzgu. Ai ecte ndanë vyshkjes luksoze tē kopshteve, mbi tē cilat ndriçimi i ditës po vda-rej me shpejtësi. Portat e mbyllura, me numrat tekë, që dukej sikur roniteshin në një ethe tē ftohtë, 41, 39, 37, 35, po ia shndërronin frikën e vetmisë në një panik tē vërtetë. Shpejtoi hapat, ndërsa veshi i tij përpiquej tē kapte pér së dyti një si zallahi tē largët, që iu duk se era e solli pér një grimë diku nga e djathhta. Mendoi se ishte treguar i pavémendshëm që e kishte lënë veten tē mbetej kështu qyqan në këtë bulevard tē vdekur. Zallahia e largët u përsëdyt, dhe ai, me një lëvizje tē vrullshme, u kthye në një rruginë anësore, që iu duk se po e conte drejt saj. Pas disa minutash ecjeje e ndjeu që nuk kishte gabuar. Dëgjoheshin që larg bori makinash dhe një zhurmëri e vazhdueshme, monotone. Kur doli në Rrugën Mbretërore, ajo që i panë sytë ishte e habitshme. Krejt ndryshe nga bulevardi «Musolini», ajo ishte plot gjallëri. Me dhjetëra vutura, qerre, karroca tē zeza pasanikësh,

motoçikleta, kuaj, kamionçina, xhipse, taksi, të ngarkuara plot e përplot me njerëz dhe dengje, lëviznin ngadalë, pritnin përpara hyrjeve të shtëpive luksoze, u binin bori-ve, gërvisheshin, iknin drejt xhadesë perëndimore të kryeqytetit.

Po ikin, tha ai me vete. Midis mjeteve lëvizëse dukeshin aty-këtu vetura të zeza ministtrash, deputetësh, klerikësh të lartë, vetura të tjera ngjyra-ngjyra tregtarësh të mëdhenj, bejlerësh, kuisingësh, bankierësh, ish-ministrash të mbretërisë së parë, vetura sportive hanëmesh moderne, aktivistësh të organizatave fashiste, kumarrxinjsh të njohur. E gjithë rruga ishte një batërdi ikjeje. Nga dritatet dhe spondet e makinave dukeshin funde sixhadesh persiane, me thekët që tundeshin trishtueshëm, këmbë të praruara mobiljesh, të spërdredhura në mënyrë kapriçioze, sepe te metalike me emblema dhe mbi shkrime përsipër, pasqyra, llampadarë, korniza ari, kolltukë, piano me bisht, çizme gjahu, ski. Dhe prapë qilima dhe sixhade persiane. Një kortexh i pafund qilimash të rëndë, të mbështjellur kutullaç, si gjarprinjtë gjatë gjumit të dimrit.

Aty-këtu gjermanë me helmeta dhe me shenjat e xhandarmërisë në gjoks u bënин me shenjë makinave dhe qerreve të lëviznin më shpejt. Megjithatë rruga nuk zbrazej, përkundrazi sa vente mbushej edhe më shumë, si një gurmaz që i rrasin e i rrasin me forcë ushqim të ri.

Përpara portës së hekurt të një shtëpie të bukur ai pa copërat e një servisi prej porcelani, që ishte thyer, siç duket, gjatë ngarkimit të plaçkave. Pa ditur as vetë pse, u përkul në tokë, mori një copë të vogël dhe e futi në xhep.

Dy-tri makina i ranë borisë me tërbim pas shpinës së tij. Pas xhameve të tyre ai pa fytyra të ngrira që dukeshin si të ngjitura mbi ndenjëset. Borsalina të zeza, të palëvizshme, një grua me kapelë që kishte vënë dy gishta midis syve dhe, me sa duket, po qante. Mbi makinë, sixhadetë e mbledhura kutullaç, në gjumin e ngrirë të dimrit.

Ai ndjeu lodhje në gjithë qenien e tij dhe një dëshirë

të fshehtë të mblidhej kruspull, ashtu, si këta qilima, dhe të fikej, të ngrinte në një gjumë të gjatë, gjersa të vinte koha e ngrohtë për t'u zgjuar. Ku ishe ti, kur gjëmonte dheu dhe rrëth e rrötull bëhej kërdia? Ku ishe ti, Adrian?

Asgjëkund, tha ai me vete.

Vështroi përsëri rrugën, mbi të cilën dengjet, si për veturnave, kokat e kuajve të qerreve, dhe kularët e qilimave lëkundeshin ngadalë, sikur po i zvariste tutje ndonjë përblytje e madhe, dhe mendoi se kjo botë po ikte përgjithmonë. Nuk ishte thjesht një ndërrim lëkurë, që mbetej e varur mbi ndonjë dru; ishte vetë trupi i saj, plagë dhe mish i gjallë, krimë, kronikë ngjethëse, zvetënim dhe pellgje gjaku, ku çizmja e kalimitarit ngre cërka anëve. Ato sixhade të mbledhura kutullalç ishin papiruse dëshmish të vjetra, mbi të cilat kishin shkelur vite me radhë këmbët e tyre, ishin ulur, kishin folur, kishin bërë dashuri. Tani i marrin me vete, mendoi ai, larg.

Koka i dhembte. I dukej sikur në sferat e trurit të tij po rrokullisej diçka e butë, që i shkaktonte një pështjellim të qetë. Donte të ikte sa më parë nga ky kalvar dhe qëndroi para hyrjes së një kafeje, njëri prej fenerëve të së cilës ishte thyer. Ishte një kafe pasanikësh, në të cilën ai vinte rrallë. Nuk kishte parë ndonjëherë që ajo të kishte kaq shumë tym, zallahi njerëzore dhe një erë lagështire, që vinte nga mushamatë e qullura dhe që e mbyste erën e cigareve të shtrenjta. Porta e xhamtë rrötulluese, në vërtitjen e së cilës kishte diçka të marrë, shtynte me fletët e saj përbrenda ose përjashta një mori njerëzish. Ai u fut prapa një burri shëmtak dhe, ashtu si ai, hodhi sytë mbi tryezat për të parë ndonjë fytyrë të njobur. Shëmtakut ia bënë me dorë nga një tryezë, kurse ai nuk njobu asnjeri. U ul në një karrige bosh që, e shtyrë midis dy tryezave, nuk dihej kujt i përkiste. Së paku të rri i ngulur në një vend, tha me vete. Të mos shikonte atë karvan ikësish, me ato arkiva sixhadesh sipër kokave të tyre, prej Jévizjes së mundimshme të së cilëve të merreshin men-

dtë. Asnjeri nuk po vinte të shërbente, por ai nuk u shqetësua. Aq më mirë, tha me vete. Së paku të rri i qëtë, i ngulur në një vend. Në fund të fundit, mos kishte bërë gabim që kishte dalë nga hoteli? Maskara.

Padashur, veshët e tij filluan të kapnin fragmen-te bisedash, që shtjelloheshin, fryheshin e derdheshin rrëth e rrotull, duke ndyrë gjithçka. Iu duk se midis tyre dëgjoi emrin e Hamide hanëmit dhe u përpoq të përqën-drohej. Ata flitnin për transferime depozitash floriri, për testamente të bëra me shpejtësi, për ndarje mallëngjy-ese hanëmesh me gjerarkë të lartë fashistë, për ikjen e përgjithshme. Munir beu, pas meningjimit që kaloi, nuk e mban mirë në mend vendin në kopsht ku ka gropo-sur florinjtë. Do të pendohesh, i tha ajo baronit Shvarc. Trembëdhjetë për qind dhe asnjë më tepër. Kopshti është bërë vrima-vrima nga kërkimi i thesarit. Sidoqoftë bankat e Zvicrës, ato janë e vëtmja garanci në këtë katrahurë. Do të pendoheni, përsëriti baroni fjalët e saj. Me sa di unë, Hamide hanëm, të njëjtën frazë ia keni thënë kontit Pontekorvo. Ah, ia bëri ajo dhe i ra të fikët. Trembëdhjetë për qind dhe pikë, asnjë santim më tepër. Në goftë se ju merrni në ma-kinën tuaj dy tezet e mia, ahere ndryshon puna. Po si-kur Zvicra? Puna po stërkeqet. Çfarë Zvicra? Çfarë Zvicra? Jo, jo, asgjë. Mjaft, se na prishët gjakun. Ka një kufi çdo gjë. Së paku hiqeni atë xham nga syri i majtë, tha ajo, pasi erdhi në vete. Më dukeni si gjykatës i fe-rrit. Vaporë i fundit nga Durrësi niset nesër natën. Dhe tani thonë se ai do ta marrë Hamide hanëmin në tankun e tij. Ha, ha, ha, ç'dashnorë! Së paku të siguroja një qerre për dy tezet e mia. Një qerre. Po një qerre tani vlen sa një çiflig. Kisha dëgjuar për dashnorë në gon-dola, por dashnorë në tanke jo. Sa do dëgjosh akoma!

Ai dëgjoi për një kohë të gjatë dhe, ngaqë të gjitha bisedat ishin për ikje, dukej sikur nën secilën prej tyre kishte rrota, zinxhirë, disqe rrotulluese. Dalngada-lë atij po i dukej sikur vetë tryezat e kafenesë kishin nisur të troshiteshin ngadalë me një synim të përher-

shëm për t'u ngritur lart, qetë-qetë, si ai qilimi fluturues i përrallave.

Ky është një purgator, tha ai me vete. Kishte vërtet diçka danteske në këtë lëvizje tur mash, shpirtrash, florinjsh dhe sixhadesh persiane. Veçse ky purgator nuk të conte në asnje parajsë. Qëndronte i palëvizshëm, midis dy kohëve, shungullonte dhe ziente brëndapër-brenda si një kazan.

Papritur zallahia monotone e kafes u duk sikur u gjerris brutalisht nga fjalët: «Tirana Rundfunk!» Një nga bankierët kishte hapur radion. Dëgjimi i emisioneve të lajmeve ishte i detyrueshëm në lokalet publike. Pas lajmeve gjermanisht u bë një pauzë e shkurtër. «Këtu radio Tirana», tha një zë gruaje në gjuhën shqipe. «Po japid emisionin mbrëmësor të lajemeve».

S'qenka zëri i Miriamit, tha ai me vete dhe tendosi qafën për të dëgjuar më mirë.

«Armata e lavdishme e njëzetënjetë e Rajhut ka kaperçyer kufirin e Greqisë dhe po shpejton t'u vijë në ndihmë trupave gjermanë që po mbajnë me heroizëm legjendar Tiranën.»

Hm, ajo paska ditur të tërhiqet në çastet e fundit, mendoi ai. Bravo, Miriam, tha pas pak.

Ai përfytyroi lëvizjen e buzëve të saj për të sajuar fjalët «armata», «Rajhu» dhe buzëqeshi brenda vetes së tij. Ishin nga ato lloj buzësh, në të cilat ndihet përnjëherësh një peshë e ëmbël. Kur ajo, pasi ishin puthur për herë të parë, i kishte mbështetur kokën në sup, ai i kishte pëshpëritur te veshi: Më duket e pabesueshme që buzët e spikeres kryesore të radios, pasi shqiptojnë gjithë ditën gjëra aq makubre, ruajnë aftësinë të puthen kaq ëmbëlsisht në mbrëmje. Ajo, që në kësi rastesh dinte të nazetonte natyrshëm, e kishte vështruar ngultazi dhe, duke kapërcyer një mëdyshje, i kishte thënë: E dini, me mua ka ndodhur diçka tepër e çuditshme. Unë më përpara kam qenë e ftohtë, e ftohtë akull, kurse qysh se filloi kjo luftë, këto lajme makubre, siç thoni ju, për çudi, dalngadalë, dalngadalë... gjithmonë e më tepër... më kuptoni... Ju kuptoja, ju kuptoja aq mirë, kishte murmuritur

ai. Më vonë, sa herë që dëgjonte komunikatat e luftës, atij i kujtoheshin këto fjalë, sidomos në ditët kur komunikatat bëheshin tepër të zymta.

Kurse tani ajo kishte ditur të tërhiqeje. Bravo, Miriam, përsëriti ai me vete dhe u ngrit të dilte.

Jashtë kishte rënë nata. Rruga Mbretërore, e llango-sur aty-këtu nga dritat e forta, të paqëndrueshme të makinave, pas rrëshqitjes apo fikjes të së cilave errësira bëhej edhe më e padurueshme, shtrihej nervoze drejt xhadesë së perëndimit. Në qytet kishte ndalim qarkullimi dhe errësim të detyruar, me përjashtim të kësaj rruge, nëpër të cilën bëhej evakuimi.

Në hyrjen e një restoranti ai u përpilas ballë për ballë me publicistin dhe kritikun letrar Nebil Kaçaj. Kishin muaj pa u parë, qysh nga koha kur tjetri kishte filluar të bashkëpunonte me një gazetë kolaboracioniste. Kishte veshur një xhaketë të trashë me kuadrate të forta, që ishin tepër të modës kohët e fundit.

— He, — ia bëri ai, — kam kaq kohë që s'të kam parë. Si je?

Ishin gjithmonë po ato nofulla katrore, të zgjeruara anash, që të linin përshtypjen se ai mbante brenda tyre një sasi uji ose lëngu çfarëdo, për të cilin nuk po vendoste dot, ta gëlltiste apo ta zbrachte.

— Ku të më shohësh? Gjithë kjo rrëmujë.

— Është e vërtetë, — tha publicisti. — Gjithçka është në rrëmujë. Megjithatë s'ka marrë fund çdo gjë. Armata e njëzenjetë...

— Po, po, porsa dëgjova lajmet.

— Në qoftë se komunistët nuk do të dalin dot gjer të dielën në bulevardin «Musolini», fati i Tiranës do të ndryshojë.

Shkrimtari nuk tha asgjë. Atij iu kujtua bulevardi me ata drurë të lagur, që u ngjanin pelegrinëve mesjetarë (dukej sikur edhe drurët donin ta braktisin tanë atë bulevard), dhe tundi kokën mendueshëm.

— Ti po ikën? — pyeti tjetri.

Shkrimtari ia bëri «jo» me kokë. Ai u përpoq t'i tinëzohej vështrimit të tjetrit dhe disa sekonda u mor me

ndejen e llullës, duke bekuar erën që i shuante shkrepëset.

— S'ke pse të ikësh, — tha Nebil Kaçaj. — Ti je shkrimitar i njojur. Bile mundet që t'u shërbesh atyre që do të vijnë.

— S'është koha për ironira.

— Unë nuk bëj ironi. Ti dhe vetë e di, se kohët e fundit shumë intelektualë janë hedhur te komunistët. Nuk është dhe larg, — shtoi pas pak, — disa kilometra gjer në shtabin e tyre, në periferi të Tiranës.... Megjithëse....

Publicisti ngriti supet, duke hapur krahët, sikur të hapte një parantezë të madhe. Tjetri deshi të pyeste se ç'donte të thoshte me atë «megjithëse», por u druajt se një pyetje e tillë do ta bënte tjetrin të dyshonte se ai po kërkone vërtet rrugën për te komunistët.

Përbri tyre, të hipur bashkë me dengjet mbi makinë, karroca dhe qerre me fenerë të zbetë, vazhdonin të rridhën si lumë ikësit. Ata një copë herë ndoqën me sy lëvizjen e tyre.

— Po ti? — e prishi heshtjen shkrimitari. — Ç'do të bësh?

Tjetri ia bëri «hm», pastaj, duke vështruar, kushedi pse, në drejtim të një rrugine të errët, tha:

— Natyrisht. Ti e di si më quajnë ata: «kolaboracionist». S'kam qejf të dergjem i pushkatuar, me brinjët plot plumba në ndonjë kalldrëm. Ke dëgjuar për terrorin e kuq?

— Diçka kam dëgjuar: Terror rouge. Terror blanc.

Atij iu duk se ishte lehtë ta përfytyroje të pushkatuar një trup të veshur me një xhaketë të tillë me kuadrate.

— Terror rouge. Terror blanc. Është lehtë t'i shqiptosh. A i ke parë rrugicat përbri Rrugës Mbretërore?

— Jo, — tha shkrimitari.

— Eja, ta shohim bashkë njérën prej tyre. S'është as dy hapa larg.

Ata ecën dy minuta, gjersa dolën në krye të një

rrugice të verbër. Në të dyja anët e saj, mbi shtyllat telefonike, kishte të varur. Në gjokse u ishin mbérthyer me gjiplëra pankarta të mëdha, ku ishin shkruar «Komunist».

— Të pushkatuarit i mbledhin me qerre në mëngjes, që pa gdhirë. Kurse këta i lënë gjatë.

Shkrimtari ndjeu një përzierje në stomak.

— Të ikim që këndejej, — tha.

— Ky është vetëm njëri terror, i bardhi, — tha Nebil Kaçaj. — Tipi tjetër, ai i kuqi, është edhe më i tmerrshëm.

— Të ikim që këndejej, — tha shkrimtari. — Më vjen të përzier.

Ai, i pari u ktheu shpinën shtyllave dhe nisi të largohet. Tjetri i vente pas.

— Për çdo shtyllë me të varur do të na kërkojnë llogari neve, — tha Nebili. — Ç'na gjeti!

Mua jo, tha me vete shkrimtari. Vetëm ty.

Vetëm ty. Si një degë e zhveshur që mbushet papritur me lulnajën e re, fjalët ndërruan natyrë. Të lehtësuara, si të mufatura nga muzika e njohur e një tangoje, ato notuan ngadalë sipër ndërgjegjes së tij, bashkë me prarimin e butë të témthave të Hamide hanëmit me ato bukle të verdha, që kundërshtonin gjithçka të zeshkët e të vratëzhdë, që përfonte emri i saj turk. Tani ajo ikën e mbyllur në një tank gjerman, mendoi ai, gruaja më elegante e Shqipërisë, ajo që e kishte të ecurën të lehtë si mijella, mbi takat e saj, gjerryen tanë dheun më putrat e hekurta të tankut. Ç'tmerr!

— E pra, do të shkosh te partizanët? — tha prapë Nebil Kaçaj, kur dolën në Rrugën Mbretërore. Tjetrit iu duk se në zërin e tij kishte ligësi të hapur.

— S'të marr vesh, — u përgjigj, — ç'është kjo pyetje?

— O, mua mund të ma thuash hapur, — tha publicisti. — Të jesh i sigurt se nuk të denoncoj. Le që s'ka kohë, — dhe buzëqeshi me hidhërim.

— Është e vërtetë. S'ka kohë për asgjë. Nofullat e publicistit u mbyllën prapë si të mbu-

shura me atë lëngun që ai duhej ta gëlltiste ose ta zbrazte.

— Ti je i njojur, — tha ai ngadalë. — Ti mund të jesh i vlefshëm pér çdo rend. Megjithëse...

— Çfarë megjithëse?...

Tjetri zgjati buzët dhe anoi kokën. Një çast qëndroi në mëdyshje, pastaj foli:

— Nuk është pak si vonë?

Shkrimtarit iu duk se një gjësim i egër u grumbullua në depozitën e atyre nofullave, që tani iu dukën të neveritshmë. Ai u shpejtua të përfytyronte xhaketën me kuadrate, të shpuar nga plumbat, dhe buzëqeshi me hakerrim.

Terror rouge. Terror blanc, përsëriste me vete, ndërsa ecte nëpër Rrugën Mbretërore, pasi u nda prej tij.

Mua s'më kap asnjeri prej tyre, mendoi. Por ky mendim, pér çudi, nuk i dha ndonjë gjësim. Përfytyrimi i tij, inert, gjysmë i përgjumur e coi në një rrafshirë të shkretë ku endeshin tigra të bardhë edhe të kuq, të dyja palët njëloj indiferentë pér mishin e tij. Asnjë terror, përsëriti me vete. Ai ishte i vëtmuar midis asaj rrafshire ireale.

Në netët e arrestimeve në portën e tij nuk trokëlliten asnjëherë me alarm, qoftë edhe gabimisht. Qëllonte që gjer ndaj të gdhirë nata shndërrrohej e gjitha në trokitje, por ai e dinte se këto këmbana ishin pér tjetërkënd. Ato ishin zëra të një jete tjetër. Kishte çaste mesnatash, që ata tinguj broncorë i dukeshin atij të dëshirueshëm dhe tallës njëkohësisht. Përpara gjëmimit të tyre shurdhues, artikujt që shkruheshin pér të në shtyp, polemikat, gjithë lavdia e tij asgjësosheshin në çast, strukeshin e çngjyroeshin pa mëshirë. Por vinte mëngjesi dhe ai, duke i bërë hile vetes së tij, i mbushte mendjen asaj, se ky ishte fati i tij, se ai ishte tashmë i vendosur, kurse në thellësi të ndërgjegjes e dinte fare mirë se ai e kishte akoma në dorë pér ta ndryshuar atë fat, se ai mund të ndillte tigrat e bardhë me një gjest të vetëm dhe ahore të gjitha boritë e kohës, këmbanat, lehjet e qenve, do të gjendeshin në mesnatë, në një ritual të lashtë e makabër, përpara

portës së tij. Por ai s'kishte forcë për këtë provë. Disa herë ishte përpjekjur pa sukses për këtë, kurse herën e fundit që ishte nisur për të bërë aktin e madh, kishte përfunduar në një dhomë hoteli, i mbyllur me një dash-nore të tij të vjetër.

Nga qendra erdhi prapë një gjëmim i mbytur, ja-shtëzakonisht i gjallë. Ai e cte rrugës krejt i shpërqëndruar, dhe dritat e makinave i binin herë pas here në sy brutalisht si shuplaka. Rruga Mbretërore dhe më tej xhadeja e perëndimit, gjatë gjithë gjatësisë së tyre shtriheshin të kamxhikosura kështu nga fasha drite dhe errësire. Rruga e evakuimit, tha ai me vete. Ndoshta ky do të ishte edhe emri i saj në të ardhmen. Zorra e trashë e këtij vendi. Hm, ja, për një krahasim të tillë atij duhej t'ia falnin asnjanësinë e tij. Ndoshta do të kishin nevojë për të, siç tha pak çaste më parë Nebil Kaçaj.

Te porta e hekurt e një shtëpie pasanikësh gëlonët në gjysmëterr një grumbull njerëzish. Një grua e thyer në moshë, me pamje aristokrate, kishte rënë përbys e po puthë pragun e shtëpisë.

— Mjaft, nënë, mjaft, — i thoshte një djalë i gjatë me borsalinë të zezë në kokë, duke u përpjekur ta ngrinte butësish nga supet.

— O zot, përvëloji ata që po na shkulin nga shtëpitë tona, — rënkonte gruaja. — Uuu...

Asaj, siç duket, i ra të fikët dhe djali i gjatë, i ndihmuar nga dy burra të dobët që ngjanin si shërbëtorë, e futën me kujdes në veturën e madhe, që priste ndanë trotuarit.

Shkulje, tha ai me vete. Kjo është e vetmja fjalë e saktë. Kur afrohet stuhia, secili rishikon rrënjet e tij. Gjatë mbasditës, ndërsa vështronë nga dritarja e hotelit drurët e bulevardit nën shi, i kishin zënë sytë larg, në një rrugicë anësore, një siluetë plake tiranase që po mbushtë ujë me shtamë te çesma. O zot, gati sa s'kishte thirrur ai, edhe ajo plakë atje përtej është më reale, më autoktone dhe më logjike se unë.

Te vutura e madhe e zezë, gruaja që i kishte rënë të fikët erdhi, siç duket, në vete dhe po përpiqej të

hapte derën e makinës për t'u sulur prapë te pragu i portës. Dy shërbëtorët mezi e mbanin.

— Uuu, — lëshonte ajo midis dënesjeve një ulërimë të shtruar.

Ai eci më tutje me hapa të çartallosur, duke u pël-plasur me supe hijesh të panjohurish. Purgator, tha dy-tri herë me vete. Një purgator lëvizës.

— Eja, i dashur, — i pëshpëriti mu te veshi një zë femre. — Thonë se sonte Tirana do të hidhet në erë.

Ai ndjeu dorën e prostitutës t'i kapte dorën e tij lehtazi, ashtu siç dinë të bëjnë vetëm prostitutat e vërteta, për ta lehtësuar partnerin nga mëdyshja.

— Ndoshta janë netët e fundit që jetojmë, — tha zëri.

Ai e la dorën e tij të kapej prej gishtave të saj (një byzylyk i ftohtë ishte aty, midis), por nuk ktheu as kokën për ta parë.

— Porsa jam ndarë me një shoqen tënde, — tha dhe shtrembëroi fytyrën nga neveria për veten, për këtë hak-marrje pas shpine, që po i bënte dashnores së hotelit.

Gishtat e së panjohurës u hapën menjëherë duke e lënë dorën e tij të varej si e prerë.

— Po ç'bredh ahere udhëve, tutkun, — tha zëri, duke u larguar në terr.

Edhe kjo më mungonte, tha ai me vete. Të quhem tutkun nga një prostitutë.

Një drithë verbuese i ra në fytyrë dhe ai mbuloi sytë me dorë, si i plagosur.

Qyteti shtrihej në terr, i ftohur, shurdhan, me një rrugë të vetme të gjallë në këtë orë të natës, me një parandjenë vdekjeje (ca mina të vëna diku thellë në bodrumet e tij, ndoshta në labirintet e kanaleve të zeza), me grupe ushtarësh që flitnin gjuhën veriore të gjermanëve, të ardhur nga larg e të mbyllur nëpër bunkere përmbrojtur atë nga vendësit e tij tremijëvjecarë, me një grua që ndoshta akoma ecte rrugës duke murmuri-tur «maskara». Sa absurde ishte e gjithë kjo.

— I dashur, — dëgjoi ai prapë një zë femre. — A vjen? Thonë se Tirana është minuar.

Ai ndjeu dorën e saj, që, duke mos e gjetur dot në terr dorën e tij, mbeti e varur në errësirë. Përpara një porte të lartë me strehë metalike po ngarkorej një kamion i madh. Shtëpia e Biçakçinjve, mendoi ai. Në dritën e fenerit metalik të portës, midis valixheve të hedhura pa kujdes, përgjumjes së sixhadeve dhe lakuriqësisë së pasqyrave, ai pa një bust merméri, në sytë e zbardhur të së cilit ishte ajo indiferencë dymijëvjeçare, si në gjithë skulpturat antike.

I shkoi nëpër mend se në një natë ankthi si kjo me siguri po iknin thesaret e galerisë së artit, statuja e koleksione të rralla mesjetare. Ai nuk i hiqte sytë nga busti i mermertë, i nxjerrë me siguri nga gërmimet e Apolonisë. Njëherë i erdhi të thërriste: Zbriteni atë bust nga makina, lëreni këtu, ka një konventë ndërkombëtare... Por ky çast ishte i shkurtër, as një sekondë dhe ai murmuriti: C'më duhet mua.

Po në atë çast tha me vete: S'kam bërë asgjë përkötë vend. S'kishte si ta fillonte nga një bust merméri. Vetëtimthi në trurin e tij u skicua plaka tiranase me shami të bardhë në kokë, që mbushte ujë te çesma. Për të ajo ishte më e largët se busti i mermertë.

— A lejohet kalimi nëpër bulevardin «Musolini»? — pyeti një njeri nga xhami i lerosur me baltë, gjysmë i hapur i një makine.

— Nuk e di, — u përgjigj ai.

— Besoj se jo, — tha një kalimtar tjetër nga errësira. — Tani është vonë.

Megjithatë ndoshta nuk është kaq vonë sa thua ti, nofulladerr, tha ai, pothuajse me zë, duke përfytyruar me gjëzim xhaketën me kuadrate mbi trupin e pushkatuar të Nabil Kaçajt.

Ndodhej në fundin e Rrugës Mbretërore. Disa hapa më tej fillonte zona e shtetrrethimit dhe e errësimit të detyruar. Ai ngadalësoi këmbët, por nuk ndaloi. Një mpirje e çuditshme po i ngjitej që poshtë në tërë trupin. Atje është terri dhe vdekja, tha me vete, duke ngulur sytë disa metra më tej, ku fillonte zona e ndalimit. Megjithatë, duke lëvizur mekanikisht, kapërceu rrugën dhe

u fut në mbretërinë e hijes... Ndërgjegjja e tij po binte në gjumë... I shpërbërë, ai po ikte tymthi nëpër terr, një përzierje këmbësh, duarsh, veshjesh e këpucësh, *nature morte* lëvizëse me borsalinë dhe llullë... Aty-këtu nëpër fushëtirën e zezë spikatnin ca forma kryqore, skeletike, me siguri mbeturina rrugësh që dekompozoheshin me shpejtësi në këtë natë prishjeje. Herë-herë, binte papritur bllumb në humbak, ngrihej, çapitej me zor, ah, ah, ndërsa ujet e pellgoreve i rridhte rrëke nëpër kindat e palltos. Pastaj prapë niste ikja monotone nëpër shurdhëri. Anash lëkundeshin tabute të gjata, si kuaj ndërrimi, mbi të cilët ai mund të hidhej në çdo çast, po të lodhej... Në pyettë në ç'kalë hipit, atje ku hipën meiti... Nënë, gati sa s'thirri ai, po kënga popullore ishte larg dhe atij i erdhë ndër mend ajo plakë tiranase që mbushte ujë te çesma, dhe pastaj, kushedi pse, titulli i veprës së tij «Elipset e shtërgjeve», me lajtmotivin e famshëm «në elipset e shtërgjeve sa herë kam vdekur». Para se të vdisje në elipset e tyre, duhej të kishe vdekur tjetërkund, kishte shkruar një G.G. në «Botën e re», në Shqipërinë tonë ka qaq mundësira sakrifikimi. Mos kini merak, tha ai me zë, do t'jua plotësoj edhe këtë dëshirë. Kuajt e ndërrimit lëkundeshin ngadalë nëpër terr, të zinj dhe të gjatë... Në pyettë në ç'kalë hipit... Zoti mësues, zoti mësues, zoti mësues, në ç'kalë hipit Adrian Guma, ahere, në atë natë, tek ajo fushë periferike, atje...

— Ndal! Kush je?

Zëri ishte i ashpër, pak i ngjirur nga lagështira e natës, dhe ai u drodh.

— Kush je, — u përsërit britma nga errësira.

A është e mundur që të kem mbëritur matanë? mendoi ai. Por, në qoftë se s'ke mbërritur, ahere aq më keq për ty, i tha vetës.

— Kush je? Do të shtie, — thirri për të *tretën* herë zëri.

Tani ai u ndërmend njëfarësoj. Dicëka duhet të them, mendoi. Ishte një fjalë, ah, po, ishte një fjalë, shqiptimi i së cilës qe i detyrueshëm, porsa arrije atje, në bregun tjetër. Pérndryshe të priste vdekja. Po, vdekja, përsëriti

ai. Kishte dëgjuar se fjala e parë që duhej shqiptuar ishte pikërisht fjala «vdekje» dhe ai thirri:

— Vdekje fashizmit!

Ja, tani do të shtien, meqenëse ua kujtova vetë këtë punë dhe do të marrë fund kjo histori, tha me vete. Por nga errësira erdhi britma:

— Liri popullit! Duart lart! Kalo!

Ai ngriti duart mbi kokë dhe eci përpara.

— Shpejt. Shpejt, — thirri zëri.

— Mos i ul duart, — thirri një zë tjetër më tutje.

Duhej të ishe stërvitur së paku për këtë gjë, mendoi ai me një qetësi të çuditshme. Asnjëherë në jetë nuk i kishte mbajtur krahët lart për një kohë kaq të gjatë.

— Mos i ul duart!

Përsëri e njëjta britmë e ashpër. Si u gjenda gjer këtu, mendoi ai. Si kishte kaluar kështu, si në ëndërr, mes për mes vijës së kufirit të dy ndërluftuesve gjer në periferitë e Tiranës. Do të donte të kthehej e ta ribënte këtë rrugë realist, kalvar të vërtetë midis britmave dhe plumbave të patrullave gjermane, por tani, ç'ishte për t'u bërë, u bë.

— Kush je? Ç'kérkon?

Ai, i ardhur më në fund në vete, tha emrin e tij dhe kérkoi ta shpinin në shtab.

Zérat në errësirë seç thanë me njëri-tjetrin, «Është një shkrimtar i njohur» tha dikush «Adrian Guma, po, po, i njohur». Një copë herë ata s'po vendosnin ç'të bënин, pastaj dikush thirri:

— Uli duart! Safet, shoqëroje gjer në shtab.

— Ec pas meje, — tha një zë i hollë, me timbër tepër të lartë.

Ai eci i bindur pas njeriut që foli i fundit. Në errësirë, mezi dallohej qafa e gjatë, e hollë si e zogut, e partizanit.

— Mos je gjë spiun? — tha ai, pa kthyer kokën.

Shkrimitari u përpooq të qeshte, por e gjithë kjo iu duk artificiale.

— Para një javë na erdhi një spiun, — vazhdoi partizani. — Kur e kuptoqi që do ta pushkatonim, filloi të

zvarritej kämbadorazi, duke iu lutur herë njërit, herë tjetrit. Ja, tek ajo zgérbonja atje.

Vendi nëpër të cilin ecnin, ishte i pjerrët, plot me kaçube të vogla. Perbri, herë pas here shfaqej një xhade malore. Më tutje ishte një shkarrëzimë.

— Kujdes, ka kufoma, — tha partizani.

Trupat nxinin aty-këtu, ca të nderur e të zgjatur jashtë mase, ca të mbledhur kruspull. Nga qelli vinte një ndriçim i dobët, i shpërqëndruar, dhe ai dy-tri herë ngriti kokën, duke kërkuar më kot ndonjë gjurmë hëne a yjesht në atë quell të pafund. Por nuk kishte hënë, shumë-shumë dukej sikur në të kishin mbetur vetëm gërmadhat e hënës dhe ky ndriçim nuk ishte gjë tjetër, veçse refleks i atyre gërmadhave.

Sytë e tij, të mësuar tani me errësirën, dallonin qartë aty-këtu kufoma gjermanësh, kuaj të vrarë, me këmente, zinxhirë tankesh, që spërdridheshin mbi xhade si zorrë të zeza përbindshash, kamiona të rrëzuar nëpër hendeqet plot me ujë, gryka të lemerishme topash, motçikleta, autoambulanca me kryqe të deformuara sipër, kuzhina fushore, kundërajrorë të rrëzuar brinjazi dhe prapë trupa njerëzish dhe pranë tyre helmeta të rroku-llisura rrëth e rrotull, si lëvozhga të panevojshme.

— Gjermanët u përpoqën të kalojnë këndej, për tu ardhur në ndihmë trupave të Tiranës, — tha partizani.

— Megjithëse me ty s'duhet folur, se mbasë je spiun.

— Nuk jam spiun, — tha ai dhe u habit edhe vetë që foli aq natyrshëm. Ishte i qetë.

Aty-këtu, në gjysmëterr, mezi dukeshin grupe partizanësh rrotull zjarreve të maskuara me kujdes. Ndriçimi i largët i qillit ravijëzonte trubull siluetat e tyre me ato batanijet e mbledhura kular sipër kurrizit. Sa më shumë i afroheshin shtabit, aq më të dendur bëheshin grumbujt e partizanëve. Aty-këtu ndonjë rrezëllim i zbetë zjarri zbulonte me një përflekje të largët, si në tablotë e Rembrandit, fytyra dhe tyta armësh. Ai mendoi se në këtë pllajë me kaçube duhej të ishin shpërndarë batalione të tëra. Ata, të përbysurit, po iknin tani nëpër

Rrugën Mbretërore, karvanë e karvanarë me kujë dhe me sixhadetë mbi koka, kurse këta po dyndeshin drejt bosh-llëkut, me këto batanije të mbledhura kular sipër qafës. Atij iu duk se tërë pllaja ishte e stërpikur nga një prushitje zjarri të pambarim.

— Ndal! Kush je?

Partizani që e cte përpara, tha diçka, dhe rojet i lanë të kalonin të dy. Siç duket kishin arritur në shtab. Ishte një konstruksion i ulët, i gjatë, një lloj garazhi apo ndërtese ferme. Në errësirë dalloheshin rojet.

— Ti prit këtu, — tha Šafeti dhe hyri.

Tjetri qëndroi përjashta, qiri më këmbë, duke i mbajtur sytë larg në vijën e zezë të horizontit. Ndoshta ishte mesnatë, ndoshta mesnata kishte kaluar. Secili e cte mbi këtë glob me një horizont të vetëm, të hapur si një era shkë rrëth kokës së tij. Ishte një orë e tillë ndaj të gdhirë, kur njeriu e kishte më lehtë, se në orët e tjera të ditës, të vendoste një raport sa më real midis tij dhe rruzullit tokësor.

— Ej, shkrimitar, hyr brenda, — thirri një nga rojet.

Ai eci drejt derës dhe hyri në një hajat të madh, të ftohtë, pjesa më e madhe e të cilit ishte kredhur në terr. Një grumbull njerëzish rrinin në këmbë rrëth një tryze të gjatë, të përkulur, siç duket, mbi një hartë. Një petromaks, vendosur mbi tryezë, ndriçonte në mënyrë të egër hartën dhe duart e tyre, duke lënë në gjysmërrësirë kokat.

I porsaardhuri qëndroi në fund të dhomës, pothuajse te pragu i derës, pa guxuar të e cte më tej. Dikush u afrua te tryesa e gjatë dhe tha diçka. Një nga duart që vërtitej mbi hartë me një laps të kuq, la lapsin dhe ngriti petromaksin gjer në nivelin e fytyrës. Drita e petromaksit lëkundi muret dhe tavanin e dhomës, si një tërmët i shurdhër. Prapa llambës i porsaardhuri pa dy sy të çelët, të veshur si me një mjegull të kaltër, që iu duk se po e vështronin ftohtë. Atij iu duk se në faqen e majtë të njeriut që kishte ngritur petromaksin dhe që duhej të ishte komandanti që po sulmonte Tiranën, kishte një prerë, por jo, e prera ishte në sytë e tij. Vonë... Përtë prerë,

para se tjetri ta shqiptonte, Adrian Gumi^s iu duk se e pa atë fjalë me sy.

— Vonë, — tha më në fund komandanti, pa e ulur llambën, — tepër vonë, — shtoi me tepër me keqardhje se me zemërim.

Te dera ai ndjeu një boshllëk në gjoks, një mungesë të madhe brenda organeve të frymëmarrjes, sipër stomakut. E kishte ditur se në këtë botë fjalët janë si ata thasët që nuk e zbrasin kurrë gjer në fund barrën që kanë përbrenda, përndryshe do t'i shurdhonin si gjëmi-mi i motit veshët e dëgjuesve. Por këto fjalë, «është vonë, tepër vonë», e zbrazën mbi të gjer në fund tërë kuptimin e tyre të hidhur. Ai kishte mbetur prapa kohës. Ajo ikte, ikte përpara, dhe humnera midis tij dhe asaj sa vente rritej.

— Megjithatë, — tha me zë të ulët njeriu që mbante llambën në dorë, por ai nuk e dëgjoi atë «megjithatë». Ndoshata, po të kishte parë lëvizjen e buzëve të tij, do ta kuptonte fjalën, por krahu që mbante petromaksin ishte ulur pak, si duket, nga lodhja, duke lënë në errësirë nofullën e folësit.

Pastaj petromaksi u ul mbi tryezë pasi i lëkundi edhe një herë muret dhe tavanin dhe gjithë jetën e tij, dhe ata të gjithë u përkulën prapë mbi hartën ushtarake.

Ai kishte mbetur në rrëthin e hijes. U kthyte ngadalë dhe, pa zhurmë, doli. Safeti doli pas tij.

— Unë po iki, — tha ai, — ti rri këtu, rrrotull. Në mëngjes mund të hysh në punë për ndonjë gjë.

Ai ndoqi me sy shpinën e partizanit që u përpí nga gjysmerrësira dhe mor frysme thellë. Ku jam kështu, tha dy-tri herë më vete. Dhe pse jam. **Ishte i vetëm**, larg mur herë-herë fare dobët nga një hënë anësore. Ndiente amorfë të natës paradigmërore. Dita që po gdhinte, kishte një emër, ishte një e premte, apo një e diel dhe kishte një numër në turmën e ditëve të një muaji, dhe ky muaj, zot i kësaj dite, kishte një emër dhe i përkiste një viti,

që kishte gjithashtu një numër, ashtu siç kishte një numër shekulli ku jetonin; mirépo të gjitha këto i dukej se nuk i përkitin më atij. Në mekanizmin ndarës të tyre diçka ishte prishur dhe ato, ditët, javët, stinët, shekujt, të çliruara nga burmat, derdheshin të gjitha në një grumbull të madh, pa emër, ku s'kishte të shkuar e të ardhme, s'kishte dymbëdhjetënëntore, tregushte, vit një mijë e nëntëqind e dyzet e katër, shekull të pesëmbëdhjetë, të premtë të shtatë prillit... Çështë ky tmerr, tha ai me vete dhe po me atë plogështi iu përgjigj vetes: Është koha jote... e tretë...

Në xhep dora e tij kishte prekur copën e thyer të porcelanit. Pa dale, tha ai pas pak. Këtë vend sikur e njihte. Tani që hëna... Kishte apo s'kishte hënë ahere... Ishte tamam ky vend, ku kishte shëtitur me Miriamin, pas pritjes së madhe të Viktor Emanuelit, pikërisht ditën e atentatit kundër tij. Pallati i nënmbretit duhej të ishte diku, më lart, prapa pyllishtes së vogël. Ajo shtrëngohet ahere pas krahut të tij dhe kërkonte të bënin dashuri në dritën e hënës, një trill i saj i vjetër, kurse ai mendonte për atë plumbin e vogël që kishte tronditur themelet e jetës së tij, bindjet, artin, titujt e librave, gjithçka ishte shpuar, kishte pësuar avari, si vapori i çarë që fut ujë në terr. I qëlluari i vërtetë sonte jam unë. Nuk i kujtohet, ia kishte thënë apo jo atë natë Miriamit ato fjalë, po kjo s'kishte rëndësi. Ajo ishte gjysmë e dehur, historia e hënës mbi gjinjtë e zbuluar e profka të tjera si këto...

Dy-tre vjet rresht ai ishte përpjekjur të gjenjente veten; riparimin e vrimës së atij plumbi të vogël s'e bëri që s'e bëri dot. Ca kohë kishte kujtar se mjaftonte një gjendje e vazhdueshme opozicioni, fraza ironike, disa herë sarkastike nëpër pritje, sallone mondane, që të duket se edhe ai kishte marrë një pozicion të eaktuar, mirépo vonë e kishte kuptuar se kjo nuk ishte gjë tjetër veçse pak më shumë se asgjë, siç thoshte bankieri Rrokaj për shumat e vogla. Kurse, për më tepër, ai s'ishte i aftë. Diçka i mungonte në... rrënjet e tij. Drurët kanë tokën për të hedhur rrënjet, kurse ne kemi klasën që i përkasim, i kishte thënë njëherë një shkrimtar i majtë.

Kurse ai i kishte rrënjet jashtë dhe qdo stuhi, qdo stuhi... oh, ato bëjnë ç'të duan me mua, rënkoi ai me vete.

Para disa orësh kishte provuar shansin e fundit: qe sulur si i marrë midis ndërluftuesve, midis dy kohëve të tyre, si midis Shilës dhe Haribllës, duke braktisur kohën e tij të tretë. Mirëpo se si gjithçka ishte false, dhe shtegtimi ishte ireal, dhe vdekja ishte bërë... hermafredite, rritne mënjanë, duke e lënë të kalonte përmes. S'merrem me ty, thoshte vdekja e njërsës palë. S'merrem me ty, kalo. thoshte vdekja e palës tjetër. Ahere kush do të merrat me mua? gati sa nuk kishte thirrur ai në atë terr, Ti vetë. Këtë zë që erdhi i shurdhër nga thellësitë e tij, bëri sikur nuk e dëgjoi, vetëm se qafa i ngriu si nga një ngërç.

Ishte ftohtë. Ajo arkeologji hëne në qellin dimëror ishte bërë tanë akoma më e largët. Ai eci ngadalë me duar në xhepa. Tejpërtej pllajës mezi dallohej ajo prushtje e shpërndarë e zjarreve të natës. Përbri xhadesë, në rreshta të gjatë e të heshtur, me pajimet në qafë dhe me tytat e armëve sipër tyre po ecte një batalion partizanesh. Njësite të tjera zhvendoseshin aty-këtu në heshtje. Ja pra, këto ishin, me sa duket, Brigadat që po sulmonin Tiranën, E para e famshme, E katërtë, kurse njeriu me petromaks në dorë duhej të ishte komandanti i tyre, për të cilin në kafene «Kursal» ai kishte dëgjuar aq shumë legjenda.

Këta janë, tha ai me vete, duke ndjekur me sy në errësirë ato qafa të ngrira sipër pajimeve. Po ecin, në batalione të panumërtë, si një gjëmim anonim që del nga nata.

C'sjellin vallë ata me vete, mendoi ai. C'drama mbajnë të lidhura, vallë, në ato boçe dhe batanije sipër shpinave të tyre? Për një sekondë, fragmentare, e pikëzuar nga faret e makinave, iu vizatua ndër mend Rruga Mbretërore, ashtu siç e pa në çastin e fundit, me ata që iknin me dramat e tyre të mbështjella nëpër pelice, në-për kularë sixhadesh.

Edhe këta nuk do ta kenë kaq lehtë, mendoi. Tani për tanë enigmat që mbajnë mbi kurriz ndoshta janë të

thjeshta, por do të komplikohen edhe ata një ditë, bata-njet e tyre mund të shndërrohen në sixhade dhe ahere, ahere...

A, po ahere unë s'do të jem më, mendoi ai me vete. Bile jo gjer ahere, unë nuk do të jem më qysh më përpara, më përpara. Në mëngjes mund të hysh në punë përndonjë gjë. Ha, ha, ha. Në mëngjes, mendoi ai, në mëngjes. Ndjeu se në kokën e tij kishte një rrallim mendimesh. Të ngrira, si copëra gurësh të thyer, të ngulur pjerrtazi, mbi një pllajë gjithashtu të pjerrët... Nga i erdhi kështu kjo ndjesi vdekjeje? Gurët po rralloheshin dhe do të rralloheshin, me sa duket, akoma, gjersa të mbetej vetëm një... një gur... mbi të. Këtu pushon shkrimtari i njohur Adrian Guma që...

— Ej, shok, nga vete? Ke humbur batalionin?

Ai pa fytyra të skicuara dobët nga mugëllima e mëngjesit, bajoneta dhe tyta të shkurtra mitralozash të vendosur mbi rrota dhe prapë ato batanijet e tyre bojë-kafe, gri... Kishte ftohtë. Por ajo që i dukej më e padurueshme se e ftohta, ishte ajo mungesa poshtë brinjëve, një boshllëk që dukej se nuk mbushej dot me asgjë në botë. Këmbët i rrëshqitën në tokë të butë dhe vuri dorën që të mbahej. Kishte rrëshqitur në një hendek të cekët plot me gjethë të kalbura. Toka ime, që m'u bëre njerkë, mendoi me gishtat të futur në dhe. Një ngashërim, një lloj sedre e fyter, që ajo kishte aq shumë bij, kurse atë po e braktiste, një hm, do të pendohesh kur të shikosh ç'do të bëj, por do të jetë vonë; pastaj mendimi i hidhur se toka s'pendohet kurrë për asgjë dhe pastaj ai boshllëk poshtë brinjëve, ah, ajo mungesë që ishte më e tmerrshme se prania e çdo dhembjeje, dhe më në fund, befas, sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, takat e një gruaje, që ikte nëpër rrugë, duke shqiptuar vazhdimeshit «maskarë». Mjaft, tha ai, ja, që mos të të dëgjoj ty dhe gjithë të tjerët... Dhe me shpejtësi, sikur nga lëvizja e tij varrej ndalimi i hapave të saj atje larg, ai nxori revolverin dhe e qëlloi veten e tij poshtë brinjëve, pikërisht në atë vend ku i dukej se ishte ai boshllëku i madh, që ai, për

një të dhjetën e sekondës, pati ndjesinë thua se po e mbushte më në fund me diçka.

Nuk vdiq menjëherë. E ndjeu si rrëshqiti butësishët në hendek dhe në fytyrë i erdhi era e mirë e gjethnajës së kalbur. Njëra dorë e tij, me pëllëmbën e hapur, mbanëtë brinjët në vendin ku ishte plaga, dhe me qetësi, me një lloj kapriçio, ai mendoi se atje tanë kishtë një plumb të vogël, një plumbth... fare të vogël... th... th...

Nga lart vinin ca zëra të huaj, që shtjelleshin me spirale të fuqishme mbi një horizont gjëmimtar, si diametri i një humnere. Kush shtiu? Kush shtiu? Asnjeri. Asgjë. Na bënë veshët. Ju bënë veshët, tha ai me vete. Ju bënë sytë. Unë s'kam qenë kurrë. Dhe vdiq.

Në orën katër e givsmë të mëngjesit, pasi fjeti vëtëm dy orë, komandanti i brigadave partizane që po sulmonin Tiranën, doli te pika e vrojtimit të shtabit dhe, megjithëse ishte akoma gjysmerrësirë, vuri dylbitë në sy me shpresë se mund të dallonte diçka. Mëngjesi ishte i zyrtë dhe në lentet e dylbive trubullira e lagësht e tij s'pësoi gjë tjetër, veçse u tkurr, sikur të përmendej edhe ajo nga gjumi, duke zbuluar dobët ravigjëzimin e diçkaje të shtrirë, që mund ta merrje për qytet po aq, sa mund ta merrje për pyllnajë apo mjegullirë nëntori. Ai uli dylbitë dhe u kthyte pas. Te hyrja e shtabit ndeshi me rojën e tij që po i sillte një filxhan kafe. E piu kafenë ngadalë, duke e mbajtur filxhanin të mbështjellë krejt me grushtin që i kishtë ngrirë.

— Më duket se do të kemi prapë shi, — tha.

Roja ngriti supet. Diku anash dëgjohej një zhurmë e shurdhër këmbësh. Sipër kokave të tyre kërcitnin degët e thata nga ngrica.

— Ai njeriu i mbrëmshëm... vdiq, — tha roja, pas shpinës së tij, duke i ngrënë fjalët nëpër dhëmbë.

— Si? — ia bëri komandanti.

— Ai... shkencëtari... apo shkrimitari, çfarë qe, ai që bisedoi me ju.

— E pastaj?

— Vrau veten, para ndonjë ore.

Komandanti nuk e vështroi rojën. Partizani mori frymë i lehtësuar. Nga tendosja e qafës së komandantit ai u përpoq të kuptonte nëse duhej të fliste akoma diçka pér këtë gjë, apo të mos e zinte më ngoje.

Komandanti qëndroi një copë herë pa lëvizur, pastaj, pa u kthyer, tha:

— Mos u sollët keq me të?

— Jo, — tha roja, — aspak.

Tjetri ndenji ashtu ndonjë minutë, me fytyrë të kthyer nga ajo anë, ku duhej të ishte qyteti. Pas pak ai u fut brenda, ndezi një shkrepëse mbi hartën që ishte akoma e hapur mbi tryezë, pa diçka në të, gjersa shkrepësja i përvëloj gishtat, dhe doli prapë. Po gdhinte.

— Domethënë vrau veten, — tha.

— Po, — ia bëri roja. — Aty përtej, në një hendek.

Ne kujtuam se...

Roja e preu fjalën, sepse komandanti kishte ngritur përsëri dylbitë në drejtim të qytetit. I murrëtyer, si i fshirë nga era, ai dallohej tani disi me pullazet, xhamitë, fortinot gjermane, barrikadat dhe vijat e vendosjes së batalioneve, që komandanti i shikonte ose i merrte më mend se ku ishin. Nga mjegulla e mëngjesit dilnin me radhë njëri pas tjetrit rajoni rrëth Bankës, Rruja e Dibrës, ku ishte mbërthyer batalioni i parë, pallatet e princesshave, bulevardi «Musolini», i përkulur pak, si njeriu që midis gjumitështë kthyer në brinjë, këmbanorja e lartë e kishës ortodokse, qendra, ku ai tanku i groposur vazhdonte të shtinte mbi partizanët. Në gypat e dylbive dilnin aty-këtu maja minaresh, dhe atij i shkoi ndër mend se, po të ishte mëngjesi më i kthjellët, mund të dukeshin mbi to çerdhet e lejlekëve. Ai shkrimtari kishte shkruar diçka pér fluturimin e tyre.

Në xhamat e dylbive vazhdonin të dilnin tymtarë të pafund, por pa tym. Qysh se ishte rrëthuar, qyteti kishte mbetur pa dru.

Ty të ra nderi të komandosh çlirimin e kryeqytetit, i kishte thënë dy javë më parë Enver Hoxha në Shtabin

e Përgjithshëm, mos e harro këtë. Duke dalë nga kasollja e shtabit, pasi i kishte dhënë urdhrin, Enver Hoxha bëri një copë rrugë bashkë me të. Binte një shi i imtë. Çizmet e tyre shkelnin pa zhurmë mbi shtresën bojëkafë të gjetheve të rëna, dhe ai përsëritë me vete fjalët e tjetrit: ty të ra nderi të komandosh...

Prapa xhamave të dylbive rrëshqiti qendra e Tiranës, me atë hirnosjen e pabesë të sheshit «Skënderbej», ku ai tanku i ngjuuar në vend thoshin se vazhdonte të përgjakte gjysmën e batalioneve të tij.

Po gdhinte tamam. Pas një ore shtabi do të zhvendoset pothuaj brenda në kryeqytet. Kryeqytet, përsëriti ai fjalën me vete. Krye-qytet. Në asnjë gjuhë nuk i thoshin kështu. Kush e kishte krijuar vallë këtë neologjizëm në shqip? Ndoshta Naim Frashëri... Varri i tij ndodhej diku në një nga kodrat rrëth Tiranës. Në lentet e dylbive vallëzuan trubull kodrina të zhveshura, vreshta dhe ndonjë tyrbe e vetmuar midis. Sa partizanë do të vriten sot, mendoi ai me një pikëllim të ngrirë si një grusht dëbore. Do të vriteshin andej-këndej, nëpër udhëkryqe dhe sheshe të mëdha, ku kishin ndodhur ngjarje kombëtare dhe nëpër rrugica dhe sheshe të vogla, atje ku për qindra vjet rresht s'kishte ndodhur kurrë asgjë e rëndësishme, njerëzit ishin rrezitur në diell, kishin gogësirë dhe, kur kishte ardhur mesdita, i kishin thënë «drekën e mirë» njëri-tjetrit. Pa e ditur as vettë pse, ndoshta nga mendimi i vdekjes së mundshme të shokëve dhe nga këngët dhe balladat e vjetra që kanë gjithmonë ca zogj sipër njerëzve që vdesin, ai vërtiti dylbitë në një rrëth të gjerë, gati të furishëm mbi qytet, por xamat e tyre nuk takuan në asnjë shpend. Iu kujtuan lejlekët që nuk vijnë në qytetet ku ka luftë dhe prej tyre iu kujtua shkrimitari që kishte vrarë veten para dy orësh. Nga larg, ai kishte ardhur që të vdiste aty midis tyre e, megjithatë, ajo vdekja e tij, megjithëse me plumb, se si ishte tjetër gjë, fare e pangjashme me atë rënietë të vërtetë përdhe, kur goja qëllon që të mbushet me baltë dhe nga kjo duket sikur vdekja merr menjëherë peshën e dheut. Ajo e tij ishte një vdekje tjetër lloj, gjithsesi abstrakte, diku në

qiel, midis formave të fluturimit, ah, po, tani iu kujtua, elipset e shtërgjeve, kështu titullohej një libër i tij. Një copë herë komandantit iu përfytyruan vijat ku ishin vendosur sup më sup batalionet dhe, megjithëse kishte kujtuar se e kishte hequr mendjen nga vëtëvrasja e shkrimtari, tha me vete për të: C'vdekje e vëtmuar.

LIBRI I KOMANDANTIT

LIBRI I KOMANDANTIT
DHE PËRFYTYRUA
VJAT KU ISHIN VENDOSUR SUP MË SUP BATALIONET DHE
MEGJITHËSE KISHTA KUJTUA SE E KISHTE HEQUR MENDJEN NGA VËTËVRASJA E SHKRIMTARI,
THA ME VETE PËR TË: C'VDEKJE E VËTMUAR.

KAPITULLI I TRETE

Komandanti i njësitit, Dino Sinojmeri, u afroa te pozicioni i Sherifit duke mos i hequr sytë prej ca fletëve të trasha, që i mbante në dorë.

— E, si duket? — tha. — Na kanë diktuar?

— Akoma jo, — tha Sherifi. — Por vështrojnë vzhdimisht me dylbi nga kjo anë.

— Siç duket, dyshojnë.

Komandanti uli sytë përsëri mbi fletët që mbante në dorë. Në to, midis tekstit të daktilografuar dendur, kishte njoftime nga më të ndryshmet për bulevardin «Musolini», krejt planimetrinë e tij, largësitë midis ndërtesave, udhëkryqet, shenja të tjera që nuk merreshin vesh mirë, skema e kanaleve të ujërave të zeza, prapë tekst i dendur me të dhëna të ndryshme, disa prej të cilave krejtësisht të çuditshme dhe të panevojshme. Hm, ia bënte herë pas here Dino Sinojmeri dhe tundte kokën e gërvishur në tëmthin e djathtë.

Ai lexoi sa lexoi, pastaj ngriti kokën për të vështruar ç'ndodhje në bulevard. Një copë herë qëndroi krejt i pallëvizur, pastaj hoqi syzet dhe fërkoi sytë me kurrizin e dorës.

— Më dhembin, — tha, — më duket se këto syze nuk më bëjnë.

Sherifi qeshi me vete. Në gjithë batalionin, bile edhe në një pjesë të Brigadës tregonin gojë më gojë për his-

toritë e syzeve të Dino Sinojmerit. Atij i thyheshin ato pothuajse në të gjitha sulmet. Pas çdo përpjekjeje, ndërsa të tjerët vraponin të shkulnin nga trupat e gjermanëve të vrarë armët dhe çizmet, ai kthente helmetat pér të parë se mos i vdekuri kishte syze. Kishte mbajtur disa herë syze gjermanësh të vrarë, disa nga ato ishin pér larg, disa pér afër, me numra të ndryshëm, por atij aq i bënte, i vinte dhe pastaj ankohej se i dhembnin sytë. Njëherë kishte mbajtur xhamë pa numër, një herë tjetër syzet e diellit të një zonje mondane, pastaj një palë syze plakash, të modës së vjetër, me zinxhir argjendi, që i varej anash. Dy herë rresht shtabi kishte marrë vendim që komandanti të mos mbante syze, sepse ato dëmtonin operacionet ushtarake. Çështë e vërteta, gjatë një sulmi ai desh ishte vrarë bashkë me katër partizanë të tjerë, sepse gjermanët, që i kishte dy hapa larg, i dukeshin larg nga shkaku i syzeve. Por një herë tjetër, gjatë një sulmi të vështirë, nëpër një ligatinë, duke u hedhur si pér të kapërcyer ndonjë gropë, atje ku nuk kishte as gropë e as hendek dhe duke rënë bllumb nëpër gropë, që, me sa duket, nuk i shihte dhe, sidomos, duke ikur gjatë sulmit me një shtrembërsi të tillë që të tmerronte, ai i kishte hutuar gjermanët dhe i kishte nxjerrë nga pozicionet.

Me bisht të syrit Sherifi shikonte se si komandanti fërkonte akoma ballin me dorë dhe dukej që ishte akoma në mëdyshje, t'i vinte apo jo syzet. Para këtyre kishte pasur një palë syze të mira, por gjatë një përpjekjeje me ballistë e gjermanë bashkë, një ballist mustaqemadh i kishte thirrur që nga larg: «O komandant, të dhjefsha gjyslykët!» Ai qe bërë si i tërbuar dhe gjatë sulmit i kishte hedhur ato tutje. Disa javë rresht nuk kishte mbajtur fare syze, mirëpo para një muaji, në një përpjekje, si pér çudi, të katër gjermanët e vrarë kishin syze. Bëri ç'bëri, ia shkuli njërit nga balli dhe i ngjeshi me furi, sikur të godiste me shuplakë fytyrën e vet.

— Siç duket, s'më bëjnë as këto, — tha duke i vështruar xhamat e plasaritur pér ibret.

— Po mbasse ngaqë kanë plasur, — tha Sherifi.

— Eh, se mos shikoja më mirë kur qenë të paplasura, — tha me një psherëtimë. — Ç'bëhet në bulevard? — pyeti pas pak, duke drejtuar nga Sherifi sytë e tij që dukeshin të lodhur e të shpëlarë, si sytë e gjithë mio-pëve.

Sherifi ndjeu një dhemshuri të madhe për të. Si mund të shikosh me sy kaq të lodhur? mendoi.

— Hë? — ia bëri komandanti.

— Duket si qetësi, — tha Sherifi. — Vetëm se rojet mbi tarracën e Radiostacionit vështrojnë vazhdimisht me dylbi këndej.

— Eshtë e qartë se na kanë diktuar, — tha komandanti dhe me një gjest të vendosur vuri syzet. — Së shpejti do të fillojë. Duhet ngritur barrikada.

Në bulevard po kalonte me zhurmë shurdhuese një tricikël. Mbi të ishin dy gjermanë. Njëri prej tyre, ai që ishte futur në kosh, kishte syze. Komandanti e ndoqi një copë herë me një vështrim lakmitar.

Kur tricikli u largua, ai pa orën. Ishte nëntë e çerek.

— Së shpejti ka për të filluar, — murmuriti dhe u largua me hapa të shpejtë.

Në orën nëntë e gjysmë, në kryqëzimin e rrugës «Rilindja» me bulevardin «Musolini», dy njerez me bor-salina të vjetra, që mezi po ngrinin një lavaman të bardhë, e lëshuan atë papritur përdhe. Lavamani mbeti i rënë përmbyss në mes të rrugës, ndërsa njerezif u larguan me shpejtësi. Pas pak nga një derikë aty pranë dikush shtyu pranë lavamanit një rrotë të shkallmuar qerreje, në kohë që nga drejtimi i kundërt një djalë e një vajzë hodhën po në atë vend, njëri një thes të mbushur, sic duket, me rërë, tjetra një qilim të vjetër, që gjer në atë kohë bënte sikur po e shkundte te porta e shtëpisë. Ata nuk ishin larguar mirë akoma, kur mbi grumbullin e por-saformuar u lëshuan me shpejtësi nga duar kalimtarësh karrige, tulla, kolltukë të vjetër, kazanë, flokse, gjyma dhe një perde e rëndë kadifeje. Po në atë çast, nga një fortino e anës tjetër të bulevardit, barrikada që porsa

kishte lindur, u godit me një breshëri mitralozi të rëndë.

— E pikasën, — tha Dino Sinojmeri, — duke shkulur syzet nga balli. — E pikasën, qentë.

Një djalë i ri me pamje studenti, që në atë çast po i afrohej barrikadës krejt i përkulur nën një thes me rrërë, e hodhi thesin përdhe, u shtri dhe vetë pas tij me lëvizje të prera të një gjimnazisti në sallën e palestrës dhe, duke nxjerrë gjithë gëzim një revolver të vogël, shthiu tri herë në drejtim të fortinos.

— Hej, c'qerrata, — tha Dino Sinojmeri. — E inauguroi barrikadën. Kujdes tani, more djalë, kujdes, mor pöllumb. Gati ju të mitë, — thirri ai me zë të lartë.

Te muri i jashtëm i depos partizanët ishin bërë gati me kohë.

— Zjarr, — tha Dino Sinojmeri. — Kjo punë filloj. Bjeri t'i biem.

Breshëria e armëve ishte e rëndë dhe e gjatë. Kur ajo pushoi një sekondë, u dëgjuva rrapëllima e xhamave të thyera të dritareve të Radiostacionit, që vazhdonin të binin akoma si mbeturina të një shiu të furishëm.

— Hajde, me hajër, — thirri përmes krismave Dino Sinojmeri dhe ngjeshti syzet në ballë.

Gjithë paraditen, me përjashtim të disa pushimeve të shkurtra, midis barrikadës dhe fortinos u këmbye zjarr i pandëprerë. Në barrikadë luftonin guerrilierët e lagjes dhe vetëm disa partizanë të njësitet, kryesisht mitralierë. Gjithë pjesa tjetër e njësitet rrinte në pozicionet e vjetra, e gatshme për sulm, ose për ta mbrojtur barrikadën nga anët, në rast sulmi të gjermanëve. Një pjesë e partizanëve mbanin në goditje të vazhdueshme tarracën e Radiostacionit, për të mos i lënë rojet gjermane ta qëllonin barrikadën nga lart.

Qarkullimi i gjermanëve në bullevardin «Musolini» ge blokuar krejtësisht. Ky ishte edhe qëllimi fillestar i barrikadës. Nga e djathta, në drejtim të Bankës së Shtetit dhe në anën tjetër, diku pranë Kishës së Re, po dë-

gjoheshin gjithashtu breshëri të vazhdueshme. Me sa dukej, edhe atje po ngriheshin barrikada. Gjëmimet e armëve, herë të mprehta, herë më të fuqishme, sipas gurmazit të tytave që villnin zjarr, sa vente dendësoheshin. Herë-herë buçitja e bombave ndërpriste e shurdhonte për ca çaste gjithçka, pastaj prapë çdo gjë fillonte nga e para.

Dalngadalë, Bulevardin «Musolini», duke filluar nga kreu e gjer në fund, si një piton të madh po e përpinte lufta.

Dino Sinojmeri, mos u hidh në aventurë. Radiostacioni është një gjë e rëndësishme për gjithë Shqipërinë. Duhet të sulmosh ahore kur të vijë çasti, jo sulm orë e pa kohe, se unë ta di kokën, ti, edhe kur shkon per te fjetur, thua me vete: sulm për në gjumë.

Ndërsa thyente gishtat gjithë nervozizëm, komandanit të njësitet i vinin ndër mend fjalët e komandanit të brigadave që po sulmonin Tiranën, kur e nisi për të marrë Radiostacionin.

Se mos unë nuk ta di kokën ty, tha me vete gjithë millef Dino Sinojmeri. Se mos ti nuk e ke mendjen te sulmi. C'po i bën kësaj Tirane, që ke dy javë që po e lot nga mendja, a nuk po e sulmon? Po ç'ti bësh, je komandat e s'ta vëmë re. Si puna e atij që thotë: bëj si them unë e mos bëj si bëj unë. Mos e ki mendjen te sulmi, thua ti. Po ku ta kesh atë të zezë mendje, përvëçse te sulmi? Ahore më mirë të mos kesh mendje fare.

Te dera e shtabit, duke e zhbiruar me sy, komandanti i brigadave i kishte thënë edhe një herë: Dëgjo, Dino Sinojmeri, unë e di që disa ta kanë ngjitur emrin Dino Sulmi, por mba mend një gjë, aventurën mund të ta falja në ndonjë pyll a në ndonjë bokërimë, po përrpara Radiostacionit nuk ta fal kurrë.

Po mbasë edhe ai s'ka faj, tha me vete Dino Sinojmeri. Mbase edhe atij kështu i ka thënë komandanti i përgjithshëm, i madhi fare, Enver Hoxha: Ngutjen s'ta fal përrpara Tiranës. Kujdes me sulmin. Kurse vetë bëje

tym e flakë gjithë Shqipërinë. Dridhe si tërmetet e kaluar tërmetit. Eh, ç'vete!

Ej, ç'vete, përsëriti ai midis një psherëtime. Megjithëse, e qetësoi veten pas pak, a s'i jap unë të njëjtat këshilla Mete Aliut përpara sulmeve? Kështu është kjo punë, shkallë-shkallë e sérë-sérë.

Ai tundi kokën një copë herë sikur të përkundte përpara buzëve murmurimën e tij. Kjo ishte nga ato murmurima, që prapa pakënaqësisë së jashtme nuk fshehin vëçse një gëzim të brendshëm. Ai e dinte se, pavarësisht nga paralajmërimet për urtësi, ishte dërguar këtu për të bërë sulm, dhe sulmi ishte i tij dhe nuk ia hqin dot. Megjithatë atij i pëlqente të ngacmonte vërveten dhe të hiqej si me sedër të fyter, sepse kjo ia shtonte kënaqësinë për ngjarjen që kishte përpara.

Kështu pra, asnjë ngutje, rikujtoi ai fjalët e fundit të komendantit në çastin që u ndanë. E, mirë, mirë, tha, nuk do të ngutemi. Do të presim kohën e sulmit. Do ta zëmë urtë e butë. Do të hamë njëherë drekë. Pa do të mbledhim një çikë veten. Pa do të dërgojmë mbasse edhe ndonjë lajmëtar te gjermanët: E, o gjermanë, a jeni gati, sikur ta fillonim një çikë atë luftën që kemi për të bërë? Hm, se kështu na u dashka tani. Urtë e butë. Urtë e butë. Eh! gati sa s'thirri ai. Këndo, o muzë, zemërimin tim, tha me vete dhe, për të hequr mendjen nga puna e sulmit, nxori nga xhepi ato fletët e daktilografuara. Asnjëherë nuk kishte parë të dhëna aq të vlefshme të përziera me gjëra po aq të pavlefishme.

Shtrimi i bulevardit kanisur në vitin 1927 sipas projektit të një shoqërie anonime dhe është bërë me metodën Shnejder. Shtresa e gurëve nën zhavorr dhe asfalt ndodhet në thellësinë 15 cm dhe ka një trashësi 40 cm. Në rast nevoje të nxjerrjes

së gurëve për ndërtim bari�ade, të kihet parasysh se spërkatja e tyre me serë është bërë me metodën Spruc 3. Në mitin-gun e inaugurimit, që u bë me 15 prill të vitit 1931, ku merrte pjesë gjithë shoqëria e lartë e kryeqytetit, kryetari i

Bashkisë së Tiranës tha midis të tjerash: Qoftë ky bulevard monument i përjetshëm i miqësisë italo-shqiptare, blerofshin në jetë të jetëve gështenjat në trotuaret e tij, u dashurofshin njerëzit nën to dhe e keqja mos mbërriftë kurër gjer këtu. (Kurse fjalët «kam parë qyte-

te pa bulevarde, por s'më ka qëlluar të shoh bulevard pa qytet», që u pësh-përit se i tha atë ditë shkrimtari Adrian Guma, duke bérë aluzion përmungesën e ndërtesave përskaj bulevardit, është vërtetuar se janë thënë një vit më vonë dhe përnjë tjetër bulevard, Të madhin.)

Hm, ia bëri Dino Sinojmeri, blerofshin në jetë të jetëve gështenjat në trotuaret e tij. Për shkak të plasartjes të xhamave të syzeve bulevardi i dukej atij qysh tani i çarë e i masakruar tejpërtej. Por në ato çarje kishte një rrezëllimë të shndritshme, që përftohej prapë për shkak të qelqit të syzeve. Ai u përpoq të përsftyronte se si nën atë asfalt të butë, 15 cm thellë, si vertebrat e panumërtë të një rrëshqanori të madh, shtriheshin gurët dhe zhavorri. Në rast nevoje të nxjerrjes së gurëve për ndërtim barrikadash... Vështrimi i Dino Sinojmerit u anua vetveti nga barrikada, që ishte bërë akoma më e lartë tani. Midis rrangullave dukej një sepet i madh, si ato të pajave dhe një sofër buke e rrumbullakët. Ajo sofër i kujtoi atij shtëpinë. Popull i mirë, mendoi, që sjell në barrikadë çdo gjë, gjer te sofra e bukës. Dino Sinojmeri mori frymë thellë. Ja, këto gjëra s'mund të parashikoje ti, o borgjez matuf, shau me vete. Më tregon mua ku duhet të gërmoj e sa duhet të gërmoj për të nxjerrë gurë për barrikadën. Mi arkivash, të shohim ç'shkruan më tutje.

Ndërtesën e parë me salë të madhe balloje, stil barroko, e ndërtuan Ali-zotajt (ajo tani mban numrin 141). Salla e ballos

u inaugura me një *ziqër* nga sekti i rufainjve. Qenë ftuar shumë dinjitarë të lartë, midis të cilëve ambasadori i Anglisë me

të shoqen. Mbetën me gjë hapur. Pallati përbri, Nr. 143, i përket Fiqiri beut, që ndërtoi i pari në këtë rrugë hamam dhe oxhak englez. Të dy pallatet kanë kollonade të trasha mermeri, **bodrume** (ku mund të vendosen mina) me kalime të fshehta me lartësi 1,20 m, ku mund të ecë një njeri i përkultur (pasi të ketë hequr armën nga supi). Më 1931 bankjeri Rrokaj ndërttoi përballë tyre Pallatin

Rahat me vend të posaçëm lufte (karakoll) në katin e sipërm, sipas traditës së kullave të malësorëve. Vec kësaj, ai bëri një pishinë (2.25 m, të thellë) në kopsht. E para grua që u la në **pishinë** ishte e shoqja e ministrit të Jashtëm, zonja D. Zh., që, në atë kohë, thuhej se kishte marrëdhënie intime me bankjerin. Kostumin e saj të banjës e përgojuan për një kohë të gjatë.

Tek po i mbledhite shuk fletët për t'i futur në xhepin e xhaketës prej lëkure, Dino Sinojmeri kërkoi me sy midis barrikadës komisarin. E dinte që ai i kishte qejf shkrimet e këtij lloji dhe kishte dashur t'i komentonin e të qeshnin së bashku me të, mirëpo qysht nga mëngjesi nuk kishte gjetur asnë rast. Pjesën më të madhe të kohës komisari e kishte kaluar në barrikadë. Ja dhe tanë dukej mjekra e tij e gjerë e mbështetur te mitralozi, prapa një mangalli prej bakri. Siç dukej, mangallin e kishin hedhur në barrikadë bashkë me hirin, sepse tullat pranë tij, ca frona dhe vetë fytyra dhe flokët e komisarit ishin pahitur prej tij. Kur të vijë, do t'ia tregoj patjetër, mendoi Dino Sinojmeri.

Lavamani i bardhë, një pjesë e të cililit dukej akoma midis rrangullave të tjera, të hedhura si një mal mbi të, ishte sfilitur krejt nga plumbat.

— S'kenka prej porcelani, — tha Javeri, — ndryshtë do të qe bërë copë-copë.

Sherifi e la dorezën e mitralozit të rëndë dhe vështrroi nga ana e barrikadës. Iu duk se tyta e mitralozit qe nxehur shumë.

— Do të jetë me siguri prej xingoje, — tha Javeri.

— Gjithë breshërëtë i bien atij, sikur ta kishin më inat, — tha Sherifi.

— Kanë njëfarë të drejte, — tha Javeri. — Ai ishte, në një farë mënyre, fillimi i barrikadës.

— Ishte si puna e vezës që bëri pulën.
Javeri e vështroi i habitur shokun.

— Shih, shih, ku të vete mendja, — tha, — e di që e the bukur?

Fytyra e Sherifit u skuq nga kënaqësia.

— Ia kam frikën asaj vajzës së re atje, — tha i gjallëruar, duke bërë me kokë nga barrikada. E nxjerr kokën si shpesh që prapa tullave.

Një copë herë ata vështruan në heshtje njerëzit e barrikadës. Ashtu si në fillim, shumica e tyre ishin qytarë tiranas.

— Sherif, — tha pas pak Javeri me zë të butë, — a më lë të shtie një herë me mitraloz?

Sherifi u përtyp nëpër dhëmbë.

— E pse? — tha.

— Ashtu kot. U mërzita duke pritur të përdor këtë antitankun tim. S'besoj se ata do të dërgojnë këtu tanket.

— S'dihet, — tha Sherifi.

— Pastaj, e di çfarë? Në qoftë se vijnë tanket, edhe unë do të lë të shtiesh me këtë, — dhe i ra më pëllëmbë tytës së antitankut.

— Vërtet? — tha Sherifi.

— Të betohem. Për ideal.

Sherifi u zhvendos nga e majta dhe Javeri u afroa te mitralozi, siç do të afrohej një i uritur te një sofër e madhe, ku nuk di q'të prekësh më parë. Mbështeti gjoksin te doreza, u puthit i gjithi pas hekurit të mitralozit sikur të donte të bëhej një me të dhe shkeli këmbëzën. Pati ndjesinë se breshëria doli drejt e nga qenia e tij. U puthit akoma, dhe kjo ndjesi iu forcua edhe më. Gjithë bota përreth pushoi së qeni, me përjashtim të ballit të fortinos ku goditnin predhat e mitralozit. Pastaj, duke i mëshuar me gjoks shtratit të armës, Javeri e ngriti ngadalë tytën e mitralozit drejt dritareve të mbetura pa

xhame të Radiostacionit dhe pastaj, edhe më lart, në katted e sipërme, te tarraca, gjer në tangentet dhe spiralet e antenave. Plumbat fluturonin larg, si rekëtima zemre, drejt qendrës së qiellit dhe të botës. Javeri ishte si i dehur dhe mbylli sytë përgjysmë, tamam në çastin që nga barrikada erdhi një britmë e gjëzuar:

— E këputi. Ra, ra.

Një nga antenat kishte rënë dhe po lëkundej akoma, gjysmë e varur te parapeti i tarracës.

— Mjaft tani, — tha me zë të butë Sherifi, duke e prekur shokun në sup.

Javeri u shkëput nga mitralozi me një psherëtimë kënaqësie.

Tek ata erdhi me vrap Teuta me radion e vogël në dorë.

— S'flet më, s'flet më, — thirri ajo, duke ua treguar radion të gjithëve. — Kush e këputi antenën? Ti, Sherif?

— Jo, — tha Sherifi, pak i pezmatuar, — Javeri.

Teutës i ishin skuqur faqet dhe merrte frymë me shpejtësi.

— Unë isha duke dëgjuar, — tha, — e dini se çfarë po thoshte? Partizanët, që nuk janë larë prej kohësh, do të kenë rastin këto ditë të marrin një banjë gjaku në bulevardin «Musolini». Bul... dhe trak, zéri u pre.

— U këput. Ra, — vazhdonte të thërriste një zë i gjëzuar nga barrikada.

Duke vrapuar përgjatë murit, se nga mbiu pranë tyre Mete Aliu. Ishte plagosur fare lehtë në vetullën e djathë.

— Dëgjova se ajo s'ka më zë, — thirri duke marrë frymë me zor. — Tani që s'hyn më në punë, ma jep mua, — dhe, pa pritur q'do të thoshte Teuta, ai ia rrëmbeu radion nga dora.

— Tani ta rregulloj unë qejfin, moj bushtër, — vërshtelleu nëpër dhëmbë. — Na ke sharë, ë? Š'ke lënë gjë pa thënë, ë?

— Mos, Mete, — tha Teuta dhe u përpoq t'ia rimerr-te radion nga duart, por ishte e pamundur.

Me një lëvizje të vrullshme Mete Aliu e kishte shqyer pjesën e prapsme të radios.

— Kujdes, Mete, se do të të zëjë korenti, — tha Javeri duke qeshur.

Mete Aliu ktheu dhe një herë kokën nga barrikada, si për t'u siguruar që komisari qe atje.

— Tani, moj bushtër, do të t'i jap leshrat në dorë, — thirri, dhe dora e tij e djathtë shkuli një tufë telash që nga brendësia e kutisë.

— Qyqja, — thoshte herë pas here Teuta, — ai po lot mendsh.

Sytë e saj levarashë kërkonin sa andej këtej sytë e të tjerëve, si pér të kuptuar prej tyre se a mund të qeshej nga kjo që bënte Mete Aliu.

— U u u, — ia bëri në këtë kohë Memeci.

— Ç'ke, Memec, — tha Javeri.

— U u u, — ia bëri prapë tjetri, duke treguar me kokë udhëkryqin. Nga barrikada po tërhiqnin një njeri të vrarë ose të plagosur. Ishte ajo vajza tiranase. Gjatë tërheqjes një këmbë iu zbulua gjer te mesi.

— E thashë unë, — tha Sherifi, duke kthyer kokën mënjanë pér të mos parë këmbën e zbuluar të vajzës, — ia kisha frikën asaj vajze.

Jo shumë larg Radiostacionit, në të njëjtin tro-tuar, ndodhet pallati i Regjencës, që më parë ishte pronë e monsinjor Toçit. Më 1940 bodrumet e verës u adaptuan pér strehime kundërajrore. Nga tarraca e tij shihet në vijë të drejtë tarraca e Radiostacionit. Në verandat e pallatit, në prill të vitit 1938 u vendosën

dhuratat e mbretit Zog, të dërguara nga Selia e Shenjtë e Vatikanit, Patrikana e Stambollit, kryemiftiu i vendeve arabe, kryegjyshi botëror i bektashinjve, Urdhri i Jezuitëve japonezë, Dalaj Lama i Tibetit etj. Po në këtë verandë, ditën e dasmës së monarkut bajraktarët e viseve të Veriut kënduan rapsodi epike me lahitë.

Gjithë pallati është i rre-thuar me kangjella të he-kurta që mund të shër-

bëjnë për pengesa anti-tanke. Në kopsht ka trëndafila të egër.

Këndo, o muzë, idiotizmin e botës, tha nëpër dhëmbë Dino Sinojmeri. Me sytë e lodhur vështroi një copë herë përmatanë murit pamjen e bulevardit. Po afronte mbas-ditja. Një dritë e shpëlarë, nënprodukt i fundit i dritës diellore, kishte rënë mbi kangjellat e hekurta, prapa së cilave shatërvanët e ftohtë, të shtetur tani, dhe trëndafilat e egër, të mbetur prej kohësh pa lule, dukeshin si të balsamosur. Komandanti i njësit mendoi se ky bulevard ishte i gjatë dy mijë e katërqind metra dhe, sa të thyhej pak dita, në gjithë gjatësinë e tij, mbi atë ronitje mospërfillëse gjethesh, metër për metër, pëllëmbë për pëllëmbë do të derdhej gjak.

Ai hapi prapë letrat e daktilografuara dhe u hodhi një sy skicave të vizatuara aty-këtu midis tekstit. Ishin prapë viaj që tregonin me hollësi largësitetë midis ndërtuesave, gjerësinë maksimale dhe minimale të bulevardit në pjesë të ndryshme të tij, rrathë, brenda të cilëve që shënuar diametri i shesheve dhe i udhëkryqeve. Kishte edhe gjithfarë shënimesh të tjera, shumica të përcudshme. Ai lexoi itinerarin e fshehtë që bënte Hamide hanëmi me fytyrë të mbuluar me një vello të zezë, për të shkuar në *rendez-vous* me kontin Pontekorvo. Sipër vijës që mbaronte me shigjetë, ishte shënuar në dy-tri vende: H. hanëm, H. hanëm, kurse sipër vijës tjetër, gjithashtu me shigjetë në majë, që vinte nga drejtimi i kundërt, që shënuar: Konti, Konti, Konti. Në pikën e takimit qe një kryq i vogël. Në një fletë tjetër, përbri një elipsi të vizatuar me kujdes, ishte shkruar: «pishina ku u mbyt bejleresa plakë Gjyslihan, pas përfundimit të gjyqit të trashëgimisë së Kasimatajve.

Pëllëmbë e krim, mendoi Dino Sinojmeri, duke i futur letrat në xhepa. Kush i kishte bërë, vallë, këto shënimë? Me siguri ndonjë borgjez matuf i bashkuar me Lëvizjen. Jashtë vullnetit të tij ai përfytyroi një pishinë me ujë të zhbrosur në një ditë dimri dhe bejlereshën

plakë, që afrohej në buzën e saj. Ç'istorira do të jenë varrosur këtu, tha me vete. Ai borgjezi maniak dukej sikur kishte jetuar me syrin të ngulur mbi këtë bulevard. Me siguri mendonte të shkruante kronikën e tij. Pëllëmbë e krim, përsëriti ai me vete. Sonte, ose e shumta nesër, ne do të luftojmë mbi fantazma.

Ai pa orën. Ishte tre e gjysmë. Nga fortinot e qendrës vinte vazhdimisht një rropamë e mbytur. Në barrikadë kishin ardhur guerrilierë të tjera nga lagjja. Kishët e një të vdekur. Ç'ditë e gjatë, mendoi ai.

Koha mezi ecte dhe ai mbështeti ballin te bërryli i djathhtë për të dremitur qoftë edhe disa minuta.

— U u u, — ia bëri Memeci.

— Ç'ke, Memec, — tha Javeri.

Memeci kishte ngritur qafën dhe po mbante vesh. Në sytë e tij kishte një drithë alarmante.

Sherifit iu duk se dëgjoi një gjëmim të thellë, por ai nuk qe në gjendje ta përcaktonte nga vinte ajo: diku nga bulevardi apo që brenda kokës së tij.

— U u u, — ia bëri prapë Memeci, këtë herë me një zë të mprehtë, si prej shpendi.

Javeri gjithashtu kishte ngritur kokën dhe po mbante vesh. Sherifi u mat të hapte gojën për të pyetur nëse dëgjohej ndonjë zhurmë apo i bënin veshët, kur një zë nga kreu i pozicionit thirri:

— Tanket.

Ata dolën papritur nga një rrugicë pas shpinës së Radiostacionit dhe u sulën drejt barrikadës. Ishin dy. Pas tyre vraponin një grup gjermanësh. Predhat e para të topit të tankut, që ranë mbi barrikadë, e prenë mes përmes komisarin.

— Pushkët antitank. Shishet me benzinë. Zjarr, — uluriti Dino Sinojmeri.

Vështrimi i tij, i zbehur nga dhembja, kaloi vetë-timthi nga tanket te trupi i vdekur i komisarit. Copérat e mangallit të shkallmuar qenë përzier me atë trup dhe, me siguri, hiri po ngopej tanë me gjakun e tij. Brenda

sekondës, të pëlekura bashkë në një rrrotullamë të furi-
shme, Dino Sinojmerit iu përshëndit në mend gjithçka e
moçmë për vatrën, vjersha dhe këngë të hershme patrio-
tike, përpara vatrave të vdeesimë, rilindasit, traktet e
para, armiku po na shkel vratat tonë dhe pastaj, pas këtij
lëmshi ndjesish, pak më i qetë pllakosi mendimi se sho-
ku i tij, komisari, porsa ishte vrarë te një mangall, pra
te një vatër, dhe hiri i saj po binte tanë qetësish mbi
plagat e tij.

— Bjeruni, — thirri ai, por, megjithëse thirrja ishte
aq e fortë, sa i dha një dhembje në ballë, ajo u mbulua
prej zhurmërisë së tankeve.

Ata po afroheshin njëri pas tjetrit. Toka filloi të
dridhej. Javeri qëlloi një herë, dy herë. Tanku që e cte në
krye, ishte më i vogël. Tjetri, ai që vinte pas me gru-
mbullin e ushtarëve pas vetes, dukej si lubi. Një shishe
me benzinë ra dhe shpértheu në flakë përpara tankut
të parë. Tjetra, e hedhur nga barrikada, i ra mu mbi
kullën e hekurt, po nuk plasi. Tanku i bëri një mënjan-
nim flakës dhe eci përpara.

— Granatat, — thirri Dino Sinojmeri.

Granatat ranë si breshër rrreth e rrrotull tankut, por
ai nuk ndaloj.

— Hidhini në zinxhirë, — thirri komandanti. —
Vetëm në zinxhirë.

Javeri qëlloi përsëri me antitank. Një partizan tjetër
qëlloi me antitank nga kreu i pozicionit. Për çudi, si ajo
kafsha që midis qindra zhurmave të skëterrshme është e
aftë të dallojë me anë të nuhatjes të vetmen zhurmë
vërtet të rrezikshme për të, tanku qëndroi në vend, disa
metra larg barrikadës. Javeri qëlloi për të katërtën herë.
Partizani tjetër gjithashtu. Motori i tankut hungriu midis
një shfryrjeje tymi dhe trupi i hekurt u kthye në fillim
ngadalë, pastaj, me një rrrotullim të egër, mbrapsht.
Dy-tri granata të hedhura prej barrikadës i ranë përsipër,
tek ikte.

Tanku tjetër, i madhi, që vinte pas, bëri një mënjan-
nim për të mos u gërvishur me shokun që po kthe-
hej dhe u vërvit përpara, drejt barrikadës. Po ndërkaq,

nga benzina e derdhur, gjithë sheshi përpara barrikadës ishte në flakë. Tanku qëndroi në vend, hungroi dy-tri hërë, pastaj filloi të zbythej me marshin e mbrapmë, ngadalë, për të mos shtypur, siç duket, ushtarët e vet, që po iknin mbrapsht gjithashtu, duke shtirë në ecje e sipër.

— He, he, qen i qenit, po ikën, — thirri një partizan dhe, duke shkulur një bombë nga mesi, u ngrit nga pozicioni për t'u sulur në ndjekje të tankut. Po nuk arriti të bënte as hapin e dytë, se një predhë e topit të tankut i shkatërrroi pothuajse krejt kokën. U dukën vetëm dy krahë që u ngriten përpjetë me boshllékun e tmerrshëm të krijuar nga mungesa e kokës, në mes, dhe trupi i partizanit ra në tokë me një kënd të pjerrët.

Ç'mbasdite e fëlliqur, murmuriti Dino Sinojmeri. E gjatë si bishti i lugatit. Ai shikonte orën çdo minutë dhe në këtë zvaritje të mbasdites shikonte një maskarallëk në paparë. Në muzg duhej sulmuar fortinoja që mbronte Radiostacionin. Pa shkatërruar atë, as që mund të bëhej fjalë për sulmin kundër vetë Radiostacionit. Gjermanët e kishin kuptuar rrezikun dhe kishin sulmuar të parët.

Në pjesën më të madhe të tij bulevardi «Musolini» gjëmonte nga krismat. Në mbrëmje ai do të ishte i gjithi në luftë, kështu që në mesnatë Dino Sinojmeri mund të sulmone Radiostacionin, pa u rrezikuar të kritikohej për ngutje nga askush. Mirëpo në fillim duhej të shkatërhohej fortinoja.

Nga barrikada kishin tërhequr të plagosurit dhe trupat e të vrarëve dhe po sillnin thasë të tjerë me baltë, tulla dhe rërë. Njësiti ishte bërë gati për sulm kundër fortinos. Pritej vetëm rënia e muzgut.

Në muzg, tamam në çastin kur njësiti do të hidhej në mësymje për të shkatërruar fortinon, gjermanët sul-

muan përsëri. Porsa Memeci ia bëri «u u u», dikush nga krahu i majtë i pozicioneve thirri: «Tanket».

Këtë herë zhurma vinte më e rëndë dhe më e shtruar. Ata dolën, si edhe herën tjetër, nga rrugica, pas shpinës së Radiostacionit dhe, të ndjekur nga një grumbull shumë më i madh ushtarësh, u sulën për të kapërcyer bulevardin. Tanku i madh ecte këtë herë në krye. Pas tij ecte tanku tjetër, ai më i vogli, dhe në fund vinin dy autoblinda me koracat e lyera në ngjyrën e samarit të breshkës.

Sherifit iu duk se e ndjeu se si plumbat e mitralozit të tij rrëshqitën si kokrriza breshri të padëmshme mbi atë kullë çeliku, kokë hopopotami, e cila ta bënte të urryer vetë idenë e hekurit, kur ai grumbullohej në një masë të tillë, të verbër. Me bisht të syrit ai pa se si Javerit iu drodhën duart nga tronditja, kur mori shenjë me antitank. Në ato duar të holla si koskë zogu, të cilat ai qe matur kaq herë të tallte, si përgjigje për ngacmimet e Javerit, por që megjithatë nuk i kishte tallur asnjëherë, se nuk i bënte zemra, tani qëndronte shpresa kryesore, pothuajse e vetme, për të shpuar lëkurën e përbindshit. Javeri qëlloi. Midis morisë së plumbave plumbi i Javerit ishte vetëm një, por i veçantë, këlysh ujku, i vettuar, midis lukunisë së qenve, i vetti që ia dinte hilënë koracës së hekurt. Qëlllo, Javer, qëlllo, vëlla, tha Sherifi nëpër dhëmbë. Javeri drejtoi prapë armën.

Ndërkaq në zhinxhirët e tankut binin pa pushim granatat, por ai nuk i ndiente ato fare. Ajo kullë gdhë, që kishte diçka të fuqishme dhe idioteske njëkohësisht, po avitej gjithnjë e mbartur nga putrat e çelikta.

— Granatat vetëm në zinxhirë, — u dëgjua për herë të tretë britma e Dino Sinojmerit.

Por as granatat në zinxhirë dhe as shishet me benzinë nuk e ndalonin dot tankun e madh. Ai po i afrohej barrikadës.

— Barrikadë — têrhiq! — ulëriti Dino Sinojmeri.
— Anash. Anash.

Tanku ishte disa hapa larg. Katër hapa. Dy. Tyta

e tij preku pjesën e sipërme të barrikadës, ndërsa zinxhirët po shkelnin trupin e saj. Sherifit iu duk se dëgjoi kërkëllimën e lavamanit dhe shtrëngoi nofullat, sikur ajo të ishte kërcitja e koskave të tij. Në kohën që tanku, si një derr që fut turinjtë në një grumbull zarvatesh, futi pjesën e përparme midis rrangullave të barrigadës, Dino Sinojmeri u ngrit nga pozicioni dhe vërviti një shishe benzinë, këtë herë jo mbi tankun, por drejt e mbi barrikadë. Balta, tullat, trarët dhe kazanët që po batërdisheshin duke u thyer me rrapëllimë të gjëmshëme poshtë dhe anash tankut, morën flakë.

Barrikada nuk ekzistonte më. Tanku u përpinq të zbrapsej ngadalë, ashtu si herën tjetër, për të mos lënë pa mbrojtje ushtarët që e ndiqnin, por flakët e barrikadës ishin kaq të dendura, saqë ai u detyrua të bënte një rrrotullim të egër rrrotull vetes dhe u vërvit me tërbim përpara për të dalë sa më parë nga flakët. Në të vërtetë iu deshën vetëm disa sekonda që ai të shkëputej nga barrikada duke shkundur rrangullat e saj, që ranë me bujë përbri tij, mirëpo ndërkaq zinxhirët kishin marrë me vete qilimin e vjetër, përden prej kadifeje dhe copëra tapicerish të kolltukëve, të cilat, të copëtuara e të ngecura nëpër kllapat e hekurta, lëshonin gjatë rrrotullimit flakë dhe tym të zi.

— Shiko, shiko, — thirri një partizan.

Pamja ishte e çuditshme. Mbuluar me lecka të përvëluara, i tmerrshëm dhe qesharak njëkohësisht, tanku i madh po ikte në panik.

— Ndiqe, derrin e derrit, — klithi me tërbim Mete Aliu dhe me një të hedhur doli nga pozicioni.

Dino Sinojmeri u mat të thërriste: «ndal, ktheu mbrapsht!», por me një shpejtësi vetëtime trurin e tij e përshkoi një ide. Ai shkuli revolverin nga brezi dhe, në vend që të thërriste «Mete Aliu, ktheu mbrapsht», thirri sa kishte në kokë:

— Njësiti me mua, kundërsulm mbi fortinon!

Ai u hodh i pari në rrugë dhe vrapi pas tankut me revolver në dorë.

Ajo që ndodhi pastaj, ishte e papërfytyrueshme. Ta-

nku i madh, gjithë lecka e copëra qilimash të ngjitura nëpër zinxhirët, ikte përpara. Pas tij gjithë britma turreshin partizanët dhe guerrilierët, sikur të ndiqnin me berihaj një të marrë, zhelet e të cilat kanë marrë flakë. Gjermanët, të mbetur pa mbështetjen e tankut, ca vazhdonin të rendnin pas tij, ca iknin praptazi, duke qëlluar në ikje e sipër mbi partizanët. Tanku tjetër kishte ndalur në vend, kurse njëra nga autoblindat po digjej dhe një krah i verdhë, që varej përjashta saj, bënte një lëvizje të dobët sa herë që flaka i afrohej. Ndërkëq tanku i madh e zhele-zhele të ndezura po rendte me shpejtësi në drejtim të fortinos, me një shpresë të kotë për të shpëtuar nga ato rrëcka të tmerrshme. Pas tij vazhdonte të shtjellej po ai kaos i mëparshëm, i potershëm e i pasbesueshëm. Gjithçka ishte përmbysur: nuk merrej vesh nëse ndjekësit turreshin pas tankut për ta goditur akoma, apo për t'u mbrojtur pas tij. Bile njëherë qëlloi që partizanë e gjermanë vrapuan disa metra paralelisht, gjersa të dyja palët, sikur të ndërmendeshin papritur, iu kthyen befas njëri-tjetrit dhe në vrap e sipër u grinë me automatikë, duke u qëlluar me breshëri brinjazi. Edhe tanku u duk sikur më në fund e mblodhi veten nga ai turavrap i marrë dhe rrrotulloi kullën e çeliktë për të goditür ndjekësit. Mirëpo tamam në atë çast flaka e zheleve të futura nëpër të gjitha dhëmbëzat e zinxhirëve arriti, siç duket, motorin dhe ai ngeci në vend, i mbuluar nga zjarri. Zhgani i gjermanëve u shkëput më në fund prej tij dhe po ikte drejt fortinos.

— Mbi fortinon, — thirri Dino Sinojmeri, — jepini djema, ja ku është.

Turma e sulmuesve vërvshoi anash tankut dhe iu sul fortinos, që, nga frika se mos godiste të vetët, kishte heshtur gjatë gjithë kësaj batërdie. Ajo nuk ishte as dhjetë hapa larg, një bllok i lëmuar gjashtëkëndësh betoni, me ato të cara vertikale dhe horizontale, që dukej sikur përmblidhnin gjithçka të ligë, të huaj dhe armiqësore që kishte ajo. Fortinoja akoma heshtte. Tetë hapa. Gjashtë. Pesë. Pastaj edhe ajo u përmend. Tre partizanë dhe një guerrilier u grinë nga mitralozat e saj, me gra-

nada në duar, tre hapa larg saj. I katërti, Mete Aliu, duke vrapuar brinjazi, arriti gjer te muri anësor i fortinos, u zvarit anash tij në këmbë, ngjitur me çimenton, dhe, duke e mbajtur trupin pas këndit që formonte betoni, zgjati krahun dhe u përpoq ta shtynte granatën me dorë brenda frëngjisë. Granata u fut gjer në një farë vendi, por frëngjia vinte më tutje në formë hinke dhe nuk e nxuri bombën. Njëherë Mete Aliu deshi ta lëshonte atë të binte përdhe dhe vetë të sprapsej edhe një hap prapa qoshes, për t'u mbrojtur nga ciflat, mirëpo tamam në atë çast, si një prushitje e beftë, i vetëtiu nëpër mend se asnjëherë, askurrë më nuk do të mund ta gjente atë fole të mallëkuar. Tani që të gjeta... tani që të gjeta, moj bushtër... Mete Aliu nuk mendoi gjë tjetër. Symbyllur, me dhëmbë të shtrënguar, duke e shtyrë trupit petë pas betonit, sa më larg, ah, sa më larg krahut të vet, që kishte mbetur i nderur matanë... matanë... në një botë tjetër tani... ai e mbajti granatën te frëngjia, gjersa ajo plasi.

Ata që vinin pas, nuk e kuptuan mirë se çfarë ndodhi. Nga larg Mete Aliu u qe dukur si ata njerëzit që i afrohen tinëzi një çerdheje pér të marrë zogjtë, gjë që e kishin bërë pothuajse të gjithë në fëmijnine e tyre. Vettëm kur nga tri frëngjité filloj të delte tym i zi dhe, sidomos, kur panë Mete Aliun, dyllë të verdhë, që po i merreshin këmbët dhe po përpinqej të mbahej pas faqes së betonit me të vetmen dorë që i kishte mbetur, ata e kuptuan ç'kishte ndodhur.

Gjatë gjithë kohës së sulmit Sherifi bashkë me tre mitralierë të tjera mbajtën në goditje të pandërprerë terracën dhe gjithë dritaret e Radiostacionit, prej nga mund të goditeshin partizanët dhe guerrilierët. Sherifi ndoqi me sy gjithçka që u bë në atë copë kohë të shkurtër, qysh se tanku i madh prishi barrikadën me feçkën e tij të hekurt. Tani, ndërsa vazhdonte të dërgonte breshëri pas breshërie në po atë drejtim, Sherifi, me sy të shqetë-

suar, vështronte se si ata, pas djegies së fortinos, po ktheheshin, duke bërë kërcime të shkurtra rrëzë mureve të rrugës. Ja Teuta, pa kapelë, tek mbante me mundim Mete Aliun, që e cte duke iu marrë këmbët, tepër i verdhë në fytyrë, bile më shumë se i verdhë, i kaltëremë. Po Javeri, pyeti ai vvetven dhe ndjeu ngadalësimin e rrahjeve të zemrës. Ah, ja ku ishte, me ata krahë të dobët, që mezi e ngriniin antitankut e rëndë. Pizevengu, mendoi gjithë gjëzim Sherifi. Në të vërtetë Javeri nuk duhej të merrte pjesë në sulm, por kishte përfituar, siç dukel, nga rrëmuja dhe që lëshuar bashkë me të tjerët prapa tankut. Po errej dhe të tjerët nuk dalloheshin mirë. Ja dhe komandanti. Syzet i kishin humbur përsëri. Diçka iu thoshte dy guerrilierëve që po tërhoqnin një të vrarë. Po ç'kishte kështu Mete Aliu? Me atë kapotën e gjatë, jashtëzakonisht të gjatë, ai ngjante si ndonjë i dehur që kthehet nga një dasmë. Duke anuar kokën, sa më larg supit të Teutës, ai po villej në ecje e sipër. Ç'ka kështu Mete Aliu, tha me vete Sherifi, kurse një zë tjetër, më i shurdhër, që brenda tij pyeti: Ç'nuk ka kështu Mete Aliu? Sherifi e la mitralozin për disa sekonda, vështroi ngultazi dhe e kuptoi: Mete Aliut i mungonte një krah.

Njëri pas tjetrit ata po ktheheshin të gjithë. Të vrrarët i vendosën rresht, pranë arkave me municion. Ishin gjithsej tetë. Pesë partizanë dhe tre guerrilieri. Pranë tyre, të mbuluar me mushama, ishin trupat e komisarit dhe të një guerrilieri të vdekur në mëngjes në barrikadë.

Te rruga autoblinda dhe tanku i madh vazhdonin të digjeshin akoma. Vinte erë shkrumbi. Dy gjermanë gjysmë të djegur kishin mbetur të shtrirë përmbyt mu në mes të udhëkryqit. Ndoshta ishin tankistët. Një tjetër kishte rënë pas me kurriz të mbështetur pas një porte, me automatikun që e mbante akoma midis gjunjëve të thyer. Flakët e fundit të tankut dhe të autoblindës dërgonin herë pas here rrëth e rrotull ndriçime të frikshme, tepër të dobëta, si krahë fantazmash.

— E? — ia bëri Sherifi, kur Javeri erdhi prapë përbri tij.

— Sulm i hatashëm, — tha Javeri.

Sherifi pohoi me kokë.

— Njëherë desh më kapi dhe mua daldia, — tha ai, — po pastaj e mbajta veten. U ngula te mitralozi.

— Mua me siguri do të më heqin vërejtjen, që shkova, si thua ti?

— Ka mundësi, — tha Sherifi.

Javeri bëri një gjest me dorë sikur të thoshte: tani, ç'u bë, u bë.

— Njëherë edhe mua desh më hipi, — tha prapë Sherifi.

— Ti, po ta bëje atë që bëra unë, me siguri do të të pushkatonin.

Sherifi vështroi mendueshëm.

— Më shkoi ndër mend, — tha. — Të lësh shokët pa mbrojtje në një çast të tillë...

— Ishte bukur? — tha prapë Javeri.

Sherifi pohoi me kokë.

— Veçse na u vranë shumë shokë, — tha Javeri.

Sherifi ktheu kokën nga ajo anë ku ata ishin shtrirë rresht, pranë arkave me municion.

— Do t'i varrosim natën.

Kishte rënë nata. Tanku dhe autoblinda po shuheshin atje përtej dhe regëtima e flakëve të tyre përpëlitez e vdiste në një rrith që, sa vente, zvogëlohej.

Nga ana e barrikadës së shkrumbosur dëgjoheshin hapa dhe zëra të shurdhër. Në terr dukeshin siluetat e njerëzve që sillnin susta krevatesh, tulla, velenxa dhe gjithfarë rrangullah të tjera. Barrikada po ribëhej.

Një çast u bë një heshtje e shurdhër e pastaj që larg nga qendra u dëgjuan fortinot e sheshit «Skënderbej». Ja dhe gjysmëtanku, tha me vete Sherifi, që iu duk se e dalloj topin e tij midis të tjerëve. Atje në fshat Tosun agai, pasi kishte vrarë nusen e re, rrinte i shushatur me orë të tëra, sikur t'i kishte rënë damblaja, pastaj, befas, sikur të vinte në vete, godiste me shkop këdo që i afrohej. Ca ditë nuk mund t'i çonin as për të ngrënë, as përtë pirë.

U dëgjuan breshëri të tjera në drejtim të Bankës. Pastaj gjëmimë murtajash nga veriu, nga ana e burgut

të ri. Gjatë bulevardit zhurmat e luftës herë përtëriheshin, herë shuheshin.

Një partizan i ri, me fytyrë të lëmuar si vajzë, erdhë dhe zuri vend në pozicion, në krah të Javerit.

— Thanas, ti je? — tha Javeri.

— Po, shoku Javer, — u përgjigj tjetri me zë jashtë-zakonisht të sjellshëm.

Ky ishte një partizan i turpshëm, që skuqej për çdo gjë. Do të na diktojnë ndonjëherë gjermanët natën nga këto faqet e tua të skuqura, i thoshte herë pas here Mete Aliu.

— C'bëhet andej? — pyeti Javeri.

— Ka ardhur një njeri nga Komiteti i Partisë së Qarkut, — tha Thanasi. — Më duket se është vetë sekretari i Tiranës.

Kushedi sa është skuqur që tha gjithë këto fjalë, mendoi Sherifi. Edhe Sherifi ishte skuqur disa herë në fillim të jetës partizane, por e skuqura e tij ishte ndryshe, kurse Thanasi... Mos më fol mua me «ju», i bërtiste Njete Aliu, i fyter, kur Thanasi i drejtohej në shumës. Një Mete Ali ka bërë nëna dhe jo njëzet. More vesh? Po ju jeni më i madh se unë në moshë dhe veç kësaj... (Thanasi donte t'i thoshte me siguri se tjetri ishte një trim i dëgjuar), mirëpo Mete Aliu ë ndërpriste gjithë inat: Léri me mua ato «ju»-ra e ato mura, gjej ndonjë borgjez apo ndonjë hanëme që t'ia thuash, more vesh?

Një hënë e verdhë kishte rënë tejpërtej bulevardit «Musolini».

— Edhe kjo na duhej, — tha Dino Sinojmeri, duke ngritur kokën nga qielli. Ai vështroi një copë herë fytyrën e qetë katërkëndëshe të sekretarit të Qarkorit. — Mund të na ngatërrojë për sulmin.

Sekretari nuk u përgjigj. Ai ktheu kokën nga bulevardi, të cilin hëna po e ndriçonte për herë të parë pas kaq netësh të vrërëta, pastaj, për një kohë të gjatë vështroi ngrehinën e errët të Radiostacionit.

— Dhe tani, para se të iki, dua të shikoj të vrarët,
— tha ai. Sonte do ti varrosni?

— Po, — tha komandanti i njësitit. — Ja ku janë.

Ai u afrua te trupat dhe ngriti një mushama të rendë, nga ato të autoblindave, me të cilën i kishin mbuluar të gjithë. Nën ndriçimin e hënës ata dukeshin edhe më të verdhë. Flokët e komisarit, të përhitura nga mangalli, ngjanin krejt të thinjura. Dino Sinojmerit iu kujtua se në fëmijni, kur qëllonte që shpohej dhe i dilte gjak, nëna i vinte pak hi në plagë. Nën kapotë ishte plaga e madhe, me përmasa të plagëve të titanëve, e komisarit. Sekretari i Qarkorit i shikoi të gjithë një për një:

— Kërkon ndonjë të njohur? — tha Dino Sinojmeri.

Tjetri bëri «jo» me kokë. Pastaj, pa thënë asgjë, ai i dha dorën Dino Sinojmerit dhe, i ndjekur nga roja i tij, u largua në drejtim të një rrugice të errët, nëpër të cilën do të ikte për të vazhduar inspektimin e njësiteve të vendosura përskaj bulevardit. Dino Sinojmeri nuk i hiqte dot sytë nga silueta e tij, që, ashtu sikurse edhe fytyra, kishte diçka nga soliditeti dhe qetësia e një katërkëndëshi. Në çastin që do të kthehej për te rrugica, Dino Sinojmerit iu duk se në pjesën e sipërme të atij katërkëndëshi, diku pranë supeve dhe qafës, diçka u prish, u rrëzua ngadalë, u drodh. Kuptohej menjëherë që tjetri në ecje e sipër po dëneste.

Dino Sinojmeri ktheu kokën nga bulevardi dhe po vështronë ndriçimin e zbetë të hënës mbi një fushë tenisi. Nga doli kjo fushë tenisi? gati sa s'thirri ai. Nuk e kishte vënë re ndonjëherë. E zbetë, me atë rrjetën transparente në mes, ajo dukej si e zbritur nga një botë ireale, e gatshme për t'u flutuar përsëri larg, në atë botë, apo të gjëmonin përbri saj bombat e para.

Pallati fqinj i Vërlacajve ka një fushë tenisi të ndërtuar më 1929. E para grua e mbretërisë që lojti tenis, ishte Hamide ha-

nëmi, në vjeshtën e vitit 1931. Në atë kohë ndodhej në Shqipëri për një vizitë zyrtare Jakomoni...

Dino Sinojmeri shkundi kokën si për të ndërprerë rikujtimin e shënimeve që kishte lexuar gjatë ditës. Në atë kohë në veshët e tij arriti një e folur e paza-konshme. Mete Aliu, mendoi ai. Kishte një orë që Mete Aliu kishte temperaturë dhe fliste përcart. Kjo ishte nata e mundimeve të tij.

Këndo, o muzë, përcartjen e Mete Aliut, tha ai me vete. Borgjezë të fëlliçur, mendoi pas pak, gjithë historitë tuaja të mbledhura së bashku nuk vleinë sa kjo përcartje.

Në natën e katërmëdhjetë nëntorit të vitit 1944, në metrin e njëmi-jetetëqindekatërt të bulevardit «Musolini» partizani i batalionit II, të Brigadës së Parë Sulmuese, Mete Aliu, foli përcart një kohë të gjatë.

Ja pjesë nga përcartja e tij... bombën tjetër... hi-

qe krahun, hiqe krahun shpejt... po bëni duele, ë?... kritikohet Mete Aliu,... mblidhuni... kritikohet Mete Aliu... granata nuk të futet.. nuk të futet, thua... ah, lavire... na ahere... ja kështu... kështu largoje krahun tjetër... au... i erdhi zëri Memecit... fol, Memec... uléri... oh...

Ju, borgjezë të fëlliçur, përsëriti me vete komandantri i njësitit, pa i hequr sytë nga fusha e tenisit. Pastaj, si njeriu që e kupton se gjendet papritur e pakujtuar në një vend të njojur, ai e kuptoi se po përsëriste rreshtin e një kënge: Ju, borgjezët e fëlliçur, ja, ku vjen, ja, ku po vjen... Thuhej se gjithë këto ditë e net borgjezët po iknin me tmerr nëpër Rrugën Mbretërore, nëpër xhadënë perëndimore. Ja, ku vjen, ja, ku po vjen... përsëriti ai, pa i hequr sytë nga bulevardi. Nesër, pa gdhirë mirë, ti do ta marrësh këtë Radiostacion, Dino Sinojmeri, i tha ai vetes. Pérndryshe... pérndryshe... çfarë pérndryshe... Pérndryshe do të ishte e trishtueshme, mendoi ai, tepër e trishtueshme. Ja, ku vjen, ja, ku po vjen... Mete Aliu... dhe një vdekje ju rrëfen... ja, ku vjell...

Hëna e verdhë vazhdonte të ndrinte tejpërtej mbi

gjithë gjatësinë e bulevardit. Frynte erë e ngarkuar me lagëshти. Nga lodhja Dino Sinojmeri mbylli sytë përgjysmë. Në mendjen e tij, ngadalë, si një gjarpër i madh që zvaritet ngathtësish, rrëshqiste bulevardi «Musolini» me trotuaret e tij të pafundme, me numrat e pallateve, me kronikën e tij të krimeve dhe të sensacioneve, me tabelat e hoteleve, të restoranteve, thashethemet dimërorre, fantazmat, oraret e kafeve, afishet e kinemave, të shfaqjeve të fundit. Atij i qe dukur se çdo rend, përpara përbrysjes, gjithnjë ka shumë afishe, me shpalljet e shtetrrethimit, të listave të të pushkatuarve, me statujat, tubacionet e ujërave të zeza, fenerët e hekurt. Jeta e tij dhe e shokëve të tij se si ishte lidhur tanimë me këtë bulevard... Hëna ndrinte dobët mbi fushën e magjepsur të tenisit, sipër portaleve të larta me trëndafila të egrë anash dhe, më këndej, mbi mbllacat e zeza që kishin mbetur pas përleshjes tek udhëkryqi. Papritur ai u drodh. Mbi asfalt, fare pranë trotuarit iu duk se pa... krahan e këputur të Mete Aliut. Fërkoi sytë, i rrudhi pak, siç bëjnë gjithë miopët për të parë më mirë, dhe mbeti ashtu një copë herë. Krahu ishte aty, i hedhur, siç duket, që larg me forcë nga shpërthimi i bom-bës, i verdhë në gri. Krejt i trubulluar, ai po pyeste veten se a duhej të zvaritej gjer atje për të mos e lënë atë krah që të shkelej të nesërmen nga njerëzit dhe makinat. Kur, për çudi, në atë kohë, nën shtytjen e erës krahu lëvizi pak. Ai lëvizi prapë dhe Dino Sinojmeri e kuptoi se nuk ishte gjë tjetër veçse një degë e tharë, këputur prej drurëve të trotuarit nga era. Ai pshëretiu gjatë dhe tha me vete: Duhet të gloodhem pak.

Ishte akoma natë, kurse għdirja tani pér tani ishte vetem në fushën e orës së Dino Sinojmerit. Ai e afroi atë pér së dyti fare pranë fytyrës dhe pa se akrepas ishin aty si dy heshta të hedhura pa kujdes, mbetur nga nata e kaluar.

Gērnjat e luftës, që gjithë natën nuk kishin pushuar

në qytet, për çudi, ishin shuar tani krejt. Hëna gjithashtu qe tërhequr nga qielli. Erdhi ora, tha me vete Dino Sinojmeri.

Në errësirë ndihej se si të gjithë ishin gati dhe pritnin. Ndihej një thundrim i shurdhër këmbësh mbi tokë dhe një si frymëmarrje e përbashkët, pra e ngjitur, që delte nga gjokse dhe gryka të ftohura.

Dino Sinojmeri vështroi dhe një herë qiellin që sapo kishte nisur të murrëtehej. Dhe prapë tha me vete: gjynah që s'kam syzet.

— Hajde, djema, me hajër, — tha pastaj dhe fare i qetë, sikur të kapërcente pragun e shtëpisë së tij në një mbasdite të diele, ai doli nga pozicioni te rrugica, me revolver në dorë. La të kalonin katër a pesë partizanë përpara (midis tyre ishte ai që kishte kyçet e portës së madhe), dhe u nis pas tyre. Të tjerët, partizanë e gue rrilierë bashkë, i shkuant pas.

Frynte erë e ngarkuar me shi. Duke ikur gjithnjë rrëzë mureve, ata dolën te trotuari i bulevardit. Përpara tyre nxinin tanku dhe autoblinda e djegur, kurse më larg tanku tjetër dhe fortinoja e braktisur. Partizanët lëvizën drejt bulevardit, sikur të rrëshqitnin mbi zhurmërinë e mbytur të hapave të tyre. Po i afroheshin makinave të djegura, kur gjermanët i diktuan. Nga dritaret e kateve të para, nga portali i portës kryesore dhe nga tarraca gjëmuani njëra pas tjetrës breshëritë e mitralozave. Dhe, sikur të mos mjaftonin ato, te një dritare apo te një vrimë e hapur në mur, nuk kuptohej mirë, u ndez papritur një projektor që e mbushi bulevardin me dritë të bardhë, midis së cilës partizanët e ndien veten për një çast si të ngrirë midis një xhelatine vdekjeje. Por në atë çast nga pozicionet përballë gjëmuani mitralozat e rëndë të partizanëve, dhe midis tyre zëri i Dino Sinojmerit:

— Verboje, Sherif, këtë, se na mori në qafë.

I shtrirë në tokë, me sytë të mbuluar me bërryl (ata edhe pa këtë dritë skëterre i dhimbnin), ai vazhdonte të thërriste «Verboje, qenin».

Disa nga partizanët e kishin arritur tankun e madh dhe kishin zënë pozicion pas tij. Të tjerët po zvariteshin

dera dhe pastaj, për çudi, u var mbi të. Po më vritten, ulëriti me vete dhe donte të shikonte duart e tij, po nuk pa gjë. Ishte akoma në këmbë, kur vdekja iu shfaq në formën e Hamide hanëmit, që po i vinte në gjysmë-terr, e mbuluar me vello të zezë, nëpër bulevardin «Musolini», sipas itinerarit të shënuar... Ai shquajti përpara tij një portë gjysmë të shqyer nga bombat dhe me vrull, sikur ta shtynte që pas një shtjellje e fuqishme ere, u përpi prej saj.

Radiostacioni u mor në orën tetë pa dy minuta, pas sulmit të katërt. Partizanët dhe guerrilierët mundën të futeshin nga dritaret e katit të parë dhe luftuan kat më kat me mbrojtësit, gjersa dolën në tarracë. Komandantin e njësitet, Dino Sinojmerin, që kishte hyrë i pari në portën e shkallmuar nga granatat, e gjetën të shtrirë përmbyss, një hap larg pragut, me ballin të çarë nga përplasja te shkalla e fundit. Kishte dy plagë të rënda në bark dhe një të lehtë në fytyrë, në mollzën e majtë. Kishte gjithashtu një karikator të tërë automatiku të zbrazur mbi shpinë, nga lart, ndoshta nga kreu i shkallëve, por kjo breshëri kishte qenë, me sa duket, pas vdekjes së tij.

P J E S A M I D I S

卷之三

古文選

KAPITULLI I KATËRT

Qyteti ishte akoma gjysmë i pushtuar, gjysmë i çliruar. Luftohej te Rruga Mbretërore, në periferinë e Laprakës, në qendër, në trotuarin e djathtë të Rrugës së Dibrës, te pallatet e avacionit, në lulishtet rrëth Pallatit të Zi.

Batalionet, kompanitë dhe skuadrat partizane të Brigadës së Parë dhe të Katërt ishin vendosur në vija të harkuara, ose zigzage, në formë U-je, në formë trekëndëshi, disa herë si pyka, në një shtrirje të madhe, përballë vendosjes pothuaj të njëjtë të njësive gjermane të Divisionit të Katërt SS që mbronte Tiranën. Pozicionet e përparuara të partizanëve ishin futur disa herë aq shtrëngueshmë midis vijave të gjermanëve dhe, anasjelltas, fortifikatat gjermane kishin mbetur po aq shtrëngueshmë midis vijave të përparuara partizane, saqë të dyja palët u ngjanin dhëmbëve të një ingranazhi, që në prekjen më të vogël lëshonin tym dhe zjarr.

Të gjitha figurat gjeometrike të vendosjes së njësiteve të të dyja palëve ndërluftuese zhvilloheshin ngadalë sipas një gjeometrie misterioze, shpërbëheshin, riformoheshin, përcudnoheshin aq, sa disa herë nuk njiheshin më. Midis tyre, si të lëvizura nga stuhia, herë më në lindje, herë më në veri, herë përpara, herë mbrapsht, zhvendoseshin në një valle të egër shtabi partizan dhe gjerman.

Në të dyja shtabet synonin të mbërrinin herë pas

here korrierë dhe njëkohësisht prej tyre niseshin korrierë për në drejtimet më të papritura. Një pjesë e korrierëve vriteshin në largësi të ndryshme prej shtabeve. Në çastet e vdekjes urdhrat, shumicën e të cilëve ata e çonin me gojë, i shthoshin si bishta kllapisë dhe gulçimeve të tyre të fundit. Kështu u vranë njëri pas tjetrit korri-erët Helmut Shval dhe Erich Moorkahne që çonin urdh-rin e Ledererit për minimin e Boulevardit të Madh. Pas tyre, treqind metra larg hotel «Dajtit», u vra tek vrapi-onte për në shtab, esesi Stortebeker. Pas goditjes tri-çikli i tij bëri një rrrotullim të verbër, për shkak të së cilit trupi i të vrarit u hallakat para, mbrapa dhe anash, pa u shkulur prej automjetit. Gjatë rënies së kokës pas, atij i doli helmeta, që i mbeti e varur në qafë, por në atë çast, për shkak të përplasjes së triçiklit tek ana e trotuarit, koka, bashkë me helmetën, i ranë përpara me vrull dhe, ngaqë mbetën të varura të dyja sipër timonit, u duk sikur në çastin e fundit trupi i të vdekurit nxori befas dy kokë.

Njëqind metra larg shtabit partizan, që ishte zhven-dosur gjatë natës, u vra korrieri i Shtabit të Përgjithshëm Muman Karafili, me një urdhër të drejtpërdrejtë të Enver Hoxhës për komandantin e sulmit të Tiranës. Ai ra përmbyss, me krahët të hapur mbi barin e ngrirë të një lulishteje dhe, ndërsa shikonte trubull me sytë e errur nga vdekja shkulmet e gjakut që i dilnin prej grykës, iu duk se urdhri sekret, që e kishte mësuar përmendësh, der-dhej tanë jashtë qenies së tij, i kuq, dallgë-dallgë, duke mbuluar gjithë dheun. Zgjati krahët, si për ta kthyer mbrapsht atë që po ikte dhe në atë çast vdiq.

Qyteti shtrihej i hirnosur midis shakullimës së erës me tymtarët e ftohtë sipër tij. Nuk kishte ngrohje. Telefonat ishin prerë si damarët, duke shtuar kështu monologët e gjatë. Nuk kishte energji elektrike. Punonin vetëm tubacionet e ujérave të zeza.

Mbishkrimet po mbushnin muret nga të gjitha anët.

Kishte mbishkrime mbi barrikada, mbi fortino, mbi shpina të vrarësh, mbi tanke. Midis batërdisë së luftës dëgjoheshin që larg copëra këngësh. Kuq është nga lind e perëndon... Pararoja, pararoja... Rruga Mbretërore ishte bllokuar nga luftimet dhe evakuimi qe ndërprerë. Gjithë veturat, furgonet, karrocat luksoze, të ngarkuara me ikës, ishin kthyer mbrapsht në barkun e trubullt të qytetit, duke shtuar si një kapsllék mundimet e tij.

Netët ishin me pak gjumë, ose, më mirë, me një surrogat gjumi, të gjerrisur aty-këtu nga motive të frikshme, siç mund të jenë netët e një qyteti, ku mijëra njerëz presin ndëshkim. Herë-herë qyteti ishte si një konstruksion i madh i mbërthyer me mijëra brava që duhej të shqysheshin, enigma të ndryshkura, dhe emblema që duhej të binin. Ishte me të vërtetë një «vjeshtë emblemash» (në përgjithësi, nga fjalët që thuheshin apo mendoheshin ato ditë, mund të sajoheshin lehtësish tituj romanesh) e, aq më tepër, po të kujtoheshe se një pjesë e emblemave kishin të stampuar vërtet sipër tyre gjethë drurësh. Kurse këngët ishin kërcënuese. Në pallatet madhështore dridhet korbi gjakatar... Që larg, midis zallahisë së luftës, të shqyera prej saj dhe prej erërave, vinin copëra vargjesh të karfosura pas muzikës si pas një salvaxhenteje. Nga kishin dalë kështu këto lloje këngësh që të ngjethnin mishtë me informacionin e zi që jepnin?! Ato s'janë muzikë, po ekonomi politike, kishte thënë bankjeri Rrokaj. Dhe vërtet, më tepër se këngë, ato ishin shpallje ligjesh të reja, afate ultimatumesh e shtetrrethimesh, dekrete, programe ekonomike, tarifa, orare, itinerare internimesh, kryqëzimesh, harrese. Ata i dëgjonin me vëmendje, i analizonin një për një rreshtat e tyre, i kthenin në shifra, vite burgimesh, tatime, nganjëherë breshëri plumbash të skuadrës së pushkatimit. Allah, thoshin ata, Jezu Krisht, si është e mundur që gjithë këtë mynxyrë ta dëgjojmë më përparrë si melodi. Edhe borja e Xhebrailit, ditën e gjyqit të fundit, nuk do t'ju dukej kaq mizore, sa këto këngë të përpikta si lajmet e bursës. Dhe deliret më të tmerrshme, që provonin gjithmonë e më shpesh, nuk ishin mundësítë e vdekjes së tyre, as

gjyqet e ardhshme (emri, korbi, mbiemri, gjakatar, dëno-hesh me njëqind e një vjet burg, mos të të duket shumë, korbi rron gjatë, siç thotë zoologja, treqind vjet)... Pra deliret më të tmerrshme s'ishin këto, por bravat dhe kyçet e tyre, të cilat në çastet e kllapisë iu dukeshin se ishin zbutur si pelte, se po rridhnin nga vrimat e dyerive si lëndë viskoze. Ata vinin kompresa me ujë të ftohtë në kokë, pér të ndaluar këtë delir, sepse ishin gati më mirë të shihnin koskat e tyre të dekompozoheshin ashtu, sesa bravat dhe kyçet e hekurta.

Të tjerë, të rënë në ekstazë mistike, bëheshin gati shpirtërisht pér kryqëzime, valvare, haxhillëk në Mekë, agjërimë të gjata, ikje nëpër këneta. Apokalipsi ishte shfaqur në formë grumbujsh mobiljesh, qilimash e rrangullah që hidheshin drejt e në rrugë pér të krijuar ca male të frikshme që quheshin «barrikada». Deve të mëdha, të ulura përdhe, herë-herë me kurriz të përgjakur, herë-herë me jelet në flakë, ato kishin blokuar udhëkryqe, sheshe të tëra dhe sidomos Rrugën Mbretërore, shpresën e tyre të fundit pér të ikur nga ky ferr. Tanket gjermane hidheshin si tigra kundër tyre, por më kot. Çdo ditë e çdo orë barrikadat lëviznin ngadalë drejt rajoneve borgjeze të qytetit. Nën këmbët e tyre, si kafshë të vogla të shpejta ose kërmij që zvariteshin papushim, vraponin frikëra, thashetheme, profecira ogurzeza, proverba arabisht, latinisht, formula të reja përshëndetjeje, strofa këngësh, monologë.

Në orët e muzgut nëpér rrugina dhe udhëkryqe shfaqeshin aty-këtu gjithfarë figurash groteske, pjesëtarë sektesh të ndryshme fetare, fallxhorë, belbanë të përjargur që mbaheshin si gjysmë të shenjtë, murgesha të ikura nga kuvendet katolike, vajtojca të çmendura, kiromane. Midis Rrugës së Elbasanit dhe urës së Boulevardit të Madh, ishte dukur një plak i gjatë, i veshur me uniformën e vjetër zyrtare të munxadhënësit, profesion i zhdukur qysh përpara njëqind e dhjetë vjetësh, kur u munxos Kështjella e rebeluar e Petrelës, përpara se të sulmohej nga trupat ndëshkimorë perandorakë.

Në qytet, si asnjëherë tjetër, hidhej fall me letra

bixhozi, përbyseshin filxhanët e kafesë për të paraparë fatin, një libër ëndrrash, «Tabir name», botim i Komunitetit Mysliman, qe shitur për dhjetë napolonë flori. Kur nga dritarja e saj hanëm Makbuleja plakë pa sakatin e trashë Dullë Gjysma, që e quanin kështu nga që s'kishte këmbë dhe përdorte në vend të tyre shputat e duarve, ajo klithi e llahtarisor: Po vjen fanti maço, po vjen fanti maço. Në të vërtetë, letrat e bixhozit me figurat e përbysura tradicionale zgjonin tanë tmerr te shumë njerëz.

Por ajo që përbënte ankthin e një pjese të njerëzve, ishte për pjesën tjetër faza më e bukur e ëndrrës. Nga të gjitha ato që thuheshin, nga ato projekte të pambirim fatkeqësish apo lumturisht të ardhshme, ishte një hamendje, që shkaktonte në mënyrë të barabartë gëzimin te një palë dhe tmerr te pala tjetër. Këto ishin fjalët: «do të jemi të barabartë». Kur i thoshin njëra-tjetrës lajmet e fundit, të errësuara edhe më keq nga reumatizmi i tyre, nga menopauzat ose nga traumat psikike, bejleshat i linin këto fjalë për në fund, ashtu siç lihet zakonisht informacioni më i zi. Ahere, ajo që e sillte atë, me favorin që ka njeriu që e ka kaluar vuajtjen i pari, ndiqte me sy se ç'do të ndodhët në fytyrën e tjetrës. Dhe ajo që ndodhët në ato katërqind centimetra lëkurë, ishte një gjëmë e tillë që, ndërsa vente e vinte nëpër faqet, vetullat, buzët, dhëmbët, qafën, flokët, të vinte çudi se si nuk i deformonte ato përfundimisht. Shpesh goditja ishte kaq e fortë, sa fytyra mbetëj e ngrirë, e larguar si një madem hëne. Ju, borgjezët e fëlliqur, ja, ku vjen, ja, ku po vjen...

Gjysmë i lidhur, gjysmë i lirë, qyteti dukej sikur mezi e duronte mbi supet e tij stinën e vjeshtës. Shakkullima e erës mbi të ishte herë-herë kaq e mundimshme, saqë dukej sikur era hallakatte sipër qytetit një togë të rënduar nga të qullurit, i ngrinte cepat dhe e fërgëllonte me ulërimë, duke ia përplasur kopsat e bakërtë pas pujlazeve apo minareve.

Luftohej te Boulevardit i Madh, pranë Xhamisë së Rufainjve, te kopshtet e ish-Pallatit Mbretëror, rrëth burgut të vjetër, te Rruga Mbretërore, ku, nën një veturë të kthyer përmbyss, i zoti, i vrarë, kishte rënë mbi sixhadenë e vet plot me pllanga gjaku.

Pas groteskëve dhe të marrëve, të shtyrë më tepër nga një rutinë e vjetër, sesa nga ndonjë qëllim, dilnin herë pas here rrugëve shkrimitarë të mesëm e të vegjël, shumica formalistë, klasikegjantë apo parnasienë të vonuar të republikës së parë e të dytë dhe të mbretërisë. Ata ecnin si të trallisur me tëmthat e shtrënguar nga një si dehje, që ua shkaktonte vetë ideja se po jetonin në çast të madh e tragjik dhe që në biografitë e tyre do të shënohej se ata kishin qenë... po kishin qenë atje, midis Purgatorit dhe... Ferrit, midis Purgatorit dhe... Parajsës, atje ku këmbëshin dy epokat, midis të cilave ata do të shtriheshin të ngrirë e të bardhë si në një tabut balladash.

Ajo që ndodhë përreth tyre, u dukej si një afresk i madh, krejt i pakuptueshmë, i ngjashëm me një vegim që është destinuar të zhduket. Ajo që mund të shpëtohej, ishte vetëm një pjesë e vogël e këtij afresku, e rindërtuar zbetë, copëra-copëra kujtimesh të çngjyrosura, me mungesa midis, me humbje, ashtu siç mund të jetë vetëm rikonstruksioni i një èndrre. Ai mund të bëhet shumë-shumë në mëngjesin e ditës së nesërmë, po kurrsesi pas disa ditësh e aq më pak pas disa vitesh.

Mbishkrime murale: Kërkohen tradhtarët e popullit Xhelal Staravecka, Xhafer Deva, Mithad beu, Fiqri beu, Kaman Kroshi, Dr. Rrokaj. Tirana e tiranisë do të bëhet Tirana e lirisë. Ha, ha, ha, c'na bëtë të qeshim. Spiun, mendohu mirë kur spiunon. Rebelë të kuq të Enver Hoxhës dhe të Mehmet Shehut, sa kohë keni që s'keni bërë banjë? Mos u mërzitni, në Boulevardin «Musolini» ju pret një banjë gjaku. Po s'mbetët të kënaqur, kaloni më tutje: në Rrugën Mbretërore do të keni prapë banjë, bile edhe me dush-përsipër. Kërkohet kryetradhtari i zi Patër Anton Harapi, i dënuar me vdekje nga vullneti i popullit. Ndalohen mbishkrimet në mure. Rroftë P K SH. Kush ka-

pet duke shkruar, pushkatohet në vend. Komandanti i qytetit, Léderer. Lederer — turiderr. Popull i Tiranës, ndihmo në ngritjen e barrikadave. Kërkohen kolaboracionistët: Menella Çullaj dhe Preng Uka. Partizanë, a keni morra? Allah, ktheji njerëzit në udhën e Zotit. Zot i sat ëme. Mos u gëzo, o i gëzuar, mos u helmo, o i helmuar (nga Bibla). Vajza partizane, kam shumë dëshirë të bëj dashuri me ju (faire l'amour avec vous). Një i singertë. Stop kalimi.

Melodi nëpër erë.

Pararoja, pararoja! Ju, borgjezët e fëlliur, ja, ku vjen, ja, ku po vjen...



Një motiv borie për sulum. Anonim.



Kori i bejlereshave plaka. Mos qofsh, moj Rruga Mbretërore, që u mbylle e na le këtu brenda, si miu në çark. Hendeqet të kalofshin sipër e të mbiftë bari tej e mbanë. E dëgjove hanëm Hava, thonë se do të bëhemë të barabartë. Të barabartë? Luaj vendit, luaj vendit, estak-furullah, hiqmet il ahim, merr mbrapsht atë fjalë, thuaj që s'është ashtu, jo, jo, jo, më mirë varri. Përëndi, nuk gjete një tjetër coup de grace? Ikën Kasimatajt? Ikën pardje, sot duhet të kenë arritur Italinë. Të barabartë? Me brashnjaret dhe çapaculët? Jo, jo, jo. Po ka edhe më, tha zoti Ekrem Fortuzi. Të futin një plumb mu në zemër, të presin një dorë, të nxjerrin një sy ose të dy sytë (ku ma gjen të mos shoh më ç'do të bëhet), të marrin florinjtë, shtëpinë, gruan, ha, ha, ha, më falni, por ka edhe

më. Është një reformë e tmerrshme, mbase e keni dë-gjuar, me një emër prozaik, *reforma agrare*. Kjo është e ç'është, moj zonja. Kjo është, si t'jua shpjegoj, që dhembiën ta ndiesh jo në këtë copë vend të ngushtë, sa ç'është gjoksi i njeriut, por në njëqind hektarë, një mijë hektarë, kur t'i shikosh që të t'i presin si me gërsherë, t'i shqyejnë, t'i ndajnë me njëri-tjetrin si një zogori qensh. Tokat e mia, me gjethë të verdha sipër, me shi. O c'giéra të tmerrshme, c'giéra të frikshme! Qaj, Makbule, qaj, thonë se lehtësohesh. Ç'të kemi bërë, o zot, që do të na prishësh?! Thonë se kanë dalë ca gjëra të tmerrshme, barrikada quhen... Edhe Vërlacajt ikën...

Barrikada e dytë e bulevardit «Musolini». Sipas dë-shmive, pér ndërtimin e saj u shfrytëzuan mbeturinat e barrikadës së parë, e cila u sakrifikuva gjatë sulmit të Radiostacionit, si dhe mobilje, jorganë, bloqe trotuari, kangjella hekuri, një vaskë banje (atë donin ta hiqnin në fillim, sepse qe shkulur nga shtëpia e bankjerit Rrokaj, dhe ishin larë në të vajzat e tij, por pastaj e lanë). Rikonstruksioni i një barrikade është më i vështirë se ai i një muri kështjelle, i një tempulli mesjetar, bile edhe se i një iqtiozauri mijéravjeçar. Kjo vjen sepse askush nuk mund të gjejë asgjékund projektin e saj, qoftë dhe të transmetuar gojë pas goje në formë legjendash, ose të vizatuar në mënyrë fare simbolike në papiruse të vjetra. Veç kësaj, edhe në qoftë se gjendet një mbeturinë e saj, kjo nuk ndihmon në asnje mënyrë pér rikonstruksionin e pjesës tjetër (si në rastin e eshtrave të iqtiozaurit), sepse dihet që asnje pjesë e barrikadës nuk lidhet me pjesët e tjera sipas ndonjë ligjshmërie. Megjithatë ka një gjë që mbetet edhe në rastin kur të gjitha gjurmët materiale të barrikadës zhduken, dhe, pér fat, kjo gjë është kryesorja. Ajo rri sipër saj si shiu ose qelli mbi një qytet, por, megjithatë, ajo është kryesorja. Vdekje në barrikadë, ja cila nuk zhduket kurrë. Në barrikadën e dytë të bulevardit «Musolini» u vranë partizanët dhe guerrierët Kamber Rruli, Pullumb Arbana, Dule Rasha, Sami Kondi, Llesh Dodë Ukaj, Marie Toska, Maksut Fraku dhe Šaniye Ylli.

Melodi nëpër erë. Motivi i një borie për sulm. Anonim.



Dalngadalë po vjen behari, dalgnadalë po na vjen.
Nëpër fusha rritet bari. Dalngadalë po na vjen. Shokët
tanë kjo luftë na i rrëmben.



Mbishkrime murale. Poshtë terrori i bardhë! Gjermania tra-la-la! Lajmërim: Shtetrrethimi fillon një orë më vonë, shtatë në mëngjes, dhe një orë më parë, shtatë-mbëdhjetë në mbrëmje. Komandatura. Lederér, po i shkurton ditët? Në botën e zhurmës e të vajit, vëllezër, faljani vëllait. Lista e të pushkatuarve ditën e djeshme (vazhdon lista). Komunistët e Mehmet Shehut masakruan pardje shkrimtarin e njohur Adrian Guma. Poshtë terrori i kuq! Shipfës, shkrimtari Adrian Guma vrau vreten. Brunetkë e vogël, e bukura Lulu, në bulevardin «Musolini» të pres në *rendez-vous*. Bota le të grihen, le të bëjnë hata, ne kemi njëri-tjetrin. Trala-la. Ç'pusht! Kërkohen tradhtarët: (vazhdon lista). Vdekje fashizmit, Liri popullit! Rroftë Vdekje! Mosni, more. Mosni!

Që nga tarraca e ndërtuesës së Radiostacionit dukej pothuajse krejt bulevardi «Musolini» me atë harkimin e tij të lehtë që të jepte përshtypjen se i kishte kthyer shpinën Rrugës Mbretërore. Nga lart çdo gjë dukej ndry-

she: rrugët të tendosura, si gratë që kanë vënë korse, njerëzit të shtypur, lëvizjet të largëta e të lehta si pupla.

Binte shi. Sherifi vështronte qytetin e madh, skajet e të cilit bënин fir në mjegull dhe ndiente një përhumbje në gjithë qenien e tij. Herë-herë i dukej se në mos koka, këmbët, duart, ose pjesë të tjera të trupit i flinin. Ai i lëvizte ato që t'i zgjonte. Nga skaji tjetër i tarracës u dëgjua prapë e qeshura e Teutës. Bashkë me një partizan të ri, një bjond i imtë nga skuadra e dytë, ajo përkulej të parapeti për të parë më mirë atë që po i tregonte me gisht shoku i saj.

Ishte hera e parë pas kaq ditësh që dëgjohej prapë e qeshura e Teutës. Ajo ishte vajzë nga qyteti, gazmore, pikëllohej dhe gëzohej shpejt. Në një farë mënyre gjithë historia e kompanisë së tyre mund të kuptohet nga përiudhat e heshtjes ose të të qeshurës së Teutës. Përse zbardh dhëmbët? i kishte thënë që natën e parë Dino Sinojmeri, kur ajo erdhi në batalion bashkë me një shoqe tjetër, të dyja të dërguara nga ilegalët e qytetit. Ahere ajo kishte filluar menjëherë të qante dhe pothuaj të gjithë menduan se kjo vajzë e hajthme nuk e kishte të gjatë jetën në mal. Ajo do të ikte së shpejti, ashtu siç iknin shumica e atyre djemve e vajzave sqimatare të qytetit që dilnin partizanë të shtyrë nga kureshtja. Mirëpo Teuta nuk iku dhe as nuk hoqi dorë nga e qeshura, që shpesh i shndërrohej në lotë. «Qaj-e-qeshja», kështu e thërriste Mete Aliu. Në përpjekjen e parë me gjermanë e ballistë, një nga ballistët kishte thirrur që nga pozicioni. Morëm vesh se paskeni femra. Do të luftojmë me qejf. Ç'harem do të bëjmë me ta. Ha, ha, ha. Teutës, siç duket, i kishte mbetur në mendje ai zë. Dalngadalë frika se mos binte robinë, iu shndërrua në një tmerr të vërtetë, gjer ditën kur një partizan i fali një revolver. Teuta u qetësua menjëherë dhe të gjithë e kuptuan se ç'do të bënte në rast se mbetej e plagosur në terrenin armik.

Sherifi nuk do ta harronte kurrë se si e kishte mbajtur në krahë si hamall gjatë një tërheqjeje në Operacionin e Dimrit. Ajo ishte plagosur, dhe Dino Sinojmeri

caktoi Sherifin, si më të fuqishmin, pér ta mbartur. Fijonte dëborë. Gjithë fshatrat pérreth ishin nén ndikimin e reaksionit dhe ata, kundër zakoneve të jetës partizane, u shmangeshin qendrave të banuara. Flokët e saj i binin atij sipër zverkut kurse krahët, krejt të drunjëzuar nga të ftohtët, e shtrëngonin rrëth qafës. Ajo herë-herë dre-miste, pastaj vinte në vete e trembur. Sherif, i thoshte, po të ndodhi gjë, kuption, po të ndodhi gjë, më jep fjalën se do të më vrasësh? Ai i thoshte po, po, dhe, duke u përpjekur të gëlltiste gulçimën, mezi ikte nëpër tragat e përbaltura, nëpër gropë me ujë. Duhet të më vrasësh pa t'u dridhur dora, i thoshte ajo, pas një copë rruge. Ti e kuption ç'do të thotë të biesh në dorë të tyre? Ti je aq fanatic, sa të mos lëkundesh, apo jo? Po, po, i thoshte ai. Ajo qetësohej, besonte, pastaj papritur ia shkrepente të qarit. Ti je zemërbutë, ti nuk do ta bësh këtë, i thoshte. Dhe gjithë ajo ikje nëpër terr, sqotë dhe baltë ishte një lutje e saj pér ta vrarë në rast se binin rob dhe një pohim i tij se ai do ta vriste, se ai ishte i egër, fanatic i tërbuar, se bile, njëherë, në fshat... Sherifi qe përpjekur, pér herë të parë në jetë, të shpikte një histori të paqenë pér çështje nderi.

Nga skaji tjetër i tarracës u dëgjuja prapë e qeshura e saj. Hm, ia bëri me vete Sherifi. Disa herë në mendjen e tij sajhej skenari i shkurtër i një ngjarjeje të thjeshtë të ardhshme... Një ftesë pér dasmën e Teutës... Vetë dasma... Ai midis të ftuarve... Dhe ky dialog: Kështu, moi Teutë, të kujtohet kur të kam mbartur në krahë si hammall, që të të merrte ky pizevengu këtu... Ha, ha, ha.

Ha, ha, ha, qeshte Teuta në skajin tjetër të tarracës. Ky bjondi, tha me vete Sherifi, por në çast e hoqi mendjen nga ata. Fortinot e qendrës gjëmuani përsëri. Në lartësi gjëmimi i tyre dëgjohej ndryshe nga atje poshtë. Ja dhe gjysmëtanku. Mbahëj akoma. Në mëngjes herët e sulmuani me bomba dore dhe me shishe benzine, por më kot... Atje në fshat, kur i erdhën ditët e fundit,

Tosun agai kishte lojtur fare nga mendja. Ai godiste jo vetëm këdo që i afrohej, qoftë edhe ata që i sillnin ushqime edhe ujë, por, kur nuk kishte më kë të godiste (ata ia hidhnin ushqimin nga larg, si ndonjë qeni), ai filloj t'i binte me shkop vetes së vet.

— Një autoblindë, — tha papritur partizani bjond, duke u kthyer nga Sherifi. — Ja, atje.

Ai tregonte me dorë nga kreu i bulevardit, ku u duk vërtet një autoblindë. Sherifi u mbështet te mitralozi i rëndë dhe, duke i mëshuar shtratit të tij, e drejtoi tytën andej. Autoblinda eci disa dhjetëra metra nëpër bulevardin «Musolini», pastaj befas u kthyte dhe u zhduk në një rrugicë.

— S'merret vesh, — tha partizani bjond, që ishte afruar bashkë me Teutën. — Bëjnë ca lëvizje si ata që ngrihen në gjumë.

Me pëllëmbën e dorës Sherifi fshiu ujët mbi shtratin e mitralozit. Shiu s'po pushonte. Fortinot e qendrës pushuan përsëri dhe ai ndjeu prapë atë përhumbjen e parë. Poshtë tarracës, nën ato pllaka monotone plot ujë, ishte ndërtesa bosh e Radiostacionit, sallat e incizimit, të heshitura, aparaturat, mikrofonat e lajmeve, të gjitha, të vëna në gjumë si nga një shpirt i keq. Ndërsa hipnin e zbritnin nëpër katet, shumica e të cilëve ishin veshur me kade, të kuqe të errët, partizanët, pa e ditur as vetë pse, flitnin me zë të ulët, disa herë me shenja. Në një nga dhomat e katit të dytë kishin mbyllur katër gjermanë që u dorëzuan në fund fare, kur partizanët dhe guerrilierët dolën në tarracë. Shumica e gjermanëve që mbronin çdo shkallë e çdo korridor, u vranë, dhe kufomat e tyre, të hedhura njëra mbi tjetren në oborrin e prapsmë të ndërtuesës, ishin akoma të pavarrrosura. Një pjesë e vogël e mbrojtësve kishte mundur të largohej nëpër një dalje të fshehtë, bashkë me tre shqiptarë, dy teknikët dhe një vajzë, spikere, të fundit punonjës nga personeli i radios,

që kishin mbetur gjer në fund në Radiostacionin e rre-thuar. Gjatë gjithë kohës që vazhdoi goditja e ndërtesës dhe sulmi, të dy teknikët dhe vajza, siç tregoi një nga gjermanët që kishte mësuar pesë fjalë shqip, ishin mbyllur në një dhomë të katit të katërt dhe, ndërsa teknikët qanin herë pas here, vajza, për çudi, pinte cigare dhe vërvshëllente lloj-lloj melodish. Ishte bjonde, tha gjermani, blondesgift, dhe qeshi: ha, ha, ha. Pse mos qeshësh, i tha një partizan i shkurtër nga skuadra e parë, na grive me mitraloz gjithë ditën dhe ne tani të japim të hash. S'i marr vesh unë këto rregullat e reja të luftës.

— Prapë ajo autoblinda, — tha partizani bjond, duke zgjatur krahun në drejtim të Bankës.

Sherifi e drejtoi tytën e mitralozit andej dhe priti që autoblinda të ecte nëpër bulevard, mirëpo ajo, ashtu si edhe herën tjetër, u zhduk në rrugicë.

— Iku, — tha Teuta.

Shiu nuk pushonte. Ato pjesë të flokëve të saj që dilnin nga kapela, ishin të qullura. Sherifi e dinte, se, të qullur, flokët e Teutës kishin një aromë të veçantë. Ahere, në Operacionin e Dimrit, fitilat e akullt të atyre flokëve i bënin në qafë Sherifit vazhdimi, vazhdimi. Ata ishin futur më në fund në një shtëpi fshatari. Ai, i mpirë krejtësisht, e kishte lëshuar atë pranë zjarrit. Dhe ahere, nga ngrohtësia e vatrës, koka e saj kishte humbur në avull, qe larguar si nëpër mjegull, dhe ai dy-tri-herë qe përmendur i trembur, se mos ajo nuk ishte aty.

— Sherif, — tha Teuta, — pse dukesh si i pikëlluar?

Ai fshiu prapë me pëllëmbë ujët mbi strehën e mitralozit dhe ngriti supet. Nuk dinte ç'të thoshte. Në të vërtetë nuk ishte i pikëlluar. Kishte vetëm një lloj hundimi, mbi këtë tarracë të lartë, nga ku dukej një qytet, që për të ishte akoma i huaj.

— Po ja, — tha ai, — gjithë ditën këtu, me këta tela të vdekur pranë.

Ajo ktheu kokën nga kompleksi i antenave, fundet e së cilave ishin mbërthyer me unaza metalike në parapetin prej betoni.

Prite tani kur të qeshë, tha me vete Sherifi. Por ajo nuk qeshi. Vështronë, duke rudhur sytë, telat metalikë, ku pikëzat e ujit rriddhnin qetësish. Spiralja që kishte këputur Javeri me mitraloz, varej akoma përgjysmë te parapeti.

— Mirë e the, — tha Teuta mendueshëm, — gjithë këta tela të vdekur.

Si i përhapin vallë fjalët në erë? pyeti veten Sherifi. Ca shkopinj metalikë, të ftohtë, në shi. Ai provoi atë ndjesi shqetësuese që zgjon kurdoherë enigma. Por ajo ishte diçka më e keqe se enigma. Uuu...

Memeci kishte vdekur ndaj të gdhirë, pasi kishte bërë «uuu» gjithë natën. Dukej sikur diçka donte të thoshte edhe ai përparrë se të vdiste. Fytyra e tij shprehë një dëshpërim të madh që s'ishte e mundur ta bënte këtë gjë. Herë-herë Sherifit i dukej se gurmazi i tij gati-gati po i artikulonte fjalët, por tamam si ajo kova që e ngre dhe e ngre nga një pus i thellë dhe pastaj, tamam te gryka e pusit këputet e bie poshtë, ashtu edhe gulçimet e Memecit binin e humbitnin në thellësitë e tij, pa u kthyer dot në fjalë. Duke e parë se sa vuante që nuk po i vinte zëri, Sherifit i shkoi ndër mend, se ndoshta për shkak të plagëve ai e kishte harruar në ato çaste se ishte memec dhe po hiqte ato mundime skëtëerre. Më në fund, kur vdiq, një partizan i vjetër në moshë, ai që ia mbylli sytë, tha: Ja dhe Memeci, erdhi dhe iku nga kjo botë pa folur një fjalë të vetme. Ndoshta për të dhjetën herë Sherifit i qenë kujtuar fjalët e komisarit dhe ishte përpjekur të merrte me mend se ç'gjë e kobshme duhej të ishte memecillëku i një vendi të tërë, dhe sado që i dukej se diçka përfytyronte nga ky tmerr, prapëseprapë, e kuptonte fare mirë se ishte vetëm në periferitë e tij, se për-

masat e këtij tmerri duhej të ishin kaq të frikshme, sa
çdo mendje njerëzore do të çmendej që në përballimin
e parë me to.

Një mijë vjet memecillëk! Dy mijë vjet, tha me vete Sherifi. Pllakat e tarracës ishin të bardha, të lëmuara, pa kujtesë. Shiu binte pa pushim. Poshtë, qyteti i madh, vende-vende i mbuluar me mjegull, vende-vende me luftë, lëshonte ca zhurma, sinjale e mesazhe të çuditshme, që, duke u bashkuar me njëra-tjetrën, sajonin një zhaurimë të largët, të pakuptueshme e misterioze një kohësisht.

Vazhdonte mungesa e energjisë elektrike. Dru s'ki-shte (ato ishin prej kohësh në zonat e çliruara). Tregu i zi bënte kërdinë. Dorëshkrimet e Adrian Gumës ishin këmbyer prej dikujt me tre kilogram miell misri dhe ca sapune. Te dyqani i porsahapur i antikuareve të Rrok Simonjakut vazhdonte të kishte radhë. Shiteshin me urgjencë sende dhe sidomos veshje, që besohej se nuk do të përdoreshin më në rendin e ri. Brenda datës 13 nëntor u dorëzuan njëmbëdhjetë raso priftërinjsh, dy uniforma ambasadorësh të mbretërisë, dy mantele klerikësh të lartë, rrobat e ballos të Marie Rrokajt, tetëmbëdhjetë frake, katër kaftanë deputetësh, skufja e një anëtari të Akademisë Fashiste, një urdhër i Franc Jozefit, rrobat e ballos të hanëmes Selma Z. Përpara hajatit të shtëpisë së fallxhores plakë Hançe Hajdije Pezë e Madhe kishin parë duke u dredhur nga të ftohtët, në shi, ish-ministrin e Ekonomisë bashkë me të shoqen, që po pritnin radhën për të hedhur fall.

Murale. Vdekje tradhtarëve të kuq. Vdekje juve, të bardhëve. Gjermanë, s'keni pér ta parë Berlinin tuaj.

Nicht hinauslehnen. Partizanë, i keni numëruar morrat që keni? Mos kini merak, do t'i numërojmë të gjitha: morrat tanë, florinjtë tuaj. Do t'i lajmë llogaritë gjer në fund. Mehmet Shehu, këtu nuk është Spanjë, ku luftonte dreqi me të birin; i thonë Shqipëri këtu, more vesh? Kokën hëngërshti një orë e më parë, të dyja palët. Ham, ham. Ish-fortino gjermane: WC për gra. Ah, Mehdi bej! Kërkohen tradhtarët e popullit (vazhdon lista). Kush gjendet duke shkruar në mure, qëllohet pa paralajmërim. Lederer. Të pushojë vëllavrasja, ku e gjeni, o të zbetë, kaq gjak? Këndeje kaloi batalioni i dytë i Brigadës së Parë Sulmuese Heroike. Urra! Vdekje kundërrevolucionit! Vdekje juve!

Legjenda dhe e vërteta e minimit të Tiranës. Ajo zvarritej si një kërmill ditë e natë, lagjeve, midis fortnove, mbi shpinë barrikadash, përmes sheshesh plot me të vrarë, atje ku nuk mund të kalonte dot njeri. Ishte më lehtë të matje drejtimin dhe shpejtësinë e erës vjesh-tore, sesa drejtimin dhe shpejtësinë e përhapjes së lajmit të minimit.

Thuhej se kishte një urdhër për të hedhur në erë Tiranën dhe se vazhdonte vendosja e minave nën themelat e saj, mirëpo grupi i xhenjerëve gjermanë që merrjej me këtë punë, lëvizte nën tokë, nëpër terr bodrumesh, kanalizimesh e zgavrash, i paparë dhe i pandier nga askush. Ç'rajon të Tiranës kishin minuar gjer tanë, ku vazhdonin minimin, ç'drejtim do të merrnin më vonë? Asgjë nga këto nuk dihej dhe asgjë nuk u mor vesh kurrë. Kjo ndodhi sepse ata s'dolen më nga nëntoka. Ç'u bënë vallë, humbën udhën, u rroposën nën dhë, ranë në hon, u shfarosën nga minjtë, mbytën njëri-tjetrin, u çmendën? E gjithë kjo mbeti nën dhe. Mbi dhe ikte vetëm gojëdhëna.

Legjenda e martirizimit të Adrian Gumešs. Nuk u mor vesh si u bë skicimi i parë i legjendës së martirizimit të shkrimtarit Adrian Guma, autorit të «Elipseve të shtërgjeve». Duhej të ishin përdorur kallëpe të vjetra evropiane dhe myslimanë — aziatike njëkohësisht, të cilat, pasi qenë shkundur nga pluhuri, ishin gati për të derdhur në to brumin e ri të legjendës. Pas projektimit, realizimi i saj ishte një gjë e lehtë. Kjo ishte një teknologji e lashtë, vepër kolektive e mijëra gojëve, veshëve, zhgënjamëve ngajeta, pikëllimeve erotike, èndrra përlavdi, të gatshme përtu paguar qoftë edhe me vdekjen e bujshme të vetvetës, përfytyrime të tabutit tënd që noton në një bardhësi lulesh dhe zi kostumesh, ngrohtësia e jastëkëve nén gulçimet e dikujt, inicialet Z.K.M., që vërtiten si zogj të vegjël të zinj nëpër qiellin bosh dhe gjithçka tjetër që i mungon dhe që e pikëllon me largësinë e saj jetën njerëzore.

Zgjedhja e Adrian Gumeš ishte një rastesi. Rendi që po ikte, do të krijonte patjetër një martir. Ishte e natyrshme që kandidatin përmartir ta zgjidhët nga vetvetja, por ishte më bindëse që ta gjente atë midis neutralëve.

Bërthamën e legjendës, ashtu si të çdo legjende të tillë, e përbënte një vdekje e dhunshme. Adrian Guma e kishte këtë vdekje, pavarësisht se dhunuesi i jetës së tij ishte ai vetë. Pikërisht këtu u bë dhe modifikimi: Në natën e 14 nëntorit, në periferi të Tiranës, shkrimtarit Adrian Guma, pasi u la tri ditë pa ujë, u martirizua prej komunistëve. Ai u mbërthyen me bajoneta në një lis qindravjeçar (vend i ardhshëm pelegrinazhi), dhe mbi trupin e tij të masakruar iu vizatuan me bajonetë elipset e famshme të shtërgjeve, motiv i preferuar i artit të tij.

Siq shihet, u shfrytëzuan dy elemente rutinore: etja dhe kryqëzimi. Njëri u mor, siq duket, nga pikëllimi mysliman përmartir Abaz Aliun e shkretëtirës, kurse tjetra nga krishtërimi. Legjenda kishte tanë gjithçka: pjesën e saj të rendë, themelin e zi, që ishte vdekja, dhe pjesën tje-

tër, eterike, të kaltëreme, elipset e zogjve shtërgj. Ajo mund të fluturonte tani lehtësisht mbi qytetin gjëmimtar.

Barrikada e shtatë e rrugës «Carnavon». Ajo u dogj dhe u ringrit tri herë. Të gjitha objektet e hedhura në barrikada dilnin nga shtëpitë e qytetarëve tiranas, duke tërhequr me vete një pjesë të historisë së familjes. Në barrikadën e shtatë të rrugës «Carnavon» ishte hedhur, midis të tjerash, tepsia gjigante prej bakri e Hallunajve, e famshme për diametrin e saj, 1,78 m. Kjo ishte një tepsi bakllavaje, e bërë, siç duket, për dasma të mëdha, e sjellë nga Janina nga plaku Hallun, i cili thoshte se e kishte blerë nga një çifut armen në një ditë të ngrohtë me shi. Tepsia kishte në shpinë një mbishkrim në formë harkore me ca gërmë që ngjanin si merimanga të thjeshtuara nga një masakër. Me sa dukej, këto qenë gërmat e armenishtes. Më 1919 tepsinë, që ishte bërë ndërkaq e famshme, e kërkoi për dasmën e vajzës Xheladin Pasha i Tiranës, por plaku Hallun që e kishte taksur atë për dasmën e djalit të tij të madh, nuk e dha. Meqenëse kjo dasmë nuk u bë, ngaqë djali vdiq nga një meningjit, tepsinë e myllën në grunarin e shtëpisë. Për të qenë hapur legjenda, dhe bankjeri Rrokaj e kërkoi ta blente atë për njëqind napolona flori, por Hallunajt nuk e dhanë. Në prill të vitit 1938, komisioni që merrej me koloretin kombëtar të dasmës së mbretit Zog me Geraldinën, e kërkoi tepsinë për bakllavanë e madhe mbretërore, por Hallunajt, duke sjellë këtë herë arsyesh sentimentale, përsëri nuk e dhanë. Kështu që në të nuk u bë asnjë herë asnjë bakllava. Më 11 nëntor 1944, në orën 4 të mëngjesit, Hallunajt e rinj, dy vajza dhe një djalë, duke e rrokuallisur me kujdes, e vendosën atë në barrikadë. Ajo ishte shpuar në katër vende nga plumba mitralozash, dhe një predhë topi të tankut i kishte bërë një shqyerje të madhe mu në mes.

Ezani i fundit. Ai u këndua nga myezini i xhamisë së qendrës në muzgun e datës 16 nëntor nën një qiell fare të ulët, me një zë të dridhshëm e të zvargur, plot pikëllim islamik, që pérhapej vajtueshëm mbi bunkerët gjermanë të qendrës, midis kolonave të Bankës, te hoteli «Kontinental» dhe më tej, gjer te tarraca e Radiostacionit. Ishte një pikëllim i vjetër, që të kujtonte mure të ulëta teqesh, varreza myslimanë me gjerryerje pluhurore bojë-kafe anash, çallma dhe rërë dhe diell të çngjyrosur, që mund të lidheshin, njëfarësoj, me emrin e fushës së Qorbelasë (ç'të verbër gjenin belanë akoma në atë fushë?) dhe në përgjithësi me shkretëtirën arabike. Minareja e xhamisë qe këputur në mes dy ditë më parë nga një predhë mortaje, dhe, tek këndonte ezanin e fundit, myezinit shtatëdhjetedyveçar i dukej se te vendi i këputjes së minaresë (copat e mprehta të gurëve ngjanin si koska të një krahu të thyer), qelli i ulët vjeshtak gjerrisej e përgjakej.

Nga falli i mbasditës së 16 nëntorit i Hançë Hajdijes Pezë e Madhe. Ja ku është filli i zi i leshit, ja filli i bardhë, ja i verdhi, i kuqërrëmti, i jeshilti. Nga dama maço tek asi i zi, nga asi i zi te dama maço, ftillohet e ftillohet pa mbarim. Ti, moj zonjë, që s'ta shoh fytyrën, dhe ti tjetra, dhe ti atje, dhe ti që dridhesh, dhe ti që je mbuluar me vello të zezë që të mos njihesh, dhe ju të tjerat, mjerë ju, se filli po ju mbështjell të gjithave. Në heshtje, si merimangat, moj gra, do të endni fije e fije leshi, ditë e net, ditë e net do bëni triko për të nxjerrë bukën e gojës. Triko për ata që ju përbysën ju. Mjerë ju, moj merimanga.

Melodi nëpër erë. Në pallatet madhështore dridhet korbi gjakatar.



Kori i bejlereshave plaka. Kjo punë mori fund. Re-gjenca iku. Kush mundi, u shkul. Ne mbetëm këtu. Kanë mbetur shumë, shumë. Kur bie tërmeti, duket sikur jeta shuhet, por s'ndodh ashtu. Pas shungullimës, dëgjohen zërat e mbuluara nën gërmadha. Ne jemi tani ata. Të marrim shkopinjtë e pleqërisë, të lidhim shifonet e zeza në kokë, të veshim qyrket dhe të dalim portë më portë. Tak, tak, tak. A jeni aty? Tak, tak, tak. A jeni aty? Tak, tak, tak. Lëre tani kujën. Tak, tak, përgjigju trokitjes sime. Të shohim kush është gjallë. Të shohim kush ka mbetur. Gjithë kjo stuhi që ish. Tak, tak.

Vazhdonte të binte shi. Që larg, të mytura nga mjegulla, vinin zhurmat e luftës. Në tarracën e Radiostacionit Sherifin e Teutën i thirrën të zbritnin në katin e parë, te zëvendëskomisari i njësitit. Atje, në një kanape të madhe, në një pozë të panatyrrshme rrinin Mete Aliu dhe Thanasi. Thanasi ishte skuqur nga turpi. Mete Aliu, përkundrazi, pas gjithë atyre vuajtjeve nga plaga, ishte i verdhë.

— Kemi urdhër nga komanda të mbledhim personelin e Radiostacionit, — tha zëvendëskomisari. — Këtë punë do ta bëni ju të katërt. Ja lista e plotë e personelit.

Ai e zgjati atë përparrava vetes, duke i hedhur një shikim të shpejtë të katërve.

— Mbaje ti, Sherif, — tha. — Ti do të jesh komandant i patrullës.

Sherifi zgjati krahun. Mënga e kapotës së tij kullaonte ujë.

— Aty keni adresat e tyre, — tha zëvendëskomisari.
— Do t'i sillni këtu sa më parë, me hir ose me pahir. E qartë?

Ata bënë «po» me kokë dhe u ngritën në këmbë!

— Tani merrni armët dhe nisuni. Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — u përgjigjën ata.

— Prit, — tha zëvendëskomisari, kur Sherifi po kapërcente pragun. — Gati sa nuk harrova. — Ai futi duart në xhepat e mëdha të kapotës, në thellësi të së cilave u bë një zhurmë metalike. — Merrni këto, pér çdo rast...

Sherifi shqeu sytë. Në duart e zëvendëskomisarit ishin një palë pranga. Ca hallka hekuri me një mekanizëm të thjeshtë pér t'u mbyllur.

— Q'i hap sytë ashtu? — tha zëvendëskomisari me nervozizëm. Ai ishte i gjatë, i hollë, me një ballë që i mbulohej shumë lehtë me rrudha zemërimi. — Pranga janë.

Ai hodhi sytë nga njëra anë e tryezës në tjetrën, sikur të mos dinte ku të ndalonte vështrimin dhe thirri me inat:

— T'u vësh këto pranga në duar armiqve të popullit, eshtë më vështirë se t'u vësh pushkën. More vesh? Këtu do zemër dhe këtu provohen njerëzit.

— Unë jam gati, — tha Sherifi, — nuk e kuptoj pse...

— Gati, po t'u mbulua balli me djersë kur i pe, — tha zëvendëskomisari që vetë e kishte kapërcyer tanë trubullimin. Ai i ra tryezës me grusht. — Radiostacioni duhet të flasë patjetër, more vesh?

Në një të dhjetën e sekondës në mendjen e Sherifit u përhije pamja e ngrirë e Memecit të vdekur me atë mundim të madh, që dukej sikur i kishte mbetur rrëth gojës së mbyllur. Tridhjetë mijë vjetë memecillëk, tha një zë i thellë, si nga fundi i një honi, brenda Sherifit. Një qind e tetëdhjetë mijë vjet.

— Me hir ose me pahir, me pranga ose pa pranga në duar, ata duhet të vijnë këtu, — vazhdonte të thoshte zëvendëskomisari. — More vesh? — Dhe ia tundte pran-

gat mu në hundë. — Pa këto nuk ka diktaturë të proletariatit.

Sherifi zgjati dorën dhe i mori. Prangat ishin të rënnda. Sherifi i futi ato në xhep dhe nderoi përsëri me grusht.

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — tha komisari.

Në kohën që po dilte, gati sa nuk u përplas me Javerin. Edhe atë po e thërritnin, siç duket, për të njëjtën gjë. Radiostacioni duhet të flasë, përsëiste Sherifi me vete, duke dalë nga porta. Antenat vareshin lart në tarracë, si ca krahë pa jetë. Llampat ishin të shuara si sy të vdekurish. Gurmazi i madh ishte i prerë në thellësi, si gurmazi i një vuvi. Vu, vu, vu, bënte era në male, sikur të thoshte vuv, vuv, vuv. Në anët e tyre njeriut memec i thoshin «vuv».

Sherifi preku me dorë prangat dhe u tha shokëve.

— Nisemi.

Ata dolën njëri pas tjetrit në rruginë, ku nga strehët e çative çuriste shiu.

Muret e Tiranës vazhdonin të ishin plot me mbi-shkrime. Ato ishin bërë me bojë të zezë, të verdhë, vishje, blu, me gërmë të mëdha ose të vogla, drejt ose shtrembër, horizontalisht, vertikalisht, pjerrtazi, në formë kurbe, rrethore, disa herë gjashtëkëndëshe. Asnjëherë në këtë qytet nuk qe shfaqur një ethe e tillë për të shkruar.

Të egra, kërcënuese, me gjurmët e afisheve të shqyerra aty-këtu, muret çoheshin përballë njëri-tjetrit me parullat e klasave kundërshtare nëpër gjokset dhe brinjët e tyre. Kërkohet tradhtari i popullit Patër Anton Harapi. Kér... et... ar... Mbishkrimet kishin shpesh mungesa gërmash, diftongjesh, por kështu ato dukeshin edhe më të tmerrshme, ashtu siç duket më i tmerrshëm kërcënimë i njeriut që i mungon hunda ose syri.

Kér... hen komunistët e rrezikshëm... K..ohen tradh... ohen...oh...o....

Muret kërkonin.

Kërkoheshin... ose... ohe... të bëheshin fli njerëz, grupe shoqërore, klasa të tëra, kujtime kombëtare, turpe ose lavdira, varrime, zhvarrime, thyerje ose ngritje monumentesh, shfaqje fantazmash, vdekje, liri, gjak, paqe, tmerr, harrim.

Dukej sikur legjenda e vjetër e murimit kishte dalë nga këmbët e urave dhe themelet e kështjellave, privilegji i të cilave kishte qenë mijëra vjet rrësht dhe vraponte tani nëpër qytet, duke u kujtuar mureve se ato të gjitha mund të ishin të denja për strehimin e saj. Kërkohen të katër regjentët tradhtarë. K...oh....Kér...oh....

Në një nga këto mbasdite linguisti i vjetër Emil Karbunara, i shmangur ngajeta, vejan, duke dalë fsheh-tazi mbesave nga shtëpia e tij në Laprakë, mori udhën drejt qendrës së qytetit. I kishin thënë për fenomene të reja gjuhësore që po shfaqeshin në këto mbishkrime muresh, për rënien gërmash, diftongjesh e grupe të tëra boshkëtingëllorësh, në fundet e fjalëve, në mes, bile edhe në rrënjet e tyre. Ai kishte dëgjuar sa kishte dëgjuar dhe, më në fund, kishte dalë vetë rrugëve për të parë këtë batërdi. Kishte dalë me gjak të ngrirë, por sa më shumë që hastë mbishkrime, aq më tepër qetësohej. Dallngadalë e vërteta po i zbulohet qetësisht. Këto cungime s'kishin gjë të përbashkët me prishjen e gjuhës, as që shfaqur gjékundi prapashtesa «llék», që do ta tmerronte linguistin më shumë se shfaqja e murtajës. Gabimet e jashtëzakonshme ortografike nuk ishin bërë nga njerëzit, por qenë shkaktuar më vonë prej predhave. Gabimet më të lehta, nga plumbat e pushkëve e të mitralozave, ato më të kobshmet, nga predhat e tankeve.

Ai bëhej gati të kthehej gjithë gjësim në shtëpinë e vet, por befas u kujtua për përbajtjen e atyre dhjetëra mbishkrimeve mbi mure. Nisi t'i lexonte përsëri, krejt i hutuar, dhe një pikëllim i madh filloj ta kapllonte të tèrin. Prej mureve vinte një erë egërsie. Gjatë gjithë luftës ai kishte qëndruar mënjanë. Kishte refuzuar nderimet që donin t'i bënin italianët dhe më vonë gjermanët, por nuk kishte bërë gjithashtu asgjë për Lëvizjen, nuk e pranonte luftën e klasave, bile tmerrohej prej saj. Ai e

quante atë gjënë më të kobshme në botë, pas prishjes së gjuhës; e quante bile më të keqe se pushtimet dhe se katastrofat e natyrës. Tani, ndërsa ecte midis mureve, që i dukej se ishin gati të lëviznin nga themellet për t'u përplasur egërsisht me njëri-tjetrin, nëpër trurin e tij kalonte një përfytyrim i vjetër, një njeri që ecte nën dritën e hënës me një thes mbi shpinë. Pas ikanakut të vetmuar, në një largësi të vogël, me opinga të lehta hajdutësh tinzoheshin banditët që e ndiqnin atë. Thesi ishte i vogël, por tepër i rëndë, hëna ishte e njëqind e ca vjetëve më parë, dhe njeriu që ecte nën dritën e saj, po kthehej nga jashtë shtetit për në Shqipëri. Atë thes kishte ditë që e mbante në shpinë nga hani në han, nga kufiri në kufi. Në një nga hanet e rrugës thesi kishte ndjellë hajdutët, të cilët ishin të sigurt se në të kishte florinj, ose, së paku, argjend. Në një nga xhadetë ata e sulmuan njeriun dhe e vranë qetësish. Pastaj, pasi e hodhën trupin e tij në hendek, hapën thesin. Ajo që ishte brenda, ishte e rëndë, por s'ishte as flori, as argjend. Për një kohë të gjatë ata nuk e kuptionin q'ishte. Ishin ca copëra të vogla, fare të vogla plumbi me nga një gërvishje në majë. Shumë prej tyre qenë të përgjakura. Më në fund, banditet ikën duke mallëkuar të vrarin, që e morën për të qëndur. I vrari s'që i qëndur. Ai ishte një gjuhëtar që po sillte në Shqipëri alfabetin e parë, të krijuar prej tij, me gërmat e derdhura në plumb në një nga vendet e Evropës. Ai po e sillte atë ilegalisht, sepse shkrimi i gjuhës shqipe ishte nxjerrë jashtë ligjit.

Shpeshherë, kur Emil Karbunara shikonte libra dhe gazeta shqipe me shumicë, i kujtohej ikanaku nën hënë. Për të ai ishte prometeu që u kishte sjellë shqiptarëve gërmat e gjuhës së tyre. Ishte e thënë që boja e parë tipografike që do të binte mbi to, të ishte gjaku i tij.

Por tani, duke parë mbishkrimet në mure, Emil Karbunara ndjeu një ligështim në shpirt. Gërmat shqipe kundër gërmave shqipe. Kjo ishte e parrokshme për të dhe ogurzezë. Sikur ai, Ikanaku i Madh, të ngrihej nga varri dhe të shikonte ç'po ndodhë me ato gërma, do të lemeritej gjithashtu. Çmësohuni, do të thërriste ai me atë

gjëmim zëri që e kanë vetëm të vdekurit. Unë nuk i solla ato për këtë gjë.

Emil Karbunara, me dorën që i dridhej, ngriti një copë thëngjill që e pa në trotuar dhe, si u mëdysh një copë herë, ngriti krahuun dhe shkroi në murin përbri: «Të bëhet prapë terr! Të bëhet padit...». Ai deshi të shkruante, siç duket «padituri», por s'arriti ta mbaronte fjalën. Pas shpinës së tij u dëgjuat një e folur gjermanisht dhe pastaj ai ndjeu shpinën t'i bëhej e rëndë, sikur po i thyhej nën një peshë kolosale... Thesi.. me plumb ... arriti të mendonte vetëtimthi në kohën që rrëzohej mbi trotuar, ndërsa krismat e automatikut fluturonin tutje, sipër tij, sikur s'kishin më punë me të.

ЭТУСИАЗЫ

KAPITULLI I PESTË

Ndërsa lidhte në kokë një shifon të zi, bejleresha plakë Mukades u afrua dhe një herë te dritarja. Jashtë binte shi i hollë.

— Mama, rri më mirë brenda, — i tha me zë lutës nusja e saj e re, Lumturia.

— Pusho, Lulu, — tha plaka, me zë të ngjirur. — Lufta ka mbaruar. Bie vetëm shi.

Lumturia psherëtiu duke u mbështjellë me një pulovër të madhe. Ajo kishte vazhdimisht ftohtë.

Gjysmë orë më parë dikush vraponte nëpër Rrugën Mbretërore duke thirrur si i marrë: «Qendra ra. Gjermainët po tërhiqen drejt xhadesë veriore. Qendra ra».

— Mama, — ia bëri prapë gruaja e re.

— Pusho, — tha plaka, këtë herë me zë më urdhërues. Dhe, për t'i dhënë të kuptonte gruas së re, se nuk donte të dëgjonte më këshilla prej saj, i nguli sytë e saj të shkruar, që dukeshin gati të bardhë nën atë tufë flokësh të lyer me këna, poshtë shifonit.

Nusja uli sytë.

— Dua të shoh se sa poshtë jemi rrëzuar, — tha plaka, me zë të rëndë. — Dhe, në qoftë se nuk e di, mësoje, meqë erdhi rasti, se kjo është pikërisht gjëja e parë që duhet të mësojë njeriu pas një përbysjeje.

— Sa gjëra të tmerrshme që thua, — ia bëri nusja, me zë të përlotur.

— S'i them unë, ato janë ashtu.

— Po mbapse nuk jemi përbysur akoma aq sa...

— Pusho, — thirri plaka dhe i ra me shkop dyshemës. — Mos ta dëgjoj më atë fjalë. — Ajo e zgjati shkopin në drejtëm të dritares. — Është po ai shi që vazhdon qysh nga e djeshmja. Por sot ai bie mbi një tokë tjetër.

— C'gjëra të tmerrshme që thua!

Bejleresha plakë doli në sallon dhe nusja e ndoqi pas.

— Thonë se Hamide hanëmja është larguar, futur në tankun e një oficeri gjerman, — tha ajo.

Plaka e përbiroi me sytë e saj të ftohtë.

— Tani do t'i marrim vesh të gjitha, — tha, — kush është larguar, kush ka mbetur.... kush... Prandaj unë po dal.

Ajo doli në oborrin e shtruar me pllaka mermari dhe, para se të hapte portën e jashtme, tha:

— Për t'u ringritur, në qoftë se e mendon një gjë të tillë, gjëja e parë që duhet të dish, është se sa poshtë ke rënë.

Nusja e ndoqi një copë herë me sy tek po largohej në rrugën gati të shkretë, nën shiun e imtë. Kush është larguar, përsëriti nusja me vete, kush ka mbetur.

Kishte kaluar një orë që patrulla kishte dalë nga porta e Radiostacionit dhe nuk kishte gjetur akoma asnjieri nga personeli. Dy adresat e para i quan në dy shtëpi të braktisura. Guerrilieri tiranas që i shoqëronte për t'u treguar rrugët, po i conte drejt adresës së tretë. Pamja ishte po ajo: xhamia të thyer, vitrina të bëra shoshë nga plumbat, gërmadha barrikadash që lageshin në shi dhe aty-këtu kufoma me flokë të quillur. Një nga të vrarët kishte rënë kruspull rrëzë një muri plot mbishkrime. Ujët që derdhej teposhtë nga qyngji i shqyer i një strehe, i binte mu mbi qafë, ku ia kishte larë prej kohësh plagë e madhe. Krejt i quillur, nën atë derdhje uji të marrë, i vdekuri kishte një pamje të padurueshme. Kur ata kaluan përbri, Mete Aliu e kapi me krahun e vetëm

për xhakete dhe e têrroqi zvarë, duke e nxjerrë nga goditja e currilit. Në dorën e djathtë i vrari shtrëngonte akoma një copë thëngjill, me të cilin ndoshta kishte dashur të shkruante diçka në mur. Mete Aliu ngriti sytë nga muri, si për të kërkuar atje shkronjat e tij. Iu duk se i njobu ato midis të tjerash, nga një fjalë e mbetur përgjysmë, gjer te gëрма «T», bishti i së cilës qe zgjatur pothuajse gjer në tokë, siç duket, gjatë rrëzimit të njeriut.

Mete Aliu shpejtoi hapat për të arritur shokët. Ishin duke iu afruar rrugës «Ali Pashë Gucia», kur panë të vinte me vrap përballë tyre një njeri me fytyrë krejt të çakërdisur, që bërtiste sa kishte në kokë: «Qendra ra. Gjermanët po ikin nëpër xhadënë veriore».

Ata e ndoqën me sy një copë herë njeriun që kaloi përbri tyre si një erë e marrë. Lajmi duhej të ishte i vërtetë, sepse një orë më parë, pikërisht në kohën që ata po dilnin nga porta e Radiostacionit, nga qendra erdhë një gjëmim bombash, i padëgjuar ndonjëherë.

— Sikur të kalonim nga qendra, — tha Teuta.

Sherifi vështroi guerrilierin.

— Ka dy adresa që duhet t'i kërkojmë matanë qendrës, — tha ai. — Po të doni, e nisim andej.

Ata dolën përsëri në bulevardin «Musolini» dhe ecën drejt qendrës. Kudo dukeshin gjurmë përleshjesh. Kangjellat e pallateve buzë rrugës ishin shqyer, siç duket, nga tanket.

— Ja muri ku kishim pozicionet tona, — tha Teuta.

— Ja dhe barrikada.

Sherifi ndjeu një sëmbim në zemër kur pa mbeturinat e barrikadës. Ajo i ngjante rrënojave të një konstrukioni të vjetër, që era e ha e e gjerryen dalngadalë. Copërat e thyera të lavamanit shkëlqenin diku aty poshtë. Më tutje ishin tanku dhe autoblinda e djegur. Gjermanët e shkrumbuar ishin akoma aty, vetëm se tanë i kishin kthyer mbi shpinë, me sa duket, pasi u kishin kontrolluar xhepat. Teuta ktheu kokën matanë për të mos e parë. Sherifi vuri re se sytë e Mete Aliut rrëshqitnin si në ethe mbi bulevard. Ndoshta shpreson se mos sheh në

ndonjë anë krahun e tij, mendoi ai. Një skuadër parti-zanësh e guerrilierësh po vinte duke kënduar, përballë tyre.

Më tutje, në një udhëkryq të ngushtë, ata panë një grumbull njerëzish që ngjanin sikur përkuleshin mbi ca tezga të padukshme. Drejt grumbullit vraponin kalimtarë të vetmuar, sidomos gra. Kur u afroan ato, dëgjuan të qara dhe dënesa. Poshtë, të shtrirë rresht, me sy të ngrirë, të hapur, kishte njerëz të pushkatuar. Fytyrat e pjesës më të madhe ishin të deformuara. Gratë uleshin në gjunjë, i kthenin kufomat mbi shpinë për t'i njojur, me duar të dridhura, shtynin njérën, zinin tjetrën, gjersa lëshonin më në fund nga një klithmë

— C'janë këta të vrarë? — pyeti Metë Aliu një hoxhë që rrinte pak mënjanë.

— Pengje, zotni, — tha hoxha, me zë të trembur. — I pushkatuan gjermanët sot në mëngjes. I kishin peng prej kohësh.

Një grup guerrilierësh po vinin duke kënduar e duke valvitur një flamur.

Hoxha filloj të këndonte me zë të ulët një lutje të vjetër, të përvajshme.

— Ikim që këndeja, — tha Teuta. Ajo ishte e zbetë në fytyrë.

Pas disa minutash ata arritën në qendër. Tani, në këmbë, qendra dukej krejt ndryshe nga ajo që e kishin parë, duke u zvaritur e duke u rrrotulluar nëpër asfaltin e saj.

— Ja fortinot, — tha Thanasi.

Rreth e rrrotull vendi ishte sterri i zi.

Sherifi kërkonte me sy gjysmëtankun. Ja ku ishte, i fundosur pak në njërin krah, me tytën e topit të ngritur në një lartësi të pazakonshme, krejt i përzhitur, tamam një ulok i vdekur. Atje në fshat, në varrimin e Tosun agait, të gjithë qenë tmerruar kur kishin parë arkivolin e tij. I tillë arkivol s'qe parë e s'qe dëgjuar ndonjëherë që nga kohërat që s'mbaheshin mend. Jo i gjatë si çdo tabut, por katror dhe, veç kësaj, sikur të mos mjaftonte kjo, përsipër kishte një të ngritur, një si kube, për të

futur, siç duket, gungën e të vdekurit. Edhe varri kishte po atë formë. Ulok i vdekuri, ulok dhe varri, kishte thënë plaka Qenane.

Një qen i madh vraponte mes për mes sheshit «Skënderbej». Te hyrja e shtrembüruar si nga një lëkundje tërmeti e njërsë prej fortinove, një kalimtar kishte zgjatur kokën gjithë kureshtje.

— Brenda ka gjermanë të djegur, — tha ai, duke shtrembüruar fytyrën me neveri.

Ca guerrilierë kalonin me vig në duar përmes sheshit. Nga batanijet, sipër vigeve, dilnin koka të anuara, shumica të lidhura me fasho.

— Njëri m'u duk si Aleks, — tha Mete Aliu.

Aty-këtu mbi shesh kishte kufoma gjermanësh, shumica të përzhitur. Nga larg vinte një gjëmim lufte. Dikush thoshte: luftohet akoma te burgu i ri. Sherifi vështronte minarenë e një xhamie të prerë përmes nga ndonjë predhë mortaje. Perbri saj, nga e djathta, ora e madhe e qytetit ngrihej si një fytyrë e verdhë mbi gjithçka. Mbi akrepat e saj, të futur nëpërmjet xhameve të thyera, rrinin tufa galash. Për shkak të tyre, të katër fushat e saj që vështronin të katër horizontet e qytetit, tregonin kohë të ndryshme.

— Robër gjermanë, — tha Teuta, duke treguar një kolonë ushtarësh që po vinte nga ana e Bankës.

Vargu i tyre i gjatë kalonte ngadalë ndanë ministri ve, midis rojeve partizane. Një burrë i dobët, i çalë rendte sa mundte, me një shkop në dorë, anash vargut të robërve. Rojet partizane e shtynë dy-tri herë, por ai gjeti rastin, më në fund, të godiste me shkop njërin prej robërve. Si e bëri këtë gjë, u ul i lodhur mu në trotuar dhe nxori kutinë e duhanit.

Teuta u bë gati t'ia plaste gazit, por në atë çast i zunë sytë prapë kufoma të rëna përbys dhe ktheu kokën nga ana tjeter. Nga kthimi i vrullshëm i kokës e qeshura iu shqye në ajër si një zog.

Qeni i madh po kalonte prapë përmes sheshit po-thuajse të shkretë, që ata po e linin tanë pas shpinës së tyre. Kishin hyrë në një rrugë me trotuare të gjera, të

shkallmuara vende-vende nga zinxhirët e tankeve. Në këtë rrugë barrikadat ishin në një dendësi të jashtëzakonshme. Ca lypës tërë zhele vërtiteshin aty-këtu sipër tyre duke kërkuar të gjenin gjësенд. Nga një rrugicë, duke i rënë një borie dhe me një trumpetë, po vinin me plot zhurmë e vrull një grup të rinjsh, me ftyra të ndezura, siç duket aktivistë të këshillave popullore të lagjeve. Ata këndonin, hidhnin parulla dhe tundnin grushtet e ngritura përpjetë. Më tutje ishte një tank me zinxhirë të shqyer. Ndërsa kalonin përbri, Teuta lëshoi një britmë të vogël. Nën zinxhirët e tankut ishte një njeri i shtypur. Duke shen vetëm krahët e tij me pëllëmbët të hapura, që dilnin anash zinxhirëve, si ca shtojca të përcudnuara mishi të huaj, krahë kartilagjinozë engjëjsh apo djajsh, në atë trup të hekurt.

Më tutje rruga sa vente bëhej më e gjallë. Kalonin grupe partizanesh, patrulla, guerrilierë, vajza, duke kënduar. Një plakë kishte dalë mu në mes të rrugës dhe ndande një byrek. Një tjetër po vinte me ngut me një tabaka porcelani në dorë. Në të kishte plot filxhanë me kafe. Kur ata të katër u afruan, në tabaka kishte mbetur vetëm një filxhan. Plaka iu zuri rrugën.

— Më raftë pika, që mbaruan, — tha ajo, — merreni këtë që ka mbetur.

— S'ka gjë, nënë, ne jemi me shërbim, — tha Sherifi, — Jepjani ndonjë tjetri.

— Jo, jo, — tha plaka. — Më raftë pika që s'kam pér të gjithë. Merre ti, të keqen nëna, — tha ajo, duke iu drejtuar Mete Aliut.

— Ta ndajmë, — tha Mete Aliu.

— Pije ti, pije, — thanë në një gojë Sherifi me Teutën.

— Pije ti, — tha dhe Thanasi, duke u bërë flakë i kuq. Mete Aliu e mori kafenë dhe mbylli sytë nga kënaqësia kur buzët e tij prekën buzën e filxhanit. Plaka vështron te vjedhurazi herë krahun e tij të vetëm që dridhej lehtë tek mbante filxhanin, herë flokët gështenjë të Teutës. Mete Aliu po e mbaronte kafenë, kur plaka, sikur të përmendej nga gjumi, thirri:

— Po pritni, pritni pak, ja, u ktheva, — dhe iku me një vrap tē panatyrshëm, që atyre do t'u dukej qesharak, sikur tē mos ishin tē mallëngjyer. «Ku shkon?» thanë një goje dy-tre partizanët, që s'dinin ku t'i vinin filxhanët ku porsa kishin pirë kafenë. Plaka u kthyen shpejt, me një frymëmarje tē dendur dhe me diçka tē vogël tē mbështjellë, në dorë.

— Vajzë e nënës, — i tha ajo Teutës, duke iu marrë fryma dhe, me atë gjest tē veçantë që mund ta bëjnë vetëm plakat kur i dhurojnë diçka njeriut që e duan, një lloj lëvizjeje edhe e dhemshur edhe pak tinzare, ajo i vuri në dorë një sapun tē vogël tualeti.

— Jo, nënë, jo, — ia bëri Teuta, e trubulluar dhe deshi tē largonte dorën, por plaka ia kishte zënë atë ndërkaq dhe po ia mbyllte gishtat mbi paketen e sapunit.

— Nuse e nënës, — murmuriti ajo dhe iku me shpejtësi, e ndjekur nga partizanët, që donin tē linin filxhanët e kafesë mbi tabakanë e saj.

— Këndeja, — tha guerrilieri, duke treguar një rrugë tē ngushtë me ndërtesa tē larta anash. Përballë tyre, e vetme në atë perspektivë tē zhveshur, midis mijëra guresh tē gdhendur tē mureve, e veshur me rroba tē shtrenjta, tē zeza, me lëkurë tē zbetë, si tē ngjitur artificialisht mbi kokën e saj, po vinte një zonjë plakë. Sytë e saj u ngjiten dhe u shqitën me vështirësi, si një leukoplast, gati me dhembje fizike, mbi sytë e tyre.

— Ç'plakë, — murmuriti Teuta, kur ajo qe larguar disa hapa dhe, pa e ditur as vetë pse, ktheu kokën pér ta parë prapë. Zonja plakë gjithashtu kishte kthyer kokën dhe Teutës së trubulluar iu duk se tjetra shpërvoli përbuzshëm buzët e saj tē holla.

Rruja herë ngushtohej, herë zgjerohej. Numrat e portave sa vente zvogëloheshin.

— Ja, kjo këtu, — tha guerrilieri.

Ishte një portë dykanatëshe, e lyer me një ngjyrë tē qetë bojë bari, në këndin e djathët tē së cilës ishin shënuar emrat e katër familjeve që banonin aty. Mbi një paftë prej bakri varej trokitësja metalike. Pragu dhe portali sipër qenë prej guri tē gdhendur. Kjo ishte adresa e

tretë dhe, ndërsa bëhej gati të ngrinte dorën për të trokitur, Sherifi për herë të parë ndjeu t'i ngadalësoheshin të rrashurat e zemrës. Po sikur të mos ishte as ky këtu? Po sikur ata të gjithë të mungonin? Sytë e tij ngrinë dy-tri sekonda tek e çara vertikale, e gjatë dhe qesëndisëse e vendit ku futej kyçi. Goja e Memecit... Dora e Sherifit ra e rëndë mbi trokitësen metalike, pushoi një çast mbi të, pastaj trokiti, në fillim rrallë, një herë, dy, tri, pastaj gjithmonë e më shpejt, me zemërim, me alarm.

Pas breshërisë së parë të të trokiturave Sherifi e uli dorën. Heshtja tani dukej edhe më e thellë, por, megjithëse nuk pipëtinte asgjë, ndihej se midis portës dhe shtëpisë ishte vendosur një kontakt. Më tepër se zhurmë e lehtë, ajo që ata ndien, ishte një fërkim, bile më pak se kaq, një si rrashje flattrash në erë. Papritur ftyra e verdhë e Mete Aliut u zbeh edhe më, pastaj u skuq.

— Borgjezë të felliqur, — murmuriti nëpër dhëmbë dhe, duke e shtyrë pak Sherifin, trokiti. Kjo ishte një e trokitur e ndryshme, trokitja e një njeriu me një dorë, me një aritmi të veçantë, që iu jepte tingujve elemente tmerri. Nga brenda, që larg, erdhi një zë i shuar: «Kush eshtë?»

— Hapeni, — thirri Sherifi, — jemi patrullë partizane.

Sipër kokës së tyre u hap një grilë e lyer me bojë jeshile. Një kokë gruaje, me dy katarakte flokësh nga të dy temthat, u zgjat te parvazi i dritares.

— Kë kërkoni? — tha ajo.

Guerrilieri uli sytë mbi letrën me adresë që mbante në dorë dhe me një zë kryeneç lexoi emrin e mbiemrin e atij që kërkohet. Që brenda shtëpisë u dëgjua në çast një kujë e mbytur. Koka e gruas në dritare u zgjat edhe më jashtë parvazit, ftyrën e saj e pëershkoi një ndriçim tinzar dhe, duke u varur krejt, tha me zë gjysmë të ulët.

— Është këtu, brenda.

Në oborr u dëgjua një trokëllimë nallanesh dhe porta u hap nga një vajzë e vogël. Ata u gjendën në një korridor të brendshëm, gjysmë të errët, nga ku ngrihej një shkallë spirale drejt kateve të sipërme të ndërtesës. Kuja

që brenda sa vente bëhej më e dallueshme. Në katin e dytë, prapa një xhamlliçku të madh opak, ata panë hije njerëzish që përgjonin. Mete Aliu i ra xhamit me gisht. Në atë kohë njëra prej dyerive të apartamenteve që dilin në korridor, u hap përgjysmë dhe ata panë vetëm një krah që tregoi derën tjetër përballë.

— E keni atje, — pëshpëriti po ai zë i njohur gruaje.

Sherifi trokiti. Që brenda u dëgjuat prapë kuja e mbytur, por këtë herë prej shumë zérash.

— Kushedi se ç'kujtojnë, — tha Mete Aliu. — Hyr më mirë ti, Teuta, që t'u dalë frika. Bile, më mirë ti, Thanas, që je më i butë se një vajzë.

Thanasi u bë flakë i kuq.

Dera u hap ngadalë në një korridor gjysmë të ndriçuar, ku ndihej prania e shumë njerëzve që rrinin anëve, qiri në këmbë.

— Oooh, — u dëgjuat një rënkim.

— Qytetarë, përsë trembeni, — tha Teuta, — ne kërkojmë një punonjës të Radiostacionit me qëllim që...

— Jo, jo, jo, — e ndërpren një klithmë gruaje. —

Ai s'ka bërë asgjë, ai s'ka sharë, s'ka dhënë lajme, jo, jo.

— Po pritni, — thoshte Teuta, — po pritni de, nuk është fjala aspak...

— Jo, jo, — ulërinte gruaja.

Ishte e pamundur të merreshin vesh. Thanasi hapi dy-tri herë gojën të fliste, por ai vetëm skuqej.

— Hej bela, — tha Mete Aliu në korridorin e jashtëm.

— Ti mos u fut, — tha Sherifi, — as unë s'futem.

Ata priten përjashta, gjersa brenda u duk sikur u qetësuan njëfarësoj. Por kjo nuk zgjati shumë. Gulçimat dhe klithmat u përtëritën në çastin e daljes. Dikush rënkonte «Maqo, Maqo». Teuta doli e para me fytyrë të shqetësuar. Ballin e kishte të mbuluar me djersë.

— Këta janë të çmendur, — tha ajo.

Më në fund, midis njerëzve të shtëpisë, në korridoren e jashtëm doli njeriu që kërkohej. I gjatë, i mbështjellë me shall, me kaçurrela të buta, të kuqe, me fytyrë të kuqërremetë, ku ishin dy sy seriozë me qeska poshtë, që

i shtonin madhështinë asaj fytyre, ndryshe nga ç'e përfytyronte Sherifi, ai eci përparrë gati i qetë, duke i lënë krahët e tij t'ia puthnin e t'ia shtrëngonin njerëzit e vet.

— Ç'bufon, — murmuriti një nga fqinjët, që kishin zgjatur kokat nga dyert e apartamenteve.

Sherifi ktheu kokën andej. Vështrimi i tij ndeshi me sytë vëngoshë të njeriut që foli. Ai ishte me pizhama dhe, siç duket, e ndjeu për detyrë të jepte një sqarim.

— Është një vanitoz i pashembullt, — tha ai. — Më falni që përdora një fjalë të huaj, por s'di si ta them ndryshe. Është gati të shkojë në pushkatim, vetëm që t'i japë pak rëndësi vetes. Një embecil komplet.

— S'ka ndër mend ta pushkatojë njeri, — tha Sherifi.

— E mora me mend, — ia bëri tjetri. — Skena të tillë kanë ndodhur shpesh në këtë shtëpi. Është për të qeshur.

Ndërkaq turma e vogël po zbriste shkallët me njeriun e gjatë, të kuqërrëmtë në mes.

— Një skenë të tillë ai e ka ëndërruar prej kohësh, — i thoshte te veshi Sherifit burri me pizhama. — Më besoni, nuk jeton, veçse për çaste të tillë.

Te porta e jashtme dënesat u shndërruan në klithma të thekshme. Gratë i vareshin atij në të dyja anët, thërritni «Maqo, Maqo», rënkonin, mbanin nga të dy krahet njérën që po i binte të fikët.

— Besoj se ju e dini, s'është veçse një nepunës i vogël në radio, — vazhdonte t'i fliste Sherifit burri me pizhama, — një nga më të parëndësishmit.

Te porta turma ndaloi, dhe njeriu që po përcillej, si qetësoi me dorë nja dy-tri palë flokë grash, tha me zë të lartë, të tingllueshëm:

— Sido që të ndodhë, unë ndërgjegjen e kam të pastër.

— Kulmi, — tha burri me pizhama, dhe sytë e tij vëngoshë u çapëlyen fare, — hajde pastaj mos luaj nga mendja.

Ai u kthye menjëherë dhe u fut brenda, duke i rënë ballit me dorë, ndërsa turma e grave, e përdëllyer nga

fjalët e atij që po përcillej, lëshoi një duhmë të re of-shamash, të prerë aty-këtu nga ndonjë piskamë.

— Pizeveng, — i tha Sherifi, kur u larguan pak dhe pas shpinës së tyre s'dëgjoheshin më veç ca klithma të vetmuara, që shuheshin sakaq, — goxha burrë dhe bën teatër e mërzit dynjanë.

Tjetri ktheu fytyrën drejt tij dhe Šherifit, pér çudi, me gjithë inatin që kishte, iu duk se në atë fytyrë të gjatë e pompoze kishte diçka të mirë.

— S'ka lezet, në moshën tënde, — vazhdoi ai, me zë të zbrujtur, i penduar në çast që i foli rëndë.

Burri nuk tha asgjë. Me pallton e zezë madhështore, me shallin rrëth qafës, mund të besoje se ai ishte ish-kryeministri i arrestuar i shtetit të porsapërmbysur.

Adresa tjetër ishte fare pranë. Portën e hapi vetë njeriu që kërkohej. Ishte një burrë i pakët nga trupi, me fytyrë të rreshkur, energjike dhe me një llullë që dukej si pjesë përbërëse e asaj fytyre.

— Unë jam inxhinieri që kërkoni, — tha ai me një zë çuditërisht të trashë pér atë trup. — E merrja me mend që do vinit.

Sherifi u mat t'i formulonte një shpjegim të shkurtër, por tjetri tundi kokën në shenjë pohimi, porsa partizani hapi gojën.

— Ju pritja, — tha ai. — Është detyra ime të vij menjëherë. Ju lutem një minutë, sa të vishem.

Ai u fut brenda dhe doli shumë shpejt bashkë me një grua jashtëzakonisht të bukur. Gruaja ishte e qetë. Ajo i përshëndeti me kokë partizanët dhe i buzëqeshi Teutës.

— Përse nuk hytë të pinit një kafe? — tha.

— Faleminderit, por nxitojmë, — tha Šherifi.

— Mirupafshim, — i tha inxhinieri gruas. Ajo i afroi kokën dhe ai e puthi lehtë midis fakes dhe qafës. Mete Aliu ktheu kokën mënjanë. Thanasi u bë flakë i kuq. Teutës i shkëlqyen sytë nga një dritë e largët.

— Isha pothuajse i sigurt se do të vinit, — tha

inxhinieri. — Kam një radio të vogël me bateri. Gjithë këto ditë e hapja vazhdimisht. Radiostacioni heshtte dhe heshtte. Ah, qenke dhe ti, Maqo? — iu drejtua ai me një zë mospërfillës burrit të gjatë ftyrëkuq.

Maqoja u përkul gjithë nderim.

— Po, inxhinier.

— Të raftë pika, — murmuriti Mete Aliu.

Teuta kafshoi gishtin që të mos queshte. Guerrilieri po shikonte letrën ku ishin shënuar adresat. Shiu kishte pushuar.

— Duhet të kthehem i në rrugën paralele, — tha ai.

Në kthesë ata dëgjuan një zallahi të largët.

— Ç'është kjo? — tha Mete Aliu.

Qëndruan dhe vunë veshin. Zallahia herë humbiste, herë vinte më shquar, si frymëmarrja e një të sëmuri.

— Pa të shohim ç'bëhet, — tha Sherifi. Dora që kishte në xhep preku padashur prangat.

U kthyen dhe ecën në atë drejtim, nga ku dukej se vinte zhurma.

— Diçka po ndodh tek ish-pallatet e princeshave,

— tha guerrilieri.

— Pallatet e princeshave? — ia bëri Teuta me një zë të atillë sikur të dëgjonte një përrallë.

Përpara pallateve të dikurshme të princeshave nxinte vërtet një turmë zhurmëtare. Kur ata pyetën se ç'bëhej këtu, askush nuk dinte të përgjigjej. Një rrëke njerëzish hynte nëpër portën kryesore dhe një tjetër dilte po nga ajo portë. Në sytë e të gjithëve kishte një kërkim enigme. I patë dhomat e gjumit? thoshte dikush. Një njeri me pasqyrë në krahë, krejt i përkulur, po delte me zor nga porta. S'ke turp, ktheje mbrapsht pasqyrën, i bërtiste një tjetër, duke ulur kokën mu te veshi i pasqyrëmbajtësit. Njeriu u kthye urtësish për t'u futur prapë andej nga doli. Ai nuk dukej fare nën peshën e vet dhe njerëzit, që mezi i hapnin rrugë, pasi zgjatnin kokat mbi pasqyrë, kishin një shprehje të tillë në ftyrë, sikur të habiteshin me pamjen e tyre. Te Pallati i Regjencës, thoshte dikush me gjysmë zëri. Atje të lënë të plaçkitësh. S'është e vërtetë. Unë po vij andej. Ka roje partizane.

Ja, dhe këtu ka roje, nuk i sheh, katër bashkë. Këta si-kur s'përzihen. Pasqyra mbi shpinën e tjetrit u duk përsëri, duke dalë me një lëvizje si prej roboti nga porta. Mbrapsht, qen bir qeni, thirri prapë një zë i egër, dhe pasqyra u kthye përsëri për t'u futur brenda mbi rrjedhën e njerëzve, si e lëvizur që nën vete nga një milionë kokëfortë. I pe vaskat e banjës, i pe? pyeste dikush. I pashë, pos. Ç'prostituta!

Një skuadër partizanësh po vinte me shpejtësi, siç duket, për të marrë në dorëzim pallatet.

— Ikim, — tha Sherifi. — Të mos humbim kohë. Ku është adresa tjetër.

— Këtu pranë, — tha guerrilieri. Ai vështroi një copë herë listën me vëmendje, duke e afruar, kushedi pse, te syri i majtë. — Sipas kësaj, dy prej tyre duhet të jenë pranë e pranë.

Ata ishin vërtet fqinjë dhe gjendeshin për fat në-për shtëpira. Njëri prej tyre, komentatori i bursës (kështu i pëlqente të quhej, kurse, në të vërtetë, nuk ishte veçse vëzhgues i lëvizjes së përqindjeve të fajdeve, një emision i vjetër, i mbetur që nga koha e mbretërisë me këmbënguljen e klanit të Fiqiri beut) pra njëri prej tyre, një burrë i hollë, i flashkët, me sy finokë, me një borsalinë të vjetër, përsëiste vazhdimisht: Besoj se e kuptoni, zoti partizan, se, të komentonsh bursën ose fajdenë, kjo nuk do të thotë aspak se je një fajdexhi ose thjesht paralli. A? Po, po, vazhdonte të murmuriste ai nën buzë, bile është krejt e kundërta. Ne, unë në këtë rast, s'jemi veçse, si ta them, të më falë zonjusha këtu, hm, ne jemi, si të thuash, kodoshë të parashë.

Sherifi vështroi më krupë strehën me zhul të bor-salinës së nëpunësit dhe tha me vete: Shyqyr që nuk e dëgjon Teuta.

Përbri tyre kaloi me shpejtësi një xhips, xhami i parë i të cilët ishte i plasaritur. Ata e ndoqën me sy disa sekonda dhe Mete Aliu tha: Ç'është ky xhips i tërbuar, kur ndonjë qind hapa larg tyre, xhipsi ndaloi aq papritur, sikur ta kishin qëlluar në gomat. Nga dyert

e tij u hodhën ca partizanë, që qëndruan përpara një muri të bërë shoshë nga predhat. Ndërsa afroheshin, ata dalluan që larg se muri, përpara të cilit kishte ndaluar grupi i vogël, ishte mbushur me mbishkrime dhe atëherë e kuptuan se ata e kishin ndaluar makinën aq papritmas, ngaqë kishin parë, në ecje e sipër, ato mbishkrime.

— Shiko, shiko, — ia bëri Mete Aliu, — kur ata mbërritën përbri xhiposit, — qenka komandanti ynë.

Përpara murit, i kthyer me shpinë nga ata, ishte vërtet ish-komandanti i Brigadës së tyre, ai që komandonte tani gjithë trupat e sulmit mbi Tiranën. Ai trengonte me dorë një nga mbishkrimet, të bëra me bojë portokalli, tundte kokën dhe queshte me ironi. Në mur ishin shkruar këto fjalë «Viva la muerte! Të kujtohet Spanja? Kështu do ta pësosh edhe këtu!»

Ai u kthye pér të hipur në xhips i ndjekur nga roja i tij dhe nga shoqërueshit, por në atë kohë i zunë sytë grüpин e vogël të patrullës:

— O, Mete Aliu, — thirri, — si je?

Mete Aliu bëri drejt tij, duke ecur pak brinjazi, sikur të donte të fshihte krahun që i mungonte. Sytë e tij u mbërthyen si gozhdë mbi sytë e komandantit, gati të shpërthenin në zemërim, po të kapte në to ndonjë shenjë keqardhjeje. Dihej nga të gjithë dashuria e komandantit të brigadës pér Mete Aliun, ashtu sikurse dihej që Mete Aliu, megjithëse partizan i thjeshtë, ishte nga të rrallët që i fliste komandantit me *ti*, i kthente fjalën dhe bënte proçka në sy të tij.

Komandanti i takoi të gjithë. Dukej më i mprehtë në fytyrë dhe, nga pagjumësia e lodhja, sytë zakonisht të çelët i dukeshin gri të errët.

— Dino Sinojmeri u vra, — tha, — E mora vesh. Të tjerët gjithashtu. I di të gjitha.

Ata pritnin që ai të pyeste: «C'i keni këta?», pér punonjësit e Radiostacionit, por, me sa duket, nuk i vuri ose bëri sikur nuk i vuri re. U kthye nga muri dhe tregoi me dorë atë mbishkrimin ngjyrë portokalli.

— E patë parullën e dikurshme të frankistëve në mur? — Ai tundi kokën ngadalë, me një buzëqeshje që

dukej sikur vinte rrotull tij, pa guxuar kurrsesi t'i vendosej në fytyrë. — Ata më kujtojnë mua Spanjën, — tha, — por ne do t'u marrim atyre hakun për të gjitha. — Ai sepse zgjati krahun në një drejtëm pak më lart se supi i tij. — Për të gjitha, — përsëriti, — për veten tonë në radhë të parë e pastaj edhe për Spanjën, edhe për Komunën e Parisit edhe për më larg akoma, po të jetë nevoja.

— Eh, ç'do t'u bëjmë, — tha Mete Aliu.

Komandanti me një lëvizje të vrullshme u hodh në xhips.

— E dëgjuat, or karagjozë, se ç'do t'ju bëjmë? — përsëriti Mete Aliu, duke iu drejtuar grupit të vogël të nëpunësve të radios në kohën kur xhipsi po largohej. — Do të paguani për të gjitha, morët vesh? Për Komunën e Parisit apo të Londrës, apo çfarë janë ato andej tutje me muerto e me koncerto.

— Lëre tani, — tha Sherifi, duke e zënë nga bërryli.

Grupi i vogël dëgjonite i nemitur.

Ajo qëndroi përpara portës së lartë, druri i së cilës ishte mbërthyer në çdo cep më pllaka hekuri e bronci dhe trokiti gjatë. Ndihej se si vala e trokitjeve vdiste në thellësi të shtëpisë së madhe luksoze. Paskan ikur, tha ajo me vete pas trokitjes së katert. Vrima e kyçit mbi atë derë solide ngjante si një organ i vdekur. Ajo deshi të këthehej, por diçka e mbajti të ngulur në vend te pragu... T'u mbylltë dera! Shprehja e dëgjuar qindra herë kishte dalë papritur nga mjegullnaja e fjalëve për t'u veshur me hekur e bronc përpara saj. Ajo derë që mbyllur përgjithmonë. Vetëtimthi ajo pa ndryshkun e ardhshëm mbi pllakat metalike, vrimat e krimbave tejemanë atij trupi të fortë, kalbjen dhe thërrmimin e saj. Ndjeu t'i këputeshin gjunjët, por e mbajti veten. Paskan ikur në minutën e fundit, mendoi. Megjithatë kjo s'do të thoshte asgjë. Të tjerët kishin mbetur.

Bejleresha plakë u kthye nëpër atë rrugë gati të braktisur dhe doli në bullevardin «Musolini». Në trotuaret

e tij aty-këtu dukeshin grumbuj njerëzish. Disa ndalonin përpara kangjellave të kopshteve dhe vështronin fasadat e shtëpive në thellësi. Portat ishin të mbyllura, rresht, dhe për një sekondë asaj iu dukën si një radhë arkivolesh të vendosura në këmbë, ashtu siç e kanë zakon myslimanët, përpara se të futin të vdekurin në to.

Diku binte një fisarmonikë dhe ajo shpejtoi hapat për të mos e dëgjuar. Motivi që po lozte fisarmonicisti i panjohur, iu duk asaj si një tallje makabre midis kësaj vëtmie. Porta e Rrokajve, mendonte ajo. Të arrij sa më shpejt në atë portë. Nxito, ja, përtej udhëkryqit.

Por në udhëkryq ishte një pengesë. Bejleresa plakë shqeu sytë dhe, duke bërë një gjysmë rrëthi për t'i ardhur rrrotull pengesës, gati sa nuk thirri me zë të lartë, me tmerr: Ja ku qenka. Ishte hera e parë që shikonte një barrikadë. Ajo ishte shtrirë përpara saj, gjysmë e përzhitur, një kodër e përgjumur, kafshë legjendare që lëpinte plagët në shi. Susta krevatesh, sirtare, thasë, tulla dhe nën to ca sy të ftohtë, katër a pesë copëra të ndritshme të një lavamani të copëtar. Ja, kështu të shtrihem dhe unë ndonjë ditë, mendoi ajo kundër dëshirës së saj, me sy të hapur, nën një tog rrangullash të vjetra, në një udhëkryq.

Te porta e Rrokajve ajo trokiti gjatë. Megjithëse nuk përgjigjej njeri, ajo sepse e ndjeu se brenda ishte dikush. Vrima e celësit nuk kishte vdekur. Dhe nuk gaboi. Që nga thellësia dëgjoi më në fund një të ecur të njohur. Ishin hapat e shërbëtorit të vjetër të shtëpisë:

- Zotërinjtë kanë ikur, — tha ai ftohtë.
- Ku? — pyeti ajo.
- Ai ngriti supet.
- S'e di.

Bejleresa u kthyte gati me inat. Të tjerët janë këtu, tha ajo me vete. Unë do t'i gjej kudo që të jenë futur.

Ajo kaloi përbri barrikadës, duke u përpjekur të mos i shikonte kufomat e shkrumbosura të dy gjermanëve disa hapa më tej.

Eci për një kohë të gjatë, gjersa trokiti më në fund

në portën e tretë. Ata ishin aty. Të gjithë. Sytë e saj gati sa nuk u rrëmbushë. Ma ndillte zemra, thoshte me vete, duke hyrë. S'ishte e mundur të kishin ikur të gjithë. Gjysma kanë mbetur këtu.

Ishin ulur të gjithë në dhomën e madhe të ftohtë, me dritat e larta, me perde të bardha, përmes së cilave hynte një dritë dëbore. Në qëndrimin e të zotërve të shtëpisë, në mënyrën se si vështronin përjashta dritat e dhetë të folurën kishte diçka ceremoniale.

Një shërbëtore solli liker, pastaj kafe. Ishin po ata shërbëtorë dhe po ato servise të shtrenjta kristali. Pastaj ajo vuri re portretet e mëdha me kornizë ari në mur, llampadarët e heshtur, qilimin persian tejpërtëj dhomës. Asgjë nuk kishte ndryshuar në këtë shtëpi dhe ajo gati sa s'thirri: Ç'bëhet kështu këtu, ç'është kjo komedi? Ju e dini se nuk është koha për lojë.

Bejleresha plakë Mukades do t'i thoshte me siguri këto fjalë, në mos në atë çast, pak më vonë, por në atë kohë dera e dhomës u hap dhe hyri brenda një njeri i qalë. Të gjithë kthyen kokat nga ai. Njeriu po qante. Bejleresha plakë kishte parë në jetën e saj shumë lloje të qarash, duke përfshirë këtu edhe të qarët me gulçima, të padurueshmë pér kujtesën, të burrave, por një qarje të tillë ajo as që e kishte përfytyruar dot. Njeriu po vinte drejt tyre duke çaluar krejtësisht. Pér herë të parë në jetë qarja u shfaq përparrë bejlereshës plakë në formën e një mekanizme, rripa transmisioni, cikrikë të mëdhenj që, duke nxjerrë ujet me kuisje nga një pus i thellë dhimbjeje, e derdhin atë anash, duke lagur me të gjithë botën.

Bota e tërë u lëkund nën ecjen e çalamakut, perdet e gjata, të bardha morën kuptimin e tyre të vërtetë: qefine të varura në dritat e madhështore; xixëllimet e serviseve ngrinë në vend. Ahere bejlereshës Mukades iu duk se ishte koha që t'u jepte atyre pak kurajë. Një copë herë folën pér rënien, pér diagramën dhe pér logjikën e saj. Pastaj përmendën kohën e trubullt që i priste dhe nevojën pér t'u mbajtur fort pas njëri-tjetrit në këtë stuhi prove. Gjithë puna ishte që të mos shpërndaheshin si zogjtë e korbit. Tmerri më i madh do të ishte po të

vinte puna që të thërritje përmes sterrimës: «ku je», dhe askush të mos i përgjigjej thirrjes sate.

Më në fund mysafirja e bindi njérën prej zonjave plaka, pér çudi, atë më gjytrymen, që të vinte me të. Mos, mama, tha dy-tri herë njëra prej nuseve, jashtë është akoma luftë, por Mukadesi përsëriti pak a shumë frazën që kishte thënë në shtëpinë e vet: jashtë bie vëtëm shi, bile edhe ai i imtë.

Ato dolën. Duke ecur, përmendnin shtëpitë ku duhej të shkonin. Nga larg vinin gjëmimë të shurdhra. Nga kreu i një rrugice doli një patrullë partizane. Mukadesi dalloi midis tyre atë njeriun e tmerrshëm me një dorë. Ajo deshi t'i thoshte shoqes: është e dyta herë që e ndesh këtë patrullë, por pati frikë të pëshpëristë. Njeriu me një dorë i kishte ngulur Mukadesit sytë e tij zhbirues, me një skuqje të lehtë të së bardhës. Në atë kohë shoqja i ra me bërryl:

— Shiko, — tha ajo, — të arrestuar.

Midis patrullës ishin disa civilë: një burrë i gjatë me pamje madhështore, të trishtuar, një tjeter, me llullë në gojë dhe të tjerë që sepse ecnin me hapa të vegjël, tepër të vegjël.

Me hapa të tillë ecet drejt vdekjes, mendoi Mukadesi.

— I marrin pér t'i pushkatuar, — tha shoqja e saj, kur patrulla u largua pak, — nxito ta shpërndajmë lajmin.

Filloi të vesëtonte prapë shi.

Nxito, tha me vete Mukadesi. Shpejt, shpejt. Rruga e lagur, plot me gjethë të kalbura zgjatej tutje. Qysh tani, pa arritur akoma, ato trokitnin në dyert e mëdha, nën portalet e mermerta, anash të cilave kacavireshin trëndafila të egër, të bardhë e të kuq, që tani ishin të zhveshur, me gjemba. Tang, tang, tang, hapeni portën. Kemi lajme.

Patrulla hyri në një oborr të brendshëm, të rrethuar me mure të larta, veshur me kulpër. Suvaja e mureve të shtëpisë ishte e zhvoshkur vende-vende nga shirat. Grilat jeshile ishin të mbyllura.

— Pizevengu, — tha Sherifi dhe i ra derës me grusht.

— Më duket se më në fund e gjetëm.

Kishin humbur gati një orë për një tip që kishte ndërruar adresë. E kishin kërkuar në një hotel të kategorisë së tretë, pastaj në një pension dhe më në fund u kishin thënë se banonte këtu, në një dhomë me qira.

— Është brenda, — tha me zë të ulët një plakë trashaluqe që u hapi dërën. — Ka dhjetë ditë që është mbyllur brenda me një ruspi. Qiraxhi të tillë s'kemi pasur ndonjëherë. Do ta pushkatoni?

— Jo, — tha Sherifi, — na duhet për tjetër gjë.

— Thashë se mos e pushkatonit, — tha plaka, — se nuk më ka paguar as qiranë.

Ajo tregoi me dorë një derë të ngushtë, tepër të lartë dhe vetë qëndroi mënjanë të bënte sehir.

Sherifi trokiti. Që brenda u ndie një zhurmë e mbytur, pastaj një pëshpërimë dhe prapë një si fërkim nëpër dysheme.

— Kush është? — pyeti që brenda një zë i ëmbël femrë.

Thanasi u bë flakë i kuq.

— Hej, ç'bela, — murmuriti Sherifi. Ai doli te porta dhe thirri Teutën. — Eja edhe ti, — i tha. — Brenda ka gra.

— Kush është, — u dëgjua prapë zëri.

Sherifi i bëri shenjë Teutës të fliste.

— Hapeni, — tha Teuta, — jemi një patrullë partizane. Kërkojmë... — Teuta iu kthye Sherifit dhe i bëri me shenjë për t'i thënë se ajo nuk e dinte emrin. Sherifi i pëshpëriti emrin, por asaj se pse i erdhi për të qeshur nga mënyra se si Sherifi foli me zë të ulët dhe kafshoi buzën që të mos ia plaste gazit. Sherifi vuri gishtin te tëmthi i majtë për t'i thënë: mos lojte gjë? dhe i tha prapë emrin. Teuta e mblodhi veten dhe, pak e fyter, përsëriti me zë të lartë:

— Kérkojmë Matish Baldojén.

— Një minutë, ju lutem, — tha prapë zëri që brenda.

Në qoshen e korridorit plaka e trashë bëri një gjest sikur të thoshte: të zestë ne ç'na shohin sytë me këtë qiraxhi.

Dera u hap përgjysmë dhe midis së çarës u shfaq një grua fare e re, flokëlëshuar, që buzëqeshte.

— Hyni, ju lutem, — tha ajo dhe u buzëqeshi të gjithëve. Thanasi uli kokën.

— Hej, ç'bela, — murmuriti Sherifi.

— Ne nuk kemi kohë, — tha Teuta. — Nxitojmë. Të dalë pak... — ajo nuk dinte si ta quante njeriun që ishte mbyllur brenda me të dhe tha shpejt e shpejt, — të dalë pak ai... burri.

— Po vij, po vij, — u dëgjua që brenda një zë gazmor.

Dera mbeti gjysmë e hapur. Nëpërmjet kanateve, nën dritën e prerë në rripa horizontalë prej grilave, dukej një pjesë e dhomës, ca shishe të zbrazëta mbi një tryezë, fundi i një krevati të gjerë, kuverta e të cilit kishte rrëshqitur në dysheme dhe një kolltuk, tip i vjetër me kadife ngjyrëbanane. Dëgjoheshin zhurmat karakteristike të një burri që po vishej, tringëllima e një tokëze metalike...

— Ti prit përjashta, — i tha Sherifi Teutës, duke mos ditur ku t'i conte sytë. Dukej që ishte gjithë nerva. Teuta doli dhe pas disa sekondash u dëgjua e qeshura e saj. Plaka bënte ca shenja mynxyre me duar, pa i hequr sytë nga dera gjysmë e hapur.

— Mjaft, — thirri Sherifi që nga korridori, pa e ditur edhe vetë pse po zemërohej kaq shumë. — Mjaft u pispillose. Ne nxitojmë.

— Erdha, — u përgjigj që brenda zëri, fare i shkujdesur, sikur t'u fliste shokëve që po e thërritnin për piknik. — Ke sallam në raft, ke dhe biskota, — dëgjohej që i thoshte ai mikeshës së vet. Pastaj u dëgjua e puthura e tyre dhe plaka zuri të shqyente faqet me duar.

— E pe, o partizan? — pëshpëriti ajo.

Në atë kohë ai doli. Ishte një djalë i bukur, në sytë

e të cilit kishte një rrjetë të imtë përskuqjeje të lodhur. Ata sy u ngjiteshin të gjithëve me ëmbëlsi. Ai u bë gati të pyeste pér se e kérkonin, por në atë çast pa në korridor grupin e vogël të civilëve dhe, siç duket, e kuptoi.

— Pér Radiostacionin, në mos gaboj? — tha duke iu drejtuar Sherifit. Sherifi bëri «po» me kokë dhe nuk deshi t'i jepte shpjegime. Tjetri u përshëndet me civilët, puliti sytë nga drita dhe gogësiu dy-tri herë. Në atë kohë ai pa Teutën që po e shikonte me kureshtje dhe u gjallërua. Sytë e tij e shkundën në çast pahun e lodhjes dhe, si të veshur si me një avull drite, u ngjitën miklues mbi sytë e saj. Ajo e hoqi vështrimin menjëherë dhe u kthye nga porta, ngaqë e ndjeu që po skuqeji. Pér çudi, në vend që t'i vinte pér të qeshur, si zakonisht, ajo ndjeu t'i nxeheshin faqet.

— Marsh, — thirri Sherifi gjithë nerva me një mënyrë që s'kishte folur kurrë. — Jemi vonë.

Grupi u nis përsëri. Rrugët sa vente bëheshin më të gjalla. Kalimtarët kthenin kokat drejt tyre. Disa përshëndetnin me grusht, të tjerët, duke parë civilët, thërritnin: Poshtë tradhtarët! Në një udhëkryq ata u ndëshën me një turmë të egërsuar, kryesisht gra, që derdheshin përpara plot klithma dhe fjalë. Dëgjoheshin britmat: «spiune» «spiune». Atëherë ata panë se midis turmës, e kapur nga shumë duar, me ata hapa të panta-tyrshëm që bëjnë njerëzit kur i tërheqin të tjerët, ecte një grua. Në fytyrën pa një pikë gjak rrotulloheshin sa djathtas majtas dy sy të ngrirë si prej gipsi, që dukej sikur kishin humbur aftësinë të përqëndroheshin diku. Të njëjtat zhvendosje mekanike bënte edhe koka e saj dhe, në përgjithësi, dukej sikur tmerri që e kishte pushtuar atë grua, ishte shfaqur në formën e humbjes së raporteve midis syve dhe fytyrës së saj, pastaj midis kokës dhe trupit e kështu me radhë.

«Spiune, spiune» thërriste turma, duke u derdhur përpara, pa drejtim të caktuar.

— Eshtë spiune vërtet? — pyeti Metë Aliu një nga gratë që ikte duke gulçuar. Ata, patrulla bashkë me civilët, kishin qëndruar në trotuar, duke pritur të kalonte turma.

— Spiune, posí, — tha gruaja, duke marrë frymë me zor. — Na ka marrë djemtë e vajzat më qafë. Kjo e kallëzoi Sanijen.

Sytë e gruas spiune, në një nga ato zhvendosjet e tyre mekanike, e kapën, siç duket, Mete Aliun, që po u fliste grave.

— Zoti partizan, zoti partizan, — klithi ajo, — s'jam spiune. Shpëtomëni.

Mete Aliu ktheu kokën mënjanë.

— Ikim, — tha Sherifi. — Jemi vonë.

Patrulla bashkë me civilët u vunë në lëvizje. Kishte nisur prapë shiu i imtë.

— Ja, prapë ato plakat, — tha Thanasi, me zë të ulët dhe u skuq. — Tani janë bërë tri.

Plakat po vinin drejt tyre të veshura krejt në të zeza, me një ecje të ekuilibruar dobët, siç mund të jetë ecja e këmbëve që dalin rrallë në rrugë. Šikur të ishin më të shëndosha, ato do të ngjanin si foka madhështore në një platformë akullnaje.

— Jane aristokrate, — tha Teuta, me zë fare të ulët. — Bejleresha.

Sytë e saj ranë midis syve të tyre si në kurth. Kishte një ndriçim ethëje në ata sy zgavrues, një urrejtje të ftohur, përzier me kureshtje.

Uf. ia bëri Teuta me vetë dhe e para hoqi sytë.

— Këtu, — thirri papritur guerrilieri, duke treguar me dorë një shtëpi të madhe gri. Ata të katër ngjitën shkallët gjer në korridorin e katit të fundit, ku dilnin dyert e tre apartamenteve. Zymltinë e korridorit e shtonte xhamllëku i shkallëve, gjysmë i thyer, gjysmë i nxirë nga pluhuri dhe ajo ftomë e veçantë që kanë ndërtesat e banimit, ku prej kohësh nuk është ndezur zjarr.

Sherifi trokiti. Derën e hapi një grua e gjatë, me një shprehje përbuzëse në fytyrë.

Sherifi shpalosi listën dhe lexoi emrin e njeriut që kërkohet.

— Nuk është, — tha gruaja dhe deshi t'ia mbyllte derën mu në turi, por Sherifi arriti të vinte majën e cizmes te pragu.

— Do të kontrollojmë, — tha ai dhe shtyu derën me sup.

Gruaja lëshoi një klithmë dhe deshi t'i zinte rrugën, por Sherifi qe futur në korridor. Pas tij hynë dy të tjerrët. Dora e Sherifit kishte prekur padashur prangat në xhepin e xhaketës prej lëkure.

Disa sekonda gruaja dhe partizanët vështruan njëri-tjetrin.

— Kontrollo ti, — i tha Sherifi Thanasit.

Gruaja vështronte me sy të çakarritur. Shprehja përbuzëse kishte humbur nga fytyra e saj.

— Më tregoni, ju lutem, shtëpinë, — tha Thanasit, duke u bërë flakë i kuq.

— Me ç'të drejtë, — klithi gruaja. — Me ç'të drejtë hyni në shtëpitë e botës si banditë.

— Ju lutem, zonjë, — tha Thanasit.

— Fillo kontrollin, — tha Sherifi, — mos e pyet më.

Thanasit eci përpara nëpër korridor. Gruaja e kapi për krahu që ta pengonte, por Thanasit eci më tutje. Gruaja klithi me një zë të egër. Në atë çast një nga dyert që dilte në korridor, u hap me vrull dhe në të u shfaq një njeri me revolver në dorë. Thanasit u gjend ballë për ballë me të.

— Lëre mamanë, — thirri ai dhe i vuri tytën e revolverit mu në gjoks.

Thanasit nuk bëri asnjë lëvizje, vetëm tha:

— Ejani me ne.

Ai nuk ishte më i kuq në fytyrë.

— Largohuni menjëherë, ndryshe do të shtie, — tha njeriu me revolver.

— Hajde, léri operat, — tha Mete Aliu dhe bëri përpara. Ai e shtyu Thasanin pak anash dhe e vëshroi në sy njeriun e armatosur. Pastaj krahu i tij i vetëm u zgjat përpara drejt revolverit.

— Ma jep armën.

Tjetri, për çudi, ia dha revolverin. Mete Aliu e futi atë në xhepin e kapotës së tij të gjatë dhe po në atë sekondë, me një shpejtësi të rrufeshme, i dha atij një shuplakë në fytyrë.

- Ec me ne, — tha Sherifi.
- Jo, — tha ai. — Unë nuk u shërbej komunistëve.
- Mos shko, — tha gruaja.
- Ec me ne, — përsëriti Sherifi.
- Jo.

Dora e majtë e Sherifit mbértheu njérën dorë të tij, kurse me tjetrën ai nxori prangat.

- Ndihmë, ndihmë, — klithi gruaja.

Gjatë më pak se një gjysmë minute që vazhdoi prangimi i duarve, Sherifit iu mbush balli me pika të vogla djerse. Sytë e tij ndiqnin si të mpirë gjer në hollësitë më të vogla lëvizjet e pakontrolluara të atyre duarve të verdha, që përpinqeshin t'u shmangeshin kllapave metalike, kontaktet e hekurit me mishin, qimet e vogla që ngeçnin midis dy kllapave. Duart e njeriut u lidhën më në fund dhe, kur Sherifi ngriti kokën, të tjerët vunë rë se ishte zbehur në fytyrë.

Gruaja vazhdonte të ulërinte. Ata po zbritnin shkallët. Dëgjohej herë pas here tringëllitja e prangave. Teuta vështronte me bisht të syrit fytyrën e Sherifit dhe i vinte çudi, se si te njeriu që ajo e kishte pasur si vëlla q'prej shumë kohe, po zbulonte papritur diçka të panjohur. E panjohura qe shfaqur bashkë me atë zverdhje mbi fytyrë, në ikjen e babaxhanillëkut dhe në atë prerje në mollëzat, të cilat kishin bërë që ajo fytyrë, gjithmonë e shëndetshme, të ngjante tani pak e hequr.

Grumbulli qe nisur drejt një adrese të re. Nga të dyja anët e rrugës, mbi parvazet e dritareve përkuleshin qafa, mbi të cilat dukej sikur qenë ngjitur ca koka si prej druri. Sa herë që dëgjohej tringëllima e dobët e prangave, Teuta vështronte pjerrtazi Sherifin. Nuk do ta kishte besuar kurrë sikur dikush t'i thoshtë më parë se një burrë që i hedh prangat një tjetri, mund të fitojë befas diçka tërheqëse. Asaj i kujtoheshin trubull orët e pafundme, kur ai e kishte mbartur atë të plagosur mbi shpinë tragave plot baltë e nëpër tokë rrëmore. Ishte hera e parë në jetë që përqafonte, qoftë edhe në mënyrë të pandërgjegjshme, një njeri të seksit tjetër. Qafa e tij, e lagur nga shiu, e paqethur, me baltë, disa

centimetra larg syve të saj, merrte herë pas here, në çastet e kllapisë, përmasat e diçkaje gjigante, mish, sipër të cilit rriddhnin ujëra dhe mbinte bari ose tokë me flokë të qullur njerëzorë e kështu me radhë, një përzierje e mundimshme përfytyrimesh nga më kaotiket. Pastaj dalngadalë, bashkë me rënien e etheve, edhe koka e njeriut që e mbante mbi shpinë, duke u shtjellur si një fugë, dilte nga mjegullat dhe merrte trajtën e saj të lodhur njerëzore. Që nga ajo kohë ata ishin bërë shokë, dhe ajo dinte pothuajse çdo gjë. Ishte hera e parë që te ky njeri qe shfaqur e panjohura.

Prangat tringëllinin gjithmonë e më fort dhe Mete Aliu i bërtiti të lidhurit:

— Mjaft i tunde ato këmborë.

I arrestuari pakësoi pér ca çaste zhurmën e prangave, por, porsa pa një grumbull kalimtarësh që po vinin drejt tyre, filloj t'i tundte përsëri.

— Ja dhe muzikë tanë, — shfryu nëpër dhëmbë Mete Aliu. — Lëri operat, more vesh? — thirri ai.

I arrestuari përsëri e shuajti pak tringëllimën. Tani patrulla dhe grumbulli i civilëve po kapërcenin një shesh të vogël, në anë të të cilit, ca arixhinj të vegjël po vërtiteshin si milingonat sipër një barrikade.

— Po plaçkitin barrikadën, — tha guerrilieri.

Kur kaluan përbri, ai u bërtiti ciganëve, por dy prej tyre thanë në një gojë:

— Tani lufta ka mbaruar. Ato s'duhën më. 

Vërtet, ç'do të bëhet me barrikadat? tha me vete Sherifi. Ky ishte mendimi i parë që i erdhi qysh se i hodhi prangat njeriut të arrestuar. Truri i tij kishte qenë si i mpirë.

— Lufta s'ka mbaruar akoma, more horra, — tha Mete Aliu. — Largo huni që andej.

Me të vërtetë, ato s'duhën më, mendoi Sherifi, me gjithatë atij i erdhi keq që ato të prisheshin kështu, në një mënyrë kaq banale. Kuaj të luftës, që s'duhën më, mendoi ai.

Përballë tyre po vinte një patrullë tjeter partizane.

— Ç'janë këta? — pyeti komandanti i patrullës, duke bërë me kokë nga civilët. — Deputetë?

— Jo, — u përgjigj Sherifi, — janë... ata të Radiostacionit.

— Vdekje fashizmit! — tha tjetri, dhe u nis.

— Liri popullit!

Sherifi vështron te grumbullin e civilëve, që po ecte përparrë tij. Këta ishin sjellësit e zërit, për të cilin kishte folur komisari. Magjistarë me borsalina, me rrufë në hundë, me pranga. Iu kujtua goja e Memecit, e kyçur nga vdekja. Një milion vjet pa zë, tha ai me vete. Ç'gjëmë e zezë! Dhe befas në kokë i vetëtiu pyetja: po sikur këta të mos ia sillnin dot zërin... atij... Radiostacionit?

Po kalonin nëpër një rrugë plot me njerëz. Të gjithë kthenin kokën drejt tyre. Konti Çiano, Konti Çiano, pësh-përitën dy gra për Maqon e gjatë. Pas një oborri dëgjo-hej një fisarmonikë. Nga porta e hapur dukeshin djem e vajza që vallëzonin. Midis tyre kishte partizanë.

— Si shpejt filluan nga operat, — tha Mete Aliu.

— Sytë e Matish Baldojës, atij që kishte qenë i mbyllur me atë vajzën në dhomë, u lëngëzuan.

— Ja, kjo është liri, — foli ai për herë të parë.

— E dija që kështu do të ndodhë.

Maqoja i gjatë ecte me kokën lart. Megjithëse pamjen e kishte të trishtuar, dukej menjëherë që ishte i lumtur. Inxhinieri nuk e hiqte llullën nga goja. I arrestuari kishte filluar t'i tringëllinte prangat përsëri.

— Shoku partizan, shoku partizan, — thanë ca kalamaj me fytyrë të trembur, — këtu, në një bodrum ka të vrarë.

Ata njëherë donin të vazhdonin rrugën, por kalmajtë ngulën këmbë se në një bodrum aty pranë kishte vërtet shumë të vrarë. Ata tregonin me dorë në një drejtim dhe fytyrat i kishin të prera. Të vrarë, përsëriti me vete Sherifi. Ata e thoshin këtë fjalë sikur të lajmëronin diçka të jashtëzakonshme, kurse në të vërtetë qyteti ishte i mbuluar tejembanë me të vrarë. Megjithatë ata u kthyen.

Bodrumi ishte i ulët, me kube të sfilitur vende-ven-

de dhe plot njolla lagështire. Një dritë e hirtë hynte nga dy frëngji të ulëta që vështronin në rrëzë të trotuarit. Të vrarët ishin në tokë, aty-këtu, të rënë në pozat më të papritura. Nuk kuptohej nëse i kishin goditur pas shpine, apo nga përpara, bile në përgjithësi nuk kuptohej nëse i kishin qëlluar të tjerë apo ata vetë kishin qëlluar njëri-tjetrin. Më tepër se të rrëzuar nga plumbi, ata dukej sikur i kishte shtrirë përdhe një befasi misterioze. Të vinte të besoje se ishin duke kërcyer një valle makabre dhe befas vdekja i kishte shtrirë përdhe në një nga ato kompozime që mund të sajobjet vetëm ajo. Midis kufomave Sherifit i mbetën sytë te një trup me xhaketë me kuadrate, fytyra e të cilat me ca nofulla të gjera, të fryra anash të jepte përshtypjen sikur ishte i mbushur me diçka në formë lëngu. Sherifit iu duk se, sikur të mund të hapje ato nofulla të kyçura, prej tyre mund të dilte papritur përjashta ose e fshehta e këtij bodrumi ose gllënjkë gjaku.

Ai vështroi me radhë shokët e tij, pastaj pa përjashta, nëpërmjet dritareve të ulëta, këmbë njerëzish që ecnin në trotuar, duke ngritur skërkë uji dhe lëvizi supet: Ne s'kemi ç'bëjmë këtu.

Ata dolën jashtë me fytyra të ngrysura. Nga larg vinin tingujt e fisarmonikës. Qielli i ulët dukej sikur nga çasti në çast do të niste të borëtonte.

— Adresa tjetër është këndej, — tha guerrilieri, duke treguar me dorë një drejtim.

Sherifit nuk i hiqeshin nga mendja nofullat e kyçura të njeriut të vrarë. Njëherë iu duk se gati-gati kishte një teshirë që të kthehej te bodrumi, t'i hapte ato nofulla, duke u hedhur mënjanë për të mos u spërkatur nga lëngu që duhej të ishte brenda tyre ose për t'i shpëtuar kafshimit të mundshëm të kafshës që mund të dilte që andej në formën e një të fshehte kobtare.

Ato trokitën një herë, dy herë, tri herë.

— Nuk kanë ikur, jo, — tha njëra prej tyre. — Vëtem se kanë frikë.

Mukadesi vështronte portën madhështore dhe mendonte se si mund të ishte e besueshme që prapa një porte të tillë, ku druri, hekuri dhe mermeri ishin ngërthyer me njëri-tjetrin me dhjetëra kthetra, të mund të kihej frikë. Të gjitha dyert e mëdha... tha ajo me vete, pa ditur as vetë pse mendimi i mbeti përgjysmë. Të gjitha dyert tona...

Asnjë ditë tjetër e jetës së saj nuk kishte qenë e mbushur me kaq porta.

Në të gjitha dyert tona ata do të trokasin, mendoi ajo. Me radhë.

Tak, tak, tak, vazhdonte të trokiste njëra prej grave.

Nga brenda u dëgjua një gërvimë. Pastaj porta u hap. Te pragu i saj ishin pizhamatë dhe ekzema e një burri të gjatë. Pas tyre u shfaq ai vetë.

— Ah, — ia bëri burri.

— Ku jeni futur kështu? — thanë ato në një gojë. — A është e nevojshme të futeni kaq thellë?

Burri ngriti supet.

— Ndoshta s'është e nevojshme, — tha, — ndoshta është më mirë të paraqitemi vetë atje ku duhet. Por ju e dini se nuk dimë as vetë se ku duhet të vemi.

Mukadesi vështronte qeskat e rrëzuara poshtë të syve të tij dhe iu kujtua se nganjëherë asaj i pëlqente të bënte shaka me të: Kasem, ti je i gjithi xhepa. Edhe nën sytë ke xhepa. C't'i bësh, thoshte ai, thonë se nganjëherë lotët kthehen në margaritarë, dhe mua më pëlqen ta besoj këtë gjë. Prandaj i kam xhepat edhe nën sy. Oh, është lehtë të kesh xhepa nën sy, thoshte Mukadesi, bile ndoshta është e besueshme që edhe lotët të kthehen në margaritarë, por del një problem tjetër: a mundet të qash ti? Dhe ata qeshnin të dy, ha, ha, ha.

— S'dimë ku duhet të vemi, — përsëriti i zotit i shtëpisë, duke ua bërë me dorë që ato të hynin. — Rrugët tani janë të tjera. Çdo gjë...

Mukadesi mendoi: Sa qejf i kanë njerëzit fraza të tillë: çdo gjë tani mbaroi. Çdo gjë, tha ajo me vete, nuk ka kurrë «çdo gjë». Ka vetëm «diçka», që njerëzve, me

prirjen e shëmtuar që kanë pér tē mallëngjyer vvetveten, u pëlqen ta kthejnë në «gjithçka».

Ato u futën në një bodrum të gjerë, ku, tē shtruar mbi velenxa e qilima, ishin ulur e rrinin me fytyra tē prishura nga tmerri gjithë njerëzit e shtëpisë. Florintjtë do t'i kenë këtu pranë, jo më larg se kopshiti i brendshëm, tha me vete Mukadesi. Hija e tyre lëshonte vezullime frike mbi tërë atë shfytirim tiparesh. Praninë e tyre tē verdheme ajo do ta zbulonte në qenien e tyre më lehtë se ç'zbulon mjeku më i madh shenjat e një sëmundjeje.

— Po ç'bëhet atje lart? — tha me zë tē thellë hanëmja plakë Qefser, duke vënë dorën si hinkë te veshi pér tē dëgjuar përgjigjen. — A u përbysëm?

Syri i saj i djathtë prej xhami rrinte i palëvizur në atë gjysmerrësirë.

Mukadesi tundi kokën disa herë rresht. Ishte një nga ato tundje koke që kryejnë njëkohësisht dy funksione: pohojnë atë që thotë bashkëbiseduesi dhe thonë «medet» pér tē.

— Po, është e vërtetë që u përbysëm, — tha ajo më në fund, — por sidoqoftë...

— Çfarë sidoqoftë, — klithi me një zë, sikur tē dilte nga një gurmaz i shqyer, plaka Qefsere. — Pér ç'sidoqoftë mund tē bëhet më fjalë.

Syri i saj i vetëm shkëndijonte si në ethe.

— Mama, — tha me zë tē ulët burri me ekzemë.

Mukadesi trokiti me shkop në dysheme sikur tē përsëiste një urdhër.

— Dhe unë prapë them sidoqoftë, — tha ajo. — Të ngjitesh lart, do tē thotë tē dish edhe tē përbysesh.

— Hm, hë, — ia bëri plaka Qefsere. — Të dish tē përbysesh.

— Po, — tha Mukadesi, — kurse kjo juaja s'është përbysje, por, por...

— Mos u përpinq tē gjesh një fjalë më ogurzezë, — tha burri me ekzemë, me zë tē butë.

— Kjo është turp, — tha Mukadesi, por plaka Qefsere e kishte hequr ndërkaq dorën nga veshi dhe fjalët kaluan tē vdekura përbri saj.

— Po ç' shpresë na sjell ti? — tha burri. Qeskat poshtë syve i uleshin e i ngriheshin ritmikisht, ndërsa fliste. Një lypës, mendoi vetëtimthi Mukadesi. Krodhë buke në qeskat e vogla. Oh, sa e lodhur jam.

Nga thellësia e bodrumit erdhi një erë kafeje e shtrenjtë. Era jonë, tha me vete Mukadesi. Edhe pak kohë e do të vijë era e tyre, era e mensave.

— Ç' shpresë sjell unë? — tha ajo, pa vështruar njeri. Zëri i saj u bë papritur i trishtuar. — Unë nuk sjell asnë shpresë, — vazhdoi ajo ngadalë. — Unë them vetëm se...

Rreth e rrotull, në gjysmësferën e errët sytë e tyre kishin ngrirë dy nga dy, një palë më lart, një palë më poshtë, gjëndra transparente në një xhelatinë muzgu, me atë, të huajin, të ardhurin nga larg, ndoshta nga gjermania, syrin e xhamtë midis.

Mukadesi e ndjeu se ata pritnin prej saj diçka më të rendësishme dhe e ndërpreu frazën në mes. Duhet të bëj pér vete atë sy prej xhami, mendoi. Iu duk se, sikur hanëmja plakë Qefser të dilte me to nëpër rrugë, kjo gjë do të ishte një shenjë e mbarë pér të gjithë.

— Një urrejtje e gjatë shpeshherë ka prirjen të pér-fundojë në dashuri, — tha ajo me zë të ngadaltë. — Pasi të na kenë përbysur, të na kenë poshtëuar, të na kenë zhbërë, ata papritur do t'i zërë malli pér ne. — Ajo pu-shoi dhe i kaloi sytë ngadalë mbi atë nemitje sysht. I xhamti vezullonte midis tyre dobët.

— Malli pér zotërintjë e përbysur është në natyrën e njeriut, — tha ajo. — Do të vijë një ditë, kur, pas shembullit tonë, pas ftyrave tona të masakuara, ata do të përpilen të krijojnë zotërintjë e tyre. Kur atyre t'u vijë një dëshirë e tillë, kjo do të jetë shenja e parë që ata do të kenë marrë fund. Ahere ne do të rikthehem.

— Oh, po ahere ne do të jemi në varre, — tha një zë i përvajshëm.

— Hijet tona, — tha Mukadesi. — Hijet janë më të qëndrueshme se njerëzit. Njerëzit e paftuar i dëbon lehtë, me armë, me daulle, me shkop, po provo të dëbosh një hije. Ahere pra do të ketë ardhur koha jonë. Ahere, thellë

në nëntokë trupat tanë, të ngrirë si në dyllë të shenjtë, do të fillojnë të bëhen inkandeshentë...

— Ah, Mukades, — tha burri me ekzemë.

Ata të gjithë filluan të thoshin si me lutje emrin e saj: Mukades, Mukades. Një eufori e çuditshme, një dritë e egër mistike shkarkohej si elektricitet nga majat e gjymtyrëve të tyre, gjëmonte në veshët, binte si daulle nën kafkat e vjetruara. Pa kuptuar se si, ata e gjetën veten duke folur të gjithë. Është e vërtetë se Adrian Guma, autori i famshëm i «Elipseve të shtërgjeve» ka vrarë veten? Ku-shedi sa ka qarë Miriami. Ajo qysh prej dy javësh nuk flet më në radio. Ashtu, kuçka. Sidoqoftë Adrian Gu-mën e ka dashur vërtetë. Ç'janë kooperativat? O zot, po a mund t'i besohet dashurisë së një spikereje? Ju përmendët Miriamin dhe mua m'u kujtua Hamide hanëmja. E dini ç'thonë pér të? Tanku në të cilin ajo udhëtonte, u dogj diku në kufirin verior dhe tani ajo grua s'është veçse një grumbull karboni. Orëzeza ajo. E kam urryer gjithmonë, megjithatë po më ardhka keq. Është një fund tepër i zi. Ç'bëhet Sara Blloshmi? Para një jave e pashë te dyqani i Rrok Simonjakut. Oh, mos ia qaj hallin asaj. Prite kur ta shohësh ndonjë ditë të martuar me ndonjë ministër komunist. Ti pyet ç'janë kooperativat, po ku ta dish, moj zonjë. Ku qëlluan të gjitha këto pikërisht tani në menopauzën time, më thoshte para një jave Lejla Fishta. E parandjeja gjithmonë: kur të vijë menopauza ime, do të ndodhë diçka e tmerrshme. Ha, ha, ha. Kjo ishte mënopauza e gjithë mbretërisë, tha burri me ekzemë. Vetëvrasja e Adrian Gumës, ja një gjë që s'më hiqet nga mendja. E pse vetëvrasje? Unë dëgjova se ishte vrasje. Gjithë puna ishte të mos humbnin njëri-tjetrin. Thonë se e masakruan komunistët, ja një lajm që duhet shpërndarë menjëherë. Dreqi e mori, ne kemi dy nofulla, një gjuhë dhe një gurmaz; me të mund të ngjizim fjalë, fjalë, fjalë, sic thoshte Hamleti. Në fillim ka qenë fjala, thotë Bibla. Tani duhet shtuar: edhe në fund mbetet fjala. Fjalë, fjalë, fjalë.

Kur të tria mysafiret u çuan pér të ikur, ndodhi e pasbesueshmja: hanëmja plakë Qefser u ngrit pér të dalë bashkë me të. Shkopi i saj filloi trokëllimën nëpér plloçat

e oborrit. Mos, mama, tha dikush, por murmurima e zërave entuziastë e mbyti atë. Nga porta e madhe me kanatet e rënda me dru lisi grupi i plakave doli në rrugë. Po binte muzgu. Në fasadën e një shtëpie të lartë një mace që zhvendosej heshturazi, dukej si një emblemë.

Që larg ata panë një patrullë partizanësh dhe e ndërprenë murmurimën.

— Prapë ajo patrulla, — tha njëra prej tyre. — Ku po trokasin kështu?

— Më duket se është shtëpia e Miriamit, — tha Mukadesi. — Sikur ta parandienim që e zumë ngoje pak më parë. E zeza Miriam!

— Bëni sikur nuk i shikoni, — tha hanëmja plakë Qefser, kur ato po i afroheshin portës, ku njëri nga partizanët e patrullës trokiste.

Por në atë kohë nga grupi i heshtur që kishte ndaluar përpara shtëpisë së Miriamit, erdhi një tringëllimë metalike. Qetësisht, në mënyrë harmonioze, si një lajtmotiv, si një mesazh i përvajshëm tringëllima shpërndahej në erë.

— Pranga, — murmuritën ato, pa kthyer kokat. — I dëgjoni prangat? Ecni më shpejt. Shpërndajeni lajmin.

Patrulla kishte ndalur vërtet përpara shtëpisë së Miriam Morinës, ish-spikeres kryesore të Radiostacionit. Ndërsa guerrilieri trokiste, Sherifi dëgjoi zërin e Mete Aliut që tha:

— S'na u ndanë këto shtriga.

Nga trotuari i djathtë, përballë tyre, po afrohej grupi i plakave të veshura me rroba të zeza, të shtrenjta.

— Vërtet, duket sikur na janë qepur, — tha Teuta.

Plakat kaluan përbri tyre pa kthyer kokën, me sytë të ngulur diku larg (midis tyre ishte një sy xhami), duke lënë pas një erë naftaline, që Sherifit iu duk si erë fantazmash.

— Trokit fort, — i tha ai guerrilierit. — Dhe ti mjaft i tunde ato pranga, more vesh? — iu kthye të arrestuarit.

Guerrilieri trokiti më fort. Përmes hekurave të portës dukej kopshti i vilës dhe rrugina e shtruar me zhavorr të imtë, që mbaronte në fund të dy-tri shkallëve prej mermeri, mu përparrë derës së brendshme. Tek ajo derë doli më në fund një grua plakë dhe, si vështroi një copë herë, krejt e hutuar, në drejtim të portës së jashtme, lëvizi drejt saj me ca këmbë si prej druri.

— Çfarë doni, — tha plaka, me zë të ngjirur.

— Miriam Morina, — tha guerrilieri. — A është shtëpia e saj?

— Çfarë? — ia bëri plaka.

— Thirr më fort, — tha Mete Aliu. — Ajo është shurdhe.

— Miriam Morina, — thirri guerrilieri.

— E ç'e doni ju Miriamin? — tha plaka.

— Të vijë në Radiostacion. Në punë. Në Radiostacion.

Plaka bëri një shenjë me gishtat e saj të tharë dhe hapi portën.

— Hyr ti e para, meqë ajo është grua, — i tha Sherifi Teutës.

Teuta hyri. Plaka vështronte e habitur. Pastaj ajo eci përparrë, drejt vilës, me ato këmbë si prej druri. Ajo hapi derën e veshur me xham akulli, dhe Teuta, Sherifi dhe Mete Aliu hynë brenda në një sallon të mobiluar bukur, nën perde që duke shin edhe më të rënda në këtë orë të muzgut. Një pasqyrë e madhe, e veshur anëve me bronc, e shtonte sadopak ndriçimin e fundit të ditës.

— Uluni, — tha plaka dhe bëri me dorë nga kolltukët e veshur me kadife vishnje të errët.

Teuta bëri e para drejt kolltukëve, po prapë ndaloi në vend. Ajo vështronte poshtë në mëdyshje, sikur atje të kishte një pengesë. Në këmbët e kolltukëve ishte shtruar një qilim i butë.

— Ah, pa shiko, më bëhet vonë mua për qilimat e zotërinjve, — tha Mete Aliu dhe shkeli rëndë-rëndë me çizmet e tij gjithë baltë mbi të.

Në atë çast u hap njëra nga dyert që delte në sallon, dhe në pragun e saj qëndroi një grua e re.

— Më kërkuat mua? — tha ajo me një zë të qetë, melodioz, fare të pangjashëm me zërin që ata kishin dëgjuar në radio.

Sherifi i nguli sytë Teutës dhe ajo, pas dy-tri sekondash, me zë të drojtur, si me turp, tha:

— Po... zonjë.

— Unë jam zonjushë, — tha tjetra me një buzëqeshje të përbajtur, që mollzat e saj të hirshme, tepër femërore, ia shpërndanin qetësish mbi fytyrë.

— Më falni, — tha Teuta. — Ju jeni spikerja kryesore, apo jo?

— Kam qenë për shumë kohë, — tha gruaja, — me përjashtimi të javëve të fundit.

— E shikon? — i pëshpëriti Sherifi Mete Aliut, — Nuk është ajo që na shante.

— Ju do të vini me ne, — tha Teuta. — Radiostacioni do të hapet përsëri.

Gruaja buzëqeshi. Ajo ishte e bukur, megjithëse pak e zbetë në fytyrë dhe me hije ngjyrëkafë poshtë syve. Kishte një valëzim të qetë flokësh gështenjë, sy të lodhur dhe buzë të plota, të freskëta, me gjithë moshën e saj prej tridhetëvejcareje. Ajo u koll dy-tri herë me një të kollur të butë, duke vënë njëren dorë te goja dhe duke tërhequr me tjetrën, përpara gushës, një shall të madh që e kishte hedhur krahëve.

— A është e nevojshme? — tha ajo dhe mënjanoi kokën, sikur të linte të rrëshqiste anash ajo buzëqeshja e saj e pikëlluar. — Unë kam folur në atë Radiostacionin në një kohë tjetër... si mund të flas edhe në... këtë kohë...

Teuta vështroi Sherifin dhe ai u trubullua.

— Ne nuk e dimë këtë gjë, — tha ai. — Ne kemi urdhër që ju të gjithë të mblidheni.

— Të gjithë? — ia bëri ajo, duke rrudhur vetullat mendueshëm.

— Po, — tha Sherifi, — të gjithë ish-punonjësit e Radiostacionit.

— Një pjesë janë poshtë, — tha Teuta.

— Ashtu? — ia bëri gruaja me po atë ton të men-

dueshëm, duke vështruar si e përhumbur në një qoshe të sallonit. — Ahere po vij. Më falni sa të bëhem gati.

Ajo u fut në dhomën nga kishte dalë, duke e lënë derën gjysmë të hapur. Që nga salloni ata panë se si ajo u ul atje brenda, përpara një komoje me pasqyrë dhe me lëvizje të qeta dhe harmonioze filloj të ngrinte e të ulte duart nga mjekra te flokët, nga sytë te mollzat, buzet dhe tëmhat. Mbi komo dukeshin një mori shishesh, tubetash, pincash, krehrash dhe kutirash me lloj-lloj etiketash përsipër. Sytë e Teutës ndiqnin krejt të hutuar duart e saj që vallëzonin magjishëm midis fytyrës dhe pasqyrës, duke hapur, duke mbyllur, duke shtrydhur, duke pikuar shishka dhe tubeta mbi pjesë të ndryshme të lëkurës së saj.

— Hajde, borgjezí, hajde, — murmuriti nëpër dhëmbë Mete Aliu. — Kjo paska më shumë vegla se mitralozi i Sherifit.

Nga dera gjysmë e hapur dukej një pjesë e krevatit të madh, mbuluar me një kuvertë atllasi, dy shandanë të mëdhenj ngjyrë ari, ca ndenjëse të ulëta, mbi njëren prej të cilave ishin hedhur një palë çorape të holla.

Mete Aliu tundi kokën me vete, pastaj befas u duk sikur ngriu në vend. Te pasqyra e madhe e sallonit ai kapi veten e vet, me kapotën jashtëzakonisht të gjatë dhe me atë mungesë ulëritëse nga ana e majtë. Mete Aliu ishte parë shumë rrallë në pasqyrë në jetën e vet. Më tepër ai ishte parë mbi sipërfaqe ujérash apo në vitrina dyqanesh, mirépo këtë herë ai ngriu në vend. Ishte hera e parë që e shikonte veten pa njërin krah. Plaga e lidhur i dhembti befas në një mënyrë mizore, dhe ai boshllëk nga e majta i ngjau aq i madh, saqë iu duk se gjithë trupi i tij, duke humbur ekilibrin, do të binte në atë drejtim.

— Edhe një minutë, ju lutem, — tha gruaja, duke dalë në sallon. Ajo i buzëqeshi kalimthi Teutës, pastaj u zhduk në një derë tjetër. U dëgjua zhurma e një rubineti, një tjetër zhurmë më e lehtë, pastaj kërcitja e një dere të brendshme.

— Pas disa minutash ajo doli.

— Më falni që ju vonova, — tha, — por, e dini, kam qenë pa qejf.

Ajo i buzëqeshi prapë Teutës dhe pastaj, duke i afroar kokën te veshi në një mënyrë fare intime dhe të thjeshtë, i shpjegoi diçka me zë të ulët. Teuta u bë flakë e kuqe.

— Hm, — hungroi nëpër dhëmbë Mete Aliu, — po ia fut cfinat dhe asaj.

— Kushedi sa vështirë e keni pasur ju atje në male, — i tha gruaja, me zë fare të ulët Teutës. — E marr me mend.

Teuta kafshoi buzën e poshtme dhe murmuriti diçka të papërcaktuar.

Kur ata dolën, jashtë po binte mbrëmja. Gjëmimi i luftës vinte nga një largësi tepër e madhe. Grumbulli i zi te dera e vilës priste i heshtur.

— Mirëmbrëmani, — tha gruaja, pothuajse gëzueshmë.

— Mirëmbrëma, Miriam, — u përgjigjën dy-tre zëra.

Nga errësira erdhi një tringëllimë e butë metalike.

— Adresa tjetër është në rrugën paralele, — tha guerrilieri.

Grumbulli, që tani ishte rritur mjaft, u drejtua andej. Aty-këtu nëpër udhëkryqe, si copëra rrebeshi që era e vjeshtës i sillte nga larg, vinin fragmente të një zallahie njerëzore, që zhvendosej gjithmonë diku larg, në sinore të papërcaktuara të kryeqytetit. Çatitë me tjegulla të kuqe, kopshtet, kupolat e xhamive e të kishave lëkundeshin ngadalë në tymtajën e muzgut, sikur përpinqeshin të zinin vend, më në fund, duke ngrirë në ato pozicione që kërkojnë ligjet e statizmit.

A ka sonte shtetrrethim? A ka shtetrrethim sonte? pyeste një zë që dilte, me sa duket, nga një gjoks i ftohur. S'dihet, përgjigjej një tjetër. Ndoshta Tirana do të çlironhet përfundimisht sonte. Po minat? A u gjetën minat? Eh, mos pyet, më mirë.

— Prapë koncert, — tha Teuta, duke ngritur kokën për të kuptuar nga vinte ajo zhurmë e sajuar nga të qeshura, tingulli i një fisarmoneike dhe copëra duartrotkitjesh. Pas disa minutash ecjeje ata panë një turmë të madhe njerëzish, që rrinin në këmbë përpara hajatit të

gjerë të një shtëpie gjysmë të shkatërruar, ku një partizan i binte fisarmonikës. Në të dyja anët e hajatit, që shërbenë, me sa duket, si skenë, dy llamba petromaksi lëshonin një ndriçim të shqetësuar mbi një pjesë të skenës dhe të turmës. Fisarmonicisti, me sy të ngulur mbi tastjerat, po loste motivin e këngës «Dalngadalë po vjen behari».

— Sa bukur, ah sa bukur, — tha Teuta dhe psherëtiu.

Patrulla, bashkë me grumbullin që shoqëronte, ngadalësoi hapat. Ata ecnin tani duke i mbajtur kokat të kthyera nga hajati i drurtë, ku partizani porsa kishte mbaruar së rënë fisarmonikës dhe përkulte kokën për të falënderuar publikun që e duartrokiste. Pastaj duartrokitjet u zëvendësuant nga një rrebesch të qeshurash e britmash. Në skenë kishte dalë një partizan i veshur si gjerman, me një helmetë qesharake të copëtuar, me mollza të ngjyera me boj të verdhë dhe me sy e gojë të çakarritur. Partizani, duke u hedhur si i lajthitur mbi dërrasat e hajatit, filloi të këndonte me zë të çjerrë.

*Unë u çmenda në Mushqetá.
Hi, hi, hi. Ha, ha, ha.*

Turma filloi të ndiqte ritmin e këngës duke përplasur pëllëmbët e duarve. Pas pak një pjesë e saj filloi të shoqëronte refrenin: Ha, ha, ha.

Sherifit i shkuant sytë te krahu i vetëm, që iu duk jashtëzakonisht i gjatë, i Mete Aliut.

— Lëvizni, — tha, — jemi vonë.

Pas një minute hajati i ndriçuar nga llambat petromaks, turma e errët murmuritëse dhe tingujt e fisarmonikës mbetën pas shpinave të tyre. Tani dëgjohej zëri i trashë i inxhinierit që thoshte: Qysh sonte në këtë qytet për net e net me radhë, ndoshta me javë, ndoshta me muaj, do të ketë një vallëzim të paparë. Ashtu? ia bënte Miriami. Dhe ai vazhdonte: Është e natyrshme, Miriam. Kjo që po ndodh këtë mbrëmje, është diçka që ndodh për herë të parë pas një mijë vjetësh, ndoshta edhe më shumë, në këtë qytet... ose thjesht në këtë fushë.

Ndërsa patrulla bashkë me grupin e civilëve ecte në-për Rrugën e Elbasanit, bejlereshat plaka vinin nga një rrugë tërthore, tabela e së cilës ishte shqyer, kushedi pse, me bajonetë. Zhurma e hapave të tyre, një zhurmë shurdhane, si e gjithë këmbëve pa muskuj, përzihej me mërmërimën e tyre të shtruar, paksa të ngjirur dhe plot kolitje midis. Ankoheshin pér plakën Nurihan që e gjetën, o c'turp, c'kob, duke u kujdesur, bashkë me gjithë një-rezit e familjes, pér një komunist të plagosur. E kam ditur gjithmonë, thoshte plaka Qefser, përparrë se të ishte një zonjë, Nurihani ka qenë gjithmonë një bisnesmene. Megjithatë jo gjer në këtë shkallë, o perëndi, psherëtinte njëra prej plakave, na shkel, na rropos në baltë, na merr sytë dhe mendtë, na jep torbën e varfanjakut, por mos na rrëzo kaq sa të lidhim plagët e atyre që na përbysën. Mos u ligshto, thoshte Mukadesi. Hidhërimë të tillë do të kemi shpesh. S'duhet ligshtuar. Është një djerrinë e shterpuar nga kriporja pranë Durrësit, thoshte plaka Qefser. Asgjë s'mbin në të, veç një kallami të helmët. Ashtu dhe ne... Ja, prapë ajo patrulla, tha Mukadesi.

Herën e fundit ata nuk u panë dot. Ishte errur krejtësisht dhe të dyja palët nuk e dalluan njëra-tjetren, veçse në formën e dy grumbujve siluetash kaotike, që rrrotullo-heshin butësisht në terr.

Ndal, ne jemi patrulla e Radiostacionit. Kush jeni ju? Ne jemi plaka, ishim pér vizitë. Pse kaq vonë? Kaloni. Ju e dini që është kohë lufte. Ikëm. Ikëm.

Ata kanë frikë, e shikoni, murmuriti Mukadesi. Ata kanë frikë nga ne. Shpërndajeni lajmin. Nesër do të shihemi përsëri. Po, po, nesër. Trokitni kështu: dy herë shpejt, tak, tak dhe më vonë një trokitje të veçuar, tak. Kështu pra, tak, tak... tak.

Antiradiostacioni po ngrihej.

KAPITULLI I GJASHTË

Aty afér mesnatës pjesa më e madhe e ish-personelit të Radiostacionit ishte mbledhur. Shumica duke u dredhur, disa entuziastë, disa të trembur, një pjesë indifferentë, ata mbushnin korridoret, shkallët dhe sallat e ftohta, me murmurima, fjalë, fishkëllima, kërcëllitje dhëmbësh, parashikime ogurzeza ose komike.

Pothuajse në mesnatë, nga një autoblindë që tronditi qetësinë e bullevardit «Musolini», zbriti një njeri, që u drejtua me hapa të ngadaltë, si të mpirë, drejt portës së Radiostacionit.

— Jam i dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm për të marrë në dorëzim Radiostacionin, — tha ai, duke u treguar rojeve një shkresë të shkurtër, të firmosur me bojë të kuqe.

Rojet e lanë të hynte dhe ai kërkoi të mblidheshin menjëherë të gjithë në sallën kryesore. Njerëzit, të mbësh-tjellë me shalle, me jaka të ngritura, duke u dredhur nga të ftohtët, me pëshpërima: «erdhi drejtori i ri», «erdhi drejtori i ri», dy-tri prej tyre duke tringëllirë prangat që akoma nuk ua kishin hequr, u mblodhën.

I porsaardhuri rrinte më këmbë vetëm fare, prapa tryezës së mbuluar me katile jeshile, në cepin e majtë të së cilës një llambë me petromaks ndriçonte nga poshtë lart fytyrën e tij, duke theksuar mjekrën e vetullat dhe duke lënë në hije sytë.

Kur u duk se u mblodhën të gjithë, njeriu që gjer atëherë kishte vështruar syprinën e tryezës, drejtoi sytë nga salla. Nga vetullat e tij të pjerrëta dukej sikur filloj të rridhte një shi përbuzjeje.

— Borgjezë, — tha ai, me një zë të prerë.

Shiu i përbuzjes duke rrjedhur midis mollzave dhe hundës, qe grumbulluar në të dy cepat e buzëve të tij të holla, që u hapën e u myllën në çast.

Salla kishte shtangur në vend. Ai hapi gojën për të folur përsëri, por diku nga mesi i sallës u bë një zhurmë.

— C'është? — tha ai.

— S'jemi të gjithë borgjezë, — tha një zë i fortë. — Ju lutemi, kontrolloni fjalët.

Në fytyrën e të porsaardhurit nuk lëvizi asgjë. Strehet e vetullave ishin të drejtuara vazhdimisht poshtë.

— Bukur, — tha ai po me atë zë, — ju kuptova.

Ai pushoi ca çaste dhe gishti i tij tregues lëvizi mbi kadifenë e tryezës, sikur të ndiqte atje një insekt.

— Në fillim po ju drejtohem borgjezëve, — tha dhe ngriti kokën lart.

Salla kishte shtangur.

— Ju, — filloj ai prapë, duke e lënë fjalën «ju» pak të vecuar, si një qenie autoritare, prapa së cilës ecin, në një largësi të respektueshme, shoqëruesh, — i keni shërbyer gjer më sot regjimeve të kaluara. Ju, — prapë një pauzë, — keni vjellur vrer, ose keni ndihmuar të villet vrer kaq e kaq vite. — Dora e tij, që u duk tepër e gjatë, bëri një rrrotullim, sikur të tregonte se vreri që ata kishin lëshuar, ishte akoma aty, rrreth e rrrotull. — Pra, ju gjer më sot keni qenë gjuha e nëpërkës. Këndej e tutje, qysh sonte, ju, me hir ose me pahir, do të viheni në shërbim të popullit. Për dy, ose e shumta tri ditë, ky Radiostacion duhet të flasë. Personeli teknik do të fillojë nga puna qysh tanë. Të tjerët do të rrinë në pritej. Do të merrni ushqim nga intendanca partizane. Sabotatorët do të pushkatohen. Qartë? Ka pyetje?

Salla heshtte. Pastaj ngadalë, si një tringëllimë këmborësh, u dëgjua një zhurmë metalike.

- Ç'është? — tha njeriu që porsa kishte folur.
 — Janë tre njerëz të lidhur me pranga, zoti drejtor,
 — u përgjigj një zë nga gjysmëterri.
 — S'jam drejtor, jam komandant i Radiostacionit, —
 tha njeriu që kishte mbajtur fjalim. — Zgjidhini, — iu
 drejtua ai dy partizanëve që rrinin më armë në krahë
 te dera.

Partizanët u futën midis turmës së errët që lëshonte
 aty-këtu ndonjë pëshpërimë, hukatje apo kërcëllitje no-
 fullash nga të ftohtët. Dëgjoheshin zërat e partizanëve:
 «Ku janë të lidhurit?» dhe përgjigjet: «Këndeja, këndeja».

Kishte kaluar mesnata. Pas dy javë heshtjeje ndër-
 tesa e Radiostacionit dukej si e banuar nga fantazma en-
 dacake, që, të dëbuara prej gropave dhe mazgallëve nga
 zhurmat e luftës dhe shqotat dimërore, në ikje e sipër,
 dukej sikur kishin gjetur rastësisht hapur portën e tij të
 hekurt dhe ishin futur brenda. Në korridoret e akullta, në
 sallat e veshura me kadife, që në errësirë dukej si veshje
 arkivoli të shtrenjtë, duke projektuar nëpër mure hijet
 e tyre (më tepër se hije njerëzish do të besoje se ato
 ishin skica të tyre, apo lloje merimangash, ca kokë të
 llahtarshme dhe ca gjymtyrë të gjata tri-katër metra),
 ata, sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, e mbushnin
 tërë ndërtesën me një murmurimë të pafund, një rënkim,
 pshërëtimë, lutje fetare, fraza anונית, të gjitha si të
 huajtura nga kohërat paralogjike. Kishin filluar nga puna
 vetëm teknikët, kurse të tjerët rrinin në pritje, të mbësh-
 tjellë me gëzofët dhe palltot e mëdha dhe me atë mur-
 murimë kaotike. Ç'do të bëjmë? pyeste herë pas here
 një zë. Shët, shët, mbylle gojën. E marr me mend ç'do
 të na bëjnë. Do të na vënë të flasim ditë e natë përpëra
 mikrofonave të hapur, të përgënjeshtrojmë ato që kemi
 thënë, ato miliona fjalë që kemi thënë. Me një fjalë, të
 vjellim e të vjellim pa pushim, gjersa, më në fund, të
 pëlcasim si gjinkalla. Shët. Tu thaftë ajo gjuhë. M'u

thaftë që ç'ke me të. Gjuhë nëpërke jemi të gjithë, e dëgjove, kështu na quajti ai. Ç'acar njeri që ish. Shët. Kështu pra, përpara mikrofonave lexoi gjithë lajmet që ke thënë: tetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë lajme nga Roma, pesë mijë e ca Berlini, mbi tre mijë Londra, katër mijë Nju-Jorku e kështu me radhë dhe në fund të çdo lajmi të thuash: «Gënjeshtër. Gënjeshtër. Gënjeshtër. Mjaft, i çmendur. Gënjeshtër. Plaç, do të dëgjojnë rojet. Hi, hi, hi.

Të strukur njëri pas tjetrit mbi divanet e gjata, mbi stola, drejt e në shesh, rrinin redaktorët e lajmëve e të muzikës, komentatorët politikë, redaktori i Orës së Shpirtit Kristian dhe i Orës së Shpirtit Islamik, kronisti i Jetës Mondane, spikeri i vdekjeve, vëzhguesi i fajdeve, që i pëlqente të quhej komentatori i bursës, redaktori i Kronikës së Zezë, spikerja e Orës së Shpirtit, spikerja kryesore e Radiostacionit, kronisti i sherreve, redaktori i lajmeve gjermanisht. Ç'natë, tha dikush nga brendësia e një dhome. Diku nga poshtë, nga katet e para, apo nga lart, nga tarraca, dëgjoheshin herë pas here çizmet e rojeve partizane. Pastaj qetësi dhe prapë ajo gjergamë e mbytur, monotone, që e mbështillte gjithçka si një push. Midis saj, të egra, të shëmtuara mundimshëm, me një ritëm të përgudshëm, vinin ca fjalë gjermanisht, që s'mund të përfytyroheshin ndryshe veçse si të dala nga një kokë me sy të mbyllur e me flokë të qullur nga djersë të skëterrshme. Ishte kllapia e një gjermani. Dhoma ku i kishin mbyllur robërit gjermanë ishte në katin e dytë, megjithatë përcartja e të plagosurit, ato fjalë të egra që synonin drejt njëra-tjetrës për t'u lidhur e që s'lidheshin dot, dëgjoheshin qartë në gjithë ndërtesën. Edhe kjo na duhej, thoshin njerëzit e kërrusur qosheve, me shpresë të dobët për të marrë ndonjë sy gjumë. Fjalët e gjermanit, të tendosura si nga një ngërç, pa përthyerjen e zakonshme dhe pa parashtesat apo prapashtesat që mund t'i lidhnin me shoqja-shoqen, ata tinguj të ngjirur, të lidhur me një sintaksë tashmë të vdekur, tekst i ftohur si kufomë, akull, Achtung, Achtung, përplaseshin verbërisht nëpër muret e korridoreve dhe të sallave.

Achtung, Achtung. Si i thoshin vallë mongolisht kësaj fjale? Miriam Morina, spikerja kryesore e Radios, e ulur në një kanape, me krahi të mbështjellë rrëth gjunjëve të përthyer, e kapi veten duke përsëritur me mend një pyetje që e kishte bërë dikur dikush tjetër. Ai gjithashtu është i vdekur tani, mendoi ajo. Përfytyroni trupin e tij pak më të gjatë se mesatarja, të rrëzuar brinjazi mbi qilim, me një revolver aty pranë dhe me shpinat e praruara të kopertinave të librave të tij, në sfond, në raftet e bibliotekës së bardhë. Kështu thoshin, kishte vrarë veten para disa ditësh, megjithëse ajo nuk dinte asnë hollësi përkëtë. Së paku të mos kishte qenë shkak Hamide hanëmja ose Kristinë Dakli, tha me vete, me një ndjenjë të hidhur, megjithëse të shpërndarë në një hapësirë të madhe xhelozie. Si gjithmonë, ajo u përpdq ta dëbonte nga mendja fytyrën e ëmbël, të pruar anëve nga flokët e verdhë të hanëmes së bukur (më tepër se floknajë, kjo i ngjet një rënieje dielli, thoshin për të), dhe të ecurën e vecantë me atë përhedhje si prej antilope të Kristinë Daklit. Pra, si i thoshin vallë mongolët fjalës Achtung? Asaj i kujtohej se ai e kishte bërë këtë pyetje në pritjen e madhe në pallatin e nënmbretit, me rastin e ardhjes në Shqipëri të Eda Musolinit. Ajo kishte shkuar në pritje në vonë se të gjithë, pasi kishte lexuar emisionin e lajmeve të mbrëmjes, ku emri i vajzës së Musolinit përmendej çdo katër sekonda, mesatarisht. Ajo priste me padurim ta shikonte dhe, kur e kishte parë, kishte mbetur pak e zhgënjiyer nga ata sy, ku më tepër se shkëlqim dhe dritë parajse danteske, siç e përfytyronte ajo, nuk kishte gjetur vecse një pikëllimi nervoz. Dukej sikur tërë vezullimi parajsor kishte kaluar tek i shoqi i saj, Konti Ciano, sytë e të cilit ndalonin me radhë mbi sytë e grave të ftuara, ngjiteshin, rrëshqitnin, notonin, shqiteshin, mbyteshin në ujin qiellzor, në një valle ekzataze qeniesh të vogla transparente deti. Asaj ai nuk i pëlqeu dhe aq. Kishte diçka prej spitullani, diçka tepër të lëmuar në flokët dhe në gjithë qënien e tij, një mungesë rrudhash, drite e hijesh misterioze dhe një kënd të mbajtjes së qafës pak më të lartë se çduhet, një kënd i tillë që i

përshtatej fare mirë shqiptimit të frazave të lustruara në gjuhën italiane, me ato ndajfolje të gjata, tepër të gjata të italishtes, që asaj i dukej se i ulnin peshën të folurit të një burri. Si i thonë mongolisht kësaj fjale? Ah, ku ju vete mendja juve shkrimtarëve, kishte ndërhyrë peshkopi Visarion. Na e thuaj, Adrian, përse të shkoi ndër mend një gjë e tillë, ishin lutur dy-tri gra. Ajo, ahore, ishte e zemëruar me të, gjithmonë për shkak të Hamide hanëmes dhe as që e ktheu kokën, mëgjithëse mendjen e kishte atje, për të dëgjuar se çdo të përgjigjej. Mongolët, kishte thënë ai, duke vështruar llullën e tij një copë herë, me atë mënyrën e tij të njobur. Ai e mban llullën po aq bukur, sa ç'mban Hamleti kafkën e të vdekurit, thoshte për të bejleresa Mukades. Me këtë gjest ajo e mbante mend për herë të parë, ditën e njobjes së tyre. Kjo kishte ndodhur ditën e dasmës së mbretit Zog, në ballon e madhe, o zot, a ishte e mundur që ajo ballo të ishte bërë njëqind metra larg, në një ndërtësë që sonte gjithash tu ishte e vdekur, si Radiostacioni. Ajo sallë e madhe, pamje e konsumuar nga kujtesa, e zbehur si një sixhade që e ka marrë dielli, çohej shpesh në kujtesën e saj, e përshkuar tej e mbanë nga rroba, perfume, bizhuteri, biseda me zë të ulët për pamjen e mbretëreshës, të mbretit... thonë se për tre muaj ajo mësoi gjuhën shqipe... ai ka filluar të shëndoshet... jo, aspak, është po ai i pari... më gjithatë kur ishte thjesht President i Republikës, nuk më pëlqente më tepër... mos do të thuash se të ka pëlqyer edhe më shumë kur ishte ministër i Brendshëm? Pse jo, ahore ishte vetëm njëzet e katër vjeç... ha... ha... ha... Pastaj bisedat për dhuratat e mbërritura nga gjithë bota, çfarë ka dërguar Hitleri, çfarë Çamberleni, po Franca... po Hindia... a ka dërguar... nga përpjekjet për të gjetur një nënkuptim në dhuratat, në ngjyrën e diamanteve, të qimeve të kuajve; nga trishtrimi i trubullt i princeshave, që vëllai... që vëllai... po çfarë vëllai?... vëllai do të merrte një ditë një grua... një mbretëreshë... si gjithë burrat... mbretërit... nga ecejaka e kurtizanëve të oborrit me Lalë Krosin në krye, nga ambasadorët, rapsodët dhe nga mërzia mospërfillëse e Hamide hanëmes së zbetë (bashkë me

emrat e kandidateve për mbretëreshë, të princeshave turke, daneze dhe italiane, ishte pëshpëritur edhe mundësia e martesës së monarkut me të), që i thoshte një mikut të saj ambasador: Hungarezët a nuk flasin një mongoli-shtë të zbutur? Midis asaj dehjeje Miriami ishte gjendur përbri shkrimtarit Adrian Guma, i cili fliste në atë çast për vdekjen, duke vështruar pjerrtazi llullën e tij prej shqope. Ndoshta qysh nga ajo natë asaj kishte filluar t'i dukej se, midis qindra gjestesh të burrave, nuk mund të ketë gjest më të bukur, sesa vështrimi i llullës me një mënyrë të tillë. Duket sikur burri shikon në të zjarr dhe hi, motive të preferuara të meshkujve. Ai po fliste për vdekjen, dhe bankjeri Rrokaj që e dëgjonte, i thoshte: Ti flet për vdekjen me lehtësi, Adrian, sepse e ke siguruar pavdekësinë, kurse neve të tjerëve, vdekëtarëve të zakonshëm, ajo na trëmb. Ai ahore kishte qeshur, dhe sytë e tyre ishin takuar për herë të parë. Juve ju dëgjojmë përnatë, tha ai pak minuta më vonë, kur u njohën me njëri-tjetrin, por do të ishte më mirë që edhe t'ju shihnim përnatë. Ajo kishte qeshur me gjithë zemër nga fjalët me dykuptim të tij dhe pastaj kishin qëndruar bashkë pothuajse gjithë mbrëmjen. Ai ahore nuk njihej me Hamide hanëmen. Historia midis tyre kishte filluar një vit më vonë, fill pas ikjes së Zogut, në pritjen e madhe që u dha me rastin e bashkimit të Shqipërisë me Italinë. Të gjitha pritjet e mëvonshme ishin aq të ngashme me dasnien e Zogut, saqë asaj i duhej të bënte njëfarë sforcimi, që copëra të njërsë të mos montoreshin tinzisht në trupin e tjetrës. Ishin pothuajse po ato fytyra, me po atë qesëndi, idiotizëm, djersë, copëra frëngjishtëje mbi mjekra; po ata bajraktarë të Veriut me dorezat e kobureve prej sedefi, ngjeshur në brez, dhe me atë të ecur si me këmbë prej druri; po ata klerikë të lartë, bejleresa plaka, hanëme të bukura, sytë e të cilave dukej sikur thoshin: Ah, edhe ju këtu, sigurisht, do të mblidheshim prapë një ditë, as që kam dyshuar; po ata rapsodë të veshur me fustanella apo me tirqe, të lumtur që i kishin thirrur përsëri dhe që fjala Itali rimohej kaq lehtë në gjuhën shqipe etj., etj. Ja ku u mblodhën prapë të gjithë, si zogjtë

e kullokkës, thoshin sytë e të ftuarëve. «Ai» iku, por ne mbetëm. Kjo ishte pritja e parë e madhe që jepej që pas përbysjes së mbretërisë së Zogut dhe pushtimit italian dhe dihej se pritja e parë pas përbysjes së një mbretërie është gjithmonë e paharrueshme. Hamide hanëmja rrinte diku, pranë nënmbretit italian të Shqipërisë, Jakomonit, me një triumf dhe njëkohësisht pikëllim në sy, thuase, po të ishte bërë ajo mbretëreshë, «ai», mbreti Zog, nuk do të ikte në asnjë mënyrë, ajo nuk do ta linte të ikte kurrsesi, dhe ai do të mbathte opingat, siç kishte premtuar një muaj më parë solemnisht përpara popullit dhe do të delte në male, bashkë me të. Mirëpo ai kishte preferuar në vend të saj virgjëreshën hungareze, ha, ha, virgjëreshën, ha, ha, hungareze, dhe ja, çdo gjë kishte rrjedhur ndryshe, fare ndryshe. Miriami nuk ia ndante sytë asaj, hirer e së cilës qenë shndërruar prej kohësh në mit dhe, sikur dikush t'i thoshte se atë mbrëmje ajo grua, për të cilën nënmbreti Jakomon po tregonte një interes të hapur, do t'i shkaktonte asaj xhelozë, duke u njojur me Adrian Gumën, kjo do t'i dukej asaj gjëja më e pasueshme. Ajo e dinte se sedra e grave të bukura, duke mos njojur kufi, kapërcen shpesh në trevat e marrëzisë, megjithatë Miriami kishte mbetur me gojë hapur nga ajo mospërfillje e dukshme që tregonte Hamide hanëmja ndaj nënmbretit italian. Të gjithëve u kishte rënë në sy kjo gjë dhe të gjithë e shpjegonin atë pas mënyrave të ndryshme, por intuita prej gruaje e Miriamit i thoshte se ngashnjyesja e bukur e bënte këtë për t'u treguar të gjithëve se ajo, megjithëse nuk qe martuar me mbretin e ikur (a s'ishin një pjesë e tyre fajtorë për këtë?), ishte mësuar në shoqëri mbretërish dhe me nënmbretërit do të sillej siç mund të sillet njeriu me zëvendësit. Ishte pa dyshim një marrëzi, që dukej megjithatë e logjikshme porsa t'i përqëndroje sytë një copë herë mbi hanëmen. Miriami po kërkonte me sy midis défrimtarëve Adrian Gumën, kur e pa të vallëzonte... me të. Miriamit iu duk në fillim thjeshtë një kureshtje, bile u përpoq të kapte vështrimin e tij për t'i bërë ndonjë shenjë të gëzueshme, mirëpo në çast se si e ndjeu që, në largësinë midis ba-

lieve të tyre, kishte diçka mizorisht të shndritshme. Ishte një tango e gjatë, tepër e gjatë, ku këngëtari, me zë të molisur, përsërise pambarimisht fjalët «vetëm ty», që, pasi e mbushnin sallën, dukej sikur têrhiqeshin në çast me shpejtësi, iknin e boshatisnin atë, për t'u grumbulluar në atë largësinë e vogël mizore pesëmbëdhjetë-njëzet centimetra, midis dy balleve të tyre. Vetëm ty. Mos i lini ata vetëm, kishte thirrur një zë brenda asaj, dhe pastaj gjithçka kishte rrjedhur në mënyrën më banale; ai i kishte dhënë asaj një shpjegim, dhe ajo s'dëgjonte shpjegimin e tij, por vinte re atë prishje të lehtë ekuilibri të frazave dhe mendonte trishtueshëm: Ndoshta do të kalojë, ndoshta do të kalojë pa shumë dhimbje. Në të vërtetë historia e tyre kishte qenë e shkurtër, dhe në pritjen e Eda Musolinit, mëgjithëse ishin akoma të zemëruar, plaga ishte malcuar disi. Atje Konti Çiano dukej krejt i magjepsur pas Hamide hanëmes, dhe ajo i përgjigjej në një farë mënyre, mirëpo as tek Eda Musolini as tek Adrian Guma Miriami s'pa ndonjë shenjë xhelozie. Përkundrazi ai dukej në qejf. Ju pyesni pse më ka shkuar ndër mend të di si i thoshin mongolët fjalës Achtung? Ai buzëqeshi dhe ajo mendoi se, sikur ai të mund t'i huante Kontit Çiano disa nga rruhat e tij, ky i fundit do ta falendëronte. Çdo pushtues të madh që shfaqet në botë, unë e përfytyroj si macen Qeshire, tha Adrian Guma. Ju kujtohet macja Qeshire te «Liza në botën e çudirave», buzëqeshja apo ngërdheshja e së cilës mbetej në horizont, edhe kur koka e saj zhdukej? Pra çdo pushtues shfaqet gjithmonë prapa bregut të kohës, zgjat kokën dhe thotë një fjalë, një fjalë që jehon në mënyrë të frikshme, që vibron dhe ngrin ajrin dhe i ngjeth mishtë botës: Achtung, Achtung, ne erdhëm. Kështu kanë bërë pushtuesit e mëdhenj: Kortezi, Atila, Çingiz Khani. Achtung, Achtung. Ç'ka këtu për të mos kuptuar? Atij i pëlqente gjithmonë të thoshte gjëra jo shumë të kuptueshme dhe t'i torturonte pastaj të tjerët me fjalët: ç'ka këtu për të mos kuptuar? Gjithmonë e njëjta histori dhe gjithmonë vështrimi i pjerrët mbi hirin e zi të llullës, prej nga dukej sikur tymtonin motivet e zymta të bisedave të tij. Cilët vdisnin më parë.

gjuhët apo popujt... Jo, kjo bisedë e murgët nuk u bë atje, por në pritjen e madhe me rastin e ardhjes së Viktor Emanuelit në Shqipëri. Për shkak të atentatit që ishte bërë disa orë më parë, të gjithë në atë pritje dukej sikur kishin në sy një perde zie. Dukej sikur përmes buzë-qeshjeve dhe kristalit të ftuarit herë pas here tundnin kokat të llahtarisor, si për të shkundur një hamendje që po i tiranizonte. Një «sikur» i tmerrshëm tymtonte mbi sallë, varej nga llampadarët poshtë, ngjitej nga anët e argjendta drejt tavani. Dhe më në fund, kur ajo u gjend me të në një qoshe të sallës, ai u përkul te veshi i saj si për ta puthur dhe i pëshpëriti: Po sikur plumbi i atentatorit të ikte njëzet centimetra nga e majta? Ajo zuri gojën me dorë sikur ai t'i kishte thënë një tmerr të madh dhe ai kishte qeshur dhe i kishte thënë: Kjo hamendje është në sytë e të gjithëve, a nuk e ndien? Ajo ishte vërtet në sytë e të gjithëve. S'ishte e vështirë të kuptoje se gostijarët s'kishin në sy as pallatin, as darkën mbretërore, por përfytyrimin e mishit të shpuar nga plumbi, të përzhitur anëve, ose barkun e çarë me zorrët përashta, ose kafkën me vetëtimën e bardhë të truve brenda dhe shkulmën e gjakut nga gurmazi, dhe trupin e perandorit plak, atë trup të dobët, jashtëzakonisht të shkurtër, me kokën që dukej sikur qafa e hollë, si e fëmijëve të pa-ardhëse, të shtrirë në tryezën kirurgjikale, lakuriq midis gjerarkëve më të lartë të perandorisë dhe të fashizmit. Atentati kishte ndodhur në mesditë, në kohën që korteu madhështor i makinave po i afrohej qendrës së Tiranës. Ajo po lexonte për të tretën herë reportazhin e mbërritjes së tij në Tiranë, që do të jepej pas njëzet minutash në orën e lajmeve të mesditës, kur drejtori bashkë me nëndrejtorin italian hynë si veriu në Radiostacion. Ata ishin të verdhë dhe të mbytur me djersë të ftohta. E vërteta pikoi gjithashtu pilkë-pikë, si djersë të ftohta kllapie, nëpër korridoret, nëpër studiot. Perandorin e kishin që-lluar me revolver pilkërisht në Rrugën Mbretërore. Një revolver i fshehur midis trëndafilave. Një djalë shtatë-mbëdhjetëvjeçar, që kishte zënë vend midis murgeshave.

Perandori nuk kishte pësuar gjë. Ishte plagosur kryeministri shqiptar. Te zyra e drejtorit telefonat binin njëri pas tjetrit. Lajmet e mesditës u shtynë gjysmë orë. Përpara hyrjes së Radiostacionit ndalonin bafasisht vetura të njëpasnjëshme (shenjat e frenimeve të tyre mbetën për shumë ditë rreshth mbi asfalt si shirita zie). Vinin nga ministria e Jashtme, nga pallati i nënmbretit Jakomoni, nga zyra e shtypit. Ahere u bë e qartë për të gjithë për se gjithë kjo zallahi: po përpilonin lajmin e atentatit. Fytyra zyrtarësh të lartë, të paparë ndonjëherë në këtë ndërtësë, dy-tre ministra, sekretari i kabinetit të nënmbretit, ndoshta vetë zëvendëskryeministri, të përkulur mbi tryezën e madhe prej druri mogani të zi të drejtorit, si mbi tryezën kirurgjikale (ah, tryeza kirurgjikale, torturuesja e tyre e përbashkët), po përpinqeshin të përpilonin lajmin. Miriamin e thirrën në drejtori për t'i dhënë tekstin e ndryshuar, por tamam në kohën që ajo po e lexonte, aty në këmbë, përpara tyre, telefonat ranë përsëri dhe ata gati sa nuk ia rrëmbyen tekstin nga duart. Ajo u ul në një kanape dhe po priste. Të dhënë pas ribërjes së lajmit, ata e kishin harruar atë. Zërat e tyre ishin të shqetësuar, seriozë. Në fillim ajo nuk kuptoi se çfarë po bën në gjithë ata njerëz që përkuleshin mbi tekstin e lajmit, si mbi një të operuar. Pastaj dalngadalë, megjithëse ata flitnin në një mënyrë të trubullt, ajo filloi ta merrte vesh. Ata po bën në falsifikim. Ata po diskutonin se ç'kombësi dhe shtetësi duhej t'i jepnin atentatorit, në mënyrë që askush në botë të mos e merrte vesh që një djalë i ri shqiptar qëlloi perandorin që porsa kishte ardhur në Shqipëri, kurorën e lashtë të së cilës ai e mbante bashkë me kurorën e Italisë e të Etiopisë. Atentatori mund të ishte kushdo, por jo shqiptar. Grek, thoshin ata. S'është mirë. Tani për tani fqinjësia me Greqinë është normale. I dërguar i Kominternit? Është pak abstrakte. Ndoshta çifut, dhe kjo përputhet me idenë e aleatëve tanë gjermanë... Megjithatë vetëm çifut nuk mjaftron. Duhet diçka tjetër. Ata vazhdonin të mos kujtoheshin për praninë e saj. E pikëlluar me një pikëllim të tillë të durueshëm lehtë, që provokohet nganjëherë te njerëzit fare thjesht, si për she-

mbull nga rënia e shiut në verandë, ajo vështron te kolltukët e rendë dhe kanapenë, mbi të cilën dy muaj më parë kishte duruar përqafimet e drejtorit, atë kokë massive, me sy të dergjur më shumë nga pijsa se nga pasioni, që herë pas here ktheheshin pas, sikur ai të druhej nga tryesa prej druri të zi, nga tablotë në mure dhe nga të gjitha objektet që janë karakteristike për një zyrë dhe format e së cilave janë në kundërshtim me dashurinë. Tamam në atë çast njëri nga të tre telefonat ra me një zile që atyre iu duk e zgjatur, me pauzat midis që iu dukën akoma më të zgjatura, dhe ai mbajti vesh sikur të donte të kuptione nga tingulli, nëse duhej të ngrihej apo jo. Ai nuk do të ngrihej në atë çast nga asnje zë i njohur, por kjo thirrje e formuluar nga elemente jo njerëzore, e ardhur nëpërmjet bakrit, kauçukut dhe metalit drejt e nga mushkëritë e ftohta të mekanizmit shtetëror, kishte një fuqi të madhe për të ndërprerë çdo pasion. Duke murmuritur, ai u çua dhe ngriti receptorin. Ndërsa ai fliste në telefon, ajo, me duart e lidhura nën gjunjë, mendonte se sa e trishtueshme ishte të duroje mbi lëkurën tënde të puthurat e dikujt, vetëm se ishte drejtori yt. Ja, ai do t'i vinte pranë përsëri dhe asaj do t'i duhej të bënte një përpjekje të re për të fshehur krrupën që i shkaktonin ato buzë, në cepat e të cilave kishte diçka prej njeriu jargan. Por ka edhe më keq, e ngushëlloi ajo veten në kohën që ai po i jepte fund bisedës. Në fund të fundit ishte një fat që ai kërkonte prej saj vetëm ca përqafime dhe puthje dhe asgjë tjetër. Pas mbarimit të bisedës telefonike ai qëndroi në këmbë me vështrimin të ngulur mbi të tre telefonat, sikur të thoshte me vete: janë shumë për të shpresuar se asnjeri nuk do të bjerë. Eja të shkojmë në studion tënde, tha më në fund. Atje s'do të na shqetësojë kush. Uf, rënkoj ajo me vete, por u ngrit pa thënë asgjë dhe eci nëpër korridoret e zbrazëta. Ishte vonë, gati mesnatë, kur ata u futën në studion e transmetimit të lajmeve. Ky ishte këndi i saj, i izoluar nga bota me veshje të trasha tapetesh. Mbi tryezën e veshur me kadife mikrofoni lëshonte një rrezëllim të dobët argjendi. Ajo pati ndjesinë se ashtu, me flokët të

shprishur siç qe, provoi një si ndjenjë turpi përballë asaj gjёje të vogël, metalike, që dukej si e vetmja gjё e gjallë në atë shurdhëri varri. Gjatë transmetimeve të lajmeve me orë të tёra ata të dy, ajo dhe mikrofoni, kishin qëndruar pranë njëri-tjetrit; ai kishte ndier nga afér frysma marrjen e saj dhe, tanë që po e shihte me një burrë, dukej sikur lëshonte një përbuzje të ftohtë argjendi me ato rrembat e tij. Aty, pranë mikrofonit, ai e përqafoi përsëri, dhe ajo u struk e u mpak brenda vetes së saj, sikur të përpiquej të linte lëkurën e saj, buzët, qafën, mollzat, larg, sa më larg, jashtë vetes, sipër, në periferi. Mbi atë jashtësirë të largme ishin puthjet e tij, që, ashtu si dihatja, si perëndimi i syve, kishin diçka të përcudur dhe kallpe. Ashtu si në gjithë jetën e tij, në pozat prej patrioti, të martirit të ardhshëm, të eruditit, ai ishte kallp edhe në dashuri. Historia e flokëve të bardhë por me zemër njëzetvjeçari, uh, ia bëri ajo thellë vetes për të dhjetën herë. Pas dy muajsh, ditën e atentatit, duke parë se si lëvizte fytyra e tij mbi tekstin e shkarravitur të lajmit, ajo thoshte me vete: O zot, éshtë e mundur, vallë, që ky njeri të jetë po ai i asaj nate, kjo fytyrë e zhveshur, e ndarë në dy pjesë nga hunda krejt e përulur përpara këtyre zyrtarëve të lartë, që thoshte vazhdimisht, mekanikisht: Po, zotëri, si sinjore, po shkëlqesë... Më në fund ata e gjetën zgjidhjen, atentatori ishte cifut sigurisht, por, veç kësaj, ishte edhe rus, pra cifut rus, agjent i Kominternit, i maskuar me emrin Vasil Laçi. Të lodhur e të lumtur, ata njoftuan me telefon më lart, fare lart, ndoshta te nënmbreti, ndoshta te sekretari i perandorit variantin e tyre dhe po pritnin të heshtur miratimin e tij. Ai erdhi po me telefon, shumë shpejt dhe pas dhjetë minutash ajo e levoi tekstin në lajmet e vonuara të mesditës: Njoftim i zyrës perandorake të shtypit. Sot në orën njëmbëdhjetë të parabitës, i frysmauar nga qëllimi i zi për të errësuar dashurinë që populli shqiptar po i shfaqte bujarisht sovranit të tij august Viktor Emanuelit të Tretë, mbret i Italisë dhe i Shqipërisë dhe Perandor i Etiopisë, agjenti i Kominternit, cifuti rus Izak Mihajlov, i dërguar posaçërisht me këtë qëllim në Shqipëri dhe i maskuar me

emrin Vasil Laçi, bëri atentat, duke qëlluar dy herë me revolver kundër jetës së Perandorit. Zoti e shpëtoi Perandorin august. U plagos vetëm në krahun e djathë kryeministri shqiptar, shkëlqesia e tij, zoti Shevqet Vërlaci. Populli... Fjalët për popullin ajo s'i mbante mend. Ato ishin të përgjithshme dhe pa fytyrë, si pamja e një turme nga larg. Lajmi duhej të ishte akoma në arkivë, kufomë e paprishur, e varrosur vertikalisht në një nga raftet e gjata përbri dhjetëra-mijëra lajmeve të tjera të vdekura. Atë ditë ajo e lexoi atë tri herë, kurse spikerët e tjerë, ata të gjuhëve të huaja, e lexuan edhe më shumë. Ndërsa po mbaronte leximin e tretë, sytë e saj, të zmadhuar parpitur jashtë mase, iu ngulën mikrofonit. Ishte një nga ato çaste të ralla, kur, midis leximit, ndërsa buzët vazhdonin të shqiptonin automatikisht fjalët, mendja ikte larg, në kushedi ç'drejtime të marra. Ç'ishte ky tiran i vogël i nikeluar, ky metal i tmerrshëm me emrin mikrofon, që i rrinte gjithmonë disa centimetra larg gojës, i ftohtë, ironik, vezullues, përpara të cilit ajo duhej të thoshtë gënjeshtra, gënjeshtra... Ç'thua ti për këtë lajm? tha një zë i vogël, i pakontrolluar brenda saj, në kohën që ajo e mbaroi së lexuari lajmin për herë të fundit dhe po zbriste shkallët për të shkuar në pritjen e madhe. Ç'thua ti për këtë lajm, përsëriti po ai zë, por ajo mendoi se ishte tepër e lodhur për ta munduar veten me pyetje të tillë dhe, veç kësaj, ajo ishte, para së gjithash, një grua, dhe për gjëra të tilla le të mendonin të tjerët, të tjerët, të tjerët... Makina e drejtoret e priste përjashta. Në qytet, në udhëkryqe, nëpër qoshe rrugësh dukeshin kudo roje me helmeta, me automatikë në duar. Kur ajo arriti në pallatin e nënmbretit, pritja kishte filluar prej kohësh. Nuk i durohej sa të shikonte perandorin. Thuhej se pas atentatit ai kishte thënë: «Unë kujtoja se shqiptarët ishin shenjues më të mirë. Por harruat që ai nuk ishte shqiptar, madhëri, i ishin përgjigjur. Ah, po, ai ishte çifut, në mos gabohem? Po, madhëri, çifut rus, agjent i Kominternit. Ata e përsëritnin të gjithë këtë frazë si për ta ngulur mirë në kokë. Ndjenja e parë që provoi Miriami kur e pa në pritje perandorin, ishte një ndjenjë keqar-

dhjeje. Ajo kokë, që dukej e madhe, si e një fëmije rakinik, ndoshta për shkak të qafës tepër të hollë dhe të trupit të shkurtër, sytë e zbërdhulur si të një plaku fusharak nuk mund të zgjonin veçse një ndjenjë të tillë. Përbri tij ndodhej vazhdimisht kryeministri kuisling, i zbetë, me krahun të lidhur me fasho, në qendër të vëmendjes. Atje, prapa asaj fashoje të bardhë borë, ishte piaga, ndoshta plumbi, vetë lavdia. Një burrë që vjen në darkën qeveritare me krahun të plagosur nga terroristët, pavarësisht nga shëmtimi i mundshëm, është i zgjedhuri im i zemrës, së paku gjatë kohës së darkës, kishte deklaruar Hamide hanëmja. Të gjithë e shikonin kryeministrin me adhurim, disa ndoshta me zili; një plagë e vogël dhe aq shumë aureolë, miqësi e mbrujtur me gjak etj., etj., në përgjithësi një investim me shumë leverdi, kishte thënë bankjeri Rrokaj. Pritja ishte elektrizuar. Llampadarët derdhnin që lart llamburitje paqeje, por shandanët në mure rishpérndanin një dyshim që dukej sikur e merrnin nga sytë e njerëzve: mos vallë atentati ishte organizuar nga fashistët për të hequr qafe mbretin? Fill pas krismave të revolverit rojet e mbretit kishin nxjerrë në çast kamat dhe ishin bërë gati të suleshin kundër kujtdo, qoftë edhe kundër dinjitarëve të lartë fashistë. Dukej sikur pikërisht për të mbetur këtë dyshim, në pritje bisedohej për gjëra të gëzueshme. Talleshin me parlamentin e vjetër, me mbretin e ikur Zog. Kur dëgjova se ai kishte ikur, unë nuk u habita aspak, thoshte ambasadori spanjoll. Një mbret me emër shpendi duhet ta ketë në natyrë ikjen. Damat përreth tij qeshnin. E gjithë pritja ishte një buzëqeshje e vazhdueshme që synonte të zhvillohej vende-vende gjer në qeshje. Askush nuk fliste gjëra të tmerrshme, dhe kjo vërtetonte se darkëtarët nuk mendonin veçse tmerre. A është e mundur që edhe ai të ketë rënë në këtë marrëveshje? tha ajo me vete për Adrian Gumën. Dhe e gjeti më në fund midis një kleriku të lartë jezuit dhe ambasadorit portugez. Pra, ju mendoni se gjuhët vdesin më parë se popujt? thoshte ambasadori. Ah, Adrian, mendoi ajo, gjithmonë besnik i vvetvetes, gjithmonë diçka duhet të vdesë në bisedat e tij. Unë do të

thosha të kundërtën, vazhdonte portugezi. Janë pikërisht popujt që treten, duke lënë mbi dhé, pas zhdukjes së tyre, gjuhën, ashtu si qeniet prehistorike, që pasi u vdes e u kalbet trupi, u mbetet pas karroca e luspave qindvjeçare. Përkundrazi, thoshte Adriani, mendoj se është karroca me luspa, pra gjuha, që vdes dhe zëvendësohet herë pas here mbi trupin e njëjtë të popullit. Oh, jo, thoshte portugezi, të marrim për shembull latinët, ata janë zhdukur, kurse latinishtja ka mbetur. Pïkërisht ky shembull tregon të kundërtën, thoshte Adriani, është i njëjti popull që ka fatur më parë latinishten dhe tanë flet italishten. Bile do të thosha se kjo vlen edhe për rendet shoqërore. Apo jo, atë i shenjtë? Ju keni hyrë në një rrëth vicioz, tha jezuiti, në kohën që drejt tyre, duke tërhequr lehtë njérën këmbë, mbështjellë me zhgunin e Urdhrit të franceskanëve, po vinte... jo, kjo kishte ndodhur në pritjen e Eda Musolini... kur ajo kishte parë të vinte drejt tyre Gjergj Fishta. Ai ishte fytyrërrumbullakët, i shëndoshë, dhe Adriani nuk e donte. Ai vështronte llullën me atë mënyrën e vet, thuase atje, si në një urnë, të ishte hiri i gjuhëve apo i popujve të zhdukur. Pas disa muajsh në funeralin madhështor të Fishtës ata ishin prapë bashkë dhe, tek ecnin në vargun e gjatë të varrimtarëve, ai i kishte thënë dy-tri herë te veshi: Nuk arrij dot të kuptoj, si një shkrimtar nën mesataren si Fishta të shpallet poeti më i madh i kombit. Ajo e kishte vështruar me një lloj qortimi, sikur t'i thoshte se nuk i shkonte të fliste kështu, sidomos atij dhe aq më pak në një ditë të tillë. O, ty të shkon mendja rë ato përrallat për zilinë letrare, qeshi ai hidhur. Më beso, Miriam (ai e thërriste shumë rrallë në emër), veç këtij funerali unë atij nuk i kam zili asgjë, asgjë.

Përse, vallë, më kujtohet vetëm ai, tha me vete Miriam. Përse vetëm ai, përsëriti, duke u mbështjellë edhe më fort me pelice. Në fund të fundit, ai nuk ka qenë i-vetmi në jetën time dhe, aq më pak, unë në jetën e tij. Ku jam kështu? gati sa nuk thirri ajo. Për ca çaste vetja ju duk si në një kllapi, midis asaj ndërtese të akullt të mbushur me gërnjë fantazmash, me fragmente të kollurash dhe me një delir gjermani që e përshkonte egërsisht

gjithçka. Ndoshta sepse ai është i vdekur, mendoi pas pak. I vdekur si kjo ndërtesë akull, me antenat të prera, që i varen anash. I vdekur dhe i rëndë, tha ajo me vete. Prej ditësh, qysh se kishte dëgjuar pér vetëvrasjen e tij, përpiquej ta ngrinte nga vdekja, ta zvariste atë si hamall, dhe kjo bëhej gjithmonë e më vështirë, sepse ai, si çdo kufomë sa më shumë ftohëj, aq më i rëndë bëhej.

Kështu e kishte tërhequr atë natë me vështirësi nga pritja e madhe mbretërore. Dolën bashkë dhe filluan të zbritnin më këmbë nëpër rrugën me blire. Kodrinat e Tiranës, gunga të mëdha plot mister, shtriheshin valë-valë nën një dritë të holluar hëne. Ata ecnin të përqafuar (krahu i tij rrinte i mpirë mi shpatullat e saj), dhe ai tha pér Viktor Emanuelin: Ai nuk do ta harrojë kurrë që në këtë qytet e qëlluan. Harroje atë, i tha ajo, ne tani jemi bashkë, e ndien aromën e blirit? Ajo e kuptoi dhe vetë se tha një gjë banale dhe kafshoi buzët nga sikleti, por ai, me sa duket, nuk e kishte dëgjuar. Nuk mundem, tha ai. Larg qyteti shkëndijonte me mijëra dritëza të vogla, disa prej të cilave dukej sikur do të shndërroheshin në zjarre e disa sikur do të shuheshin. Nuk mundem, përsëriti ai. Dhe pas pak shtoi: Tani atje, në një nga ato dritëza, atë po e marrin në pyetje, ndoshta pér të dhejtën herë. Ajo deshi të thoshte prapë «harroje», por nuk pati guxim. Qyteti që kishte brenda atentatorin, xixëllinte në këmbët e tyre. Atje midis dritëzave ishte njeriu që kishte qëlluar perandorin. Ata ekzistonin në një kohë me të dhe brenda një hapësire më diametër jo më shumë se dhjetë kilometra. Asaj i erdhi turp nga vetja, por vetëm pér një çast. Vera që kishte pirë dhe atmosfera ngazëlluese e pritjes, e kishin molisur krejt. Ai njeri mua më ka ndryshuar sonte përmasat e mia, tha ai, duke treguar me dorë nga qyteti. Ajo filloi të mos e kuptonte dot. Ai hënëzim vjeçshtë sipër kodrash ishte i padurueshëm. Brenda një nate unë kam degraduar më shumë se gjatë mijëra vjetësh degradimi të krokodilit në zhapi, tha ai. Ajo deshi t'i thoshte: unë të dua edhe kështu siç je, «i degraduar», por nuk guxoi. Dora e tij vazhdonte të rrinte e mpirë mbi supet e saj, e rëndë, e vdekur qysh më parë. Me këtë

dorë ai ka shkruar veprat e tij, mendoi ajo dhe kujtoi përkëdheljet e atyre gishtave në trupin e saj. Nuk e kupton që ai na ka bërë sonte atentat të gjithëve? pothuajse thirri ai. Plumbin e tij unë e ndiej, ja mu këtu, dhe tre-goi me dorë brinjën, në anën e majtë, pranë zemrës.

Ndoshta pikërisht atje e ka qëlluar veten, mendoi ajo. Në çastin kur mori vesh vdekjen e tij, midis përfytyrimeve të shkurtra, shumica të çmendura, që iu dyndën me një çrregullim të plotë, ajo kaloi përpëra syve pothuajse krejt trupin e tij, duke u përpjekur të merrte vesh se në ç'vend ishte qëlluar. Ishte e sigurt se plaga ishte në njérën nga brinjët. Lajmin ia dha Kristinë Dakli të nesërmen e vdekjes së tij. E kishte lexuar diku në ca mure dhe shpejtoi tek ajo, për t'u lehtësuar pak. Ato ishin rivatele të vjetra, por që të dyja bënin sikur nuk dinin gjë për njëra-tjetren. Kristinë Dakli thoshte se e vriste ndërgjegjja, oh, sa e vriste ndërgjegjja. Miriam, oh Miriam, ai e ka vrarë veten dhe unë... unë... jam shkaktarja. Dhe ajo, me sy të rrëmbushur pëershkroi takimin e tyre të fundit në hotelin «Kontinental», grindjen e tyre, ndarjen dhe atë fjalën «maskara», e fundit fjalë që ajo i tha tek po përplaste derën dhe që tani i rëndonte si plumb në zemër. Desha të kthehesha, t'i kërkoja ndjesë për atë fjalë dhe për gjithçka, të pajtoheshim. Si nuk e bëra vallë, përsë, përsë. As vetë s'e di përsë. Ai bulevardi «Musolini» kishte një pamje ogurzezë dhe më kapi, tek po ecja, një tmerr i ftohtë. Ah, sikur të kthehesha, ai tani do të ishte gjallë. Ajo qau prapë një copë herë, dhe Miriami e vështronë si e murosur. Në zemër ndiente një shtrëngim të keq, ndërsa tjetra filloj të fliste përsëri midis gulçimave, të thoshte se sa e tmerrshme ishte për të që në vitet e ardhshme, ndoshta... në shekuj do t'i rëndonte ky krim mbi emrin e saj. Ajo tundte kokën me dëshpërim, kurse Miriamit iu duk se në brendësi ajo triumfonte: Në historinë e letërsisë nxënësit nëpër shkolla do të mësonin se ai shkrimtar i madh e vran veten për Kristinë Daklin, gruan e bukur dhe misterioze që, për fat të keq, nuk ia fali plotësisht zemrën e saj. Ai shtrëngim në zemër Miriamit po i shndërrohej në një therje. A është e mundur që

ai ta ketë dashur vërtet këtë budallaqe, tha me vete. Dhe, duke bërë një sforcim mbinjerëzor pér ta bërë zérin sa më të dhemshur, ajo tha: Po ti, Kristinë, mos e mundo veten kështu. Ndoshta ai nuk e ka vrarë veten pér... ty. Në sytë e Kristinës vetëtinë dy dritëza të vogla, të bardha. Ishte një egërsi që buroi papritur nga thellësia e kafkës dhe që ajo ia ndaloi vërshimin vetëm disa milimetra pranë retinës së syve. Nuk ma heq dot këtë kurorë... Megjithatë, duke mbledhur veten, ajo i tha Miriamit: Sa e mirë je ti, Miriam. Ti do që të më lehtësosh, po q'ë do, kjo këtu (dhe dy gishta të saj, me atë manikyr të urrejtshëm në thonj, treguan gjoksin), kjo këtu nuk qetësohet kollaj. Shtrigë, kishte thënë me vete Miriami.

E ka dashur, vallë? mendoi ajo, duke u përpjekur të sillte ndër mend lëvizjen e lehtë, pak si me të kërcyer të trupit të saj të gjatë, mbi takat që ajo i mbante pérherë tepér të larta. Miriami nuk e kishte kuptuar asnjëherë se q'gjë të veçantë gjenin burrat në ecjen e Kristinë Daklit (notim nëpër erë e quanin, shkundje hiresh e të tjera budallallëqe si këto), kurse pér të ajo ecje nuk ishte veçse një pérhedhje avdalle e një gruaje me këllqe dhe ndjeshmëri të zhvilluar jashtë mase. Në të vërtetë grindja e saj e fundit me Adrian Gumën kishte ndodhur pér shkak të Kristinës. Ai ia kishte mohuar që kishte marrëdhënie me të dhe, kur Miriami, e tërbuar nga inati, i kishte thirrur: ti më gënjen, më gënjen, ai i qe përgjigjur me cinizëm: E çë, në qoftë se të gënjej. Ti gënjen tri herë ditën një popull të tërë, a e ke menduar këtë? Ajo kishte qarë gjithë atë mbasdite dhe në mëngjes, me sy të fryrë akoma, kishte shkuar te drejtori pér të dhënë dorëheqjen. Ah, i kishte thënë ai, domethënë ajo historia e vaporit që po mbytet dhe e minjve, e tjera e tjera. Drejtori i kishte sytë të kuq nga piça dhe netët pa gjumë dhe përpiquej që të mbërrhente me to, si me gozhdë, sytë e saj. Tani që gjithçka po përmbyset, ju po më braktisni, kishte thirrur ai, po me mua s'luhet kollaj. Ai vështronte herë-herë diku në anën e majtë të tryezës dhe ngadalë, pér të mos rënë në sy, edhe ajo vështroi atje. U rrëqeth e gjitha. Ishte një buton i vogël, një buton i vogël zileje elek-

trike dhe ajo e kuptoi se tingulli i saj lidhej me helmeta të mëdha, me fjalë gjermanisht dhe trena dhe kampe përqëndrimi larg në mjegullat e Evropës Qëndrore. Ahere ajo u përpoq ta merrte me të mirë. Qau, iu lut, i tha fjalë përkëdhelëse duke vënë atë në rolin e martirit që sakrifikohej pér të gjithë, kurse ajo, ç'ishte ajo, një grua mendjelehtë dhe pa shumë fat. Zëri i tij, i ngjitur nga pija, ishte i përqarë. Roli i martirit pér çështjen e përgjithshme ishte më i preferuari i tij. Së paku, aq sa kam mundur, e kam bërë, tha. Kam shpëtuar ç'kam mundur. Së paku, ky Radiostacion flet akoma shqip. Ah, ia bëri ajo me vete, por atij nuk i tha asgjë nga ato që mendonte pér të mos e acaruar. Natyrishit, i tha, të gjithë e dinë se ju keni bërë gjithçka pér të shpëtuar atë që mund të shpëtohej. Gjithë këto furtuna, ah, sa e tmerrshme është të qëndrosh në gjithë këto furtuna. Kjo ishte një frazë e thënë prej atij vetë një vit e ca më parë në pritjen e parë të madhe të gjermanëve. Në atë pritje Adrian Guma nuk ishte, dhe ajo kishte qëndruar pothuajse gjithë kohën me drejtoren e saj. Pritja kishte një madhështi të ftohtë gotike. Ishte prapë po ai klan të ftuarish, me po atë nëntekst në sy: Ja ku u mblohdhëm prapë si zogjtë e klockës. Mirëmbërëmani. Mirmbrëma, zonjë. Dukej sikur kjo gosti e kishte fillimin e saj që dy mijë vjet, që nga pritja e konsullit romak Paulus Emilius, ku mysafirët talleshin me mbretëreshën e mundur Teuta dhe me mbretin e mundur Gent. Dy mijë vjet që ata vinin në të njëjtën gasti, herë me tunika të lashta, herë me mburoja e me toga mesjetare, pastaj me çallma e me ferekhe, me gjeste romake, bizantine, normande, turke, austriake. Dhe gjithmonë talleshin me pararendësit. Tani, në këtë valpurgji gotike talleshin me Viktor Emanuelin, me shkurtësinë e tij, me sëpatat e liktorit (në fillim, kur i pashë, thoshte bnakjeri Rrokaj, m'u duk vetja si në një dyqan kasapësh). Oficerët gjermanë qeshnin në një mënyrë të veçantë, duke tendosur qafat, sikur donin që e qeshura të dilte sa më drejt nga trupat e tyre, si një predhë. Hamide hanëmja ishte atje, me një buzëqeshje të lodhur. Flokët e saj kishin atë mbrëmje një nuancë kashte edhe më të çelët. Të

gjithë e kishin kuptuar që ajo ishte bërë edhe më bionde për shkak të gjermanëve. Flokët e Hamide hanëmes, ja, ç'do, të shpallja unë flamur të vërtet të Shqipërisë, kishte thënë gysmë i pirë bankjeri Rrokaj. Midis të ftuarve ajo kishte parë katër regjentët që lëviznin ngadalë midis sallave si një pamje apokaliptike. (Katër regjentë, kishte thënë një natë Adrian Guma, s'ka gjë më të frikshme se të shikosh ata katër cerekmbretër tek ecnin së bashku, njëri me një sy mbreti, tjetri me një vesh mbreti, i treti më ca gishta, apo qime, apo... ha, ha...) Ajo i ndiqte me sy dhe gati sa nuk zuri gojën me dorë për të mos lëshuar një britmë. Njëri prej tyre, me një zhgun bojë-kafe françeskanësh dhe me litarin në mes, i kalli datën. Kush është ky, pyeti ajo drejtoren. Nuk e njeh? i tha ai. Patër Anton Harapi, prifti i famshëm. Përbri bëhej një bisedë për racën shqiptare. Fyhreri ynë, ndoshta jeni në dijeni, e ka vënë racën shqiptare midis racave të zgjedhura, i thoshte një oficer i ri gjerman me ftyrë krejt të lëmuar një grupi bajraktarësh të Veriut. Njashtu, bre, ia bënин ata, na bahet qejfi, për zotin. I thoni oficerit, i drejtoheshin ata përkthyeses, se ne e çmojmë, veç të tjerash, Hitlerin, se ai është burrë kanuni. Përkthyesja vuajti një copë herë për të përkthyer shprehjen *burrë kannuni* (dukej sikur shpjegimi nuk ngjiste mbi xhamllëkun e lëmuar të ftyrës së gjermanit), gjersa ajo, me sa duket, e perifrazoi atë aq shumë, saqë i humbi kuptimin. Midis të ftuarve Miriami pa redaktorin e porsaardhur gjerman të radios. Quhej redaktor, por të gjithë e dinin se ai ishte i plotfuqishëm i gestapos. Kishte po atë rrezëllimë të ftohtë buzëqeshjeje, që i dukej si e montuar mbi ftyrë me anë të kornizave tepër të holla ngjyrë argjendi të syzeve të tij. Ai ishte shfaqur tri javë më parë në Radiostacion dhe gjithë personeli ishte mbledhur në sallën e madhe për t'u njojur me të. Zotërinj, kishte thënë ai, duke drejtuar nga ata atë akullsirë kornizash argjendi. Drejtori rrinte përbri tij, në krah të djathë, me sy të skuqur nga pagjumësia. Asaj iu kujtua se para disa vjetësh, fill pas ikjes së Zogut dhe ardhjes së italikanëve, tek e njëjta tryezë, mbi të njëjtën kadife ngjyrë-

vishnje, kishte folur nëndrejtori i porsaemëruar italian. Përbri tij, ashtu si tani, rrinte drejtori. Zotërinj... Dita ishte me shi e brerimë. Shiu godiste xhamet e të gjitha kateve dhe lart në tarracë ulërinte era. Era veriore mbi mbretërinë e përbmysur, kishte thënë Adrian Guma. Ata takoheshin ahore çdo mbasdite në shtëpinë e tij, në një dhomë që i kishte dritaret nga veriu... i ish-mbretërisë. Në atë dhomë e kishin kaluar pjesën më të madhe të ditës së gjashtë prillit të njëmijenëntëqindetridhjetenëntës. Ishte një ditë e gjatë, pa realitet. Një boshllék i madh varej kudo. Njerëzit, si të marrët, rrrotullonin butonat e radiove pér të marrë vesh diçka, por prej tyre nuk dëgjohej gjë tjetër, veçse një muzikë e marrë. Gjithçka po e humbte peshën me shpejtësi, pejsazhet po shndërrohen në dekore të harruara nga një shfaqje e vjetër, bile dhe retë lart në qiell dukej sikur do t'i palosnin e do t'i futnin nëpër valixhe. Thuhej se mbreti po ikte. Një natë më parë, kur u fol pér ultimatumin e Musoliniit, ai deklaroi se do të mbathtë opingat e do të dilte në male. Miriami kishte pritur t'i lexonte lajmet e mesditës dhe, meqenëse lajmet vononin (dukej sikur lajme nuk do të kishte më), ajo kishte ikur nga Radiostacioni pa lajmëruar njeri. Në rrugë kishte copëra demostratash. Përpara kangjellave të pallatit mbretëror grumbuj njerëzish thërritnin «armë». Te pallati i princeshave grilat ishin të mbyllura. Mbreti ka ikur, i tha dikush që kalonte përbri. Ajo nuk e ktheu kokën. Dita ishte si një qenie e ftohtë, pa gjak, megjithatë ajo ndjeu frikë dhe shpejtoi hapat. Ë? i tha ai, porsa ajo hyri. Ç'lajme ka? Ajo ngriti supet. Thuhet se mbreti ka ikur. Atij nuk i bëri ndonjë përshtypje. Vështronte pjerrtazi herë llullën, herë atë që po zhvishej dhe, kur ajo e pyeti «ç'mendohesh», u përgjigj: Po mendoj se ku e kam vendin unë në një ditë të tillë. Ku e ke vendin ti? tha ajo, duke buzëqeshur që sipër mollzave. Ja këtu e ke vendin, dhe vuri dorën mbi gjoksin e saj të zhveshur e u shtri pranë tij. Më vonë ai i kishte thënë se në ditë të pasigurta kthesash të historisë si kjo, atij i pëlqente t'i kalonte pranë ndonjë gruaje dhe ndoshta kjo ishte një gjë e neveritshme, por ja që ai

kështu ishte mbrujtur. Nga dritarja hynte ndriçimi i vaktët, i fundit i një dite-kufomë. Që nga pozicioni i shtrirë në krevat dukeshin mansandrat e shtëpive dhe pullazet mbi bulevardin «Musolini», një copë qìll, në mesin e të cilit dukej sikur porsa kishte ndodhur një katastrofë, ca zogj. Ai ndezi llullën, vështroi një copë herë andej dhe tha: Ja, më në fund ky vend s'është më mbretëri. Ajo ndiqte me sy fluturimin e zogjve mbi pullaze dhe, e lodhur, pyeti: Po ç'është ahtere? Ç'është? përsëriti ai, i befasuar nga pyetja. Hm, thjesht Shqipëri, ja ç'është. Një copë herë vështruani të dy atë pamje, pastaj ai tha: Tokë, shumica djerrinë dhe ndonjë shqiponjë e rrallë që vërtitet sipër, si etiketë, sa për t'i dhënë emrin këtij vendi. Ajo deshi t'i thoshte se kjo, sidoqoftë, ishte pak cinike, por nuk donte të shkaktonte grindje. Sa herë që në darkat qeveritare të mëvonshme ishte zënë në gojë prejardhja e emrit «Shqipëri» (dukej sikur gjithë ardhësit e huaj e ndienin për detyrë të shtjellonin këtë motiv qysh në pritjen e tyre të parë), asaj i kujtoheshin fjalët e tij. Ishte e natyrshme që gjermanët, ashtu si edhe të tjerët, të interesoheshin për atë temë, Albanien? Ach so! ia bënin ata duke tendosur qafat e bardha, dhe ajo për të njëzetën herë kishte pyetur veten: Përse ai nuk kishte ardhur? Zhguni bojëkafe, i lidhur me litarin karakteristik, i Patér Anton Harapit, i dukej sikur e ndiqte nga sella në sallë dhe asaj nuk i durohej sa të vinte e nesërmja, që ta pyeste, qoftë edhe në telefon: Përse nuk erdhe mbrëmë në pritje? Nuk ishte e mundur që të mos e kishin ftuar. Të gjithë ishin në tryezat, vetëm ai mungonte. Të nesërmen dita ishte e zymtë dhe e lagur. Strehët kallonin ujë. Në xhamet e sallonit të katit të katërt, ku asaj i pëlqente herë pas here të çlodhej, e ulur vetëm në kolltukët masivë, kishte kalvare të pafund ujërash, tutje nxinin retë dhe ndonjë vetëtimë e ngathët mezi zvaritej midis tyre. C'mërzi, tha ajo dy-tri herë me vete. Tekstet e lajmeve atë ditë ishin ogurzeza. Bëhej fjalë për një fushë të pafund, për transhe dhe hendeqe dhe për një grup armatash që herë përparonin, herë prapseshin ngadalë tutjetëhu. E gjithë kjo ndodhë mbi baltë dhe nën shi. Pastaj

një deklaratë e trubullt e Hitlerit për fazat e ardhshme të luftës. Në mbrëmje ajo kishte takim me Adrianin. Dytri herë bëri gabime të lehta gjatë leximit, duke i shkuar mendja se ai e dëgjonte. E dinte se, sa më të tmerrshme të ishin lajmet, aq më shumë ai e dëshëronte. Kur doli në rrugë, qiejt kullonin. Bulevardi «Musolini» ishte i shkretë. Përse nuk ishe mbrëmë në pritje?, e bëri ajo, më në fund, pyetjen e dëshiruar. Ai vështonte llullën dhe dukej që e kishte vështirë të përgjigjej. Të dëgjova kur lexove, i tha ai, dukeshe e lodhur. E mora më mend që më dëgjoje, tha ajo. Buzët i kishte të ftohta, gishtat nervozë si asnijëherë. Ti më pyet përsë nuk erdha në pritje, tha ai. Zëri i tij ishte i humbur, një zë që kurrsesi s'mund të thoshte diçka të qartë. Dhe vërtet shpjegimi që dha ai ishte i trubullt, ca paranteza të gjata, ca hyrje që nuk të çonin asgjékund, historia e zakonshme se diçka duhet bërë, se më mirë vonë se kurrë, se, sidoqoftë, para së gjithash, ai, si shkrimitar... si shkrimitar... si shkrimitar... oh, e gjithë kjo ishte e mërzitshme, e dëgjuar sa e sa herë nëpër sallonet mondane, fati i vendit, i popullit, të lëmë mënjanë grindjet e partive, interesat e kombit mbi gjithçka, në këtë skëterrë... në këtë skëterrë... Ajo shikonte profilin e tij të pambrojtur dhe befas ndjeu keqardhje për të. Ishte një nga ato keqardhjet e padurueshme kur të duket sikur ke nevojë të ulërish për t'u çliruar prej saj. Ky njeri është i mbaruar, tha ajo. Krejtësisht.

Ai qysh ahene ishte i vdekur, mendoi ajo, me të vëmin ndryshim se nuk e kishte akoma plagën në brinjë. Por kjo nuk ishte veçse një çështje forme. Kryesorja ishte vendosur prej kohësh. Asnjë Kristinë Dakle, asnjë Hamide hanëm, asnjë unë, asgjë tjetër s'mund të kishte lidhje me mbarimin e tij. Ishte diçka më e pandryshme, diçka që kishte lidhje me terrin e kësaj nate, me këtë ndërtesë pa ngrohje, të mbushur me këto gjermëre pa mbarim, më këtë kollë të vjetër dhe me këtë klapi gjermanisht që përshkonte gjithçka si një elektrodiagramë.

I vdekur, tha ajo me vete për të katërtën herë. Radio-stacioni gjithashtu ishte i vdekur. E vdekur muzika e bo-

tës, në disqe të vendosura vertikalisht. Të vdekura lajmet. Në skeda të veçanta kronikat mundane, informacionet e parlamentit, komentet politike, mësimi i dancit, gjithçka kishte rënë ne gjumin e fundit. Dhe e gjithë kjo ndërtesë nuk ishte veçse një morg i madh. Nesër, pas nesër, ata do t'i hidhnin nga dritaret disqet, arkivat, shirrat e incizuar dhe, në vend të tyre, do të vinin zhurma të tjera, lajme, muzikë dhe fjalë të reja.

Miriami u drodh. Si do të ishin vallë këto zhurma? Ajo sepse i përfytyronte trubull si ca gjëmime të ftohta nën një horizont gjysmë mavi, gjysmë të përgjakur. Unë jam një njeri i mbaruar, tha ajo me vete dhe tërroqi cepat e shallit. Si ai. Nga xhamet e thyera era e ftohtë përshkonte korridoret me një hungrimë të përvajshme. Ajo mendoi se s'kishte gjë më të pamëshirshme se një erë dimri që fryn përmes xhamesh të thyera. Dukej sikur tërë ato presa xhami, të mbetur si xixa në kornizat e kanateve, era i merrte më vete dhe të therte, të therte gjer në koskë.

Po gdhinte. Ajo donte të shkonte në banjë dhe lëvizi në fillim njérën këmbë që i ishte mpirë, pastaj tjetrën. Doli në korridorin e gjatë dhe eci ngadalë drejt fundit të tij, duke qëndruar herë pas here në vend, në mënyrë që t'i thërritnin «ndal», në qoftë se kishin për t'i thirrur. Në kthesën e korridorit, përpara xhamllékut të madh që përcudi kishte mbetur i paprekur dhe që po zbardhë tanë frikshëm midis errësirës, si një copë tokë ku dikush po bën prova përmblidjen e ndriçimit të ditës, ajo dalloi në këmbë dy silueta të gjata. Ato bisedonin me zë të ulët. Kur u afrua dhe pak, ajo dalloi tytën e armës mbi supin e njërit dhe e kuptoi që ishin roje partizane. Nga të dyja anët e korridorit era kuiste si një qenie me turi përtokë dhe ajo nuk i dëgjonte as fjalët e tyre dhe as hapat e saj. Vetëm kur kaloi përbri, veshi i kapi zërin e njërit (që përcudi iu duk si zë i njobur) që po i thoshte shokut: «Nuk e besoja që do të rrinin kaq të heshtur. Tamam si kuaj të vjedhur».

Javeri qeshi mbyturazi.

— Si the? Si the? — ia bëri ai. — Po rrinë si kuaj të vjedhur?

— Po, — tha Sherifi, — kështu thonë në anët tonë kur njerëzit rrinë sus dhe në terr.

Pas patrullimit të fundit ata kishin fjetur dy-tri orë dhe ndaj të gdhirë po bënин roje në katin e katërt.

Rojet nuk mjaftonin dhe ata kishin lënë mitralozin e rëndë dhe antitankun lart në tarracë, për të plotësuar numrin e tyre.

— Ç'ishte kjo damë që kaloi? — pyeti Javeri.

— M'u duk si spikerja kryesore, — tha Sherifi, — njëfarë Merjeme apo Miriana, s'iа mbaj mend mirë emrin.

— Ti e solle?

Sherifi bëri «po» me kokë.

— Lidhe ndonjë ti? — pyeti ai pas pak.

— Ohu, — tha Javeri, — nja katër a pesë.

— Pizevengët, — ia bëri Sherifi. — Ke duhan?

Ata filluan të dridhnin cigare dhe Javeri herë pas here tundte kokën, sikur përkundte një të qeshur mu përpara turinje.

— Kuaj të vjedhur, — murmuriti ai, — s'kam dëgjuar ndonjëherë shprehje më të saktë.

Sherifi tërë qejf po lagte me buzë fletën e cigares. Kur Javeri bëhej i mirë, Sherifit i dukej sikur do t'i çahet zemra nga dashuria për të. Mirëpo Javeri ishte tip allosoj. Dukej sikur, porsa e pikaste këtë dashuri, shpejtontë t'i fuste një shqelm, sikur ajo ta besdiste. Mbasherë pas here Sherifi. Mërziten shpejt edhe nga e mira, edhe nga e keqja.

— Shyqyr që pushoi ai gjermanni, — tha Javeri.

Dera e banjës në fund të korridorit kërciti dhe gruaja që ishte futur pak më parë atje, doli. Ata panë mollzat e saj të gjera të ravijëzoheshin në gjysmerrësirë, pastaj shpina e saj, me jakën e peliqes të ngritur, u zhduk në fund të korridorit.

— Ja, kjo femër kushedi ç'ka folur kundër nesh, —

tha Javeri. — Me siguri éshtë ajo që donte të vriste Metë:
Aliu kur i ra me revolver radios.

— Jo, — tha Sherifi, — ajo éshtë tjetër.

— Ashtu?

— Edhe atë unë e solla. Thonë se éshtë nga ato të...

— Brrr... sa ftohtë, — tha Javeri.

Era e akullt rënkonte aty-këtu nëpër korridore. Një derë e hapur përgjysmë përplasej herë pas here diku nga fundi.

— Vdiqa për gjumë, — tha Javeri duke gogësitur.

— Dremit pak, — tha Sherifi. — Ja, mbështetu te muri dhe dremit.

Javeri u ul në bisht me pushkën midis gjunjëve dhe mbështeti kokën te tyta e saj.

— Kuajt e vjedhur rrinë të qetë, — tha si nëpër èndërr.

Sherifi, pa ditur pse, psherëtiu.

Po gdhinte. Kishte diçka kërcënuese në ndriçimin e dobët, ngjyrë balte argjiloze të ditës. Në këmbët e tij Sherifi ndjeu prapë një fëshfërimë tinzare. Ai nguli sytë në dysheme dhe në gjysmëterr dalloi ca fletë të bardha që era i zvarrise ngadalë sa andej këndeja. Ç'të jenë këto? tha ai me vete. U përkul dhe, duke mbajtur me njérën dorë pushkën, me tjetrën ngriti njérën prej tyre. Ishte një fletë e daktilografuar pastër. Ai e afroi te xhamllëku dhe lexoi ngadalë: «Romë. 19 tetor. Sot Benito Musolini, prijësi i madh i popullit italian, priti delegacionin parlamentar shqiptar që ka ardhur në Romë...»

Lajm i vjetër, tha ai me vete dhe e lëshoi fletën. Ajo u lëkund si në një djep të padukshëm dhe, kur iu afrua dyshemësë, rrëshqiti anash. Ai ngriti një fletë tjetër dhe lajmi ishte akoma më i vjetër, i kohës së mbretërisë. Ahere, i habitur, ai vuri re se korridori ishte plot me fletë të tillë. Tani që po zbardhite dita, ato dallohen në kudo mbi pllakat e ftohta, nën ciflat e xhameve të thyera. Gjatë natës dikush, duke kërkuar, me sa duket, diçka, kishte hapur ndonjë dollap të arkivës dhe fletët e rrëmbyera nga era kishin fluturuar nëpër korridor. Disa prej

tyre, të rënduara me njolla balte nga të shkelurit më këmbë, sipër tyre, nuk lëviznin, por shumica fëshférin në herë-herë duke rrëshqitur si të verbëta sa djathtas majtas, sa herë që era përshkonte korridorin e gjatë.

Gjuha e nepërkës, mendoi Sherifi. Ja, kjo ishte gjuha e nepërkës, që kishte thënë komisari i vrarë dhe e kishte përsëritur komandanti i ri. Kuiste përvajshëm nën çizmet e tij të rënda, plot baltë. Gjuha e prerë e shtetit të vjetër.

Sherifit i vinte gjumë. Lart në tarracë ishte mitralozi i tij i rëndë, i lagur nga nata. Aty punonin tanë teknikët përrregullimin e antenave. Do të çmontonin shpirtin e shtrigës dhe do të vinin në vend të saj një shpirt të ri.

Korridori i gjatë, plot erë, cifa qelqesh dhe kufoma lajmesh, rënkonte vajtueshëm. Sherifit i dukej sikur po e humbte peshén. Këngët e tij kishin ngecur diku poshtë, midis një mal i xhamesh dhe lajmesh të thyera, që rrezëllinin dobët atje larg, larg dhe midis tyre ishin xhadera dhe fshatra të mardhura nga dimri, dhe një daulle dasme, dhe Naim Frashëri me poemat e tij, dhe ranishtja e detit, e lagur frikshëm, sipër së cilës dukeshin gjurmë kalorësish të vjetër, ndoshta të Skënderbeut, dhe prapë fshatra memecë me nganjë hënë sipër, që shtriheshin larg, gjer pranë qyteteve plot demonstrata në nëntorin e vitit 1941, dhe zëri bubullues i Enver Hoxhës, dhe prapë dheu i mardhur me erë dimri që ia bënte vu, vu, vu, sikur të thoshte vuv, o vuv, dhe ca hekura të gjatë, që thoshin se ishin puse vajguri, por që, me siguri, ishin gjilpëra të thella të ngulura tokës për t'i nxjerrë zërin, dhe ai pusi në fshat që e gërmonte në djerrinë usta Vllasi, dhe njerëzit të mbledhur përreth me llulla në gojë dhe dyshime: do të delte vallë ujë? Do t'i vinte vallë zëri tokës? S'ka ujë këtu, jo, thoshin pleqtë dhe tundnin kokat kaq shumë, sa dukej se do t'u përplaseshin si këmborë. Dum — dum-dum, koka pleqsh në mbrëmje. S'ngjitet ujët këtu. Duhet thellë. Një mijë metra thellë. Zëri s'vjen. S'ka zë. Një mijë vjet thellë. Dy mijë vjet. Dhe, më në fund, dikush thirri: Ujë, ujë, ujët po del. Ka zë! Ka zë!

Zëri po vinte nga thellësitë, i frikshëm, i ngjirur, sikur e thërriste Sherif... Sher...if... Sh...er...if...

Sherifi u drodh dhe shkundi supet. Kishte dremitur në këmbë.

Në dritën e mëngjesit ai pa Javerin që po flinte me kokën të mbështetur te tyta e pushkës. Poshtë gjunjëve të tij letrat e vjetra të lajmeve të dikurshme cijatnin pikëllueshëm.

KAPITULLI I SHTATË

Në një kënd të tarracës Teuta po thante në diell flokët e porsalarë. Ishte një diell i kursyer, që binte copëra-copëra si një xham i thyer, mbi qytet. Pas qepallave ajo ndiente ndriçimin e tij, që, duke kapërcyer përmes lëkurës, si përmes një filtri, humbte rrezet dhe bardhësinë dhe kthehej në një det të kuq gjaku. Ishte një det i ngrirë, pa valë, me një përgjumje të madhe që shtjellej rrathë-rrathë brenda tij si qindra vorbulla zjarri.

— Teuta, — dëgjoi ajo një zë, që dukej sikur vinte nga bregu i një bote tjeter.

Hapi sytë përgjysmë. Valët e detit të kuq u tërhoqën me shpejtësi, duke lënë pas vetes reliefin e zbetë të një bote me ngjyra të përkora, por reale.

— Çfarë? — ia bëri ajo me zë të dobët.

— Teuta, — thirri për herë të dytë zëri i Javerit. — Ne do të dalim në qytet, a do të vish?

— Më pritni pak, — tha ajo, — sa të më thahen flokët.

Në tarracë rrinin në këmbë Javeri dhe Sherifi. Më tutje Mete Aliu, ulur te parapeti me automatik në krahë, po vështronte teknikët që punonin tek antenat. Aty pranë mitralozi i rëndë i Sherifit dukej sikur flinte nën mushamanë e lagur nga shiu i natës.

— E, — ia bëri Mete Aliu, — sa do të presim akoma?

Ai shikonte Teutën që po krihte flokët me një krëhër që dreqi e di se ku e kishte gjetur, dhe tundte kokën

sikur të shihte diçka të pakuptueshme. Më tutje një partizan me fytyrën tërë prenka po rrezitej në diell.

— Ç'ke që murmurit? — i tha Javeri. — Ajo është vajzë dhe duhet të jetë e bukur.

— Ajo është partizane dhe jo llasticë, — tha i vrenjtar Mete Aliu.

— Ajo është vajzë partizane, — tha Javeri.

— Ajo është para së gjithash partizane, — hungroi Mete Aliu.

Javeri qeshi, duke çmpirë krahët. Larg mbi pullazet dhe kupolat e qytetit ngriheshin ngadalë shtëllunga mje-gullash, që nën rrezet e pakta të diellit herë kaltëronin, herë argjendoheshin.

— Shiko, sa bukur! — tha Javeri. — Kurse ti...

— Çfarë? — ia bëri Mete Aliu.

— Asgjë, — tha Javeri.

Teuta vazhdonte të krihte flokët. Me njérën dorë ajo i mbante, kurse me tjetrën kalonte krehrin mbi to, butësisht, me një lëvizje të panjohur gjer ahere për ta, të huaj dhe gjithsesi të largët. Nga bishtat e syve të saj lëshohej pjerrtazi mbi majat e flokëve të gjatë një dritë indiferente, gati enigmatike, ndërsa dora vazhdonte të merrej vesh me dallgëzimin e flokëve, ta zbuste e ta shtronte atë.

— Teuta.

Këtë herë ishte Sherifi që thërriste. Zëri i tij ishte pak nervoz dhe ai e mbante kokën të kthyer andej me një shprehje mundimi dhe frike, shpërndarë mbi mollzat e tij.

Teuta ktheu kokën. Ajo maskë magjie u tret mbi ftyrën e saj si e përpirë nga poret, dhe ajo qeshi me atë të qeshurën e saj tingullore, plot reflekse.

— Ja, erdha, — tha dhe u ngrit.

Kishin një orë që ata të katër shëtitnin. Rrugët e Tiranës ishin plot me njerëz. Ishin hequr prej tyre ku-fomat, që dukej sikur kishin qenë pengesa e fundit, e

cila kishte kufizuar vërshimin e të gjallëve në to, dhe tani gjithçka ishte maramendëse dhe e zhurmshme. Ndanë drurëve të zhveshur ose të shkallmuar nga predhat, përbri grilave të hekurta të vitrinave, të bëra vrima-vrima, kalonin grumbuj partizanësh gazmorë me uniforma dhe çizme të reja, gjithfarë turmash laramane, midis të cilave herë pas here shfaqeshin çeta guerrilierësh me flamurë dhe me këngë. Disa prej tyre dukej sikur vërtiteshin kot nëpër qytet dhe, kur ata takuan për të tretën herë një çetë të tillë, Mete Aliu i pyeti tërë inat:

— Po ju ku veni?

Kuptohej menjéherë që vërtiteshin kot, sepse tre të parët, që kryesonin kolonën dhe që u drejtoi pyetjen Mete Aliu, u trubulluan. Ata ngadalësuan hapin, kthyen kokën nga njëri-tjetri dhe ahore, ai që ishte në mes, një djalë i shkurtër, i shëndoshë, që mbante flamurin, thirri, flakë i kuq në fytyrë.

— Ku të na thërresë Rev-Revolucioni.

Atij i mbahej pak goja dhe ca nga kjo, ca nga zemërimi iu frysni damarët e tëmthave dhe buzët iu shkumbëzuan anëve.

— Ngadalë, ngadalë, — tha Mete Aliu, — se nuk të kemi ndonjë borxh.

— J-jo, po ta di-dish, — tha djaloshi dhe ktheu kokin përpëra, duke vazhduar këngën.

Par-aroja, pararoja

Ju, borgjezët e fëlliqur, ja, ku vjen, ja, ku po vjen...

Teuta qeshi me zë.

Në sheshin «Skënderbej» njerëzit buisnin nga të pesë rrugët që dilnin në qendër. Njerëzit ndiqnin me sy nxjerrjen e trupave të djegur të gjermanëve prej fortinove, vështronin me kureshtje zinxhirët e tankeve që dikush i kishte çmontuar dhe tërhequr mënjanë, kushedi pse, gjatë natës dhe mbeturinat e barrikadave në të dy udhëkryqet veriore. Majë një shtyllë të lartë ca njerëz po mowntonin, siç duket, një altoparlant.

— Teknikët e radios, — tha Teuta, — ja ai hundë-madhi majë shtyllës.

Ajo ia plasi gazit. Ata ngriten kokat dhe panë vërtet një nga teknikët, që kishte punuar gjithë ditën e djesh-me në tarracën e Radiostacionit.

Gjysmëtanku ishte akoma atje, i anuar në një krah dhe përreth tij vërtitej një turmë kureshtarësh. Sherifit iu duk se kishte kaluar një shekull që kurse ai ishte gjallë dhe villte zhurmë e vdekje. Atje në fshat... dy muaj pas vdekjes së Tosun agait, qe hapur fjala se ai ishte ngritur lugat. Gjithë fshati kishte rënë në të zeza. Ia kishin dje-gur varrin me vajgur, kishin thirrur tre hoxhë për t'i bërë duva që të kthehej prapë atje, por ai s'kthehej që s'kthehej. Mynxyra më e madhe ishte kur u hap fjala se lugati bënte dashuri me një nuse të re që e kishte burrin në kurbet. Nusja tretej e ligej çdo ditë. Sytë i qenë zver-dhur dhe barku i dhembte për kiamet. Upupu, thoshin plakat, sevda lugati kjo, të zverdh e të tret si qiri. Dhe, sikur të mos mjaftonte sevdaja e lugatit, na edhe barra nga lugati. Disa donin të thoshin se nusja s'ishte me barrë, se kishte një tumor, por s'i besonte kush. E hoqën nusen nga fshati, e shpunë në teqenë e Beunit, në tyrbën e Kumakut dhe, më në fund, në shpellën Hajal (ku, siç e tregonte edhe emri, çdo njeri, kur flinte, shikonte èndrra të mira), mirëpo lugati s'i ndahej që s'i ndahej, gjersa ajo vdiq. Ahere gjithë nuset e fshatit i zuri tmerri: kujt do t'i qepej lugati? Por në atë kohë plasi lufta dhe Tosun agai, i trembur, siç duket, nga zhurmat e saj, u platin nën dhe, duke pritur një kohë më të qetë për të dalë.

Sherifi përkulte kokën për të kuptuar se si kishin pasur mundësi ta sharronin tankun. Atje në fshat... Tosun agai ishte kthyer në ulok pas një sëmundjeje të gjatë dhe mjekët e kishin shkurtuar pak nga pak gjysmën e tharë të trupit të tij për të shpëtuar gjysmën tjetër. Kurse ky tank...

— Ej, ku po veni ju, — dëgjuan ata një zë të njohur.

Ishte Stefan Papa, i skuadrës së tretë. Dukej që kishte ecur me shpejtësi, sepse ishte skuqur në ftyrë dhe

ishte ndoshta i vetmi njeri në sheshin «Skënderbej», që kishte djersë në ballë, në këtë ditë të ftohtë.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti Javeri.

— Çfarë ka ndodhur? — përsëriti ai, pa vështruar askënd. Dukej i shpërqëndruar dhe fryma i merrej akoma. — Ku janë zyrat, — pyeti, — dini gjë ku janë zyrat?

— Ç'zyra? — ia bëri Mete Aliu. — Ç'na duhen zyrat? Ne kemi marrë liridalje. Eja, të bredhim.

Stefan Papa vështroi dy-tri herë anash, fshiu ballin me mëngën e kapotës dhe tha shpejt e shpejt.

— Po ndahan postet, s'keni marrë gjë vesh ju?

— Ç'pose? — ia bëri Sherifi.

Stefani kafshoi lehtë buzën e poshtme.

— Ju s'dini gjë, — tha ai hutueshëm, — kot që ju pyes.

— Shoku partizan, më falni, — tha një njeri që kishte ndalur përbri tyre, — dëgjova se po flitnit për zyrat, në mos gaboj. Ka një orë e ca që edhe unë po kërkoj zyrat.

Sherifi e vështroi me sy dyshimtarë. Njeriu ishte flokëverdhë, me pantallona me kuadrate dhe me xhaketë të ngushtë në supet. Gjithçka tek ai njeri ishte e rrëgjuar dhe fino ke, me përjashtim të mollës së Adamit, që e kishte tepër të madhe dhe që i jepte qafës së tij një farë peshe.

— Kam një orë e ca që i kërkoi, — përsëriti i panjohuri. — S'merret vesh se ç'po ndodh. Zyrat i bëjnë korridore dhe korridoret i kthejnë në zyra. Po kjo është e shpjegueshme, — shtoi ai, — është urrejtja për botën e vjetër, që i shtyn të lëvizin çdo gjë.

— Po ti me ç'qëllim i thua këto? — iu kthyte befas Mete Aliu. — Ç'je ti?

Tjetri i buzëqeshi Mete Aliut fare pranë fytyrës, saqë ky e tërroqi kokën pas me përcëmimi.

— Unë jam një njeri objektiv, — i tha i panjohuri. — Jam kronisti i një gazete.

— Ndonjë nga ato fletushkat borgjeze? — tha Javeri me gjakftohtësi.

Tjetri rrudhi ballin me një farë hareje.

— Ti qenke vetë botë e vjetër, — tha Mete Aliu.

— Pikërisht, — u përgjigj kronisti. — Jam ashtu, siç e thatë ju, botë e vjetër.

— Mirë që e pranon vetë, — tha Mete Aliu.

— Megjithatë s'kam qenë kolaboracionist, — tha tjetri. — Gazeta jonë s'u ka shërbyer gjermanëve.

— Hm, — ia bëri Javeri.

— Në shtabin tuaj këtë gjë e dinë me siguri, — vazhdoi kronisti. — Ndryshe ne nuk do të guxonim të kërkonim sot leje për të nxjerrë prapë gazetën tonë.

Mete Aliu tundi kokën me mosbesim.

— Unë kam një orë që kërkoi ta gjej për t'i marrë një intervistë komandanit partizan që komandoi luftën për çlirimin e kryeqytetit. Thonë se është i rreptë, por besoj se do të më pranojë. Ja, pyetjet i kam këtu, — vazhdoi të fliste ai me vrull, duke nxjerrë nga xhepi një defter bojëqielli. — Pyetja e parë: «Në kufijtë e këtij qyteti janë shfaqur gjatë shekuarve pashallarë, baronë, imamë rebelë, gjeneralë. Të gjithë ata e kanë pushtuar ose e kanë çluar atë nga të tjerë pashallarë, baronë, imamë rebelë apo gjeneralë. Ju s'jeni as pasha, as baron, as imam rebel, as gjeneral...»

— Ti kujton se do të durojë ai që ti të përrallisësh një orë për imamët e dhespotët e dreqin me të birin, — tha Mete Aliu, që kishte filluar ta zbaviste kronisti.

— Pritni, pritni, — e ndërpree gazetari duke shfletuar defterin me nervozizëm. — Pyetja ime është kjo: Pra, ju s'jeni as pasha e tjera pra... ja, e gjeta: ç'nditet ju atë mëngjes, pa gdhirë mirë, kur filluat sulmin mbi kryeqytetin e parë të Evropës, që po çlirohej prej murtajës naziste, nga partizanët e vet?

— Këtë s'e paske keq, — tha Mete Aliu nëpër dhëmbë.

Kronistikit iu çapëlye ftyra nga një buzëqeshje që dukej sikur ishte më e madhe se përmasat e asaj ftyre të imtë.

— Dëgjo më tutje, — tha ai. — Pyetja e dytë: Ju zoti komendant, keni luftuar në Spanjë. Ç'mendoni ju për ndryshimin e luftës midis, midis, pritni, — tha kronisti, — më falni, u ngatërrrova pak. Nejse, vazhdojmë

më tutje. Pyetja e tretë: Flitet se shkrimtari i njohur Adrian Guma, përpara se të vriste veten, pati me ju një bashkëbisedim dramatik. A mund të na thoni me dy fjalë shkakun, sipas jush, të fundit tragjik të Adrian Gumës?

— Hm, — ia bëri Mete Aliu, që iu duk se tanishte i detyruar të jepte një farë mendimi për të gjitha ato që thoshte kronisti.

— Dhe pyetja e fundit, — vazhdoi reporteri, — a mendoni se në Tiranën që ju e çliruat do t'ju ngrenë në të ardhmen një monument?

— Këtu e prishe, — tha Mete Aliu. — Po ia bëre këtë pyetje, të siguroj unë që do të të nxjerrë përjashta me shqelma.

Teuta që ia kishte ngulur sytë prej kohësh kronistit, ia shkrepi të qeshurit, ngaqë e përfytyroi, siç duket, se si do të nxirrej ai përjashta me shqelma nga zyra e komandantit.

Edhe Javeri me Sherifin qeshën. Vetëm Stefan Papa dukej sikur e kishte vëmendjen diku, sipër kokave të tyre. Herë-herë ai shikonte me mllaf reporterin që u kishte tërhequr atyre vëmendjen dhe, në rastin e parë që gjeti një boshllék midis bisedës së tij, tha sikur të fliste në gjumë.

— Coçol Zverku u bë drejtor i postë-telegrafave. Ai s'ka postuar kurrë një letër në jetën e tij, pa le pastaj telegramin apo telefonin, që s'i ka parë as në ëndërr.

Mete Aliu e vështronte sikur Stefani të fliste një gjuhë të pakuptueshme. Nga qëndrimi në vend e skuqura po i ikte, duke ia lënë vendin një të bardhe të panatyrshme, që bashkë me djersën që po i ftohej, e bënte fytyrën e tij të largët. Befas ai u kthyte e iku me hapa të çartallosur.

— Prit, — i thirri kronisti, — po vij me ty, — dhe i ra pas.

Stefani nuk e ktheu kokën, por qafa e tij dukej sikur thoshtë: «C'mu qepe?» Megjithatë kronisti e ndoqi pas.

Përballë tyre po vinte një njëshkolonë e zhurmshme me kazma në krahë. Ata këndonin:

*Në pallatet madhështore
Dridhet korbi gjakatar.*

— Ku veni? — u thirrën ca zëra nga trotuari.

— Të kërkojmë florinjtë e pasanikëve kolaboracionistë, — u përgjigj njëri nga njëshkolona, duke tundur një fletë të zhübrosur, ku ishin shënuar, me sa duket, adresat e të pasurve.

— Fiu, fiu, — fishkëlleu dikush nga trotuari. — Shikoni kérkuesit e florinjeve, shikoni Çarli Çaplinët.

— Do të vijë radha e shtëpisë sate, o këlysh bushtre, — thirrën nga njëshkolona.

— Në shtëpinë time ka një m..., — u përgjigj tjetri.

Një copë herë njëshkolonasit dhe ngacmuesit nga trotuari u përshanë gëzueshëm.

Një xhips me oficerë ndaloi mu në mës të sheshit. Një kokë me beretë të zezë u zgjat përjashta dhe pyeti diçka në një gjuhë të huaj.

— Oficerë englezë, — tha Javeri.

Xhipsi vazhdoi rrugën, duke i rënë borisë çdo katër-pesë sekonda.

— Shkojmë të shkojmë si gjenden florinjtë, — tha Sherifi.

Ata u nisën pas njëshkolonës. Gjatë rrugës njëshkolonës i bëheshin të njëjtat pyetje nga kureshtarët.

— Ej, Mete Aliu, — u dëgjua një zë i ngjirur.

Mete Aliu ktheu kokën me vrull. Nga trotuari tjetër dikush po ia bënte me dorë. Ishte një fytyrë tepër e njohur, por që diçka e largonte nga kujtesa e tij. Njeriu mbante për dore një djalë të vogël shtatë ose tetë vjeç.

— Xhemal? — tha Mete Aliu, ndërsa tjetri po afrohej — Xhemal Struga, ç'paske pësuar kështu?

Sytë e tjetrit kaluan rrëshqitazi mbi mëngën bosh të kapotës së Mete Aliut, pastaj dora e tij preku flokët e vet të përzhitur.

— U përzhitja dje, — tha partizani. — Bashkë me dy shokë hodhëm në erë varrin e mbretëreshës plakë.

— Ah, dje, e dëgjuam shpërthimin. Ti e paske bërë?

Ky éshtë një shoku im i vjetër, — u tha Mete Aliu të tjerëve. — Xhemal Struga nga batalioni i parë.

Ai vështronte me gëzim mollzat e nxira të tjetrit, që dukej sikur kishin të stampuar përsipër një buzëqeshje të bërë shkrumb e hi.

Teuta vuri dorën në gojë, siç duket, për të gjelltitur me zor të qeshurën.

— S'i lënke mbretërit rehat as në varre, — tha Mete Aliu. — Po ky, ç'është? I biri?

— Po, — tha Xhemal Struga. — I biri.

Djali, i dobët, me ca këmbë të gjata, që i dilnin nga pantallonat e shkurtra si kërcinj lejleku, rrinte pothuajse i ngjitur pas t'et, duke vështruar habitshëm përreth.

— Ku veni kështu? — pyeti Xhemal Struga.

— Duam të shohim si gjenden florinjtë, — tha Shrifia.

— Unë kam pak punë në shtab se do të vija, — tha Xhemal Struga dhe u nda me ta.

— C'partizan i mrekullueshëm që ishte, — tha Mete Aliu. — Po c'e do, éshtë bërë si oxhakfshirësit.

Teuta ia plasi më në fund gazit.

— C'i duhet atij të merret me varret e plakave, qoftë dhe mbretëresha, — grindej më vete Mete Aliu.

— Duhet të shpejtojmë se njëshkolona po na ikën nga sytë, — tha Javeri.

Ata nxituan hapat.

Njëshkolona ktheu nëpër Rrugën Mbretërore dhe u ndal përparrë një porte të hekurt. Tri-katër duar trokitën përnjëherësh. Në trotuarin përballë po mblidheshin plot sehirxhinj.

Kur ata u afroan, i zoti i shtëpisë kishte hapur portën dhe po mundohej t'u shpjegonte diçka. Nga dritatët fytyra të ngrira grash (ato, më tepër se fytyra, dukeshin si ornamente të stilit barrok) vështronin poshtë.

— S'kam florinj të fshehur, — thoshte pasaniku, — zotérinj, shokë, s'dua të mburr veten, por unë s'kam qenë ndonjë bez apo fajdexhi, unë kam qenë industrialist, parët e mia i kam në llogarinë rrjedhëse bankare. Ja, shikoni fletoren e çequeve: Llogaria rrjedhëse numër tre mijë

e treqind e dyzet e një, fraksion njëzet e shtatë A. Shikojeni.

I gjatë, me flokë të thinjur dhe kostum të bukur, ai nxirrte nga xhepat shkresa pas shkresash dhe i hapte para syve të tyre.

— Ja dhe përqindja e fitimeve, ja dhe...

— S'ka nevojë të na i tregosh, — ia preu një nga vullnetarët. — Ne nuk marrim vesh nga ato shkresurina djallëzore. Florintjtë e tu i gjen kjo babaxhania këtu, — dhe ai i ra me pëllëmbën e dorës bishtit të kazmës. — O burra, djema, gérmoni ku të mundni.

Vullnetarët, që me sa dukej nuk u durohej sa të fillonin batërdinë, u sulën brenda. Ai mbeti në këmbë, hapi njëherë krahët, vështroi grumbullin e njerëzve të mbledhur në rrugë dhe, kur dëgjoi goditjen e parë të kazmës diku brenda shtëpisë, erdh e u bë baltë në fytyrë.

— Po t'i gjejnë vërtet florinj, do ta pushkatojnë, — tha Javeri.

— Do ta pushkatojnë edhe pa i gjetur florintjtë, — tha dikush. — Ai ka qenë kolaboracionist.

Goditjet e kazmave gjëmonin në katër a pesë vende përnjëherësh. Gérmonin në kopsht, në mure, nën parketin luksoz.

Njeriu i gjatë u fut njëherë brenda, pastaj doli jashtë përséri. Tani ai ishte bërë aq i verdhë në fytyrë, saqë dukej sikur floriri që vullnetarët po e kërkonin kudo, po i ngjitej ngadalë nga thellësitë e qenies së tij mbi lëkurë.

— Ou, sa do të rrimë këtu? — tha Teuta me një zë ankues, — ndoshta ata vonojnë sa t'i gjejnë, ose ndoshta nuk i gjejnë dot fare.

— Ke të drejtë, — tha Mete Aliu. — C'na duhet të mbërthehem pas një surrat borgjezi.

Ata filluan të largoheshin në kohën që përpara kan-gjellave të shtëpisë sa vente po rrитеj grumbulli i të riardhurve. Të gjithë pyetnin: C'po ndodh këtu?

Pasi u endën një copë herë nëpër Rrugën Mbretërore, ata të katër u gjendën prapë në sheshin «Skënder-

bej». Rreth fortinove të shkatërruara dhe gjysmëtankut si gjithmonë kishte shumë njerëz. Te nulla e orës së qytetit kishin hipur ca njerëz, që, më sa duket, po përpinqeshin ta rregullonin. Fusha e saj nxinte në tri-katër vende nga të çarat e shkaktuara prej predhave. Akrepi i vogël ishte thyer. Poshtë, në këmbët e kullës, ca partizanë lebër këndonin, të mbledhur kokë më kokë.

*Nga sevdaja jote
Unë vrava xhaxhanë.*

Sherifi vështroi me bisht të syrit Javerin, por fytyra e këtij të fundit ishte e qetë. Sherifit iu kujtua ai aeroplani i çuditshëm që dukej e zhdukej përmes reve thinjake, duke hedhur fletushka me emrin e Javerit. Ej, ti atje, ti i aeroplanit, e thërriste, kur kishte ndonjë punë, Dino Sinojmeri. Sherifi ndjeu një si rroposje në gjoks. Kështu, në formë grope, i vinte herë pas here malli për komandantin e vdekur.

Partizanët vazhdonin të këndonin. Ata rrinin më këmbë, duke krijuar një rreth, brenda të cilët anonin kokat, si për të ngjizur atë brumë zjarri, pëshpëritnin, i fryrin, përkuleshin, si për të derdhur në të një pjesë të vetvetes dhe pastaj, kur brumi merrte flakë, ata tërhiqnin vrullshëm kokat pas, sikur të ruheshin që të mos përzhiteshin nga ajo që porsa kishin krijuar vetë.

*Hapi sytë e zes,
Të na sjellç beharë.*

— Eh, ç'bukuri, — tha Mete Aliu. — Megjithëse në anët tona s'këndoja kështu, kjo këngë më nxori mallin e tyre.

— Edhe mua, — tha Sherifi.

— Në anët tuaja këndoja edhe më bukur, — tha Mete Aliu.

Sherifit iu ngrit në kujtesë grumbulli i madh i gërmadhave gri të fshatit të tij nën shiun e akullt të dhjetorit. Mendimi se në rrebeshet e mëdha ato që pësojnë

më pak janë fjalët dhe këngët e njerëzve, e përshkoi të gjithin. Kishin një berber plak në fshat, që thoshte gjithnjë: Dëgjomëni mua, vdesin qytete dhe fshatra, shkatërrohen trupat e burrave e të grave, vetëm fjalët e njeriut s'pësojnë gjë. Shumë-shumë thyhen pak në bishta apo në sqepe (ai sepse i përfytyronte fjalët si zogj që ikin nga gërmadha në gërmadhë, nga koha në kohë), po helbete, rrebeshe të mëdha këto, diçka do të thyejnë dreqi ta marrë.

Vallë e kamë marrë vesh pleqtë që unë dogja shtëpinë me duart e mia? pyeti veten, ndoshta për të njëmijtën herë, Sherifi.

— Ç'ke? — i tha Javeri. — Pse re në të thella?

Sherifi s'dinte ç'të thoshte.

— Shët, — ia bëri papritur Teuta, — vini veshin.

— Çfarë?

— Vërtet, ç'është kjo?

Ata kthyen kokat në njërin drejtim të sheshit, pastaj me po atë vrull u kthyen në drejtimin tjetër. Një hungrimë e egër, një gërritje e rëndë bishe u dëgjua dy-tri herë diku lart në horizontin e sheshit.

Mete Aliu vuri dorën si hinkë te veshi. Edhe njerëzit e tjerë në shesh kthenin kokat sa në një anë në tjetren. Gërvima e shurdhër, jo njerëzore, u përsërit.

— Altoparlanti, — ia bëri papritur Teuta. — Radioja jonë.

Ata kthyen kokat nga shtylla, sipër së cilës ishte mbërthyer altoparlanti dhe po pritnin gojëhapur se ç'do të ndodhte. Frymëmarrja e rëndë me përmasa të frikshme u dëgjua prapë tejembanë sheshit.

Po përpinqet të ngjallet, mendoi Sherifi dhe iu përhijen kompresat e lagura mbi fytyrën e vdekur të Memecit dhe anët e buzëve të tij, të kyçura që në gjallje. Vdekjes, që i kishte dërguar heshtjen e saj qyshkur mbi atë gojë, nuk i kishte mbetur të bënte ndonjë ndryshim të madh tanë që kishte ardhur vetë.

— A thua do të flasë, — tha më zë të lartë Teuta, duke hedhur me një lëvizje flokët pas shpine, si për të dëgjuar më mirë.

— Do tē flasë se s'bën, — tha Mete Aliu.

— Sa qejf — ia bëri Teuta.

Altoparlanti lëshoi dhe një herë një si grahmë tē hekurt, pastaj heshti.

Te fasada e një ndërtese përbri dy djem tē rinj po ngjitnin një afishe tē madhe.

— Soirée e madhe partizane në hotel «Dajti», — lexoi Mete Aliu. — Ç'është kjo soirée?

— Suaré, — tha Javeri, — i thonë frëngjisht mbrëmjes së vallëzimit.

— Ja, këto s'më pëlqeijnë mua, — tha Mete Aliu.

— Pa le pastaj, filluan edhe me frëngjishtera.

— E pse s'të pëlqeka ty, shok, — iu kthye një partizan që po ecte përbri me pajime në krahë. Ishte një partizan i shkurtër me kokën tē rruar krejt dhe me ca sy si xixa. — Mbaruan hallet, vëlla, erdhi liria. Ç'do tē bëjmë, po nuk vallëzuam, do tē rrimë me turi varur?

Mete Aliu as që ktheu kokën t'i përgjigjej. Ai ishte zbehur pak në fytyrë?

— Ç'ke? — i tha Sherifi pas pak.

— Më dhemb krahu, — tha Mete Aliu.

— Mos duhet ndërruar plaga? — tha Teuta.

— Mbështet.

— Ej, shokë, e dini gjë ku ka ndonjë spital apo ambulancë këtu afér? — pyeti Javeri një grup partizanësh.

Ata treguan me dorë në drejtimin e Rrugës Mbretërore.

Ndërsa po shkonin andej, u takuan ballë për ballë me njëshkolonë e florikërkuesve. Të djersitur, të llangosur me baltë, me fytyra tē shkrehura nga kënaqësia dhe lodhja, ata po vinin drejt qendrës duke kënduar. Tre të parët mbanin në duar qypa tē vegjël.

— Qypa me florinj, qypa me florinj, — thërritnin ca kureshtarë që e ndiqnin anash karvanin.

— I paskan gjetur, — tha Javeri. — Të them tē drejtën, nuk e besoja.

Në fund tē njëshkolonës, me duar tē lidhura përparrë me një litar tē trashë, kokulur, pothuajse pa fytyrë (në vend tē saj kishte një boshllék tē madh, një gërryerje tē

vjetër, tashmë të ndryshkur, thuase edhe ajo porsa ishte nxjerrë nga toka, ashtu si qypat), po vinte i zoti i florinje. Në faqen e tij të djathtë shkëlqente një lëng gjysmë i tharë. Ishte pështyma e dikujt.

— Ku po i çoni qypat? — pyeti dikush që nga tro-tuari.

— Në Bankën e Shtetit, — u përgjigjen dy-tre nga njëshkolonasit.

Ata po drejtosheshin vërtet nga ndërtesa e Bankës, përpara basoreliefeve dhe kolonave të marta prej mermeri të së cilës bënин roje partizanë me helmeta. Poshtë, në shkallinat e saj, përpara portave të zeza prej hekuri dhe gjatë gjithë trotuarit rrinin në këmbë, shëtitnin ose këndonin partizanët e batalionit të katërt që çlroi Bankën. Kur njëshkolona e gjetësve të florinje, me qypat që i mbanin në duar me kujdes, gati me frikë, sikur të ishin idole, iu afroan portës kryesore, partizanët u mblo-dhën në një grumbull të madh rrëth tyre. Ata zgjatnin kokat për të parë florinjtë, për pushtimin e kështjellës të së cilëve ishin vrarë njëzet e një partizanë. Një si qeshje e verdhë, e përbaltur anëve, sikur të delte nga varri zverdhëte mbi qypat. Gjer ahore ata i kishin parë florinjtë apo imitacionet e tyre vetëm nëpër dasma, mbi ballët e nuseve të porsamartuara që kërcenin valle, dhe monedhat hidheshin, tringëllinin, të bukura, transparente, më tepër muzikë se metal; sipër syve, sipër qepallave, thuase dhe ata vetë ishin pjesë e ftyrave të nuseve. Kurse ky flori, mbi këto urna, kishte një peshë vdekjeje, saqë ata heshtën padashur, kur njerëzit me qypa në duar po ngjittin ngadalë shkallët. Dhe vetëm kur qypat u zhdukën prapa kanateve të zeza të portës metalike, njerëzve iu erdhi goja. Aty në këmbë, te shkallinat e Bankës, në ditën e ftohtë, të ndriçuar në mënyrë të pabarabartë prej diellit, po vazhdonte të lindte Legjenda e Thesarit Shtetëror. Partizanët që kishin marrë pjesë drejt për së drejti në pushtimin e Bankës, u tregonin shokëve të tyre se si kishin depërtuar nëpër labirintet e saj, gjersa kishin arri-tur më në fund në zemrën e saj, poshtë në bodrumet e thella, atje ku ishte një sfinks betoni me katër këmbë,

një si bunker, brenda të cilit ishin ndryrë florinjtë dhe diamantet e shtetit. Katër rojet që duhej të ruanin ditë e natë thesar, kishin rënë të vrarë, kushedi se nga kush, mu përpala shpellës.

— Si, si? — pyetnin dëgjuesit dhe partizanët përsëritnin copëra të tregimit, konstrukt i të cilit ishte i paqëndrueshëm si çdo konstrukt që pasqyrohet mbi një ujë të dridhshëm. Nuk dukej mirë, thoshin ata, s'dëgjohej mirë, ishte gjysmëterr, ishte një shurdhim i madh.

Mjedisësit, ata që, pasi e dëgjonin tregimin, ua ritreronin të tjerëve, i ngjitnin atij tregimi, si pafta bronci, zbulurime arkaike, copëra nga përrallat e gjysheve, ankthe të temperaturave që kishin kaluar gjatë epidemive të gripit apo të tifos së zorrëve, shkëndijime të fantazisë së tyre prej leximeve të Kontit të Montekristos, Ishullit të thesarit apo Ekonomisë Politike. I veshur kështu si me luspa dragoi, që e mbronin nga faktet dhe numrat, i kuqëremtë e shndritës, tregimi po shndërrohej në legjendë. Dhe s'kishte si të ndodhë ndryshe, sepse ishte e natyrshme që për këtë thesar, një pjesë e të cilit ishte marrë natën e pesë prillit nga mbreti i ikur Zog, një pjesë nga italianët, në net të tjera të panjohura, kurse një pjesë ikte tanë drejt Evropës Qendrore e ndryrë në kushedi c'tanke, mbi shpinat e të cilëve binin, ndoshta, predha e bomba, pra për këtë thesar asnjë kontabilitet nuk mund të jepte informacion më të saktë, sesa legjenda.

Kur ata u kthyen nga ambulanca dhe po ecnin drejt Radiostacionit, në bulevardin «Musolini» çeta vullnetare të rinjsh po hiqnin kufomat e fundit, kryesisht ato që ishin rrëxosur nën kangjellat e rënda, të shkulura prej tankeve si dhe trupa të mbetur përgjysmë nën zinxhi-rët e tyre.

Ndërsa kalonin për të tretën herë asaj dite mes përmes sheshit «Skënderbej», ata dëgjuan prapë atë gérhitjen e njojur, të stërmadhe, jonjerëzore, që dukej si e ngjitur në perimetrin e qiellit mbi shesh.

— Krejt si një zog, — tha Sherifi, duke treguar me dorë altoparlantin, — është një lloj bufi në anët tonë... .

Por papritur hinka gri e altoparlantit foli me fjalë njeriu. «Një, dy, tre, katër. Prova teknike, prova teknike. Një, dy, tre, katër.»

— Foli, — klithi Teuta gjithë gëzim dhe përplasi duart. Radioja jonë.

Njerëzit që ndodheshin në shesh, kthenin të gjithë kokat nga shtylla ku ishte lidhur altoparlanti.

«Një, dy, tre, katër. Prova teknike. Një, dy, tre...»

— Vetëm kaq? — tha një partizan, me pamje të zhgënjyer, kur zëri i altoparlantit përsëriti për të dhjetën herë të njëjtën gjë. — Kësaj i thonë të flasësh katër e pesë, — shtoi ai dhe iku si i ndërkyer përmes sheshit.

— Tamam si një zog në anët tonë, — tha prapë Sherifi. — Rri majë pemëve dhe herë-herë lëshon papritur një gërvimë të tillë.

Ata priten se mos altoparlanti fillonte të fliste, por hinka e hekurt përsëriti për një kohë të gjatë po ato fjalë.

— Uf, — ia bëri Teuta, — pse po zgjatet kaq tepër? Mbështetje teknikët nuk e rregullojnë dot.

— Unë s'kam besim në asnjërin prej tyre, — tha Mete Aliu. — Sidomos janë ca që qelben brilantinë. Më vjen krrupë kur i shoh.

Teutës iu kujtua njëri prej tyre, ai Matishi, ai që mezi e kishin gjetur të mbyllur në atë dhomën, i cili, sa herë që e shihte tanë nëpër shkallët apo tarracën e Radiostacionit, e përpinte me ata sytë e tij të avullt, të ndriçuar përbrenda nga një paturpësi e singertë. Ndërsa përkulte kokën për ta përshëndetur, ai herë e thërriste atë «zonjushe», herë «shoqe», herë «shefe». Teuta ndiente një neveri të lehtë, megjithatë i vinte inat që s'i vinte përtë qeshur me të.

— Ndoshata nesër Radiostacioni do të fillojë, — tha Javeri. — Eshtë diçka me rëndësi kombëtare. Bile edhe më tepër, — shtoi pas pak. — Ka rëndësi ndërkombëtare.

Teuta seç lexoi në një mur dhe ia plasi gazit, duke mbuluar gojën me pëllëmbë.

— Mjaft, — i têrholi vëmendjen me zë tê ulët Mete Aliu, — s'bën tê qeshësh kështu në rrugë.

— Ua, po më qeshet, — tha Teuta.

— Ti je partizane, — tha Mete Aliu.

Me bisht tê syrit Teuta lexoi, siç duket, diçka tjetër dhe mezi e mbajti tê qeshurën. Pastaj, duke e zgjatur kokën te supi i Mete Aliut, i tha me përkëdheli:

— Tani nuk qesh më.

Mete Aliu ecte me pamje tê ngrysur. Kapota e tij jashtëzakonisht e gjatë i mbështillej nganjëherë përfund këmbëve, si një dolloma.

— Ja dhe ata pëllumbat, — tha ai, kur te qoshja e bulevardit «Musolini» u shfaqën Stefan Papa me atë kronistin. Fytyra e Stefan Papës kishte atë paqen e zakonshme që bie me vete çmërzitja. Ai mezi e fshihte gjëzimin. Kronisti, përkundrazi, dukej pikë e vrerë. Kafshonte gishtat tek ecte dhe, kur pa Mete Aliun, shpërvoli buzët.

— Më nxori jashtë, — tha. — Doli fjala jote.

— Ia bëre atë pyetjen?

Kronisti bëri «po» me kokë.

— Mirë ç'tu bë, — tha Mete Aliu.

— Ke tê drejtë. Mirë tê më bëhet, — tha reporteri. — Ja që s'më rri rehat kjo e shkretë, — dhe tregoi me gisht gojën.

— Mirë ç'tu bë, — përsëriti Mete Aliu, i nxehur. — A tê thashë unë?

Mete Aliu po nxehet gjithmonë e më tepër, por pamja e kronistit, ajo fytyrë e rreshkur si fik i tharë ishte kaq e dëshpëruar, saqë atij, ashtu siç i ndodhë shpesh, zemërimi iu kthyë në keqardhje.

— Mbështet se s'ke dhe shumë faj, — i tha me zë tê zbutur. — se, në fund tê fundit, borgjez je, megjithatë...

— Jam një zero, — tha reporteri. — Një nul, një...

— Më vjen mirë që dëshpërohesh, — tha Mete Aliu.

— Kjo tregon se s'je fare ashtu si thua.

— Jam, jam, — gulçoi reporteri.

— Mbështet në tê ardhmen do tê përmirësohet, — tha Mete Aliu, i prekur.

Befas, pa kthyer as kokën pér t'i pérshëndetur, reporteri iku tutje si i marrë.

— C'njeri! — tha Mete Aliu.

— Eh, sa probleme që do të ketë, — tha Stefan Papa më një ton gjithsesi të çuditshëm. — Duhet punuar seriozisht me njerëzit.

— Si? — ia bëri Mete Aliu, që s'e kishte mendjen në vend. — Po ti ç'bëre andej?

Stefan Papa bëri një lëvizje koke si pér të treguar se ajo që kishte ndodhur andej nga zyrat, kishte qenë diçka krejtësisht normale.

— Më emëruan nëndrejtor të kinemave, — tha. — Në të vërtetë unë u thashë se do të preferoja ndonjë punë të thjeshtë, por shokët ngulën këmbë. Ja, kështu. Tani do t'i përvishemi punës. Ohu, sa probleme do të dalin.

— Do të hapen kinematë? — ia bëri Teuta. — Sa qejf!

Stefan Papa tundi kokën me një pamje të merakosur.

— Kinema, — tha, — një fjalë goje, por...

— Ka probleme, — ia bëri Javeri, pa ngritur sytë.

Teuta vuri dorën te goja sikur të rraste brenda vetes të qeshurën që po i shpërthente përjashta.

Ata u ndanë me Stefanin dhe po ecnin drejt Radiostacionit. Te qoshja e rrugës dikush kishte hequr pllakën metalike me fjalët «Bulevardi Musolini» dhe atje, në vend të saj, kishte mbetur një katror bosh, i zbetë në krashtë me ngjyrën e murit të ndërtesës. Kur ata kaluan përbri, Javeri mbajti këmbët dhe diç kërkoi nëpër xhepa. Më në fund ai nxori nga xhepi një laps të trashë, qëndroi përpara atij katrori bosh dhe, duke e shtrënguar fort lapsin me gishtat e hollë, shkroi mbi mur me gërmë të mëdha: «BULEVARDI DINO SINOJMERI».

— Mirë e bëre, — tha Mete Aliu, — oh, sa mirë e bëre!

KAPITULLI I TETË

Po ajo mesditë.

Një vig, që dy infermierë partizanë po e kalonin mes për mes Sheshit të Pavarësisë, tërhiqte vëmendjen e të gjithëve. Njerëzit, që gjithë ato ditë kishin parë qindra të vdekur e të plagosur që përpëliteshin nga plagët mbi lloj-lloj vigesh, qerresh, apo thjesht rrëzë trotuareve, shqy-enin tani sytë tek shihnin atë vig të thjeshtë, të mbuluar me mushama. Kjo ndodhë sepse nga ai vig nuk kullonin në rrugë currila gjaku, gjë që do të ishte për të gjithë një pamje e zakonshme, por kullonte vaj. C'është ky, c'është kjo, pyetnin njerëzit, duke mos i hequr sytë nga gjurmët e vajit mbi asfalt dhe nga mushamaja që mbulonte të vdekurin, e cila gjithashtu dukej e pirë vendevende me njolla, si ato letrat e ambalazhit me të cilat mbështillen gjérat e lyrshme. Të térhequr nga e fshehta e të vrarit, prej plagëve të të cilit nuk rridhite gjak, njerëzit ecnin një copë herë përbri vigut, gjersa merrnin vesh të vërtetën. I vdekuri ishte një tregtar që qe mbetur atë mëngjes në depon e vajit të vet.

Ata që e shoqëronin vigun tregonin raste të tjera vëtrrasjesh të atyre ditëve dhe të gjitha ato ishin të shëmtuar ose tragjikomike.

Nëpër portat e mëdha me dru lisi trokitej vazhdimi. Kërkoheshin ish-ministrat kolaboracionistë, çifligarë të mëdhenj, regjentët dhe gjithfarë spiunësh. E gjithë kjo bëhej nën një marramendh dehës që shtohej nga

rënia e copëzuar e diellit, nga ca fasha të gjera drite, që dilnin papritur nga avlëmendet e reve dhe farfurinin mbi fasadën e kinema «Kosovës», ku gjyqi partizan kishte hapur seancën e parë.

Grumbuj kalimtarësh ndalonin përpara mureve ku ishin ngjitur shpallje të Qeverisë së Përkoħshme, të nënshkruara poshtë nga Kryeministri i porsazgħedhur Enver Hoxha.

Në rrugë kalonin qerre me të plagosur, armë dhe miell të sekuestruar. Përpara kafe «Kursalit» vërtiteshin murgesha të ikura nga kuvendet. Nëpér rrugën «Lord Bajron», ca guerrilierë po çonin të arrestuar në shtab një grua të shëndoshë, në qafën e bardhë të së cilës palët e dhjamit sajonin ca si varëse argjendi. Ishte fallxhorja e famshme Hançe Hajdija Pezë e Madhe, në shpinën e së cilës dikush kishte ngjitur me gjilpërë damën maço. Ajo ishte arrestuar, sepse në fallin e atij mëngjesi kishte thënë se kishte parë midis letrave të fallit përbysjen e revolucionit.

Ndërkag në të gjitha drejtimet qyteti përshkohej nga batalione dhe kolona partizanësh që ose zhvendoseshin, ose niseshin drejt periferisë veriore, e vëtmja që ishte akoma e pushtuar. Partizanët kishin fjetur nëpér kazemat ushtarake, në sallat e hotel «Dajtit», të shtruar me batanije drejt e mbi parket, nëpér gjimnaze, ministriira, xhamira, në sallat e pritjeve, bile edhe në sallën e frontit të pallatit të nënmbretit, megjithatë, megjithëse të gjitha këto ishin ndërtesa të mëdha, ato mund të nxiniv vetëm një pjesë të vogël të batalioneve. Shumica ndahe-shin për të fjetur nëpér shtepitë tiranase. Qindra qytetarë, sipas një organizmi që nuk kuptohej mirë se si drejtohej, paraqiteshin nëpér shtabet partizane për të kërkuar mysafirë.

Mëngjeseve bujtësit, bashkë me të zotët e shtëpive, dilnin grumbuj-grumbuj nëpér qytet, përcillnin ata që ni-

seshin pér nē luftë dhe, pasi vërtiteshin një copë herë andej-këndej, shkonin prapë nga shtabet pér të kërkuar mysafirë të rinj.

Të tjerë ndalonin pérpara kangjellave të kopshteve të pasanikëve dhe vështronin mendueshëm kopshtet e hështura. Thuhej se ato ditë nē to ishin groposur shumë florinj, testamente e perla. Gjithë ai xixëllim ishte futur nē dhe, ndërsa nga dheu, përkundrazi, nga bodrumet e shtëpive të vogla tiranase po nxirrnin aty-këtu makina shkrimi e shaptilografë që kishin punuar vite me radhë nē ilegalitet. Pranë një shaptilograpi të tillë gjysmë të çmon-tuar, pjesët e zeza të të cilit ndritnin nga vaji, një grua tiranase i thoshte një grumbulli kureshtarësh: Shtrak-shtruk, shtrak-shtruk, muaj të tërë, ditë e natë, atje nën dhe; nganjëherë thosha me vete: E ç'do të dalë nga kjo shtrak-shtruk, e ç'do të dalë nga ato pëshpëshe të djemve, atje poshtë nē bodrum? Kështu thosha me vete, e pse të gënjej, s'mi besohej se do të vinte kjo ditë.

Kur ata mbërritën nē Radiostacion, Javerit dhe Teutës u thanë se i kërkonte komandanti. Në të gjitha katet e ngrehinës së madhe vlonë puna. Një pjesë e personelit, pikërisht ata që një natë më parë e mbushnin me murmurima terrin e akullt të korridoreve, tani hipnin e zbritmin nē tarracë, vraponin shkallëve, hapnin dyer, thërritin njëri-tjetrin dhe të gjithë dukeshin të quditshëm, me ato kufje dhe tela që u vareshin nëpër veshët dhe që u tundeshin tek ecnin, si zbukurime të njerëzve primitivë. Teuta dy-tri herë ia plasi gazit mu pérpara fytyrave të tyre, gjersa Mete Aliu më nē fund i tha:

— Po mjaft, moj Teutë. Vërtet janë borgjezë, por, së paku, tani punojnë.

Në një sallon të madh të katit të parë një grumbull partizanësh ishin ulur nē kolktukë dhe ca pinin cigare, ca ishin mbledhur pranë një radioje të madhe, butonat e se cilës i lëvizte më kujdes njëri prej tyre.

Sherifi me Mete Aliun ndezën nga një cigare dhe qëndruan në këmbë përpara radios. Midis butonave fusha e radios dukej si e përflakur zbetë nga një ndriçim tepër i largët. Emrat e kryeqyteteve rrinin pezull sipër atij ndriçimi të përgjumshëm, dhe Sherifit iu duk për një çast se gjithë shtetet, republikat dhe mbretëritë e kësaj bote ishin shtruar, ja, në atë fushë të mardhur, pranë atij zjarri të përhumbur dhe herë pas here, sa po shenjëza e kuqe binte mbi to, ato zinin e flitnin përcart, ashtu si Mete Aliu tri net më parë. Disa e kishin zërin të fortë; disa të dobët, si të trembur, të tjerë heshtnin si gërmadha. Shenja e kuqe kaloi si kometë mbi emrin TIRANA, por nga kryeqyteti që gjer para njëzet e katër orësh ngrihej një zhurmë skëtëerre, atje në fushën e mardhur s'vinte gjë tjetër veçse një gërritje e dobët. Dukej sikur dikush po jepte shpirt, i rënë përblys midis fushës.

Partizani që lëvizte butonin po bëhej, siç duket, pak nervoz, sepse e folura e stacioneve u shpeshua aq, sa erdh një çast dhe Sherifit iu kujtua kroi i fshatit ku gratë më gjyme dhe kova në duar flitnin të gjitha përnjëheresh duke ndërprerë njëra-tjetrën. Ai është akoma atje, mendoi Sherifi, i vetmi dëshmitar që kishte parë atë kur i kishte vënë zjarrin shtëpisë së vet. Ndërsa batalioni ikte ahore nga fshati, Sherifi habitej me vete se si nuk e kishte menduar ndonjëherë më parë se një krua është shumë më jetëgjatë se qdo lloj ndërtese, dhe se krojet nuk vdesin kollaj, sado luftë e batërdi të bëhet mbi dhe. Ata u ngjanin në një farë mënyre fjalëve.

Në zyrën e ish-drejtorit të Radiostacionit ishte ngjitur me gozhëdë një karton ku ishte shkruar «Komandanti i Radiostacionit», ndërsa te dera e dhoniës përbri qe shkruar me shkumës «Këshilltari teknik». Në këtë të fundit ish-drejtori i Radiostacionit, akoma i befasuar nga emërimi i tij si këshilltar teknik, me zë të dobësuar nga një lloj mallëngjimi të përzier me gjësim, servilizëm dhe

ekstazë nënshtrimi, po bënte çmos për të vënë punën në vijë. Njerëzit e personelit të vjetër, të përshkuar, ashtu si ai, nga një dridhje shprese, e thërritnin tanë «zotni drejtor i vjetër», ndërsa e thërritnin komandantin «zotni drejtor i ri». Sa për partizanët, ata e quanin këtë të fundit thjesht komandan, ndërsa tjetrin: «ai borgjezi».

Në zyrën e komandantit pesë a gjashtë partizanë, midis të cilëve ishin Teuta me Javerin, po bisedonin për programin e ditës së parë të radios. Teknikët kishin thënë se Radiostacioni mund të fillonte të fliste pas dy orësh. Javeri me Teutën rrinin në fund të tryezës prej druri të zi dhe pritnin me ç'detyrë do të ngarkoheshin. Sherifi që hyri rastësish, qëndroi dhe ai e po dëgjonte. Po diskutohej se çfarë muzike do të jepej në fillim fare. Ndërsa të gjithë ishin në një mendje kundër himnit të mbretërisë, kishte mendime të kundërtë për atë që mund të zëvendësonë atë himn. Disa ngulnin këmbë që të vihej Himni i Flamurit, i cili kishte qenë edhe himni i vjetër kombëtar i Shqipërisë. Po kjo ishte e njëjtë gjë, kundërshtonte dikush, hiq një himn të vjetër, vur një himn tjeter akoma më të vjetër, me një fjalë rrangalle pas rrangallesh. Unë s'jam dakord. Unë propozoj Internacionalen ose, akoma më thjesht, një këngë partizane.

— Po s'mund të ketë Internationale pa nacionale.

Komandanti dëgjonte herë njërin dhe herë tjetrin dhe s'dinte ç'të vendoste. Ai merrte frymë thellë, sikur të thoshte me vehte: Ç'më polli mua më këto himne, ku ma gjetën këtë punë.

Në të vërtetë programi i shkurtër i ditës së parë të radios, bile nën vija të përgjithshme edhe i javës së parë, kishte ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm. Kishte ardhur deklarata e Qeverisë së Përkohshme, një përshëndetje e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Nacionalçlirimtar, drejtuar popullit me rastin e çlirimtës të kryeqytetit si dhe dy-tri materiale të tjera. Kurse për muzikën në material nuk thuhej asgjë. Siç duket muzika hynte në pjesën që i ishte lënë në dorë administratës së re të Radiostacionit.

— Po dëgjo këtu, mor shok, — ngulte këmbë njëri,

— himni i vjetër i Flamurit nuk është njëlloj si himni i mbretërisë. Ky ka qenë himni ynë ahore kur Shqipëria nuk ishte akoma mbretëri, more vesh, nuk ishte akoma mbretëri.

— Po ç'ishte ahore?

— Ç'ishte? — tjetri shqeu sytë. — Si ç'ishte? Dëgjo, ti, Shaqo, — tha ai, — bën ca pyetje ti që të prish gjati, Shqipëria ahore? Shqipëri ishte dhe pikë.

Sherifi dëgjonte gjithë interesim. Kishte kohë që e tërhiqnin pa masë të gjitha bisedat që kishin lidhje me shtetin, me kombin dhe me qeverisjen. Ato ishin si një mur i madh që herë bëheshin të kuptueshme dhe e afro-nin, por më të shumtën e rasteve tjetërsoheshin, i rrin larg, me një buzëqeshje mospërfillëse.

Ahere kur Shqipëria nuk ishte mbretëri, përsëriti ai me vete. Një farë mekanizmi i trurit të tij, një lloj transformatori i çuditshëm, që i kthente idetë abstrakte në gjëra konkrete (nganjëherë aq konkrete, saqë atij i vinte turp nga vetja) ishte vënë në lëvizje. Ahere kur Shqipëria qe pa mbret... kur ajo nuk ishte m... r... ahore kur Shqipëria ishte akoma... vajzë. Diku brenda tij, të rrëshqitshëm e farfuritës si kokrriza zhive, u roniten dy rreshta të një kënge të vjetër: Ky zinxhir i hollë, larë me flori, as na fol një fjalë, si në çupëri...

— Sherif, ç'ke rënë në të thella, — tha dikush.

Ndërkaq në zyrën e komandantit të Radiostacionit hynin e dilnin pa pushim partizanë, disa me punë, disa kot, për të bërë sehir. Ata uleshin në kanapenë e madhe, pinin cigare dhe merrnin pjesë në diskutim.

— Ahore u vendos, — tha komandanti — në fillim Himni i vjetër i Flamurit, pastaj Marshi i Brigadës së Parë Salmuese dhe në fund Internacionalja.

— Si shumë janë tre...

— Mjaft, — thirri komandanti, — nuk do të kthehem i më te ky problem. Tjetër.

Ata filluan prapë të flitnin me rrëmujë për programin e ditës së parë. Disa thoshin se fill pas himneve dhe deklaratës e përshëndetjes duheshin dhënë lajmet, të brendshme dhe të jashtme, të tjerë kundërshtonin, përpara se

të vinte puna te lajmet, duhej diçka më e përgjithshme, më solemne. Të përgjithshme dhe solemne janë himnet dhe deklarata e Qeverisë së Përkoħshme bashkë me përsħendetjen e Frontit, tha komandanti. Dikush propozoi që tē shfrytēzoheshin robërit gjermanë pér tē dhënë lajme edhe nē gjermanisht. Disa ishin pro, disa kundér. Më nē fund u vendos që tē jepeshin, meqenëse mund t'u bēhej edhe një thirrje gjermanëve tē Shkodrës pér t'u dorëzuar. Veç kësaj, c'të keqe kishte që gjithë ata miliona ushtarë gjermanë, tē shpérndarë anembanë Evropës, tē merrnin vesh se nē një nga kryeqytetet e kontinentit ata u dëbuant pér jetë tē jetëve.

Ndërsa përreth thërritej e pihej cigare, Javeri, nē një cep tē tryezës, po formulonte lajmin e parë. Ai ishte i thjeshtë. Tirana. Dy ditë më parë kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, u ćlirua nga forcat partizane shqiptare. Ky éshtë kryeqyteti i parë nē Evropë që ćliron vetveten. Populli shqiptar, pas tre mijë vjet ekzistence, ka më nē fund kryeqytetin e vet tē lirë dhe... dhe... Javeri po kafshonte majën e lapsit.

Rreth e rrotull vazhdonte diskutimi. U vendos që, pas lajmeve, Teuta bashkë me dy-tre partizanë tē tjerë tē këndonin pérpara mikrofonit ca këngë partizane. Teuta queshte dhe kundërshtonte. Dikush u kujtua se kishte dëgjuar që stacionet e botës japid edhe nga një buletin meteorologjik. Kjo éshtë gjëja më e lehtë, tha një tjetër, shih nga dritarja qielin dhe fol.

Hyri një nga inxhinierët, ai me llullë, dhe tha se pas njëzet minutash Radiostacioni do tē ishte i gatshëm pér transmetim. Një tjetër solli diskun e Himnit tē hershëm tē Flamurit. Por Internacionalja nuk ishte, dhe aq më pak Marshi i Brigadës së Parë. Do ta zgjidhim nē një farë mënyre, tha dikush. Di unë ca mitralierë nga Brigada e Katërt që këndojnë më mirë se ata artistët nëpér ato pjata apo disqe, si i thonë. Sherifi, krejt i përpirë, vështronnte diskun e zi tē Himnit tē vjetër tē Flamurit. Ishte e para herë që shikonte një pllakë gramafoni. Ata e kaluan atë dorë më dorë me lëvizje që atij iu dukën tē pakujdes-

shme, i fshinë pluhurin me mëngë dhe, më në fund, e lanë mbi kadifenë e tryezës. Sherifi zgjati dorën me drojtje për ta prekur edhe ai. Ja pra, kjo copë plastmasi i zi, me rrathë që shtjelleshin e shtjelleshin pafundësish, të gjerryer në trupin e tij, ishte ajo muzikë ngjethëse, përpëra së cilës vite me radhë, në ato kohë të vjetra, njerëzit zbulonin kokat në heshtje. Megjithëse e kishin fshirë me mëngë, aty-këtu kishte akoma pluhur dhe Sherifi, me gishtat e tij të ashpër, e ciku fare lehtë atë rrotullame të zezë, që i dukej e shenjtë, për t'i fshirë pluhurin e fundit.

Ora po i afrohej katrés. Hyri ish-drejtori i vjetër dhe më zë të drojtur tha: Zoti drejtor i përgjithshëm, Radio-stacioni është gati përfunksionim.

Komandanti ngriti fytyrën e tij të zbetë, me vetullat e pjerrëta si strehë çatish dhe tha:

— Ta hapim, ahere, s'kemi q'presim më.

Ai u nis i pari për të dalë në korridor dhe pas tij vinte gjithë grumbulli tjetër. Javeri mbante në dorë fletët ku kishte shkruar lajmet, dikush rrëmbeu diskun e himnit të vjetër dhe dy-tri herë Sherifi desh bërtiti, sepse iu duk se tjetri po e mbante diskun me një shkujdesje mizore.

Grumbulli i zhurmshëm filloi të ngjitte shkallët, i ndjekur gjithmonë e nga më shumë njerëz, që bashkohe-shin me të gjatë ecjes. Aty-këtu dyert në korridore hapeshin dhe njerëzit, si zgjatnin kokat pas tyre, thoshin: «Po fillon, po fillon». Nga një studio përbri dolën dhe u bashkuar me grumbullin lëvizës Teuta me partizanët e tjerë që po bënin prova për këngët partizane. Në katin e tretë u bashkuar me ta ca teknikë dhe redaktori i gjermanishtes, i cili, gjatë ecjes, ngulte këmbë që ushtarit gjerman që do të lexonte përkthimin e lajmeve, duhej t'i mbahej tyta e kobures te koka, përndryshe ai, redaktori, nuk merrte asnje përgjegjësi për tekstin. Komandanti e cte në krye me kapotën e gjatë që i hallakatej anëve dhe, sa më shumë që grumbulli i afrohej studios kryesore, aq më tepër ai shpejtonte hapat dhe nuk dëgjonte më asgjë nga ato që thuheshin, bërtiteshin ose murmuri-

teshin pas shpinës së tij. Në katin e katërt me grumbullin u bashkua Mete Aliu dhe, në çastin kur dera e studios nuk ishte as pesë hapa larg, dikush u kujtua për spikeren kryesore. Ahere të gjithë filluan të bërtitnin: «Miriami. Miriami. Ku është Miriami?», gjersa ajo doli nga një sallë e vogël, e përgjumur, me një si ndriçim hënор mbi mcollzat e zbeta. Bebëzat e syve të saj ishin akoma larg, në tokën e gjumit dhe ato po aviteshin me shpejtësi, gjersa u gjendën në një çast të trembura, në korridordin e ftohtë.

— C'është? — pyeti ajo me zë të ulët. — Përse më thérresin?

— Radiostacioni po hapet, shpejt, shpejt, — thanë dy-tre zëra.

Dikush thoshte: S'duhet të flasë Miriami. Ajo është e përdhosur politikisht.

Grumbulli i çrrëgullt ishte duke hyrë në studion kryesore. Zhurmat e tij po vdisnin rrëth e rrötull mbi tapiceritë dhe kadifetë e rënda që vareshin gjer në dysheme. Dëgjoheshin pëshpërimat «Shët! Shët!» Mbi një tryezë të vogël Sherifi pa një mikrofon të vogël ngjyrë argjendi, që ndriçohet si nga një dritë prej altari. Kishte diçka prej idoli ai metal i vogël rremba-rremba, në atë vetminë e tij, atje mbi kadifenë jeshile. Grumbulli i njerëzve ndryshoi formë disa herë, gjersa më në fund zuri vend në formë gjysmërrathi, nën perdet kadife. Dy veta sollën një gramafon dhe e vunë mbi tryezë (Diçka nuk ishte rregulluar akoma në studion e muzikës dhe ata vendosën ta vinin gramafonin drejtpërdrejt te mikrofoni i lajmeve). Ish-drejtori, me duart që i dridheshin, mori diskun dhe e vendosi në gramafon. U dëgjuan prapë zërat «Qetësi, po hapet mikrofoni» dhe komandanti, ish-drejtori dhe tre-katër inxhinierë e teknikë tanë po bënин ca shenja me njëri-tjetrin me duar e me sy. Diçka kërkonin akoma. Më në fund te karrigia përparrë tryezës me mikrofon Sherifi pa të ulej spikeren kryesore, që mbante në duar letrat e daktilografuara. Komandanti ishte i pakënaqur. Me sa dukej, ai nuk donte që të fliste Miriami dhe vazhdonte t'i bënte shenja me duar dikujt, që nuk e kuptonte. Flokët e

dendur të ish-spikeres kryesore qëndruan ca kohë të paliqerit sipër shpinës së karriges, pastaj ajo vështroi djath-tas e majtas. Pranë saj, nga e majta, Sherifi dalloi kapotën e gjatë të Mete Aliut, që s'dihet se si ishte afruar aq shumë. Poshtë syve të prerë dhe në krejt ftyrën e tij kishin ngrirë alarmi dhe zymtia. Në studio ishte bërë një nga ato lloj qetësish që e ndien po aq në sytë, sa edhe në veshët. Sherifit i dukej sikur nga çasti në çast të gjithë ata njerëz do të këputeshin e do të binin përdhe, të trullosur nga një gjumë magjik. Por midis përgjumjes zëri i trashë dhe shumë i qetë i inxhinierit me llullë tha: «Ju lutem, qetësi të plotë. Po hap mikrofonin kryesor».

Me hapjen e mikrofonit asgjë nuk ndryshoi në pam-jen e tij, vetëm se një nga teknikët, me dorën që i dridhjej lehtë, afroi dorezën e gramafonit mbi diskun që vërtitej në heshtje. Ai i ngjante tanë një gjeratoreje të zezë, që, duke u vërtitur, thithë gjithçka e i çonte poshtë, poshtë nëpër thellësira. Befas nga ajo rrrotullame e zezë u ngritet, në fillim ngadalë, si një pluhur i rëndë që ngrihet nga toka, pastaj gjithmonë e më tronditshëm, sikur pas pluhurit të ngriheshin vetë themelët e dheut, një muzikë e rëndë, e shtrirë tejemanë, si një gjëmë e trubullt e por-sapjellë nga tabani i vjetër i shtetit.

Sherifi u rrëqeth nga koka në këmbët. Ai ndjeu t'i zbuteshin koskat dhe për një grimë fare të shkurtër iu duk se ishte shtrirë edhe ai, diku larg, në fushën dimë-rore, dy metra nën tokë, përbri të vrarëve të tjerë, të panumërt, dhe kjo muzikë e cte mbi të si një grumbull resh. Ata e dinë atë, mendoi ai si i mpirë. Ajo është atje poshtë si det që i qulli nga të gjitha anët.

Himni po shuhej dalngadalë.

Mbi diskun e gramafonit u zgjat po ajo dorë dhenë ngadalë, në çastin që muzika pushoi, e ngriti dorezën me gjilpërën e vogël vezulluese në majë. Disku vazhdonte të rrrotullohej akoma i zi, humneror. Ata që ishin pranë tryezës, shkëmbyen shenja me spikeren kryesore dhe ajo ngriti kokën qetësish dhe me një zë që pas asaj shungullime madhështore të himnit iu duk të gjithve fare i dobët, i zhveshur dhe i zakonshëm, tha: «Ju flet Tirana».

Ajo bëri një pauzë të shkurtër, para se të lexonte shpalljen e fillimit të funksionimit të Radiostacionit të Shtetit të parë Demokratik të Punëtorëve dhe të Fshatarëve mbi tokën e Shqipërisë, kur ndodhi diçka e çuditshme. Mete Aliu, që gjatë kohës së dhënies së himnit ishte afrouar edhe më te tryeza, gjersa ishte mbështetur mbi të, kur spikerja tha «Ju flet Tirana», e vështroi një hop me sy të shqyer, i zhgënjer, i acartë, dhe pastaj, me zë të mbytur, shkrofëtiu nëpër dhëmbë: «Bushtër borgjeze, ngreje zërin!»

Ajo ktheu nga ai sytë e saj të pikëlluar, me një pyjetë të madhe në ta, por ndërkaq, përpara se dikush të ndërhynte, ai u gjend përbri saj, uli kokën te mikrofoni dhe, duke shtyrë me faqen e tij të rreshkët faqen e saj, thirri me sa kishte në kokë: «Ju flet Tirrrana!»

Ata që ishin përreth, mbetën si të ngrirë në vend, ish-drejtori i vjetër vuri duart në kokë, komandanti kërkonte të gjente, siç duket, butonin për të mbyllur mikrofonin, ndërsa Mete Aliu, krejt i mpirë midis kësaj shtançieje, vështronte herë njërin, herë tjetrin me ca sy të mpirë, sikur të pyeste: A nuk bëra mirë? A?

Miriami ishte bërë dyllë e verdhë. Ajo kishte mbetur si e paralizuar në karrige, midis atyre kapotave të gjata, plot armë dhe plumba dhe në trurin e saj kishte një boshllék të çuditshëm. Sytë e saj i jepnin trurit ca regjistrime të shkëputura, pa vazhdimësi. Ja, sytë e errët të komandantit i bënin ca shenja këmbëngulëse asaj partizanes së bukur që kishte qenë te shtëpia e saj. Ajo ngriti supet një herë, dy herë, pastaj u afroua nga krahu tjetër i saj (oh, nga krahu tjetër, sepse në njërin krahu ishte akoma ai i tmerrshmi i gjatë me një dorë), pastaj vajza uli kokën te mikrofoni, faqja e saj e lëmuar, me një erë sapuni të thjeshtë, preku faqen e saj dhe pastaj ajo me një zë të lartë, të tingullt, shumë më të lartë se ç'duhet përpara mikrofonit, tha: «Ju flet Tirana».

— Tani vazhdo ti, — i pëshpëriti te veshi një zë dhe Miriami bëri një përpjekje mbinjerëzore për të dalluar shkronjat e lajmeve nëpërmjet asaj mijegulle.

O Zot, tha me vete, ndihmomë, o zot, dhe pastaj,

si të ardhur anash, dëgjoi zërin e saj, që shqiptoi përparrë mikrofonit: «Radiostacioni i Tiranës së lirë po fillon transmetimet e tij në valët...»

Po në atë çast komandanti e preku lehtë në sup dhe, kur ajo ktheu kokën, ai i bëri shenjë të ngrihej nga karrigia. Në karrige, duke kafshuar buzët nga tronditja, u ul Teuta. Ajo u gëlltit një herë, dy herë, pastaj me një zë të dridhshëm, tepër të lartë, filloi leximin e deklaratës së Qeverisë së Përkohshme.

Pas gjysmë ore Sherifi me Javerin ishin përsëri në rrugë. Ata po shkonin në shtab për të çuar një letër të komandantit të Radiostacionit.

Rrugët ishin plot. Grupe partizanësh, kolona të rinjsh entuziastë, kërkues florinjsh, partizanë italianë të batalionit «Antonio Gramshi», patrulla të armatosura, venin e vinin poshtë e përpjekjet ashtu si edhe në mëngjes. Gjatë Bulevardit të Madh katër qerre, përparrë të cilave ishin mbrehur tetë buaj jashtëzakonisht të mëdhenj, po tërhoqnin zvarë një tank të djegur. Një grumbull njerëzish ecnin prapa asaj zvaritjeje të mundimshme.

— O, shiko, shiko, — ia bëri Sherifi dhe ndaloj në vend për të vështruar. Në sytë e tij ishte ndezur një dritë e përkorë. Javerit iu duk se gjithë qenia e shokut po synente, po bymehet, po derdhej drejt atyre muskujve mësive, tendosja madhështore e të cilëve vizatohej qartë prapa lëkurës së djersitur. — Shikoi sa të bukur janë, — tha ai me zë të ulët, sikur fliste me vete.

Sherifi e ndjeu se po i mekej zëri nga tronditja. Nuk ishte vetëm malli i tokës dhe i punës, që lëvizte pak hapa larg tij në formë brirësh, thundrash, sysh e djerse të njojshur. Ishte diçka më e madhe: këta buaj fushe po tërhoqnin kufomën e hekurt të një tanku. Ky ishte një shpagim i vjetër, i ëndërruar prej tij herë pas here gjatë gjithë viteve të luftës. Përparrë se të shikonte për herë të parë në jetë tanket, ai kishte parë gjurmët e zinxhirëve të tyre nëpër fusha dhe xhade të ndryshme. Ato ishin të gjera,

të sheshta, me një rregullsi që të ngjethet mishtë. Pastaj ai kishte parë lopët e fshatit Mullaraj, të vrara prej tankeve në një fushë përpara vaut të një lumi. Duke u tërhequr nga një operacion, gjermanët nuk kishin mundur, siç duket, të ecnin me ritmin e lopëve të grabitura dhe i kishin masakruar me tanke. Kur batalioni kishte kaluar andej, ishte mëngjes herët. Fusha ishte qullur nga vesa. Lopët ishin shtrirë aty-këtu, afër e larg, disa me plagë jashtëzakonisht të mëdha, të hapura siç duket, nga topat me qitje direkte, të tjerat të rëna thjesht përdhe sikur flinin. Mbi disa dukej batërdia që kishin bërë zinxhirët, duke kaluar mbi këmbët apo kokat, që shumë trupave iu mungonin. Sherifi kishte ndier një angushti të tillë, që s'e kishte provuar kurrë. Mushkëritë i ngjanin si prej gipsi. Disa herë i qe dukur se aty-këtu në fushë ishin shpërndarë sy lopësh, si copëra xhamesh të thyera (sepse i qe dukur që pas shtypjes së kokave sytë do të kishin pëlcitur anash zinxhirëve pa u shkatërruar dot) dhe një pëllitje e zvargur, e përvajshme rrinte e s'donte të ikte nga ajo fushë me shkurre dhe nga brendësia e vetes së tij. Ai, ashtu sikurse shumë partizanë të tjerë, mezi i kishte mbajtur gulçimat dhe më vonë Sherifi kishte menjuar, se, në qoftë se ndonjëri prej tyre do të gulconte vërtet (i qe dukur se për lopët mund të qaje pa të ardhur turp), kjo gulçimë do të kishte diçka nga pëllitja. Qysh ahore ai kishte ndier për tanket një nga ato urrejtjet që duket sikur i ke brenda vetes në formë tehu thike dhe që të shpojnë pas çdo lëvizjeje që të bësh.

Më vonë, kur Dino Sinojmeri u kishte treguar një natë për një luftë të vjetër që ishte bërë rreth një qyteti të rrethuar që quhej Trojë, dhe se si një grek me emrin Akilé, që ishte i paprekshëm nga shpata dhe shigjetat, kishte vrarë në dyluftim një mbrojtës të qytetit, një farë Hektori, Sherifi kishte pyetur se a kishte ahore shishe me benzinë. Pse? i kishte thënë Dino Sinojmeri dhe Sherifi qe përgjegjur: Sepse, me sa kuptoj unë, ky Akileu s'pas ka qenë gjë tjetër, veçse një lloj tanku dhe dihet se tankut s'i bën dot gjë as plumbi, pa le pastaj shpata,

kështu që ai i ziu Hektor qysh në fillim e kishte pasur të humbur davanë. S'është ashtu, qe hedhur Mete Aliu. Tan ket s'janë ashtu siç i bëjnë. Do të na dalin ndonjëherë përpara dhe do të shohim sa u vlen samari. U vlen një çikë, u vlen, kishte thënë Dino Sinojmeri. E kanë samarin një gisht të trashë dhe të derdhur me çelik.

Ata ahore akoma nuk kishin parë tanke dhe me sigruri të gjithëve u qenë kujtuar fjalët e Mete Aliut pas ndeshjes së parë me ta, ahore kur po sprapseshin të dëshpëruar nën një diell zharitës, dhe turinjtë e tyre të gjerë, të çeliktë dukeshin sikur shqyeshin gazit me plumbat që u binin përsipër, ndërsa suleshin përpara me hungri-më. I fundit zmbrapsej Mete Aliu. Dyllë i verdhë, kthe nte kokën nga tanket, kafshonte buzët, qëndronte ca qaste në mëdyshje dhe ikte përsëri. Zmbrapsuni, thërriste Dino Sinojmeri me revole në dorë. Unë ju thashë sulm, unë ju them mbrapa.

Po sido që kishte kaluar shumë kohë qysh ahore dhe sido që kishte parë shumë herë tanke më vonë, Sherifit nuk i shqiteshin nga mendja lopët e vrara prej tyre në atë fushë që s'ia mbante mend emrin. Kjo kishte hyrë në pikëllimet e jetës së tij, ashtu siç ishte vdekja e gjyshes, vdekja e qenit të madh të shtëpisë, vetë shtëpia e djegur. Njëherë, bile, ai kishte parë një ëndërr të përcudshme. Po kthehej në mbrëmje në fshat me një kope lopësh që i kishte kullotur dhe befas, kur po i afrohej gardhishtes së shtëpisë, kishte vënë re se ato nuk ishin lopë, po ca tanke të zeza që ecnin me këmbë lopësh, duke prerë barin me zinxhirë krëk-krëk-krëk. Sherif, q'na solle kështu? kishte thënë i ati duke dalë te pragu i shtëpisë në kohën që tanket-lopë pëllitnin ultazi, fare ultazi, me një pëllitje që të kallte datën.

Në të dyja anët e Boulevardit të Madh kalimtarët kishin qëndruar ndanë trotuareve dhe po ndiqnin me sy, bënин gjeste me duar dhe komentonin zvaritjen e tankut.

— Po të ishte «Tigër», nuk do ta têrhiqnin dot, — thoshte një zdap i gjatë qafështrembër. — Po të ishte «Tigër», do të duheshin edhe katër buaj të tjerë. Si thua ti?

— Ku di unë, — u përgjigj dikush, duke ngritur supet.

— Në mos katër, së paku dy do të duheshin, me sigruri, — ngulte këmbë zdapi i gjatë. — Ë, si thua?

— Ku di unë.

— Po mirë, thuaj së paku një mendim. S'u bë qameti se do të thuash një shifër.

— Sa bukur, — pëshpëriti Sherifi, — shiko, Javer, sa bukur.

Buajt për një çast kishin shtuar shpejtësinë dhe tanku ikte pas tyre, duke u mënjanuar sa djathtas majtas mbi pllakat e zinxhirëve të tij. Dy-tri herë zinxhirët goditën bordurat e trotuarit dhe dikush thirri:

— Ej, kujdes se do të na shkallmojë bulevardin kjo ngordhësirë.

Ngordhësirë, mendoi Sherifi. Zemra ment i pëlciste nga një hare e qetë. Ish te tamam ai shpagimi i vjetër që ai, pa e ditur as vetë, e kishte pritur me vite: shpagimi i lopëve.

Në një nga udhëkryqet përtëj filloj të gjëmonte një altoparlant.

— Po punon, — tha Javeri, — e dëgjon?

Ishin akoma larg dhe nuk kuptoheshin mirë fjalët që thoshte spikeri. Shumë njerëz në rrugë ngrinin kokat të habitur. Kur ata iu afroan udhëkryqit, altoparlanti po jepte këngën «Dalngadalë po vjen behari». Pastaj, në kohën që ata po kapërcenin rrugën, kënga pushoi dhe pas një heshtjeje të shkurtër një zë i lartë femre, që e mbante, me sa duket, kokën fare pranë mikrofonit, sepse i dëgjohej krejt frysëmarrja, tha: «Pëershëndetje partizanëve të Brigadës së Parë Sulmuese heroike. Për ndër të tyre po japim Internacionalen».

Tani ata vunë re se altoparlantet ishin vënë në shumicën e udhëkryqeve kryesore. Ata qëndronin majë shtyllave si ca zogj të hekurt gri, të paparë ndonjëherë në asnjë vjeshtë të shkuar të këtij kryeqyteti.

Ndërsa ktheheshin nga shtabi, ata dëgjuan se alto-parlantet po jepnin lajmet gjermanisht. Një zë i ngjirur, i ngjashëm me atë që kishte thirrur gjithë natën përcart, e mbushte sheshin me ca fjalë të shqiptuara me grykë dhe me aq tërsëllëm, saqë të krijohej përshtypja se h-rat dhe c-rat e atyre fjalëve fluturonin e binin si pupla të shqyera në këmbët e turmës. Gjermanishtja, mendoi si i ngrirë Sherifi. Kjo ishte gjuha e gjermanëve, e mundur ndoshta, ashtu si dhe ata. Dhe kjo dukej qartë nga ai shtrëngim fyt, nga ajo frymëmarrje si në jerm prej njëriu që mezi mbahet në këmbë dhe nga ato c-ra dhe h-ra që vërtiteshin si pluhur midis gërmadhave.

Befas, midis asaj katrahure ata dëgjuan një fjalë, ose më mirë një klithmë të njohur: «Achtung, Achtung!» Dy net më parë ajo, e përsëritur qindra herë midis kllapisë së gjermanit të plagosur, i kishte lënë ata pa gjumë.

— Ja, prapë ajo fjala, — tha Sherifi. — Të kujtohet?

— Siç duket, po u bëjnë thirrje gjermanëve të Shkodrës pér t'u dorëzuar, — tha Javeri. — Kjo fjalë do të thotë pak a shumë «vini re!»

— Fjalë e rëndë, — tha Sherifi, — duket sikur dikush të hedh litarin në fyt.

Javeri buzëqeshi. Ata po i largoheshin gjithmonë al-toparlantit dhe gjermanishtja e tij sa vente dukej sikur zhytej në mijegull. Kur pas dhjetë minutash dolën në sheshin «Skënderbej», radioja po jepte një muzikë të gëzueshme.

— Kanë hapur diskotekën, — tha Javeri.

Sherifi solli ndër mend ato mijëra disqe të vendosura vertikalish në rafte të pafundme, në të cilat, sipas shpjetimit të Javerit, ishin gdhendur si me daltë të gjitha zërat e gëzuar dhe të pikëlluar të botës. Ai buzëqeshi përbrenda vetes së tij. Një gëzim, i madh sa nuk ta rrokte dot mendja, shtrihej këndeji e tutje përpara jetëve të tyre. Ç'disqe do të duheshin pér to, mendoi ai. Dhe i përfytyroi në rreshta të pambarim dhe jo ashtu të vegjël

e të zinj, siç ishin gjer tani, por të mëdhenj sa një sofür buke dhe... të bardhë.

Muzika e gjëzueshme, bashkë me turmën që kishte mbushur sheshin e madh, krijonte një si vorbull të gjallë. Pastaj ajo pushoi dhe Sherifit iu duk se dora që ngriti dorezën e gramafonit atje, në studion e veshur me kafe, u ul mbi gjithë sheshin e madh, që u mbulua nga heshtja. Pas disa sekondash, midis heshtjes, ai zë i lartë, që tani atyre iu duk si i ngjashëm me zërin e Teutës, tha: «Mbrëmje e madhe vallëzimi në hotel «Dajti». Filimi në orën shtatë e tridhjetë. U kujtojmë shokëve se...»

Zëri u ngatërrua, ngeci dhe pastaj, tamam kur ai po shndërrohej në fillimin e një të qeshure, u dëgjua një «krëk» i thatë.

Pas pak altoparlanti gjëmoi përsëri: «Ju flet Tirana. Po përsëritim lajmet».

Lajmet ishin të shkurtra, gjithsej shtatë minuta, dhe pas tyre vunë prapë muzikë të gjëzueshme. Pastaj, mu në mes të muzikës, u dëgjua një si gërvishje. Muzika u ndërpredhe dhe një zë burri me frymëmarrje të shpeshtë tha: «Përshëndetje shokëve që pushtuan Postë-Telegrafën, nga shokët dhe shoqet e Radiostacionit. Partizanin e batalionit të parë Emil Cara e kërkojnë në shtab.

— Ky më duket se është zëri i intendentit, — tha Javeri.

Muzika gjëmoi përsëri. Sherifi u mat të thoshte se kushedi si do t'i ketë ardhur atij partizanit Emil Cara, që dëgjonte emrin t'i gjëmonte nëpër qytet, kur muzika u ndërpredhe prapë nga po ajo gërvishje që e bënte, siç duket, doreza e gramafonit, duke u shkëputur nga disku dhe zëri i femrës (i Teutës, me siguri) që tha «Mitralieri Sherif Goreni të paraqitet në Radiostacion. E kërkon... e kërkon... dikush... ndoshta e fejuara.»

Fjalët e fundit u përzien me një të qeshur të njojur, që Sherifit iu duk se shpërtheu mbi shesh si një shtëllungë e madhe flake, kaloi si furi mbi kokat e qindra njerëzve dhe pullazeve, gjersa u përpi prapë nga goja e hekurt e altoparlantit. Sherifi ishte bërë flakë i kuq në

fytyrë, thuajse ajo e qeshur e marrë e kishte përcëlluar krejt.

— Mos ia vër re, — tha Javeri, duke e kapur për supesh. — Vajzë e re, s'di ç'bën.

Si është e mundur, si është e mundur, mezi arrinte të thoshte me vete Sherifi, pa ditur as vetë të kuqtonë përsë dhe çfarë ishte e mundur. Turpi i digjte faqet, zverkun dhe sytë. Ideja se ndoshta zëri qe dëgjuar kudo, gjer në fshatin e tij të largët, u përpi ngadalë nga ideja tjetër, se fshati prej kohësh nuk ishte më, se edhe sikur të ishte...

— Ç'ia vë re, — e ndërpren Javeri, pa ia hequr krahun nga supet. — S'di ç'bën nga gëzimi.

Gëzimi, mendoi Sherifi. Të gjithë ishin si të dehur prej tij. Megjithatë...

— Më turpëroi, — tha ai fare ultas, — kushedi ç'mendon kush e ka dëgjuar.

— E kush të njeh në këtë rrëmujë, — tha Javeri. — Pastaj, se mos ka radio në Shqipëri. Shumë-shumë e kanë dëgjuar në Paris ose në Berlin.

Javeri ia plasi gazit.

— Mos u tall, — tha Sherifi, akoma krejt i trubulluar. — Nuk e prisja këtë nga Teuta.

— Ç'ia vë re, — tha Javeri. — Pastaj dëgjo këtu, te ne, në qytet, kur një vajzë ngacmon një djalë, ashtu siç të ngacmon ty Teuta, e di çfarë thonë? — Sytë e çelët, zhbirues të Javerit kërkonin sytë e Sherifit, që ishin akoma të veshur. — E di ç'thonë? — përsëriti ai. — Thonë se asaj vajze i pëlqen ai djalë.

— Lëri këto, — tha Sherifi, duke ndier një valë të re skuqjeje, që i dukej sikur i buronte nga rrënjet e flokëve. — Lëri këto, të them.

Ai dukej vërtet i zemiëruar tani dhe Javeri tha:

— Mirë, mirë, ti e di që bëj shaka.

Ata ishin fare pranë ndërtesës së Radiostacionit, kur panë të dilte nga porta e hekurt dhe të vinte përballë tyre spikerja kryesore. E mbështjellë me shallin e madh, nga anët e të cilit dukeshin vetëm dy mollzat e saj të gjera, me një ndriçim lotësh të rënë mbi to, ajo ecte me

atë të ecurën e veçantë të njerëzve që e kanë mendjen fare larg, në ca treva ku këmbët nuk do të shkelin kurrë.

— E kanë dëbuar, — tha Javeri me zë të ulët. — Shikoje sa e pikëlluar duket.

Gruaja kaloi përbri tyre pa e ngritur kokën dhe mollzat e saj ishin vërtet pafundësish të pikëlluara nën atë lotëri të ngrirë.

Te hyrja e Radiostacionit bënte roje me automatik në duar Thanasi.

— Është brenda komandanti? — pyeti Sherifi, i ngrysur.

— Jo, — tha Thanasi dhe u bë flakë i kuq në ftyrë.
— Se ku e thirrën me urgjencë para një ore.

Ata hynë brenda me vrull, Sherifi përpëra, Javeri prapa dhe filluan të ngjitnin shkallët nga tri e nga katër. Kur hynë në njérën nga studiot, panë një skenë të çuditshme: përpëra mikrofonit një gjerman me kokë të lidhur me fasho lexonte, siç duket, për të dytën herë lajmet gjermanisht, ndërsa përbri tij, në këmbë, me një revolver në dorë, tytën e të cilët e mbante të drejtuar mbi tëmthin e djathtë të gjermanit, rrinte i ngrysur Mete Aliu.

Ata mbetën qiri më këmbë dhe, duke harruar se përsë kishin nxituar me aq vrull për në Radiostacion, po dëgjonin gojëhapur gjuhën e të mundurve. Sherifit iu duk sikur studjoja po mbushej me c-ra dhe me h-ra, që të merrnin frymën.

Ndërkaq, një korridor më tutje, në studion kryesore, Teuta dhe tre-katër partizanë të tjerë mezi ç'po pritnin mbarimin e emisionit të dytë të lajmeve gjermanisht që e ndiqnin me anë të një radioje, për të vazhduar programin, midis të cilët ata, pa e ditur as vetë se si, duke përfituar ndoshta nga mungesa e komandantit, bënин ndërhyrjet e tyre gazmore. Të përkulur te tryeza e vogël, mbi të cilën rrinte akoma i heshtur gramafoni dhe një grumbull disqesh përbri, ata flitnin të gjithë përnjëheresh,

shfaqnin mendime dhe ndërpritnin njëri-tjetrin se q'lajmërimë do të bën me anë të radios, kë do të përshëndetnin dhe bile kë do të ngacmonin. Dukeshin si të dehur.

Që nga qoshja e tyre dy nëpunës nga personeli i vjetër që ishin ngarkuar të rrinin pér çdo rast pranë mikrofonit, vështronin pikëllueshëm, pa guxuar të ndërhyrin pér asgjë. Njëri prej tyre, një burrë i vjetër, i imtë, me një nofull të ngushtë si prej kukulle u mat dy-tri herë të thoshte diçka, por fjalët s'dolën që s'dolën nga goja e tij. Edhe ish-drejtori që hyri dy herë në studio, gjoja si rastësisht, u mat, me sa duket, të thoshte të njëjtën gjë, por nuk shqiptoi veçse fjalët «ndoshta» «sikur të...», «do të thoshja se...» dhe pastaj pasi u buzëqeshi me radhë partizanëve dhe veçanërisht Teutës, me ata syltë e tij të lyrshëm, doli pa thënë asgjë tjetër.

«Achtung, Achtung» u dëgjuat në radio zëri i gjermanit dhe një nga partizanët tha:

— Po i afrohet fundit, bëhuni gati.

Teuta qysh tani mezi po e mbante të qeshurën pér atë që do të thoshte. Ajo afronte gishtin tregues, të përthyer te buzet dhe lëvizte njérën këmbë nga padurimi. Më në fund emisioni i dytë i lajmeve në gjermanisht mbaroi dhe Teuta, duke përkulur kokën te mikrofoni, tha:

— Dëgjuat emisionin e dytë të lajmeve në gjuhë të huaja.

Një nga partizanët afroi kokën te mikrofoni pér tu dërguar një përshëndetje një grupi shokësh të batalionit të katërt. Pas tij Teuta, me një zë, uniformiteti i të cilit kërcënohej në dy-tri vende nga vërshimi i së qeshurës, tha diçka tjetër. Në fjalët e fundit ajo afroi dorën te goja dhe e qeshura i shpërtheu fare natyrshëm, duke mbuluar çdo gjë. Pas kësaj, njëri nga nëpunësit e vjetër, ai që qe caktuar pér muzikën, me një gjest të drojtur ngriti dorezën e gramafonit dhe e uli mbi disk. Tjetri rrinte duarlidhur me një shprehje pikëllimi të tillë, që dukej sikur ia ngushtonte edhe më atë nofull prej gipsi.

Të gjithë ndiqnin me sy rrotullimin e diskut (ai vërtitej qetësisht, duke lëshuar nga trupi i tij i zi vezullime

të zbeta, që shuheshin sakaq), kur u dëgjua tringëllima e një zileje, që e bëri shumicën e tyre të dridhej. Askush, përveç nëpunësve të vjetër, nuk e kishte vënë re se në një qoshe të studios, pas kanapesë së gjerë, ishte një telefon. Ky ishte, më sa duket, një telefon që përdorej shumë rrallë dhe për qenien e të cilit dinin shumë pak vetë. Zilja e tij ra për të tretën herë midis heshtjes që, sa vente, bëhej më e thellë. Partizanët, për herë të parë pas një mospërfilleje të gjatë, kthyen sytë nga nëpunësit e vjetër. Mirëpo fytyrat e tyre ishin krejtësisht të ngrira. Aherë ata vështruan njëri-tjetrin, pastaj të gjithë vështruan Teutën dhe ajo, në pauzën midis ziles së katërt dhe të pestë, eci drejt telefonit dhe, duke mbytur me zor të qeshurën, që kushedi pse ia provokoi telefoni, ngriti dorëzën.

— Alo? — tha duke vështruar për një sekondë brimmat e vogla, të zeza të receptorit. Prej tyre erdhi një zë i trashë burri, me timbër të ulët:

— Jam Enver Hoxha, kush jeni ju?

Teutës iu duk se do t'i thyhej krahu nën peshën e receptorit, që iu qindfishua papritur. Ajo ngriti sytë si për të kërkuar ndihmë nga të tjerët, por fytyrat e tyre se si iu dukën pak larg. E qeshura ra nga fytyra e saj si një kristal që bëhet copë-copë.

— Alo, — tha zëri në skajin tjetër të telit.

Teuta e kuptoi se ishte e vetme, ballë për ballë me atë zë.

— Unë jam një partizane, shoku Komandant i Përgjithshëm, — tha ajo, duke vënë gjithë fuqinë e saj për t'i shqiptuar qartë këto fjalë. Ajo pa përmes djersës së retinës së saj një grumbull sysht që ishin ngulur mbi të.

— Dëgjo, mój shoqja partizane, — foli zëri i Enver Hoxhës. — Unë nuk e kuptoj se ç'po bëni ju atje në Radiostacion. A e mendoni se ato që thoni përparrë mikrofonit, dëgjohen në gjithë botën? — Zëri pushoi për dy-tri sekonda, por ndihej prania e frymëmarrjes së tij.
— Alo.

— Po ju dëgjoj, — tha Teuta, me zë të shuar.

— A e mendoni se këndej e tutje ne jemi shtet dhe

se Radiostacioni është zëri i shtetit dhe i popullit dhe jo një vend për të qeshur? Si?

— Po, po, — pëshpëriti Teuta, me një zë të zbrujtur.
— Më falni, shoku Komandant i Përgjithshëm.

Të tjerët që kishin ngrirë përreth, vështronin sytë e saj të veshur e të ndritshëm, si ai qelli i mbushur që ndrit përpara shiut dhe, porsa u dëgjua zhurma e lehtë e aparatit, që u mbyll në skajin tjetër të telit, Teuta, e plogështuar papritur, vuri receptorin mbi aparat dhe po në atë çast nga koka e saj e ulur lotët ranë njëri pas tjetrit mbi telefon.

— Çfarë tha? — pyeti dikush fare ultas, por të tjerët i bënë shenjë të pushonte. Teutës i dridheshin supet.

Në atë kohë dera e studios u hap dhe hynë brenda me një pamje të ngrysur Sherifi me Javerin.

— Ç'është? — pyeti me zë të ulët Javeri, kur pa Teutën. — Ç'ka ndodhur?

— Komandanti i Përgjithshëmi.

— Shoku Enver i tërroqi asaj vërejtje, — u përgjigj me pëshpërimë një partizan, — vetë Enver Hoxha i tërroqi vërejtjen.

— Shoku Enver, vetë? — ia bëri Sherifi.

Tjetri tundi kokën.

— Vetë ai.

Mendimi se Enver Hoxha kishte dëgjuar ndoshta në radio se atë, Sherif Gorenin, e kërkonte me altoparlante e fejuara, e bëri Sherifin të skuqej prapë, por, kur pa Teutën që rrinte akoma te telefoni, kokulur, si një nxënëse, gjithë zemërimi i fluturoi sakaq. Bashkë me të tjerët ata qëndruan në këmbë në një heshtje gati ceremoniale, sikur pritnin të ndodhët diçka.

Dy ditët që erdhën më pas, dimri, sikur të desh të provonte vetë se ç'mure ishin çarë e ç'pullaze ishin hapur nga lufta që porsa kishte mbaruar, që sulur mbi qytet me shi e vërvshëllimë ere. Retë që kishin mbushur qielin, lëviznin plot shqetësim mbi shtetin e porsafor-

muar. Aty nga mbasditja ato u rënduan e u bënë si të përgjumura dhe prej gjithë asaj hapësire të madhe uniforme filloj të mizonte dëborë.

Kjo ndodhë tamam në kohën që disa nga njësitet e Brigadave që çliruan Tiranën dhe që për disa ditë kishin mbajtur rojën në Postë-Telegraf, Bankë, Radiostacion, Agjenci Telegrafike dhe në ndërtesa të tjera shtetërore, po niseshin tani drejt veriut, fill pas brigadës të tyre, për të ndjekur gjermanët pértej kufijve, në tokat e Jugosllavisë dhe ndoshta më tej, drejt Evropës Qendrore.

Të gjitha institucionet shtetërore i kishte marrë tani në dorëzim «Shteti i ri Demokratik Popullor», siç thuhej në urdhurat e dërguar njësiteve partizane.

Në të dy trotuaret e Boulevardit të Madh, përmes të cilit kalonin partizanët, turmat e kalimtarëve, burra, vajza, partizanë të brigadave të tjera ndalonin për të parë, përshëndetnin me duar dhe shumë prej tyre fillonin të këndonin të njëjtën këngë të marshuesve:

*Në s'u kthefsha, o moj nënë,
ti për mua mos mbaj zi.*

Ku shkojnë? Prapë ka luftë? pyetnin aty-këtu një-rëz që arrinin me një frymë nga rrugët dhe rrugicat. Si s'ka luftë? Atje po nisen. Në luftë, në veri. Gjer në Kosovë dhe më tej akoma, gjer në Berlin. Ashtu? Shiko sa bukur qesh ajo partizania në rreshtin e tretë, shiko.

Mete Aliu seç i thoshte Javerit dhe Teuta që ishte një radhë përpara tyre, i dëgjonte dhe mezi e mbante të geshurën. Sherifi, që ecte përbri saj, ishte krejt i përpire nga kënga. Kjo ishte një këngë e re, që porsa kishte dalë, ose që porsa kishte mbërritur në brigadën e tyre dhe atij i pëlqente shumë. Në s'u kthefsha, o moj nënë, këndonte ai dhe se pse, padashur, i bëhej në sy një pllajë e madhe, atje në veri, e mbuluar me dëborë dhe erë dhe nën të, të shtrirë rresht ishin Mete Aliu, Javeri, Teuta dhe përbri ai vetë, Sherif Goreni dhe përreth, afër e larg, fshatra ku thoshin se flitej gjuha shqipe, por që akoma ishin memecë, dhe memecillëku shtrihej akoma më tej, si kërkë-

llimi i erës, si dëbora larg, mbi krahina dhe shtete që ai s'ua dinte as emrin. Dhe kolona partizane marshonte e marshonte për t'u sjellë zërin...

Shiko sa bukur qesh ajo partizania, dëgjoi ai një zë nga trotuari dhe mbi hapësirën memece të përfytyruar mbi ta iu duk se dëgjoi të qeshurën e Teutës, si një erë të dikurshme.

Ata vazhdonin të ecnin duke kënduar, gjithmonë në drejtimin e veriut dhe dëbora, që ngjante si një delegate atyre viseve, që kishte dalë për t'i pritur para kohe, po sajonte tani një shtresë të bardhë, fare të hollë mbi batanijet e hedhura krahëqafë.

Partizanët këndonin:

Kuq është nga lind e perëndon....

Rreshtat e tyre s'kishin fund. Ata largoheshin gjithmonë dhe, kur njerëzit, pasi i kishin përshëndetur me duar, kthenin kokën për t'i ndjekur me sy, ata shikonin vetëm kularët e bataniujeve gri dhe tytat e pushkëve që dilin sipër tyre. Qielli ishte i ulët dhe tytat e pushkëve, për shkak të perspektivës, dukej sikur merrnin kontakt të drejtpërdrejtë me të.

Tiranë, 1974.

Mj. takimi: peptitet
Sudmilla Pojo

Redaktor Lazar Siliqi
Kopertina nga Safo Marko

opje Format 78x109/32 Stash: 2204-72
Tirazhi 30.000 k —
htyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Spshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë 1975
Shty